



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 12 dhe 13 TETOR 2009

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
12 i 13 OKTOMBRA 2009. GODINE

TETOR – OKTOMBRA
2009

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit, ndërsa bashkëkryesues ishte **Sabri HAMITI**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 68 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se në bazë të rregullave 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit i ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Gjithashtu, ju njoftoj se deri në fillim të seancës plenare nuk kam pranuar asnjë propozim për amendamentimin e rendit të ditës ose propozim për shqyrtim të ndonjë çështjeje urgjente në pajtim me rregullat procedurale.

Fillojmë me pikat e rendit të ditës.
Pika e parë e rendit të ditës:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 30 shtator 2009

Ju njoftoj se Procesverbali dhe Transkripti i seancës plenare të mbajtur më 30 shtator 2009 u janë shpërndarë deputetëve.
Pyes deputetët, nëse kanë vërejtje në këtë procesverbal. Nuk ka. Konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 30 shtator 2009.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta.

Procedimi i pyetjeve do të bëhet sipas kohës së parashtruar dhe numrit rendor të pyetjeve.

Fillojmë me pyetjen e parë. Deputetja Teuta Hadri, pyetje për ministrin Zenun Pajaziti. E ka tërhequr. Mirë, vazhdojmë. Deputetja Kaqusha Jashari, pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi. Deputetja nuk është këtu.
Vazhdojmë, deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Zenun Pajaziti. Deputet, e ke fjalën!

RIZA SMAKA: I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,
Qeveritarë, deputetë të respektuar,
Zoti ministër Pajaziti,
Çfarë është vlerësimi i Ministrisë për Punët e Brendshme, përkatësisht i juve referuar liberalizimit të vizave të qytetarëve të Kosovës në kontekstin e shtetit të së drejtës, antikorruptionit, antitrafikimit, antievazioneve tatimore, antiabuzimeve zyrtare,

antiprostitucionit, rendit dhe sigurisë, ndarjes dhe kontrollimit të ndërsjellë të pushteteve shtetërore dhe të drejtave të njeriut? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra, deputetë,

I nderuar zoti Smaka, më lejoni t'ju jap disa informata që kanë të bëjnë me angazhimet tona për sa i përket në përgjithësi reflektimit tonë në procesin e liberalizimit të vizave.

Siç e dini ju, Kosova ende nuk është përfshirë në këtë proces, është një proces që është shumë i rëndësishëm në kuadër të angazhimeve të BE-së, pra nuk është krejtësisht proces i brendshëm i integriteteve evropiane, por është një proces paralel që, po ashtu, i ka përfshirë me angazhime të mëdha të gjitha shtetet e regjionit dhe shtetet tjera që aderojnë ose kanë interesim për BE-në.

Për shkak se ne nuk kemi qenë të përfshirë në këtë rast, Kosova në mënyrë të njëanshme ka bërë një udhërrëfyes të vetin për sa i përket procesit të liberalizimit të vizave. Ne kemi miratuar në Qeveri një udhërrëfyes dhe kemi përgatitur, po ashtu, një plan të veprimi. Gjatë gjithë këtij procesi jemi konsultuar edhe me Komisionin Evropian dhe me partnerët tanë dhe kemi adaptuar një udhërrëfyes që është bazuar në përvojat e tjera. Pra ende ne nuk kemi arritur në një fazë ku BE të na ketë disa kritere për sa i përket procesit të liberalizimit të vizave, por ne jemi bazuar në praktika të tjera të vendeve tjera dhe njëanshëm kemi filluar zbatimin e kriteve.

Dëshiroj t'ju them që ndër kriteret kryesore që janë në procesin e liberalizimit të vizave, që janë në udhërrëfyesin tonë në planin e veprimit, janë menaxhimi i integruar i kufijve, lufta kundër krimit të organizuar, riatdhesimi ose politikat e migrimit, që është po ashtu një sfidë e rëndësishme, reformat në gjendjen civile dhe në kualitetin e dokumenteve. Pra, janë këto kriteret kryesore që kanë të bëjnë me procesin e liberalizimit të vizave dhe në të cilat Qeveria e Kosovës ka bërë një plan veprimi i cili është kryesisht i adaptuar në bazë të përvojave të tjera dhe kërkesave që zakonisht i ka BE-ja në këtë proces. Sfidat kryesore do të jenë, do të mbetet menaxhimi i integruar i kufirit, ku ne legjislacionin e kemi plotësuar dhe po ashtu varret edhe prej fqinjëve tanë që ky proces të kompletohet bashkërisht, pra zbatimi praktik i këtij procesi.

Do të jenë, po ashtu, politikat e migrimit. Ju siç e dini, kemi një detyrim si Kosovë që të nënshkruajmë marrëveshje për riatdhesim me shtetet e BE-së. Ne kemi tentuar që këtë ta bëjmë njëkohësisht vetëm me BE-në, por ky proces shkon edhe sipas sugjerimit të tyre, ne duhet të negociojmë me secilin shtet veç e veç, janë kritere për ...

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, ke pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: Kam kënaqësinë t'i falënderohem ministrit Pajaziti për angazhimin dhe përgjigjen adekuate dhe të sigurtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi. Deputete, e ke fjalën!

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, Kryetar!

Një pjesë e madhe e ndërmarrjeve shoqërore të cilat i nënshtrohen procesit të privatizimit janë të uzurpuara nga individë të ndryshëm dhe ata nuk largohen nga pronat e shitura nga AKP-ja, më parë nga AKM-ja, deri në një vendim gjyqi, i cili zgjatë me vite. Ndërsa, blerësit e ndërmarrjeve shoqërore pas nënshkrimit formal të kontratës, presin me vite derisa të marrin në posedim pronën.

Zoti zëvendëskryeministër,

Pse AKP-ja nuk i liron nga uzurpatorët patundshmëritë që i nxjerr në shitje, në mënyrë që blerësit e tyre të mos kenë nevojë që me procedurë gjyqësore të kërkojnë lirimin e tyre? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti zëvendëskryeministër, e ke fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Zonja deputete,

Unë e kuptoj shqetësimin e gjithë atyre që nuk mund të shfrytëzojnë pronat e tyre në mënyrë legale, por Qeveria e Kosovës nuk ka kompetencë mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ata i përgjigjen Kuvendit të Republikës dhe është mirë që kryetari i Bordit apo dikush tjetër të japë përgjigje në këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, pyetje shtesë.

MYRVETE PANTINA: Mendoj se nuk ka vend për pyetje shtesë me qenë se përgjigje nuk ka.

KRYETARI: Faleminderit deputete!

Deputetja Donika Kadaj – Bujupi, pyetje për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zotin Idriz Vehapi. Deputete, e ke fjalën. Ministri nuk është këtu.

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Faleminderit, Kryetar!

Duke marrë parasysh që ministri Vehapi, nuk qenka këtu dhe kjo flet për transparencën e Qeverisë ndaj Kuvendit dhe opinionit. Unë do të dëshiroja kësaj pyetje t'i përgjigjet ministri i financave duke marrë parasysh që një pagesë e paligjshme lidhet me nënshkrimin e tij të bërë me natën e vitit të ri, pas mbylljes së thesarit. Prandaj, do të doja që pyetjen ta shtrojnë për ministrin e Financave, nëse është i gatshëm të përgjigjet.

KRYETARI: Nuk është i gatshëm të përgjigjet.

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Atëherë, unë do ta bëj pyetjen publike në opinion, duke marrë parasysh që Qeveria po e neglizhon realisht përgjigjen në pyetje që lidhen me keqpërdorimin e buxhetit të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Gjylnaze Sylja, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete, Kryeministri nuk është këtu, doni ta bëni pyetjen.

Regjia, fjalën deputetes Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, Kryetar!

Edhe një vit e gjysmë pas shpalljes së pavarësisë, ekonomia e Kosovës jo vetëm që nuk është përmirësuar, por është keqësuar. Treguesit ekonomikë flasin se Kosova është më e pazhvilluara në rajonin e Ballkanit, ndërsa sipas studimeve të Bankës Botërore - 45% të popullsisë jetojnë në varfëri dhe 18% në varfëri të skajshme. Ndryshimi i gjendjes ekonomike është domosdoshmëri për përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës. Prandaj, pyes Kryeministrin Hashim Thaçi, pse Qeveria e Kosovës edhe një vit e gjysmë pas pavarësisë nuk ka strategji për zhvillimin e Kosovës, kur do ta hartojë këtë strategji, meqë Kryeministri ka deklaruar se viti 2009 është vit i pavarësisë ekonomike dhe i qëndrueshmërisë ekonomike?

Zoti Kryetar, mund të përgjigjet edhe zëvendëskryeministri, në qoftë se është i gatshëm.

KRYETARI: Zoti zëvendëskryeministër, a jeni të gatshëm? Jo, nuk janë të gatshëm. Deputetja Nerxhivane Dauti, pyetje për zëvendëskryeministrin Ramë Masnaj.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, Kryetar!

Ligji për detyrimet është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2004, nuk është nënshkruar nga PSSP-ja dhe është kthyer në rishqyrtim te propozuesi. Në Qeverinë e Kosovës është formuar grupi i punës për rishqyrtimin dhe finalizimin e tekstit të këtij projektligji. Vlen të theksohet se ky ligj është me rëndësi të veçantë. Miratimi dhe zbatimi i tij do të krijojnë kushte që Kosova të shkëputet nga legjislacioni i sistemit të kaluar dhe që raportet juridiko-civile të subjekteve të së drejtës në Kosovë të rregullohen me rregullativë juridike nga fusha e detyrimeve që bazohet në standardet ndërkombëtare.

Prandaj, duke pasur parasysh këtë që u theksua, për zëvendëskryeministrin parashtroj këtë pyetje: - Ku qëndrojnë shkaqet e vonësës që Ligji për detyrimet nuk procedohet në Kuvendin e Kosovës, për miratim.

KRYETARI: Zëvendëskryeministër, e ke fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete,

Ligji për detyrimet është miratuar më datën 26 të muajit korrik të vitit 2004, siç e thatë, ndërsa më 6 gusht 2004 është dërguar për shpallje, atëherë te Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së. PSSP-ja nuk e kishte shpallur. Pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, më 15 qershor të vitit 2008, gjithsej 27 ligje mbeten të pashpallura nga PSSP-ja dhe ato kthehen, në mesin e tyre edhe Ligji për detyrimet.

Prej 27 ligjeve të pashpallura, Qeveria ka kërkuar nga Kuvendi që t'i kthehen në rihartim gjithsej 10 ligje, prej tyre prapë edhe Ligji për detyrimet. Ligji për detyrimet, me vendim të Kuvendit, me datën 30 korrik 2008 është kthyer për rihartim, respektivisht për harmonizim, plotësim në Qeveri. Aktualisht, në grupin për rishqyrtimin, për plotësimin e këtij ligji punohet në kuptim të harmonizimit sa i përket harmonizimit me Kushtetutën, por bëhet fjalë edhe për disa harmonizime përmbajtjesore. Sipas agjendës legjislative të Qeverisë, ai ligj duhet të procedohet dhe do të procedohet në Kuvend në muajin dhjetor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër Ramë Manaj!

Deputete, ke pyetje shtesë? Faleminderit!

Vazhdojmë, deputetja Qamile Morina, pyetje për ministrin Alush Gashi. Deputete, e ke fjalën!

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Argumenti kryesor që përdorni për vlerësimin e suksesit tuaj, si Ministri e Shëndetësisë, është rritja e buxhetit për barëra 100%, që me rishikim të buxhetit është vlere mbi 20 milionë euro dhe furnizimi mbi 80%. Zoti ministër, besoj që jeni i vetëdijshëm që qytetarët e Republikës së Kosovës po shpenzojnë sasi enorme të parave për barëra dhe material shpenzues nga lista esenciale. Këtë po e vërtetojnë çdo ditë pacientët tanë, personeli mjekësor, mediat si dhe Raporti i Zyrës së Auditimit të Përgjithshëm dhe ky është realiteti jonë që çdo ditë sa vjen e rëndohet.

Zoti ministër, pyetja për ju. Duke pasur parasysh që ky është një problem kronik, a keni ndonjë analizë më të thellë të kësaj situatë dhe program të zhvillimit të planeve për përmirësimin e situatës në sektorin farmaceutik? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër Gashi, fjalën e keni!

MINISTRI ALUSH GASHI: I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Zëvendëskryeministër, ministra dhe deputetë,

E nderuara zonja deputete,

Ju faleminderit për mbështetje dhe për pyetje parlamentare për një çështje që është një nga prioritetet e Qeverisë së vendit dhe që ka një mbështetje të fuqishme në Kuvendin e Republikës. Ashtu siç thatë ju, ne kemi arritur të gjithë së bashku që nga fillimi i mandatit nga 8 milionë të bëjmë një ngritje për barëra dhe material shpenzues në 20 milionë. Për përgjigje të sotshme unë ju ofroj të dhënat e datës 9 tetor të vitit 2009, ku lista esenciale prej 404 barërave, në mesatare për këtë muaj është e plotësuar 82%. Këtë mund t'ju argumentojmë, sepse 3 muaj kemi arritur ta instalojmë monitorimin elektronik. Çka do të thotë kjo? Këto barna dhe material shpenzues që hyjnë në depon qendrore, ato regjistrohen dhe dalja nga depoja qendrore për në QKUK është hyrje në depo, kështu që aktualisht më nuk ka tregime të ndryshme për një çështje.

Ne pajtohemi se qytetarët e vendit japin barna, japin të holla për barna, sepse me analizën për ligjin, për koston financiare, për Ligjin për sigurime shëndetësore, të cilin ne e kemi kryer dhe e afrojmë në Kuvend, ne kemi paraparë një ngritje graduale të këtij buxheti dhe ekspertët argumentojnë se lista esenciale e vendit tonë kërkon diku mbi 40 milionë euro. Të ndërgjegjshëm për këtë që ju e thoni se qytetarët blejnë, ne jemi të kënaqur se në këtë fazë kemi arritur këtë listë e cila nuk është më e pasura në rajon, kjo listë ka nevojë të pasurohet që për barna të arrijnë 79%, për material shpenzues 84%, që si mesatare del diku 82%. Të vetëdijshëm se nevojitet të bëhet më shumë, ne kemi filluar test projektin e dhënies falas të barnave për gjithë pensionistët e vendit tonë dhe këtë test e kemi filluar në Prishtinë, do ta vazhdojmë deri në fund të vitit dhe nga pensionistët vetëm kërkojmë që të shkojnë te mjeku familjar për ta marrë një recetë. Ju e dini që vendi ynë s'ka pas receta deri sa kemi filluar punën së bashku dhe jam i bindur se me partneritetin publiko-privat që ua ofrojmë të gjitha farmacive të vendit që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputete, keni pyetje shtesë?

QAMILE MORINA: Zoti ministër, në mes të deklaratave tuaja dhe realitetit është një hendek shumë i madh dhe nga ajo që ju thoni, e kam të qartë që kurrë nuk keni të re në rregullimin e sistemit farmaceutik. Unë dua t'ju rikujtoj, sipas rregullës 2005/15 përgjegjësi e juaja është të përcillni situatën në shëndetësi dhe të zbatoni masat adekuate për të parandaluar dhe kontrolluar problemet në lëmin e shëndetësisë, por nëse ju mungesën e barnave nuk e identifikoni si problem, atëherë mundësia për ta zgjedhur nuk ekziston fare. Dhe, unë mendoj që përgjegjësia do të mbetet e juaj, kurse pasojat dhe efektet negative do të barten tek pacientët tanë dhe te punonjësit shëndetësorë.

KRYETARI: Vazhdo, ministër!

MINISTRI ALUSH GASHI: Ju falënderoj, zonja deputete! Jam shumë i ngazëllyer me angazhimin tuaj. Unë e di që ju keni obligime me orar të plotë si deputete, ju keni obligime në punë me orar të plotë si klinikiste, ju keni obligime me orar të plotë si pedagoge, ju keni obligime në punën e praksës private, por megjithatë ju ftoj që të vini t'i konfirmimi të dhënat në Ministri të Shëndetësisë. Jam i gatshëm që t'ua konfirmoj para komisionit parlamentar dhe unë e kuptoj shqetësimin tuaj kur nga reparti, ku ju punoni, keni deklaruar se nuk ekziston asnjë barë. Atë ditë ua kemi konfirmuar që nga 20 të mundshëm 14 i keni pasur në vend. Unë e kuptoj se ka filluar fushata, e uroj një fushatë të suksesshme dhe të begatshme dhe ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë. Deputetja Drita Maliqi, pyetje për ministrin Sadri Ferati.

DRITA MALIQI: Faleminderit! Zoti ministër, qytetarëve shqiptarë që kanë shtëpitë në veri të Mitrovicës dhe nuk i kanë shitur, nuk u paguhet qiraja nga Qeveria, ndërsa ata që i kanë shitur, Qeveria ua kompenson qiranë. Si e komentoni këtë fakt, zoti ministër?

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI SADRI FERATI: Faleminderit!

I nderuari Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar Kabinet qeveritarë,

E nderuara deputete,

Unë po besoj se interesimi i juaj lidhet me vendimin e Qeverisë të datës 18 shkurt 2009 me numër 04/56, me të cilën vendim Qeveria e Republikës së Kosovës ndan një shumë prej 360 mijë euro për familjet e zhvendosura në Mitrovicë, për secilin prej tyre nga 100 euro. Dhe, shpreh fillimisht edhe kënaqësinë time që me këtë rast u është ndihmuar qytetarëve të Mitrovicës që pa fajin e tyre janë të detyruar të paguajnë qira në qytetin e tyre në pamundësi që të kthehen në pronën e tyre.

Ndërsa, sa i përket gjithë rrjedhave, unë nuk kam shumë informacione, por kam dëshiruar që të ndihmoj në këtë rast, kam siguruar vendimin e Qeverisë dhe në pikën tre të njëjtit vendim shkruan se për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kuvendi Komunal në Mitrovicë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Se a ka Ministria ndonjë raport përfundimtar në lidhje me këtë që do të kishte mund t'i plotësojë interesimet e juaja, nuk e di, por unë kaq informacione kisha.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputete, ke pyetje shtesë? Faleminderit! Vazhdojmë, deputeti Driton Tali, pyetje për ministren, zonjën Justina Shiroka Pula. Deputet, e ke fjalën. Ministria nuk qenka këtu, po pyetjen mund ta bëni.

DRITON TALI: Pyetja është për Kryeministrin dhe zonjën ministre, po si shoh, asnjëri nuk është këtu, atëherë po e lë për herën tjetër.

KRYETARI: Mirë, faleminderit!

Deputeti Riza Smaka, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputet, Kryeministri nuk është këtu, doni ta bëni pyetjen?

RIZA SMAKA: Kryeministri Thaçi e dëgjon pyetjen nëpërmjet mediave, prandaj do ta shfrytëzoj këtë oportunitet.

KRYETARI: Shfrytëzoje!

RIZA SMAKA: Zotëri Kryetar,
Qeveritarë dhe deputetë të nderuar,

Në strukturën organizative të Qeverisë së Kosovës nuk ekziston Ministria për Diasporën e Kosovës! Sikundër dihet, vendi ynë ka një numër të madh të mërgimtarëve (imigrantë) të cilët për (kohësisht) qëndrojnë në diasporë. Nga shkaqe historike por edhe politike tejet të pavolitshme, veçanërisht deri në vitin 1999, mërgimtarë kosovarë ishin me bazë të ndjeshme edhe ndiheshin jetim, sepse ishin pa shtet, e së andejmi të pa përkrahje institucionale legjitime. Ndërkaq, pas vitit të theksuar më parë e aktualisht mërgimtarët tanë në diasporë tanimë pa shkak të arsyeshem, pos sensit se e kanë shtetin e vetë, gjithnjë janë të papërkrahje institucionale të mirëfilltë, madje janë të neglizhuar e në raste jo të rralla edhe të keqtrajtuar...

KRYETARI: Faleminderit, deputet!
Përgjigjet zëvendëskryeministri Kuçi.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

I nderuari deputet Smaka,

Me miratimin e Ligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës, i cili është në procedurë të miratimit në Kuvendin e Republikës, organizimi dhe funksionimi i Qeverisë së Republikës do të përcaktohet me Rregulloren për strukturimin dhe organizimin e Qeverisë. Megjithatë, Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar thellë për një përkujdesje më të mirë dhe më të qëndrueshme për diasporën. Kjo është reflektuar edhe në Programin e Punës së Qeverisë së Kosovës për vitin 2008 – 2011 me pikën 4.8, ku janë parashtruar një varg masash të cilat duhet të ndërmerren dhe janë ndërmarrë.

Hartimi i Projektligjit për diasporën dhe harmonizimi i plotë me ligje të tjera të Republikës së Kosovës, krijimi i ambasadave, konsullatave, shoqatave për mbrojtjen e kosovarëve jashtë vendit, përpjekjet diplomatike të Qeverisë së Kosovës për mbrojtjen e shtetasve tonë jashtë vendit, ngritja dhe bashkimi i komunitetit kosovarë jashtë vendit, krijimi i lehtësirave për nxjerrjen e dokumenteve të udhëtimit, ruajtja dhe kultivimi i identitetit kulturor, grumbullimi i të dhënave për diasporën tonë sikurse janë vendndodhja e tyre, lidhja e tyre me Kosovën, përgatitjet e tyre profesionale, biznesi dhe çështje të tjera, rregullimi i së drejtës së informimi i tyre me zhvillime në Kosovë dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale.

Në këtë drejtim, Qeveria e Republikës së Kosovës në funksion të realizimit të programit të saj ka paraparë në strategjinë legislative të vitit 2009 Projektligjin për mërgatën e Kosovës, i cili është aprovuar në mbledhjen e Qeverisë më 10 shtator të këtij viti dhe i njëjti është në procedurë për miratim në Kuvendin e Republikës.

Qëllimi i këtij Projektligji është që në mërgatën e Kosovës të ruhet dhe të zhvillohet identiteti i tyre, gjuha, kultura dhe krijimi i mundësive për rritje dhe bashkëpunim të ndërsjellë në mes të Kosovës, vendit të tyre, si në fushat kulturore, arsimore, shkencore, ekonomike dhe fusha të tjera. Gjithashtu, në kuadër të Qeverisë themelohet dhe funksionon Agjencia për Mërgatën e Kosovës dhe themelimi i qendrave kulturore të Kosovës jashtë vendit. Ky ligj do të zbatohet për gjithë mërgatën e Kosovës dhe nënkupton një lidhje të ngushtë juridike në mes të shtetit të Kosovës dhe secilit person veç e veç që jeton jashtë vendi.

Natyrisht që ne kemi bërë edhe përpjekje tjera diplomatike të Qeverisë së Kosovës, siç janë krijimi i ambasadave dhe konsullatave në vendet ku kryesisht janë të koncentruar shtetasit e Republikës së Kosovës dhe qëllimi i tyre është të mbrohet identiteti i tyre edhe njerëzor, edhe shtetëror dhe kombëtar.

Natyrisht, në këtë drejtim kemi bërë vitin e kaluar dhe këtë vit lehtësirë në nxjerrjen e dokumenteve të udhëtimit gjatë mandatit të kësaj Qeverie dhe ka qenë një ndër prioritetet tona ku është angazhuar Ministria e Punëve të Brendshme që gjatë pushimeve verore të punohet edhe me orar që nga ora 8,00 deri në orën 19,00 dhe besojmë që këtë vit kemi arritur që t'u dalim në ndihmë qytetarëve tonë që jetojnë jashtë vendit.

Ruajtja dhe kultivimi i identitetit kulturor është pjesë e punës së Qeverisë që kemi ndërmarrë një varg masash, duke përfshirë edhe rolin e informimit të mërgimtarëve tanë jashtë vendit dhe duke rregulluar apo duke marr shumë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër!
Deputet, ke pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: I falënderohem zëvendëskryeministrit, zotëri Kuçit, për përgjigjen e përkushtuar. Do të isha angazhuar që përpos aktit ligjor, me të cilin do të konstituohej edhe Ministria në fjalë, që edhe me aktin nënligjor siç është, po e zëmë, ndër të tjera që pagesa gjobë e mërgimtarëve tanë të cilët i kanë automjetet e veta të siguruara, i paguajnë sigurimet e veta në shtetet, bie fjala, në Mbretërinë e Bashkuar, në Holandë e tjera, kur vinë në shtëpinë e vet, duhet të paguajnë prapë taksa gjobë. Kjo është e patolerueshme, e paimagjinueshme edhe absolutisht në asnjë shtet në Evropë nuk aplikohet kjo formë e dënimit të qytetarëve tanë që dhanë aq shumë kontribut e që vazhdojnë të japin aq shumë kontribute, që kur të vinë në shtëpinë e vet paguajnë taksë dënuese. Kjo mund të bëhet me një akt nënligjor. Unë i apeloj Qeverisë në këtë rast nëpërmjet zotëri Kuçit, që menjëherë ta aprovojë këtë dispozitë që s'ka...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju lutem, respektoni rregullat e pyetjeve dhe përgjigjeve. Urdhëro, zoti zëvendëskryeministër Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit! Besoj që profesor Smaka e ngriti edhe një çështje që ka të bëjë me pagesën për sigurimet kufitare. Natyrisht që këtu ka qenë një problem me kartonin e gjelbër, që nuk është njohur ende për shkak të rrethanave politike që i ka Kosova, por ne kemi vënë kontakte me shoqatën e sigurimeve dhe kemi kërkuar që minimum 30 deri 50% të zbritet ajo taksë që momentalisht ekziston.

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë. Deputetja, Donika Kadaj - Bujupi, pyetje për Kryeministrin, zotin Thaçi. Deputete, doni ta parashtroni pyetjen?

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Kryetar, duke marrë parasysh që Kryeministri Thaçi nuk është këtu, unë do ta lë pyetjen time për seancën e radhës. Besoj që nuk do të hiqet nga rendi i ditës qysh më ka ndodh më herët, po do të jetë këtu edhe Kryeministri edhe pyetja. Faleminderit!

KRYETARI: Do të thotë, edhe pyetjet tjera janë të njëjta. Mirë, faleminderit!
Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Zenun Pajaziti. Deputet, e ke fjalën!

RIZA SMAKA: E tërheq këtë pyetje, me qenë se përgjigjen tashmë e kam marrë.

KRYETARI: Mirë, faleminderit!
Deputeti, Riza Smaka, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

RIZA SMAKA: Zotëri Kryetar, zotëri ministër Shala,
Nga të dhënat e publikuara në media, si dhe nga konkludimet e Komisionit për Buxhet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, auditimet e menaxhimeve financiare praktikisht përfundojnë në konstatime, në rekomandime, në preferenca të mangësive, të dështimeve e të abuzimeve financiare më se të shumta dhe më se të ndryshme. Ju lutem, do të thotë, përfundojnë në konkludime apo në preferenca, në rekomandime. Pyetja akcentohet në këtë: - Pse nuk aplikohen këto, pse nuk sendërtohen ashtu siç do të duhej në procedurë, bije fjala, penale. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuari zoti Kryetar i Parlamentit,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,
I nderuari zoti deputet Smaka,

Në qoftë se analizohen raportet e auditimit të vitit 2008 me vitet paraprake që nuk është mbase një ... për neve, megjithatë ka një përmirësim të dukshëm në raportet e auditimit. Raportet e vitit 2008 për ministrinë e Kosovës japin një përmirësim të dukshëm, tri ministri përkatësisht tri njësi buxhetore janë me auditim të pakualifikuar, përkatësisht në shkallën më të lartë të vlerësimit pozitiv, katra të tjera janë të pakualifikuara me theks të çështjes që megjithatë janë prapë janë të pakualifikuara, do me thënë kemi shtatë agjencione buxhetore që kanë shkallën më të lartë të vlerësimit për rregullsinë e tyre financiare dhe kjo konsideroj duhet të vlerësohet si gjëja më pozitive që ka mund t'i ndodh shoqërisë kosovare.

Natyrish, nuk duhet të jemi të vetëkënaqur, si do që të jetë, rekomandimet në pyetjen e juaj rekomandimet e Auditorit Gjeneral janë rekomandime për të gjitha institucionet e Kosovës dhe për institucionet ekzekutive dhe ato zbatuese të forcës dhe të ligjit.

Sipas raportit të Njesisë Harmonizuese Qendrore, e cila funksionon pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, krahasuar me vitin paraprak, viti 2008 ka një zbatueshmëri të rekomandimeve të Auditorit Gjeneral për 17% më shumë se sa një vit paraprak dhe kjo ngritje e zbatueshmërisë së rekomandimeve tregon për një gatishmëri të institucioneve të Kosovës për të aprovuar disa nga rekomandimet e nevojshme që janë në funksion dhe në kompetenca të ministrave, përkatësisht të udhëheqësve të agjencioneve buxhetore.

Rekomandimet tjera që i përkasin eventualisht shkeljeve materiale, ato janë institucionet zbatuese, përkatësisht prokuroritë dhe njësitë hetimore të cilat do të duhej të merrnin veprime dhe detyra të duhura ose udhëheqësit e njësive që duhet të fillojnë procedura. Unë, natyrish, përgëzoj çdo iniciativë të çfarëdo institucioni, duke përfshirë edhe përgjegjësit kryesor të institucioneve që të marrin këtë guxim dhe të veprojnë konform ligjit dhe konform zbatimeve ku nuk është agjencioni buxhetor prokurori. Ato institucione të cilat kanë argumente të mjaftueshme, besoj që do ta kryejnë punën e vetë sot apo nesër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!
Deputet, ke pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: Në përgjigje që e respektoj përgjigjen edhe personalitetin e zotit Shala, del se 17% sivjet më mirë se vjet, a nëse e marrim vjet në kushte më të volitshme se ka qenë 17%, del diku 34%, ku është 100/100, kjo është një. E dyta, është fjala të shpresa, besojmë se unë e di se Ministria nuk është ajo, po është ajo që do të duhej së paku zyrtarisht në emrin e Qeverisë t'i përcjell të gjitha këto defekte që konstaton auditori në prokurori publike. Kjo do të ishte punë edhe mendoj që duhet të bëhet, me qenë se veç nuk është bërë, që të mos lehet, se kjo është punë e prokurorisë, kjo është e gjyqësorit që i ka 360 mijë lëndë të paprekura. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!
Zoti ministër, ke përgjigje, edhe pse kontrolli është i Parlamentit jo i Ministrisë së Financave.
Vazhdojmë, deputetja Drita Maliqi, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete, doni ta bëni pyetjen?

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Pyes zëvendëskryeministrat, në qoftë se kanë mundësi të përgjigjen, me arsyetimin se kjo pyetje ka më se 6 muaj që është parashtruar, kështu që qytetarët të veriut të Mitrovicës, qytetarët shqiptarë presin përgjigje me muaj të tërë. Arsyetimi është ky, kërkoj që nëse kanë mundësi zëvendëskryeministrat, sepse mungesa e Kryeministrit ka shty që kjo çështje të prolongohet gjer më tani.

KRYETARI: Ju faleminderit! Zëvendëskryeministër, a jeni të gatshëm të përgjigjeni? A pyetjen, urdhëro parashtroje pyetjen, veç pyetja është bërë me 7. 10.2009.

DRITA MALIQI: Mirë ju faleminderit, zoti Kryetar!
Për njoftim kjo pyetje është përsëritur, është radha e dytë. Atëherë, më lejoni të nderuara zëvendëskryeministra, pyetja është kjo: - Çfarë ka ndërmarrë Qeveria e Republikës së

Kosovës për lirimin e 723 banesave të qytetarëve shqiptarë në Veri të Mitrovicës, të cilat padrejtësisht shfrytëzohen nga uzurpuesit dhe nuk marrin kurrfarë kompensimi për pronën e tyre? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete! Zëvendëskryeministri Kuçi përgjigjet.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, deputete Maliqi për pyetjen! Ne kemi qenë të përkushtuar që të zhvillojmë aktivitetin në tërë territorin e Republikës së Kosovës, në veçanti edhe në Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe në pjesën ku territori ynë ndoshta ka qenë jo në kuptimin e sovranitetit të plotë plotësisht i menaxhuar. Për rasti konkret që e thatë ju, ne kemi një filozofi politike që secili qytetarë të ketë të drejtën e shfrytëzimit të pronës së vetë kudo që gjendet ajo, natyrisht, pa dallime etnike. Në këtë drejtim ne kemi ngritur këtë çështje disa herë me përfaqësuesit ndërkombëtarë që veprojnë në Kosovë, por natyrisht kemi marrë edhe hapa konkretë duke ndërtuar disa shtëpi nga Fondi i Qeverisë së Republikës së Kosovës në Veriun e Mitrovicës, respektivisht në Kroin e Vitakut.

Në anën tjetër, Qeveria e Republikës së Kosovës për rreth 500 familje ka ndarë pagesën e qirasë për vitin 2009 dhe besoj të gjithë ata marrin nga 300 euro qira në muaj për pjesën që nuk mundë ta shfrytëzojnë banesën në anën tjetër. Ne jemi të bindur që procesi ndoshta nuk shkon me dinamikën çfarë ne kemi dëshirë, dinamikë të përshpejtuar, por secilit qytetar do t'i krijohen kushte që të kthehet në pronën dhe në shtëpitë e tyre dhe t'i shfrytëzojë ato.

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, ke pyetje shtesë? Faleminderit, deputete! Pyetja e fundit për sot, deputeti Riza Smaka pyetje për zëvendëskryeministrat Hajredin Kuçi ose Ramë Manaj. Deputet, mund ta parashtroi pyetjen.

RIZA SMAKA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar zotëri zëvendëskryeministra Kuçi, Manaj.

Gjatë periudhës 1998 nën forcat paramilitare serbomëdha, krahasuar me qytete tjera, në Pejë, ndër të tjera, patën shkaktuar dëmtimet materiale më të mëdha. Së andejmi, suazat e resurseve qeveritare do të duhej që pikërisht në Pejë të ndërtoheshin objekte të destinacionit social, për çka ju adresohem me këtë mocion, do të thotë, pse nuk është bërë një punë së pakut në këtë drejtim që do të ishte në favor të lehtësimit të dëmtimeve jashtëzakonisht të rënda. Janë evidencat në Pejë, janë bërë shkatërrimet materiale më të mëdha në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Përgjigjet zëvendëskryeministri Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti deputet Smaka!

Ne kemi qenë të interesuar që të bëjmë ndërtimin e një objekti social në komunën e Pejës, por fillimisht kemi pasur problem për ta gjetur pronën. Më pastaj komuna e ka rregulluar dhe për vitin 2010 do të jetë gjithsesi një prej objekteve sociale që do të ndërtohet edhe në komunën e Pejës.

KRYETARI: Faleminderit! Deputet, ke pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: I nderuar zoti Kuçi,
Shpresoj që do të realizohet ky premtim.

KRYETARI: Faleminderit! Më falni që unë e kam kaluar edhe një pyetje, se u bënë shumë, ndoshta. Përsëri deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Valton Beqiri. Kjo është pyetja e fundit për sot.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti Kryetar,
Zoti ministër Beqiri,

Në vendin tonë po thuaj se papengueshëm madje edhe në emitimet publike tekste me shprehje irrituese të kundërta me norma gjuhësore, standarde të shkruar dhe shfaqen telegrame të niveleve më të ulëta me përmbajtje antimorale, muzika e ashtuquajtur tallava dhe telenovelat me përmbajtje edhe mesazhe kolizive etike, ndër të tjera sfidojnë identitetin e mirëfilltë, degradojnë dhe degjenerojnë esencën e vlerave të traditës së afirmuar dhe të mirënjohur për të mirë edhe jashtë dimensioneve nacionale.

Zotëri ministër, ju lutem, ju pyes, Ministria i ka disa ingerenca, i ka disa kompetenca dhe juridiksione që do të mund të bënte shumëçka në disfavor të këtyre dukurive. Pse nuk është ndërmarrë pothuaj se asgjë deri në ditën e sotme? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën, unë nuk di pse është kjo lëndë e jotja. Urdhëro!

MINISTRI VALTON BEQIRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputetë Smaka,

Para së gjithash, kam një vërejtje që disa herë pyetjet e adresuara ndaj meje, mbiemri im është me “q” të butë, ta kemi para sysh, meqë jeni ithtar i normave gjuhësore.

T’ju them se pavarësia e mediave është e pakontestueshme, pra Ministria e Kulturës nuk ka të drejtë as ingerencë në programet, në politikat e tyre programore. Prandaj, politikat programore përgjithësisht orientohen në bazë të ekonomisë të tregut dhe ata janë të pavarur dhe Ministria e Kulturës absolutisht nuk ka të drejtë të ndikojë dhe interferojë në punën e tyre. Por, megjithatë, në të gjitha tryezat dhe debatet që janë organizuar nëpërmes shoqatave të ndryshme të intelektualëve, është konstatuar se lufta më e mirë kundër jo vlerave është promovimi i vlerave, ndihmesa dhe përkrahja e organizimeve që kanë vlerë artistike. Në këtë kontest, Ministria e Kulturës, pra gjithmonë i ka përkrahur të gjitha festivalet. Po e përsëris edhe një herë, të gjitha festivalet më të rëndësishme kulturore ku promovohen vlerat tona artistike. Prandaj, ne do të vazhdojmë edhe më tutje me këtë punë, në mënyrë që të bëjmë një balancë në mes të prezantimit të vlerave dhe ato që nuk janë vlera. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr anëtar i Kryesisë, zoti Sabri Hamiti

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministër! Zoti deputet, a ke vërejtje apo pyetje të shkurtër.

RIZA SMAKA: Ndjesë për aplikimin “q” në vend të “ç”, kjo tani e tutje do të përfillet me respekt, apo jo. Megjithatë, unë mendoj që shoqëria politike kosovare nuk mund të jetë indiferente dhe indolente ndaj dukurive negative dhe megjithatë me Ligjin për Qeverinë, përkatësisht dokumentet që e rregullojnë statusin e Ministrisë për Kulturë, ekzistojnë autorizime së paku për emisionet publike edhe për publikacionet publike. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organizimin sindikal

Në bazë të rregullës 35.1 të Rregullores së Punës janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij Projektligji. Ftoj ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rashiq, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të paraqesë Projektligjin. Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine presedavajući!

Gospodo zamenici premijera,

Kolege ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Kao što je već rečeno, mi imamo Nacrt zakona o sindikalnom organizovanju na Kosovu i kao što u svim drugim normama pokušavamo da stignemo do jednog nivoa koji bi bio zadovoljavajući na svim aspektima, tako u ovom delu sindikalnog organiovanja smo pokušali da postavimo neke demokratske norme za jedno savaremeno organizovanje.

Vi znate i sami da smo mi na samom početku mandata Vlade pokrenuli inicijativu za ponovno, za ponovni rad ovog Saveta za socijalno-ekonomsku ravnopravnost, Saveta za socijalno-ekonomsku podršku, tako da na tome i dalje radimo i biće još verovatno nekih konkretnijih kokraka ubuduće, ali mislim da je ovo jedan od onih koraka koje moramo preduzeti da bi cela ta naša aktivnost mogla da bude onako u skladu sa svim zakonskim normama i jednostavo da napravimo tu zakonsku bazu za dalje organizovanje svih sindikata i svih ljudi unutar tih sindikata za njihovu samu dobrobit.

Nacrt zakona je garancija slobode i prava zaposlenih na Kosovu da mogu biti organizovani u sindikatima prema međunarodnim standardima, a pogotovo utvrdjivanje uslova i kriterijumima za formiranje sindikata, njihovo registrovanje, odnos sindikata sa Vladom, zaštita ekonomskog prava, profesionalnog i socijalnog prava za sve zaposlene.

Najbitnije tačke koje će ovaj sam zakon da utvrdi, to je da se utvrdi stepen prava radnika da formiraju i da imaju mogućsot udruživanja u sindikate prema njihovom izboru, da budu preduzete sve neophodne mere i potrebe da radnici mogu slobodno da deluju u okviru sindikata, pogotovo u okviru onih sindikata koji su ravnopravni i bez diskriminacije. Da se formiraju uslovi za optimalni rad sindikata i da se poštuju zakonske odredbe na Kosovu. To je, kao što sam rekao, to su osnovna načela ovog zakona. On bi stvarno trebao da obezbedi jednu ravnopravnost. Znam da će primedbe nekih od vas sigurno biti vezane za osnovni zkon, to je Zakon o radu i ja mogu samo da kažem da mi intenzivno radimo na tome i to najviše sa Svetskokm bankom, koja je jedna od glavnih okosnica, koja je jedna od glavnih sistema koje podržavaju ovaj zakon i ja mislim da ćemo u finalnu fazu ući ovog meseca. Mislim da ćemo zakon imati kompletan onako prema međunarodnim standardima. Moram da napomenem da smo sa Svetskom bankom imali nesuglasnice, kada kažem ensuglasnice, mislim na razmenu mišljenja o tome kakav bi zakon treba da bude i mislim da smo skkoro uskladili te naše stavove i zakon bi trebao tehnički da bude vrlo brzo pripremljen.

Pored toga, moram da naglasim da je Svetska banka takodje jedan od sponzora tog zakona, odnosno da jedan deo finansijskih sredstava koji je predvidjen u projektu za održivo zapošljavanje koje vodi Svetska banka u iznosu od 60 miliona evra, jedan deo ofinansira sama Svetska banka. Prema tome, mislim da smo pri kraju utvrđivanja tih naših zajedničkih koraka, zajedničkih pravaca delovanja i to što ovaj Zakon o sindikalnoj organizovanju ide pre Zakona o radu, ne znači da Zakon o radu takodje neće biti uskoro tehnički završen, odnosno pripremljen za dalju... Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Në emër të komisionit funksional, a ka dikush? Sadik Idriz e ka fjalën!

SADIK IDRIZ: Hvala predsedavajući!

Funkcionalna komisija je razmatrala ovaj Nacrt zakona i nema jedinstven stav oko toga dali ovaj Nacrt zakona treba da ide prije nego što će doći na red zakon, bazični Zakon o radu i to ostaje pravo poslaničkih grupa da se oko toga opredeli. Podeljeno je mišljenje, neki smatraju da ovaj zakon bi trebao da sačeka Zakon o radu i da nakon toga, odnosno ili u paketu sa tim zakonom, sa Zakonom o štrajku i još nekim drugim zakonima koji su jedan paket, set zakona koji regulišu ovu materiju. Medjutim, ponudjeni Nacrt zakona je kvalitetetan i mislim da uz neke sitnije ispravke i korekcije može da prodje zato što je usaglašen sa Evropskim zakonodavstvom. Zapravo Evropsko zakonodavstvo ne reguliše ovu materiju, jer je ostavljeno nacionalnom zakonodavstvu da ponaosob reguliše ovu materiju. Takodje su date one osnovne stvari oko organizovanja, sindikalnog organizovanja, upis u registar sindikata i tako dalje, znači materija čisto tehničke prirode. Medjutim, ovaj zakon je svakako povezan sa Zakonom o radu i ukoliko Zakon o radu zaista stigne u neko dogledno vreme, mislim da to ne bi bila smetnja.

Medjutim, ako ovaj zakon bude prošao kompletnu proceduru, a čekamo još nekoliko, možda godinu ili duže na Zakon o radu, i ovaj zakon neće imati nekog velikog smisla da bude bez onog bazičnog osnovnog Zakona o radu. U svakom slučaju, Komisija će, ukoliko prodje prvo čitanje, raditi na kvalitetnijem pristupu ovom zakonu, da ćemo dati svoj doprinos i da će komisija sigurno raditi na poboljšavanju ovog Nacrt zakona. Ostaje da svaka parlamentarna grupa odluči o tome da li će podržati ovaj zakon bez Zakon o radu ili ćemo čekati na taj zakon. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të grupeve parlamentare, meqë komisionet tjera deri tash nuk janë paraqitur, Mimoza Ahmetaj në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

MIMOZA AHMETAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra dhe deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar Projektligjin për organizimin sindikal. Në parim ne e përkrahim ligjin duke marrë parasysh rëndësinë që e ka në organizimin sindikal. Një gjë e tillë deri më tani në Kosovë ka qenë e rregulluar nëpërmjet Rregullores së UNMIK-ut 17/2001, prandaj e shohim të arsyeshme që ta kemi një ligj të tillë.

Jemi të vetëdijshëm për rëndësinë që Ligji e ka dhe për problemet si dhe mangësinë që na e shkakton mungesa e Ligjit të punës. Do të ndërlihdesh edhe me fjalën që ministri më

parë e tha, që shumë shpejt do ta kemi Ligjin bazë të punës në Kuvend dhe duke marrë parasysh këtë argument, ju ftoj që Ligjin ta votoni. Aq më parë, desha të them edhe një argument tjetër që Konfederata e Sindikatave të Kosovës, e cila në vetvete ngërthen diku rreth 18 sindikata, deri më tani nuk ka pasur Ligj për një organizim sindikal të tillë. Ardhja e këtij ligji, si dhe miratimi i Ligjit, kalimi i ligjit në Parlament do t'i hapëte rrugë organizimit sindikal në mënyrë të ligjshme. Prandaj, e përkrahim si Grup Parlamentar ligjin në fjalë.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit të LDK-së, deputetja Nurishahe Hulaj.

NURISHAHE HULAJ: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për organizimin sindikal është një ligj shumë i rëndësishëm, por lidhshmëria dhe zbatueshmëria e këtij projektligji është direkt e lidhur edhe me Ligjin e punës.

Ne anëtarët e Komisionit kemi qenë të mendimit që Ligji për organizimin sindikal, Ligji për grevat dhe Ligji për punën të shkojnë si pako e ligjeve, meqenëse lidhshmëria e tyre është direkt e ndërlidhur me zbatueshmërinë e tyre. Ky ligj është i përpunuar mirë strukturalisht dhe teknikisht, mirëpo nga funksionaliteti dhe esencialiteti i zbatueshmërisë do të ketë probleme, prandaj edhe unë jam e mendimit dhe paraqes edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës që ky ligj të mos kalojë pa Ligjin e punës në Kuvendin e Kosovës dhe të vijë kur të përgatitet Ligji i punës, të vijë bashkë me Ligjin e punës në Kuvendin e Kosovës, sepse do të ketë probleme në zbatueshmëri. Andaj, me qenë se u deklarua edhe ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale që do të jetë së shpejti Ligji për punën, atëherë ne jemi që ky ligj të kthehet dhe t'i bashkëngjitet Ligjit të punës, meqenëse duhet të zbatohet funksionalisht edhe esencialisht për të gjithë punëtorët e Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, nuk e di a Gjylnazja apo Shkumbini?

SHKUMBIN DEMALIJA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar pjesëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Sot në këtë pikë të rendit të ditës kemi edhe Ligjin për organizimin sindikal, gjë që grupi ynë parlamentar nuk e përkrah këtë projektligj për shkak se është ligj derivat. Është fatkeqësi kur flitet se grupet e ndryshme parlamentare e përkrahin këtë formë, se është ligj me rëndësi. Nuk ka ligj të parëndësishëm, sado që të jetë mirë apo keq i punuar, kur është ligj, është ligj. Kjo fatkeqësi po na drejton në vazhdimësi duke marrë kahet politike.

Organizimi sindikal sot në Kosovë është në humnerë dhe i pa përkrahur komplet. Ligji bazë i punës i ka kaluar të gjitha procedurat dhe ka ardhur disa herë në Kuvendin e Kosovës. Flitet për kosto të lartë financiare për te, nuk është e vërtetë. Pse mund të implementohet atëherë Rregullorja për Ligjin e punës 2001/20 edhe në bazë të çkahit funksionon sot Ministria e Punës kur nuk e ka ligjin bazë. Duhet të arsyetohen dhe ta sjellin ligjin në Kuvend, ta miratojmë, duke ua çelur rrugën edhe ligjeve të tjera bazike.

Ligji për organizimin sindikal ka lidhje edhe me ministritë dhe ligjet e tjera, sepse edhe mekanizmat e tjerë që janë në shërbimin civil, kanë të drejtë të organizimit sindikal, gjë që edhe sot funksionon edhe kryesisht lidhur me këtë çështje, përfundimisht duhet të ndalemi se nuk mund të jetë fëmija para prindit. Në këtë rast, po e nxjerrin fëmijën para prindit, do të thotë një ligj derivativ e nxjerrim para ligjit bazik. Pa kalimin e ligjit bazë, nuk mund të kalojnë ato, sepse po të dojë Ministria e Punës t'i funksionalizojë dhe t' i hapë mundësitë e tjera me mekanizmat ekzekutiv që ka brenda saj, mund të krijojë mjete që me anë të transfereve të ndryshme t'i ndihmojë edhe mekanizmat e tjerë në resorë të Qeverisë. Për të mos u lëshuar më shumë në këtë, ne si Grup Parlamentar nuk e përkrahim. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të AKR-së, Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar

Edhe pse nuk është zoti ministër i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, nuk është arsye e mirë të thuhet se shumë shpejtë do të vijë Ligji i punës, andaj duhet t'i kalojmë këto projektligje tjera, të cilat as për së afërmi nuk i rregullojnë marrëdhëniet e punëmarrësve dhe punëdhënësve të Kosovës, sidomos punëmarrësve në këtë rast. Kishim edhe Ligjin për punësimin e shtetasve të huaj, i cili nuk do të duhej të kalonte para se të vinte Ligji i punës. Po ashtu e kemi atë për organizimin sindikal. Ne, zoti kryesues e dimë shumë mirë që ka ekzistuar një kontratë kolektive dhe ekziston ende, por asnjëherë nuk është respektuar dhe gjithmonë sindikalistët kanë mbetur nën mëshirën e fatit. Ne e kuptojmë shumë mirë që Qeveria e Kosovës, në prag të zgjedhjeve mundohet që në mënyrë gjysmake t'i plotësojë disa kërkesa të qytetarëve të Kosovës, por duhet shikojmë realisht se kjo nuk është zgjidhje për problemet dhe hallet e tyre. Andaj ne si grup parlamentar kërkojmë, me qenë se nuk po u vonohet shumë Ligji i punës, të vjen Ligji i punës, pastaj të miratohet edhe ky ligj tjetër, sepse nuk është zgjidhje e problemeve, edhe në herë po e përsëris. Ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar Projektligjin, jo vetëm që nuk duhet të kalojë, por ky projektligj ka edhe mjaft gabime teknike edhe përmbajtjesore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të LDD-së, Qamile Morina

QAMILE MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Lidhja Demokratike e Dardanisë, Projektligjin për organizimin sindikal e konsideron të rëndësishë së veçantë, sepse ky projektligj do të duhej të krijonte infrastrukturën ligjore për të drejtat dhe liritë e organizimit sindikal në Kosovë.

Ky organizim sindikal do të kishte për qëllim përfaqësimi dhe mbrojtjen e interesave ekonomie, sociale dhe profesionale të punëtorëve nga puna dhe marrëdhënia e punës. Rezervat tona për këtë projektligj janë të bazuara lidhur me fuqinë ligjore që do të duhej ta kishte ky ligj, si dhe efektivitetin e mbrojtjes së interesave të punëtorëve, duke pasur parasysh mungesën e Ligjit bazë të punës.

Qeveria këtë vit po dështon në përgatitjen dhe procedimin e Ligjit bazë të punës në Kuvend. Ajo do të duhej që në krijimin e infrastrukturës ligjore të ndjekë parimin e prioritetit që do të ishte në interes të lartë për qytetarin e Kosovës dhe assesit të krijojë

prioritete të principit të piramidës së përmbysur siç po ndodhë tani. Vërejtjet tona konkrete lidhur me këtë projektligj janë, meqë Sindikata është organizatë shoqërore vullnetare e pavarur nga punëdhënësi, Qeveria, subjekti politik dhe organizatat fetare, andaj dispozitat në këtë projektligj që kanë të bëjnë me të drejtën për anëtarësim në organizatë sindikale, zgjedhjet në sindikata, themelimin dhe veprimin e sindikatës, me një fjalë organizimi i brendshëm sindikal, duhet të bëhet ekskluzivisht në bazë të statutit të tyre, që paraqet aktin më të lartë juridik të tyre. Liria e bashkimit në sindikatë dhe themelimi i saj është parimi kryesor i Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe këto parime mbrohen dhe promovohen nga një numër i konventave dhe rekomandimet për të drejtat në punë.

Dispozitat 12, 13, 14, që kanë të bëjnë me kriteret dhe proceduat e regjistrimit që parashihen të bëhen nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale janë diskutabile nga se konsiderojmë se cenojnë pavarësinë e sindikatës në procesin e seleksionimit.

Vetëm dispozitat si 16, 17, 18 që kanë të bëjnë me legjitimitetin sindikal, gjegjësisht përfaqësimit të tyre, duhet të mbeten kompetencë e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Sa i përket përcaktimit të burimeve financiare të Sindikatës, siç parashihet në nenin 20, duhet të përcaktohet qartë dhe taksativisht mbrojtja e sindikatave nga financimi i bërë nga organet shtetërore apo punëdhënësi, nga se jemi dëshmitarë që sindikata të ne dinë të financohen edhe nga organet shtetërore që është kundër të gjitha parimeve të organizimit sindikal. Shembull konkret e kemi se Ministria e Shëndetësisë, nga buxheti i saj financon Federatën sindikale të shëndetësisë me hiq më pak se 180.000 euro në vit. Këtë të dhënë mund ta gjeni në raportin për buxhetin e Qeverisë së vitit 2009. Andaj, me plotë të drejtë punëtorët shëndetësor kontestojnë legjitimitetin e Federatës sindikale të shëndetësisë e cila për 10 vite me radhë, nuk arriti asnjëherë të realizoj as kërkesat më minimale të punëtorëve shëndetësor.

Unë dua ta keqpërdori në këtë moment foltoren, t'ju përgjigjem ministrit për disa të pavërteta që i tha gjatë pyetjes sime parlamentare...

(Ndërhyrje e kryesuesit: Jo, jo nuk të jepet. Ti po flet në emër të Grupit, të lutem qëndrimin e Grupit)

... po ndërlidhet me këtë...

(Kryesuesi, jo, jo, nuk ndërlidhet kurrëgjë, bëhu korrekt. Qëndrimin e grupit)

... Në fund Lidhja Demokratike e Dardanisë, Projektligjin për organizimin sindikal e konsideron të rëndësishë së veçantë dhe ky Projektligj duhet të ketë theks të veçantë në mbrojtjen e sindikatave duke respektuar pavarësinë e tyre. Respektimin e përfaqësimit sindikal si dhe përcaktimin e qartë të burimeve financiare me qëllim të mbrojtjes efektive të interesave ekonomie dhe sociale të punëtorëve. Mungesa e Ligjit bazë të punës, konsiderojmë se do ta vështirësoj këtë synim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit “7+”, Sadik Idriz e ka thënë mendimin. Ju faleminderit!

Në emër të Grupit SLS, Mursel Halili.

MURSELJ HALILJI: Hvala, gospodine predsedavajući!

Dame i gospodo prisutni,

Ja bih želeo da obrazložim zašto će SLS glasati za ovaj predlog Nacrta zakona objasnim na sledeći način: Na Kosovu postoji veliki broj problema između poslodavaca i zaposlenih, znači postoji veliki broj zaposlenih radnika kojima se od strane poslodavaca najčešće krše i pojedinačna i kolektivna prava iz radnog odnosa. Smatramo da su primedbe onih koji su rekli da je potrebno da u ovoj oblasti postoji bazični zakon, a to je Zakon o radu, ispravne. Međutim, ne vidim nikakvu, i mi iz SLS ne vidimo nikakvu prepreku da ovaj zakon bude podržan u načelu zato što je opravdan imajući u vidu značaj i potrebu zakonskog regulisanja iz ove oblasti. S toga, SLS će kao Parlamentarna grupa podržati ovaj nacrt zakona u načelu. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ne dëgjuam mendimet e grupeve. Kemi tri grupe parlamentare në mënyrë të qartë që kërkojnë që ky ligj të nxirret sot nga diskutimi i mëtutjeshëm në mënyrë që të jetë i shoqëruar... Veç një moment, para se ta marrë ministri fjalën, ke të drejtë ta marrësh fjalën. Unë i them regjisë le t'i thërras deputetët të kthehen për votim. Regjia, zilen, thirri le të kthehen për votim!

Zoti ministër!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hteo sam samo da dam još neke dodatne informacije. Razumemo se absolutno što se tiče Zakona o radu. Znam koliko i mi želimo da taj zakon o radu što pre bude u Parlamentu. Ovako, reći ću vam šta se u tim našim odnosima desilo. Svetska banka imala je zadatak da pošalje eksperte ... za finalni deo projekta u julu, to je tada bilo obećano. Nažalost, zbog različitih obaveza te osobe, odnosno tog eksperta, on nije mogao da dodje, pa smo taj period vremena izgubili. Sada, sledeći, odnosno ekspert koji dolazi 19-tog, verovatno sa pripremljenim Nacrtom zakona, mi ćemo moći s njim da se konkretno dogovorimo o svim aspektima upravo tog Zakona o radu koji je vrlo bitan, slažem se i koji stvarno treba da bude osnova našeg društva.

Ukoliko bi zakon, ovaj postojeći nastavili sa procedurom bez detaljne konsultacije sa Svetskom bankom, u opasnost bi došao projekat koji sam malo pre pomenuo za održivo zapošljavanje od 60 miliona kao donatora Svetske banke, koja bi taj projekat započela na Kosovu još ove godine. Ukoliko bi nastavili sa zakonom kao što je bio pripremljen, bukvalno mi je rečeno, ka me ra në dështim. Znači, taj zakon, taj projekat do 60 miliona za održivo zapošljavanje koje je stvarno jedan bitan aspekt našeg društva, pogotovo što imamo toliko veliku nezaposlenost, ja nisam mogao i neću da pareuzmem odgovornost da taj projekat padne, odnosno taj projekat ne bude realizovan. Zato moramo da budemo strpljivi još malo da bi mogli da dobijemo više na dugoročni period. Opet kažem, ne mogu da prihvatim odgovornost da projekat za održivost zapošljavanja ne bude realizovan zbog naše neke da nazovem tvrdoglavosti da obavezno podnesemo zakon na usvajanje. Možemo puno toga da izgubimo, a malo da dobijemo. Znači, ja vas molim, razumite i mene kao ministra i Ministarstvo da radimo sve što je u našoj moći, ali moramo da imamo tu podršku jakih naših donatora i naših jakih partnera kao što je u ovom slučaju Svetska banka. Hvala vam!

KRYESUESI: Mbaruan diskutimet dhe paraqitjet. Zotëri, unë zbatoj Rregulloren. Grupet parlamentare kanë dhënë mendimin. E hedh në votim mendimin grupeve të cilat janë tri, në mënyrë eksplicite kërkojnë që ky Ligj mos të diskutohet më tutje sot.

Kush është për mendimin që ligji të shtyhet?

(Reagime nga salla)

Votojmë, tash.

Kush është që të shtyhet ligji..?

(Reagime nga salla)

Po, është paraqitur mendimi, nuk po flasim për vlerësim, rëndësinë si është ligji. Ne e kemi një kërkesë që të shtyhet. Unë jam i detyruar. Ju lutem, votoni ose “për” ose “kundër” kërkesës që ligji të shtyhet nga seanca e sotme. Kaq.

(Reagime nga salla)

Po, ka edhe “për”, edhe “kundër”. Votoni “për” dhe vazhdojmë.

(Reagime nga salla)

O zotëri, çdo moment kur tri grupe, tri grupe – 120 e japin, por nuk janë 120, janë 67 deputetë. Me rregull duhet të hidhet në votim, nëse grupet kërkojnë.

Rregulla 30 ...procedurale, në çdo seancë plenare të Kuvendit, deputetit i jepet e drejta t’i propozojë këto mocione procedurale.

Nën a) e para, mocioni për shtyrje të debatit. Ky është mocion që e keni bërë ju, jo unë. E ka bërë Grupi Parlamentar i LDK-së, e ka bërë Grupi Parlamentar i Aleancës, e ka bërë Grupi Parlamentar i AKR-së dhe i LDD-së, që unë nuk e kuptova saktë. Po, duke folur për paraqitjen e Ligjit e kanë bërë mocionin.

Fjalën e ka Gjylnaze Sylja, se po bë zhurmë shumë. Hajde Gjylnaze!

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, kryesues!

Deputetët kanë të drejtë ta shprehin mendimin tyre. Projektligji për organizimin sindikal është i një rëndësie të veçantë për interesin e punëtorëve, interesin e tyre ekonomik, social profesional dhe mbrojtjen e këtyre interesave nga puna dhe marrëdhënia e punës.

Duke marrë parasysh rëndësinë që ka ky projektligj, është e rëndësishme që dispozitat e këtij ligji të zbatohen edhe në praktikë. Meqenëse mungon ligji bazë, Ligji i punës, ky projektligj nuk mund të zbatohet dhe unë do t’iu referohem të dhënave të cilat duhet të dalin nga Projektligji për punë, por edhe nga Projektligji për organizimin sindikal. Neni 23 thotë se nuk mund të sigurohet zbatimi i nenit 23 dhe as imuniteti i përfaqësuesve sindikalë pa Ligjin e punës dhe po i numëroj. Pra, thotë që për aktivitetet sindikale, pa pëlqimin e sindikatës, përfaqësuesit sindikal nuk mund t’i ndërpritet kontrata e punës, nuk mund t’i caktohet vend tjetër, nuk mund t’i ulet pozita e vendit të punës, nuk mund të fillojë procedura disiplinore ose t’i zvogëlohet paga. Të gjitha këto janë ato që duhet të caktohen në Ligjin e punës. Tjetra është se punëtorët tani në Kosovë gjenden në një gjendje të rëndë, duke marrë parasysh shkallën e lartë të papunësisë dhe të varfërisë dhe në praktikë duke marrë parasysh se pa Ligjin e punës nuk ka mund të sigurohen as vetë vendimet dhe marrëveshjet të cilat janë bërë në mes të sindikatave dhe të Qeverisë dhe po i referohem vendimit i cili është marrë në mes të sindikatës, gjegjësisht Federatës

Sindikale të Shëndetësisë dhe të Qeverisë për pagesën e 44 urove, e që nuk është zbatuar. Vendimi i tillë ka pasur për qëllim përmirësimin e kushteve të punës, të efikasitetit dhe të përgjegjësisë në punë.

Tjetra është se janë shkelur mekanizmat sindikalë, do të thotë se kontrata kolektive e cila që në tetor 2007, në të vërtetë ka kaluar, ka skaduar afati, nuk është vazhduar. Këto janë të dhëna pse nuk bën tani për t'u kaluar pa Ligjin e punës.

Tjetër, të drejtat e punëtorëve dhe interesat e punëtorëve në sektorin privat dhe atë informal, nuk mund të bëhen me këtë projektligj, fatkeqësisht organizimi sindikal në ndërmarrjet private pothuaj se nuk ekziston. Prandaj, për shkak të rëndësisë që ka ky projektligj, zoti ministër, duke marrë parasysh se ju thatë se veç është gati teknikisht Ligji bazë për punën, atëherë propozoj që së pari Kuvendit t'ia sillni Ligjin bazë, ashtu që Ligji për organizimin sindikal të mund të zbatohet në jetë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Unë, sa pash, ju insistuat, ju veç e thatë mendimin e Grupit, nuk pash diçka tjetër... Fjalën e ka Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit shumë, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është mirë t'i diskutojmë çështjet në parim dhe t'i kuptojmë drejt. Ligji për të cilin po diskutojmë është ligj bazik për çështjen që e rregullon dhe unë po befasohem kur njerëzit po deklarohen këtu në këtë sallë plenare, Ligjin e punës po e konsiderojnë bazikë për sindikatë. Jo. Nëse duhet diskutuar sot se a duhet të jetë Ligji i punës, gjithsesi po. Të gjithë jemi të mendimit që Ligji i punës duhet sa më parë të vijë në Kuvend, sepse njerëzit po punojnë pa kontrata, po ju shkelen të drejtat. Prandaj, do të ishte ndoshta e pakuptimtë që organizimi sindikal të jetë dhe të mos jetë ligji i cili i rregullon të drejtat dhe liritë e punëtorëve. Është shumë normale, është shumë e drejtë, por jo që të japim akontacion të ndryshëm, sepse ky do të jetë ligj bazik, ky është ligj bazik për organizimin sindikal. Mirëpo, është mirë ndoshta ta dëgjojmë ministrin, të jetë i qartë, a ka mundësi që Ligji i punës të vijë sa më parë dhe nuk do të ishte asnjë pengesë, sepse institucionet e Kosovës kanë nevojë ta plotësojnë infrastrukturën ligjore dhe nëse do të aprovohet ky ligj në parim, nuk do të bëhej nami, nëse ministri deklaroi që Ligji për punën do të jetë në seancat e ardhshme dhe ne e kuptojmë që duhet dhënë dhe kërkuar që ligji të vijë sa më parë, nëse jo, është mirë të diskutojmë. Ligji është jashtëzakonisht i punuar mirë. Qeveria e ka punuar ligjin mirë. Nuk është ligj derivativ, si po e quajnë, s' ka ligje derivateve, sepse për këtë çështje të organizimit sindikal do të jetë vetëm ky ligj, do të rrjedhin edhe ligje të tjera për protestat, për format e ndryshme, por ky do të jetë ligj bazik.

Por, unë do t'i diskutoj disa çështje vetëm nëse vihet deri te votimi. Është mirë ndoshta neni 2 i Projektligjit të riformulohet në komision funksional. Nuk ka nevojë të parashihen, siç janë paraparë ambasadat e huaja, sepse ato veprojnë konform ligjeve dhe rregullave që vijnë nga shtetet përkatëse. Ndoshta është mirë që ministri ta ketë parasysh apo komisioni funksional, varësisht si do të ndodhë me ligjin, që të parashihen edhe institucionet tjera, që nuk janë paraparë, që nuk kanë të drejtë të kenë organizim sindikal, në këtë rast po e përmend vetëm inteligjencën dhe format tjera, është mirë që gjykatat të mos i obligojnë me ligje të veçanta. E këtu është fjala tash për ligjet bazike. Ne nuk mundemi me ligje që rregullojnë fushat e tjera t' i obligojnë gjykatat, të cilat i kanë ligjet bazike që i rregullojnë. Për shembull, siç ndodh, neni 14.4 thotë, për

shembull, Ministria e Punës, nëse ia refuzon kërkesën një sindikate për t'u regjistruar, sepse nuk i plotëson kërkesat, menjëherë në paragrafin 5 i jep autoritet për t'iu drejtuar gjykatës, jo absolut çdo kund, në çdo institucion, së paku duhet të jenë dy shkallë. Nëse nuk i ka plotësuar të gjitha dokumentet herën e parë, duhet kërkuar për t'i plotësuar ato dokumente, nëse nuk i plotëson brenda afatit të paraparë, mandej çështja mund të ngrihet në instanca tjera.

Çështja tjetër është imuniteti i përfaqësuesve sindikalë, zoti ministër. Mendoj se edhe njerëzit, edhe punëtorët që punojnë për sindikatën, duhet ta respektojnë Ligjin e punës, sepse edhe ata kanë kontrata, kurse për organet të cilat janë drejtuese, natyrisht vlejnë parimet tjera. Mirëpo, këtu keni paraparë tash te imuniteti sikurse ata punëtorë që punojnë për sindikatën, duhet ta rregullojnë marrëdhënien e punës me ligjet tjera. Jo, do të jetë një ligji, i cili do ta rregullojë marrëdhënien e punës për të gjithë punonjësit, prandaj edhe këtu ndoshta nuk ka qenë mirë të parashihi këto si i keni paraparë që jo masa disiplinore e tjera, pa ndihmën e sindikatës jo, por do të veprojë Ligji i punës për të gjithë. Dhe, ndoshta është, krejt në fund, mbrojtja e anëtarëve para gjykatës. Edhe një herë e thashë, me qëllim po i përmend gjykatat, sepse në çdo ligj që po vjen, po obligohen disi gjykatat.

Unë mendoj që ka raste kur mbrohen në mënyrë kolektive të drejtat e punëtorëve në gjykatë, por shkelja e të drejtave të punëtorëve është individuale. Nëse me ndonjë vendim është larguar në mënyrë kolektive, atëherë fitohet e drejta, por kështu qysh është neni 30, domethënë sindikatës i jep autoritet t'i mbrojë individualisht të drejtat e punëtorëve në gjykatë. Kjo nuk mund të bëhet, nuk mund të ndodhë në të ardhmen, sepse çdo individ, nëse konsideron se ju ka shkëputur marrëdhënia e punës, ai duhet në mënyrë individuale të paraqes padë e mandej ta realizojë me ndonjë aktgjykim, sepse gjykata nuk do të marrë autoritet, siç e keni shkruar për ta zbatuar mandej ligjin, por gjykata duhet të nxjerrë aktgjykim për çështjen apo aktvendim në raste të caktuara, për çështjen konkrete dhe do të zgjidhin problemin. Këto do të ishin disa vërejtje, në parim.

Unë, natyrisht, e përkrah Grupin Parlamentar dhe konsideroj që Ligji për punën duhet të vijë, gjithsesi bile është mirë të marrim garanci prej ministrit që të jetë në seancën e ardhshme plenare apo, nëse nuk mundet në seancën tjetër plenare, mirëpo nuk jam që ne të pengojmë, sepse ky ligj e rregullon një fushë shumë me rëndësi dhe nuk bëhet nami nëse e votojmë edhe sot. Faleminderit!

KRYESUESI :Fjalën e ka Gani Koci, në emër të Komisionit.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues,

Për fillim, te çështja e mocionit, unë po e marr këtë mohim tash të tri grupeve në rastin kur pohohen tri grupe, pohojnë që duhet të miratohet, asnjëherë s'është ndërprerë debati, por është diskutuar dhe në fund është miratuar, prandaj në qoftë se është rregull të bëhet rregull edhe në rast të mohimit, edhe në rast të pohimit të një çështje të caktuar që shtrohet në Kuvend. Sa i përket ligjit, unë nuk do të flas për ligjin. Në mandatin e kaluar ne kemi pasur një ligj për grevat atëherë, të drejtën e grevës dhe kemi pas diskutuar se nuk mund t'i paraprijë Ligji i grevës për derisa nuk kemi Ligjin e punës dhe ne e dimë që sferën e marrëdhënies së punës nuk e kemi të rregulluar dhe nuk e kemi të rregulluar jo për faktin pse ne nuk duam ta rregullojmë atë sferë, por për një fakt tjetër që e tha edhe ministri. Si kryetar i komisionit, në çdo takim që e kemi pasur me institucione

ndërkombëtare, sidomos me Bankën Botërore, edhe me Fondin Ndërkombëtar, ata nuk janë kundër ligjit, por kostoja e ligjit është tepër e madhe në mënyrë që buxheti i tashëm i Kosovës nuk mund ta përballojë këtë. Pra, kjo është arsyeja ndoshta e zvarritjes të atij ligji dhe nuk është mirë që ne si Kuvend të bëhemi, si të them, pengesë, peng i vetvetes duke e kushtëzuar një ligj me një ligj tjetër, sepse kjo praktikë, keni pasur edhe raste të tjera të ngjashme, kjo praktikë nuk na çon askund, vetëm do të presim në pakufi ose në pafundësi ligje që një herë kostoja jonë buxhetore nuk i përballon. Ju e dini, përpara këtu kemi diskutuar për ligje të caktuara dhe kemi kërkuar me konsekuencë a përmbush koston financiare, a e ka deklaratën financiare dhe në qoftë se e ka pasur, e kemi miratuar, në qoftë se jo, që është rregull, atëherë e kemi refuzuar dhe në qoftë se konstatimi i të gjithë subjekteve relevante është se ky ligj është, tash për tash, është fjala për Ligjin e punës, nuk përballon koston buxhetore, mendoj se ne nuk duhet të jemi peng i atij ligji nëse s'e përballon në këtë vit, mund ta përballojë në vitin tjetër dhe të mos nxjerrim Ligjin për organizimet sindikale në Kosovë. Prandaj, arsyetimet e tri grupeve parlamentare në këtë rast që nuk e kanë parasysh koston buxhetore dhe kërkojnë këtu në ligjet tjera këtë kosto, mendoj që është i padrejtë dhe nuk do të duhej vepruar ashtu. Ne si Kuvend nuk mund të jemi peng i një ligji. Kemi rastin e Ligjit të Qeverisë atje, që duhet ta kemi, Ligjin për pagat e zyrtarëve, që duhet ta kemi atë dhe nuk e kemi dhe e kemi kushtëzuar me diçka që nuk përballon koston tonë ose buxheti ynë nuk i përballon këto ligje, prandaj për derisa nuk gjenden burimet financiare, ju lutem, të mos bëhemi peng i vetvetes dhe të prolongojmë ligje që nuk kanë kosto buxhetore.

KRYESUESI: Fjalën e ka Ardian Gjini.

Faleminderit, zoti kryesues!

Janë disa çështje që janë hapur këtu, që ma merr mendja vlejnjë për t'u diskutuar para se të marrim vendim. Krejt ajo që unë kam për të provuar ta bëj, është t'i bind deputetët të mos e votojnë këtë ligj tash, pa marrë parasysh a është i mirë apo i keq dhe kjo është e drejtë imja, është e drejtë e deputetit, e secilit do prej deputetëve. Në fund të fundit, debati këtë qëllim e ka, të provojë për t'ia mbushur mendjen njëri-tjetrit ta votojë ose të mos e votojë një ligj. U përmend Ligji i punës. Qëndrimin e Grupit nuk po e përsëris edhe një herë e keni dëgjuar, prapë është e njëjta vi, nëse dikush thotë se s'kemi mjete për Ligj të punës, nuk po e aprovojmë këtë ligj të punës se ka kosto të lartë, por t'i aprovojmë ligjet tjera në një formë metaforike, nëse do ta përdorja një analogji, nuk e di sa është e qëlluar nëse dikush ju thotë lirisht, vetëm nëse unë kam laps të arit - shkruaj, përndryshe s'dua të shkruaj. Ne po u themi - bleni të drurit një herë, nisjani se s'mund të mos shkruani, duhet të shkruani e më vonë bëjmë laps tjetër. Në esencë, nuk ka nevojë ne ta mbajmë peng Ligjin e punës e për t'i votuar ligjet tjera të cilat mund të kenë ndikime negative, të cilat do t'i përmend tash, pa ligj të punës në vend se për t'ia ulur pak koston Ligjit të punës, nëse Kosova në këtë fazë nuk e përballon, a ka menduar Ministria të gjejë mënyra që Ligjit të punës t'ia ulë koston përkohësisht përderisa e kemi të përballueshme më pak tash? A duhet të themi vetëm të arit e duam lapsin, s'ka laps të arit, nuk shkruajmë. Çështja e parë.

Çështja e dytë, po e citoj veten – shumë herët në fillim të këtij viti dhe vitin e kaluar diku në dhjetor, ndoshta, ju kam thënë se ajo agjendë legjislative të cilën e ka sjellë Qeveria e Kosovës, nuk është agjendë, por është listë e ligjeve, e hartuar prej administratës, e bërë bashkë në një letër dhe e sjellë para Kuvendit. Po del tash, një vjet më vonë, që nuk ka qenë agjendë legjislative. Agjendë do të thotë prioritet dhe afat, çka bëhet para çkafit? Lista nuk është agjendë. Po them edhe një herë, kemi kërkuar agjendë legjislative, është

përmendur edhe nga shumë institucione të cilat na monitorojnë, të cilat na kanë thënë se nuk ka agjendë legislative, kjo nuk është agjendë legislative është vetëm grumbull i ligjeve që janë hedhur në letër. Pse tani ligji është problematik dhe i paimplementueshëm? E përmendëm Ligjin e punës. Po hajt se për një moment po themi se ndoshta bën. Nëse e shihni këtë ligj dhe mendoni në aspektin dinamik çka do të ndodhë në momentin kur nënshkruhet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, është i aprovuar, është në fuqi, atëherë ky ligj ka provizione të cilat do ta determinojnë Ligjin e punës, i cili ka qenë dashur të jetë përpara. Do të thotë, nuk është problemi vetëm se çka po bëjmë më përpara ne, apo është i paimplementueshëm për shkak se i duhet Ligji i punës këtij ligji. Jo, jo, është edhe tjetra. Ky ligj nëse është në fuqi, ka provizione të cilat kanë për ta determinuar hartimin e Ligjit të punës, e tash aty ngatërrohemi në hapa, zoti ministër. Edhe atëherë do të kemi problem në hartim të Ligjit të punës se do të kemi provizione në fuqi, të cilat do ta determinojnë atë ligj. Unë po e lus Kuvendin që të mendojë për politikën e këtij ligji dhe ta ndërpresë njëherë e përgjithmonë këtë praktikë që meqenëse ka ardhur ligji para nesh, duhet gjithsesi ta votojmë për shkak se ja është i rëndësishëm, ja nuk është i rëndësishëm, por më keq është mos ta votojmë se ta votojmë.

Dhe, çështja tjetër, shihni edhe një aspekt të vogël të ligjit, para Ligjit të punës. A mund të ketë agjendë të shtetit, agjendë të Qeverisë për zhvillim të hovshëm ekonomik e mos të ketë, shembull ta marrim, një mendim të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për këtë ligj? Çdo ligj që ka të bëjë me punën, me organizimin sindikal, me të hyra, duhet të ketë qenë një ligj për të cilin e jep një mendim edhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave, na thotë ose na ndihmon në zhvillim të hovshëm ekonomik ose na ngatërro. Unë nuk e di tash këtu, a na ndihmon, a na ngatërro, mirëpo për të marrë vendime të drejta Kuvendi i Kosovës, nuk kemi ne nevojë këtu të bëhemi të gjithë ekspertë. Kemi ekspertë të cilët duhet të na japin një mendim, mendim të cilin realisht kurrë nuk po e marrim, edhe atëherë po duhet të improvizojmë ne vet, herë të jemi politikanë, herë ekonomistë, herë juristë pa nevojë. Na nuk kemi nevojë ashtu të jemi Ne kemi nevojë ta shohim politikën e ligjit dhe sot këtu po tentoj t'ju lus për ta parë politikën e ligjit dhe të provojmë këtë ligj ta votojmë një herë tjetër pasi ta kemi votuar ligjin i cili detyrimsht na duhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Ibrahim Gashi!

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra prezentë,

Kolegë deputetë...

(Ndërhyrje e deputetit)

KRYESUESI: Gashi, s'e ka fjalën, Koci!

GANI KOCI: Zotit Gjini, desha t'i them se ky ligj që po e përmendni ju, nuk është objekt i trajtimit vetëm në këtë mandat, por ka qenë objekt i trajtimit edhe në mandatin tënd, do të thotë gati në 3 mandate. Pse nuk e bërë ti atëherë ose pse nuk konstatove të shkruash me laps të drurit atëherë dhe ndoshta në mandatin tonë ne kishim shkruar me laps të arit, në këtë rast. Prandaj, me pasojat që ju s'e keni bërë atë, po përballemi ne sot dhe nuk mund të flasësh për atë absolutisht se tash duhet t'ia nisim me laps të drurit. Në fund të fundit, ne kemi një ligj që quhet ligj themelor, a është Rregullore e punës, që i ka diku nja 36-37 nene, s'ka më shumë, që nuk përcakton krejt marrëdhëniet e punës, por së paku

është një bazë që e përcakton marrëdhënien e punës. Domethënë, s'kemi ligj, kjo nuk qëndron absolutisht.

KRYESUESI: Tash e do edhe ai fjalën!? Merre! Merre, se s'jeni duke u lodhur për ligj asnjëri.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Rregullorja e Kuvendit thotë se deputeti pasi që ka folur një herë, nuk ka të drejtë t'i replikojë idesë. Zoti Gani Koci i ka replikuar idesë sime, unë nuk e kam përmendur as implicit, as eksplisit, as nuk i jam referuar fjalës së tij asnjëherë dhe arsyeja pse ia dhatë fjalën, ia keni dhënë dy herë, nuk ka pas nevojë të më replikojë mua. Tjetra është, ne kemi punuar mirë. Ti i ke dy vjet afat dhe për dy vjet afat nuk je kah di të bësh kurrgjë. Qe dy vjet je në pushtet, mos harro. Krejt e ke bënë mish-mash, e ke tollovitur krejt këtë punë edhe të Kuvendit, edhe të Qeverisë.

KRYESUESI: Faleminderit! Kolegë, të nderuar, unë ju lus për një sjellje, do të thosha etike, parlamentare. S'po them politike, se po shihet që ju vyejnë këto diskutime të gjithëve. Pra, ne i dëgjuam këto, unë mendoj që duhet të përcaktohem – a do të vazhdojmë të diskutojmë për ligjin, që ende s'kemi vendosur ta votojmë ose jo sot? Unë nuk po shoh ide të reja. Unë zotërinj, po ju shoh që po i përsëritni, veç se në emër të grupeve. Është PDK-ja që po e përsërit idenë në mënyrën e vet. Është AAK-ja që po e përsërit në mënyrën e vet. Ju lutem shumë, është koha të mos bëjmë biseda që po i largohen materies së ligjit.

Kush është që ky ligj, sot të diskutohet tutje, do të thotë, të lexohet dhe të bëhet leximi i parë, le ta çojë dorën. Kush është për “jo”, është kërkesa, le të votojmë tash. Regjia, gati dhe po votojmë.

Do të thotë, votojmë a ta vazhdojmë sot apo ta shtyjmë në një ditë tjetër bisedën për këtë ligj, sepse ky është propozimi?

Ju lutem, regjia bëhuni gati. Votohet kërkesa që të hiqet ky ligj apo për të mbetur Votojmë tash.

(Ndërhyrje deputetësh)

Kërkesa për shtyrje, fiton me 33, katër janë...

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

O zotërinj! Kërkesa për shtyrjen e këtij ligji, që të mos shqyrtohet tutje sot, hidhet në votim. Votoni për ta shtyrë? Votoni tash, edhe një herë, se nuk po merremi vesh.

Faleminderit shumë! Zonja e zotërinj, unë thashë, mbani etikën parlamentare, edhe etikën parlamentare, edhe të grupeve, edhe të detyrave, më në fund 30 thonë duhet të shtyhet, 3 abstenojnë, 27 thonë nuk duhet të shtyhet. Pra, shtyhet ligji për tjetër herë.

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale**

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Unë e ftoj ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotëri Ahmet Shalën, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë projektligjin. Ahmet Shala e ka për detyrë ta paraqes. A ka caktuar dikë nga Qeveria që ta paraqesë ligjin? Thanë, që është poshtë, që po më thotë ndihmësi. Nëse thonë se është poshtë, thirreni dhe, nëse ai nuk është këtu, unë e mbylli mbledhjen. Të lutem shumë! Ahmet Shala thirret të vijë ta paraqesë ligjin.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Unë jap pushim prej 15 minutash. Faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pushimit

KRYESUESI SABRI HAMITI: Zotërinj deputetë, vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale

Ftoj ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë projektligjin. Urdhëroni, zotëri ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që sot para jush të paraqes Projektligjin për masat doganore për mbrojtjen e pronësisë intelektuale në Republikën e Kosovës.

Ky projektligj është pjesë e pakos ligjore, të bazuar në standardet dhe praktikat më të mira të vendeve të Bashkësisë Evropiane dhe të regjionit që përcakton procedurat për veprim nga dogana e Kosovës për mallrat që janë të dyshimta, për shkelje të drejtave të pronës intelektuale, për ato produkte dhe licenca që hyjnë apo dalin nga territori doganor i Republikës së Kosovës.

Me këtë projektligj, ne kemi arritur të rregullojmë dy procedura: për ndërmarrjen e veprimeve nga ana e Doganës së Kosovës, në pengimin e falsifikimit të markës, dizajnit, paketimit dhe piraterisë, si dhe kemi paraparë iniciimin e procedurës sipas kërkesës së bartësit të së drejtës së pronësisë, markës, dizajnit industrial, patentës apo tjetër. Po ashtu kemi rregulluar procedurën sipas detyrës zyrtare ex-officio, të ndërmarrë nga ana e Doganës për të mbrojtur bartësin e së drejtës së lartpërmendur.

Me këtë ligj, po ashtu kemi rregulluar edhe procedurën e shkatërrimit të mallrave për të cilat kanë përfunduar procedurat e dëshimit se mallrat janë të falsifikuara apo janë pirate. Projektligji është punuar në përputhje të plotë me Rregulloren e Komisionit Evropian numër 1383/2003 dhe është në harmoni me të gjitha praktikat më të mira të

legjislativit të vendeve të regjionit dhe standardet ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Marrëveshjen e TRIPS-it, përkatësisht Marrëveshjen për aspektet e të drejtave të pronësisë intelektuale që lidhen me tregtinë e mallrave në Unionin Evropian.

Deri më tani në Kosovë është në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut numër 2008/22 për zbatimin e masave doganore lidhur me mallrat që i shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale, rregullore që nuk ka ofruar një mbrojtje të mjaftueshme, të paktën me nevojat e kohës, për të drejtat e pronësisë intelektuale dhe nuk ka qenë në përputhje të plotë me Komisionin Evropian, përkatësisht me Rregulloren 1383/2003 dhe e cila paraqet një pengesë për Doganën për të vepruar konform mundësive dhe kapaciteteve që i ka zhvilluar.

Të nderuar deputetë,

Projektligji për masat doganore për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë intelektuale do të kontribuojë edhe sa vijon:

- Do të sigurojë zbatimin doganor të së drejtës së pronësisë intelektuale me anë të kontrollit kufitar që nuk pengon tregtinë legjitime;
- Do të sigurojë zbatimin doganor të së drejtës së pronësisë intelektuale me anë të kontrollit kufitar që nuk pengojnë tregtinë legjitime;
- Do të sigurojnë mbrojtje kundër abuzimit të drejtave të pronësisë intelektuale;

Me këtë projektligj po ashtu do të arrijmë mbrojtjen e bizneseve legjitime nga konkurrenca e padrejtë, sidomos nga falsifikimet e markave dhe bench-markave si dhe krejt markave të ndryshme të cilat vërtet po e shkatërrojnë biznesin legjitim dhe atë serioz.

- Do t'i plotësojnë standardet për thithjen e investimeve të huaja në Kosovë duke i mbrojtur nga po ashtu falsifikimet dhe pirateritë e ndryshme.

Me këtë ligj, po ashtu, do të arrijmë mbrojtje më të mirë të shëndetit dhe sigurisë së shtetasve të Republikës së Kosovës.

Dogana e Republikës së Kosovës është subjekt përgjegjës për zbatimin e këtij ligji dhe përmes këtij projektligji i jepet një mundësi shumë e madhe ligjore dhe zbatuese për të qenë më e efektshme në luftën kundër këtyre parregullsive.

Ky projektligj përmban 26 nene dhe duke vlerësuar rëndësinë e tij, kërkoj nga ju deputetë të nderuar, që ta aprovonin në parim dhe pastaj përmes grupeve dhe komisioneve do të kemi mundësi, eventualisht të tejkalojmë ndonjë paqartësi apo ndonjë element që është i domosdoshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Në emër të komisionit funksional, a e do fjalën kush? Jo.

Në emër të komisioneve të përhershme. Nuk ka.

Atëherë, kalojmë me diskutimet në emër të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Nerxhivane Dauti.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,
Në vazhden e përpjekjeve për të kompletuar bazën ligjore për rregullimin e çështjeve financiare dhe ekonomike është edhe Ligji për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mirëpret dhe e përshëndet sjelljen në Kuvend të këtij ligji me rëndësi të veçantë.

Ky projektligj rregullon procedurat për veprim nga Dogana për mallrat që janë të dyshimta, për cenimin dhe shkeljen e të drejtave të pronës intelektuale gjatë kontrollit të mallrave duke hyrë apo dalë nga territori doganor i Republikës së Kosovës, si dhe për mallrat e deklaruar për qarkullim të lirë, eksport apo ri-eksport. Gjithashtu, përmes këtij projektligji përcaktohen masat për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale që merren nga Dogana si institucion përgjegjës për zbatimin e këtij ligji.

Arsyeja për nxjerrjen e këtij projektligji është se Rregullorja e UNMIK-ut numër 2008/22 nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme për të drejtat e pronësisë intelektuale. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet rregullorja e lartpërmendur që do të kontribuojë për të siguruar zbatimin doganor të së drejtës të pronësisë intelektuale me anë të territorit të kontrollit kufitar që nuk pengon tregtinë legjitime dhe të sigurojë mbrojtjen kundër keqpërdorimit të pronësisë intelektuale. Me zbatimin e këtij ligji fuqizohet roli i Doganës në mbrojtjen e të drejtës së pronësisë intelektuale duke zgjeruar veprimtarinë doganore dhe duke fuqizuar bashkëpunimin në mes të Doganës dhe bartësit të së drejtës së pronësisë intelektuale.

Projektligji i propozuar është në përputhje me Kodin Doganor dhe të akcizave të vitit 2008 dhe Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat tjera të përafërta, si dhe është i harmonizuar me standardet ndërkombëtare, konkretisht me Marrëveshjen TRIPS, Marrëveshjen për aspektet e të drejtave të pronësisë intelektuale që lidhen me tregtinë.

Projektligji i propozuar, marrë në përgjithësi, përmban një teknikë juridike të mirë.

Sa i përket gjuhës juridike propozoj që terminologjia juridike latine të zëvendësohet me terminologjinë juridike në gjuhën shqipe, si për shembull neni 3, 6 dhe të tjerë, që mundëson që ligji të jetë më i lehtë për t'u zbatuar në praktikë.

Në nenin 12 është përcaktuar se bartësi i të drejtës duhet ta njoftojë doganën brenda 10 ditëve të punës se procedura për përcaktimin e shkeljes së të drejtës të pronësisë është incizuar. Me fillimin e procedurës së tillë, periudha e pezullimit të lirimit të mallrave apo ndaljes, zakonisht zgjatet derisa gjykata të nxjerrë vendimin në lidhje me këto mallra. Në këtë aspekt, afati i përcaktuar prej 10 ditësh duhet të jetë më i shkurtër duke marrë parasysh natyrën e çështjes.

Magazinimi i mallrave gjatë periudhës së anulimit të lirimit ose ndaljes, zhvillohet në pajtim me dispozitat e Kodit Doganor, që parasheh magazinimin e përkohshëm të mallrave, gjë që në aspektin e magazinimit duhet zgjeruar rregullativa ligjore në këtë pjesë e jo vetëm në nenin 14.

Te dispozitat kundërvajtëse, në nenin 18 dhe 19, gjobat në lartësi prej 250 dhe 500 eurove për personat fizikë nëse shkel pronësinë intelektuale dhe veprimet tjera të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 7, propozoj që gjobat e tilla të jenë më të ulëta.

Unë përshëndes Ministrinë për punën e bërë, për intensitetin e shtuar në drejtim të miratimit të ligjeve funksionale, të ligjeve të cilat na nevojiten për ekonominë e lirë të tregut.

Në emrin tim personal dhe të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, konsiderojmë se ligji i propozuar duhet të miratohet në shqyrtim të parë. Ju falënderoj për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Dauti. Në emër të Grupit të Lidhjes Demokratike, deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me kujdes Projektligjin për masat doganore për t'i mbrojtur të drejtat e pronësisë intelektuale. Shumë qartë janë përcaktuar procedurat për veprim nga Doganat e Republikës së Kosovës kur mallrat e dyshimta që kanë të bëjnë me të drejtat e pronës intelektuale që mos keqpërdoren në hyrjen apo daljen nga territori doganor.

Duke marrë parasysh se prona intelektuale është atakuar vazhdimisht nga pirateria dhe falsifikimet që ndodhin si në vend, ashtu edhe në plasimin jashtë vendit, Grupi Parlamentar i LDK-së mendon se me zgjerimin e veprimit doganor në mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe biznesit legjitim me këtë projektligj, i cili përmbush edhe standardet ndërkombëtare, prandaj domosdoshmërisht i japim përkrahje në parim, si dhe duke marrë obligimin që anëtarët tanë në komisionin funksional të japin kontributin maksimal për të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që dalin nga kjo seancë plenare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar zoti kryesues!

Të nderuar zonja deputete dhe zotërinj deputetë,

Edhe Grupi Kuvendor i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar me vëmendje këtë projektligj. Pra, qëllimi i projektligjit është funksionimi dhe fuqizimi për masat doganore që të pengohet falsifikimi i mallrave që importohen dhe eksportohen, pra që hyjnë dhe dalin në Republikën e Kosovës, e që janë të dyshimta. Dhe, me këtë jo vetëm që bëhet shkelje e të drejtave të pronës intelektuale, por me këtë projektligj do të mbrohet edhe biznesi legal nga konkurrenca e padrejtë dhe me këtë mbrohen shëndeti dhe siguria e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Me Rregulloren e UNMIK-ut 2008/22, kjo rregullore edhe pse e ka pasur për detyrë ta bëjë një pjesë të kësaj pune, nuk e ka bërë dhe ka pasur të meta të mëdha në këtë rregullore dhe me këtë projektligj tentohet që ato të meta të asaj rregulloreje të jetë një projektligj më funksional.

Në projektligj, përveç disa gabimeve teknike, përveç disa gabimeve terminologjike dhe përmbajtjesore që i ka dhe që besoj që duhet të eliminohen në leximin e dytë, shpresoj që Grupi Kuvendor edhe i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, do t'i japë vërejtjet e veta në Komisionin funksional dhe në komisionet kryesore që do të kalojë ky projektligj. Ne shpresojmë se me këtë projektligj do të jetë edhe një ekonomi më e drejtë dhe do të bëhet

ndalja e ekonomisë ilegale të markave dhe të mallrave të ndryshme që janë duke hyrë në Kosovë.

Në përgjithësi, Grupi i Aleancës e përkrah në parim këtë projektligj dhe do të kontribuojmë në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Aleancës Kosova e Re, deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuari ministër Shala,

Grupi Kuvendor i AKR-së në parim e ngrit çështjen se do të duhej apo nuk do të duhej të bëhej ky dokument. Ja pse, po e zëmë, sikundër të aplikohej mirëfillshëm, me konsekuencë Kodi Doganor, nuk do të kishte nevojë fare për këtë se do të aplikoheshin të gjitha këto norma që janë dizajnuar në këtë dokument. Kjo është një çështje parimore. Ndryshe, ne e mbështesim angazhimin e Ministrisë, të ministrit për ta bërë një punë të mirë në favor të mbrojtjes së pronës intelektuale, e cila sot për sot mjerisht nëpërkëmbet në mënyrat më banale, në forma më se të ndryshme. Pra, krejtësisht është e pambrojtur. Ka vërejtje në terminologji, ka terma që nuk janë adapte, se këtu është fjala për shkencën juridike dhe në 3 gjuhët ka dallime, diskrepanca që e ndryshojnë substancën e nenit, se kur është fjala për aplikimin e ligjit atëherë mund të aplikohet cildo ligj, bie fjala, në gjuhën këtë apo atë dhe do të thuhet se është aplikuar ligji e nëse do të aplikohej në këtë version, do të dilte me diferenca.

Edhe disa vërejtje parimore. Bie fjala, në nenin 2 paragrafi 2, alineja 1, panevojshëm dhe pa bazë bëhet dallimi ndërmjet pronës intelektuale dhe pronës industriale. Po, prona industriale është pronë intelektuale dhe aty s'ka diskutim, ajo manifestohet në formën e patentit, të licencës Nau-Hau, ama janë pronë intelektuale, nuk duhet të bëhen gabime të tilla. Këtu është fjala për gabime profesionale.

Ose thuhet – “markë tregtare” Qysh “markë tregtare”, duhet ”shenja tregtare”. Pra, janë terma që e rendojnë, si të thuhet.

Te neni 3, është në kundërshtim përmbajtja me titullin. Bie fjala, thotë “kërkesa për veprim nga Dogana, masat paraprake për kërkesën për veprim nga Dogana në kllapë (procedura ex-officio)”, a këtu krejt shkruhet se kush kur i dëmtuari apo e dëmtuara, bie fjala intelektual, që prona intelektuale iu ka cenuar se çfarë do të duhej të bënte, a kur është fjala për ex-officio vetë institucioni, autoriteti publik kompetent ndërmerr masa pa kurrfarë kërkesë, si të them. Kërkesa mund të jetë e mirë ama e ndërmerr ex-officio, domethënë është dallim, diskrepancë ndërmjet vetë titullit dhe përmbajtjes së tekstit ligjor.

Bie fjala, te neni 4, në parim, thuhet, paragrafi 2 – “drejtori gjeneral i Doganës merr vendim, aktvendim”. Ne e dimë se kjo nuk thuhet – Dogana, se zakonisht asisoj, nuk thuhet kryeministri merr vendim, as kryetari i Kuvendit, thuhet Kuvendi, Qeveria, pra Doganat, se është fjala për institucionin. Atje ka një alamet organogrami ku ka shumë të autorizuar për vendosje.

Neni 6 është krejtësisht i paqartë dhe siç e tha profesoresha Dauti, me vend. Ishte dashur të hiqen këto gëlllosat në latinisht, mutadis-muntadis, dhe nuk përshtatet se këtu mutadis-

muntadis e ka për këtë punë pak më vonë, ama nuk përkon me tekstin dhe teksti është i paqartë.

Me nenin 7, tolerohet afati, i jepet mundësi, po e zëmë, autoritetit publik një vit për zbatim. Po, ju lutem, një vit, qysh një vit, ne jemi të interesuar që ligji të aplikohet menjëherë. Ne e dimë që me njëherë s'mundet, por le të jetë bile së paku një muaj ditë, qysh një vit. Ne e dimë, ka raste kur me vite nuk aplikohen normat ose fare, mirëpo na mos t'i japim bazë juridike, që do të thotë – e unë një vit, pas hyrjes në fuqi, kam hapësirë...

Te dispozitat kundërvajtëse, gjoba, dënimi me të holla, plus 1.000 euro për personin juridik apo entitetin legal. Është qesharake. Në qoftë se e marrim atje cenimin e të drejtës intelektuale apo të pronës edhe gjobën 1.000 euro, po e zëmë, për një institucion, po kjo është me të vërtetë qesharake. Qysh ashtu, po ajo lartësi do të ishte e ulët edhe për individin që ia merr një tekst një profesori universitar e nëpërkëmbë, po e zëmë, se lere më, apo një shaptilografist që e shumëzon me mijëra ekzemplarë dhe i shet publikisht, se lere më për personin juridik. Këtu sikur të ishte menduar nga ata që e kanë hartuar, do të kishin rezonuar pak më seriozisht.

Edhe te neni 22, ju lutem, nuk është përcaktuar cili organ do t'i procedonte çështjet kundërvajtëse. Ne kemi sot gjykata për kundërvajtje, por kemi edhe dizajnuar një dokument që ato do të suprimoheshin, e tjera. Këtu intenca është që vetë, bie fjala në këtë rast, Dogana, deliktet kundërvajtëse doganore, Dogana do të duhej t'i procedonte me procedurë administrative dhe ky është një koncept që gjykatat kundërvajtëse të suprimoheshin, të shkriheshin në institucione. Kështu është praktikë në Evropën bashkëkohore.

Në nenin 22, që ky do të duhej të ishte, po e zëmë, ligj, me të vërtetë siç e tha një kolegë më herët me vend – derivativ, përderisa e kemi Kodin Doganor. Këtu veç e cakton se doganat, domethënë, tematikën e Kodit Doganor se i cili dokument në procedurë aplikohet edhe thotë atje- do të aplikohet, domethënë me aktin më të ulët i caktohet aktit më të lartë, apo institucionit më të lartë. Ai më i ulëti ia përcakton me cilin ligj do të duhej të procedonte dhe e fut atje Kodin doganor e pastaj edhe Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative që është një ligj sistemor që aplikohet kurdoherë përderisa nuk ka dispozita speciale.

Dhe, për mua neni 4, kam medituat, por s'kam mund të vijë te një konkluzion i logjikshëm, po e zëmë, bindës. Neni 24 ...thotë, neni 9 i këtij ligji fillon të zbatohet 12 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Në parim, do të thotë e mbështesim punën dhe mundin e angazhimit të Ministrisë dhe ministres për këtë dokument dhe natyrisht në procedurat që presin do të përpiqemi të japim kontributin për ta bërë këtë dokument sa më të mirë që është e mundshme. Ju falënderoj për kujdesin!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të LDD-së, Synavere Rysa.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar deputetë,

Projektligj për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale plotëson vakuumin për veprimin institucional për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Qëllimi i projektligjit është luftimi i mallrave të falsifikuara, të piraterisë, kryesisht mallrat që i nënshtrohen Doganës, respektivisht masat që duhet të ndërmerren në rast të vërtetimit të shkeljes së të drejtave të pronësisë intelektuale. Ky ligj do ta mbrojë biznesin legjitim nga konkurrenca e padrejtë, e po ashtu edhe do të mbrojë edhe shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, në parim e mbështet këtë projektligj dhe kontributin tonë do ta japim në komisionin funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në emër të Grupit “7+” Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti kryesues!

Bu Yasa Tasarısı entelektüel şüphesini taşıyan malların Kosova Cumhuriyetine sokulan veya gümrükten çıkartılan malların ya da serbest alış-veriş malları olarak beyan etilen malların yanı sıra ihraç veya yeniden ihrac etilen malların gümrük kurallarının işlemlğine bağlı olan prosedürleri denetlemesini düzenlemektedir. Ayrıca bu Yasa Tasarısı ile gümrüğün bünyesine almadığı entelektüel sermayenin korunması önlemleri de belirtmektedir. Bu Yasa Tasarısının getirilmesinin en önemli nedeni UNMİK'in 6 Mayıs 2008 yılında getirmiş olduğu 2008/22 sayılı Yönetmeliğin entelektüel sermaye hakkını yeterli derebe korumaması ve Avrupa Birliğinin 1383/2003 sayılı Yönetmeliği ile uyumlu olmamasıdır. Bu Yasanın amacı, vasalet işletmeciliğın haksız rekabetçilikten ve aynı zamanda vatandaşların sağlık ve güvenliğinin korunması amacıyla sahteciliğın ve geciktirme olaylarının engellenmesi yönünde gümrüğün mevcut rolünün güçlendirilmesidir. Entelektüel sermaye hakkının korunmasına yönelik gümrük önlemlerine ait Yasa Tasarısının şu anda yürürlükte olan Yönetmeliğın kaldırılmasıyla vasalet ticareti engellemeyen ve entelektüel sermaye hakkının kullanılmasına müsaade etmeyen gümrük denetim yardımıyla entelektüel sermaye hakkının korunması önlemlerine destek inanmaktayız. Bütçe hesaplamasıyla kapsanmış ve bu yasanın uygulanışı süresinde meydana gelebilen ancak tahmin edilemiyen bütün hakuar 2009 yılına ait bütçe dağılımı çerçevesinde karşılanacaktır. 2010/11 dönemi için bütçenin planlaştırılması ve kabul edilmesi sürecinde sıralı bütçe bütçe prosedürü kapsamında karşılanmış olacaktır.

Dolayısıyla 7+ Parlamento Grubu olarak Yasa Tasarısının birinci okunuşunu kabule ediyoruz.

Teşekkürler!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit SLS, nuk kemi të paraqitur për fjalë. Fjalën e ka kërkuar deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për ministrat që janë prezentë dhe të gjithë deputetët brenda kësaj seance, Fatbardhësisht, shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave dhe të pronësisë intelektuale është një ligj që është dashur ndoshta edhe pak më herët, mirëpo për mundësinë që ka ardhur tash, mund të them se është ligji që e përforcon

edhe çështjen e doganave dhe çështjen e shtetësisë së Kosovës me gjithë pronësinë intelektuale e cila është anashkaluar, ndoshta jo me fajin e vetë Kuvendit apo me fajin e ekzekutivit por ndoshta me fajin e Rregullores së UNMIK-ut të cilën e potencoj ministri mjaft mirë që është dashur kaheër të ndërrohet. Mund të them se projektligji me të gjitha të metat teknike prapëseprapë është një projektligj i cili pas përmirësimeve të cilat do t'i pësojë në Komisionin funksional do t'i japë mundësinë e mbrojtjes shumë të mirë të çështjes së doganave - daljeve dhe hyrjeve të pronësisë intelektuale, markës, dizajnit, rregullimit edhe më evident të konkurrencës së lirë dhe abuzimeve intelektuale mirëpo në përgjithësi kisha të kërkoj që ky projektligj të pësojë ndryshime aty ku duhet po në përgjithësi projektligji i plotëson konditat e një shteti çfarë është Kosova. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kolegë të nderuar, nuk shoh ndonjë paraqitje tjetër për diskutim. Ministër, a e do fjalën apo s'e do? Ministri nuk ndien nevojë që të japë mendime plotësuese. Në seancë janë 65 deputetë. Regjia, bëhuni gati. Ju thërras ta votojmë ligjin në lexim të parë – Projektligjin për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale. Votojmë, tash!

Me 58, vota “për”, 1 abstenim dhe 2 “kundër” votohet Projektligji në lexim të parë për përmasat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Buxhet e Financa, si komision funksional,
- Komisionin për Legjislacion e Gjyqësi,
- Komisionin për Komunitete dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandimet.

Kolegë të nderuar, unë jap pushim deri në orën 14:00 dhe në orën 14:00 do të vazhdojmë punën. Faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI SABRI HAMITI: Kolegë deputetë, po vazhdojmë punën me seancën e pasdites. Në rend dite kemi pikën e pestë:

- **Shqyrtimi i Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2008**

Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin për Bankën Qendrore ia ka paraqitur Kuvendit Raportin për vitin 2008.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës, ka shqyrtuar Raportin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2008 dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë.

Raporti i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe rekomandimet e Komisionit u janë shpërndarë të gjithë deputetëve.

Thërrasim përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës, zotin Ahmet Shala, ministër për Ekonomi e Financa ta jap fjalën e vet. Urdhëro, zoti ministër!

(Ndërhyrje nga deputetët)

Drejtimin e seancës e merr Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Gani, ne e kemi një rend dhe unë e bëj rendin kush ka për të folur. Kjo, le të dihet, ju lutem! Fjalën, sipas renditjes e ka përfaqësuesi i Qeverisë së Kosovës, ministri Ahmet Shala. Pas ministrit, e merr fjalën ti. Urdhëro, ministër! Ju duhet ta dini, është njëfarë rendi dhe pastaj e ke fjalën ti.

(Ndërhyrje e Gani Kocit, pa kyçje të mikrofonit)

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar, zoti Kryetar!
Të nderuar....

KRYETARI: Ministër, ju e dini se Parlamenti e ka një organ që përfaqësohet nga të gjitha grupet parlamentare, është Kryesia e Parlamentit dhe Kryesia e Parlamentit ka vendosur që jo vetëm për Bankën Qendrore, por edhe për organet e tjera që i përgjigjen Kuvendit. Nuk është kundër kushtetuese. Do të thotë, Parlamenti e ka zgjedhur Qeverinë dhe Qeveria i mbulon disa sfera dhe sferat që i mbulon....

(Ndërhyrje)

Po mirë, le të flasë ministri për sferën e vet që e ka, ju si komision pastaj.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar, Kryetar!

Konsideroj që për afërsisht të njëjtat shqetësime edhe unë i kam. Natyrisht, unë i jam përgjigjur ftesës së Kryesisë së Parlamentit dhe si Qeveri besoj që e kemi shprehur respektin tonë ndaj këtij institucioni të rëndësishëm. Përndryshe, para kësaj audience të respektuar dhe publikut, në bazë të Kushtetutës do të duhej që guvernatori ose kryetari i Bordit të BQK-së të japë raport këtu.

Unë e kam përgatitur, natyrisht, raportin dhe në qoftë se ju konsideroni se duhet ta lexoj, unë do ta lexoj. Raporti nuk ka ndonjë devijueshmëri nga ajo që e ka përgatitur bordi, do të jetë vlerësim i juaj dhe vendim i juaj nëse duhet ministri ta paraqet apo duhet guvernatori.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Unë nuk di se guvernatori a ka nevojë të jetë a jo. Komisioni e ka bërë raportin, Komisioni për Buxhet dhe Financa është përgjegjësi kryesor për Kuvendin. Ju lutem, ju nëse bini rekomandime, çfarëdo rekomandime, mendoj që Kuvendi duhet t'i votojë. Prandaj, nuk ka nevojë të bëjmë zhurmë. Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Buxhet e Financa, zoti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

E di që edhe ju jeni në zor prej shumë anëtarëve të Kryesisë që nuk donë t' i shohin njerëzit këtu, njerëzit që i ka zgjedhur vetë ky Kuvend dhe janë përgjegjës para këtij Kuvendi.

Në qoftë se unë nuk dua ta shoh një autoritet, të një autoriteti kushtetues, si person, është çështje tjetër, por është e drejtë institucionale që ai autoritet që zgjidhet nga Kuvendi, t'i përgjigjet Kuvendit.

Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk i bëhet avokat Bankës Qendrore të Kosovës, nuk i bëhet avokat as Qeverisë dhe ata duhet ta mbrojnë vetveten, punën e tyre dhe veprimet e tyre. Kjo nuk është hera e parë që po na ndodh. Na ka ndodhur edhe në rastet e tjera, prandaj është mirë të disiplinohemi edhe si Kryesi, edhe si Kuvend në këtë çështje.

Neni 140 i Kushtetutës thotë: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës....

Ju lutem! ... Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është autoritet i pavarur dhe i përgjigjet vetëm Kuvendit. Në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës shkruan se guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, jo ministri, as kryeministri dhe asnjë ministër tjetër, së paku një herë në vit, do t'i paraqesë Kuvendit të Kosovës raport gjithëpërfshirës për gjendjen në sektorin financiar të Kosovës.

Në rekomandimin e Komisionit për Buxhet e Financa, pika 2, nuk e di a e keni lexuar ju të Kryesisë, i rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës që në seancën plenare, me rastin e shqyrtimit të raportit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2008 të ftohet guvernatori i Bankës Qendrore që të raportojë në Kuvend. Këta i kanë pasur edhe rekomandimet, pse nuk e kanë bërë ftesën, unë nuk e di? Komisioni ka propozuar që ai raport të shqyrtohet në Kuvend dhe të miratohet sipas Kuvendit, megjithëse ligji nuk e thotë se duhet të votohet. Është çështje e Kuvendit a do ta votojë a s'do ta votojë, por që këtu për Bankën Qendrore autoritet i vetëm për raportim është guvernatori.

KRYETARI: Të nderuar deputetë, në mbledhjen e fundit të Kryesisë, që kemi vendosur për këtë rend të ditës, ku kanë qenë edhe shefat e grupeve parlamentare, jo që jemi marrë vesh, por jemi konsultuar. Për shembull, në Republikën e Shqipërisë, përveç anëtarëve të Qeverisë, në Kuvend raporton vetëm Avokati i Popullit. Dhe ne, vërtet, duhet ta vendosim një praktikë.

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës ka bërë një raport, Bordi i Bankës Qendrore. Raporti i ka ardhur Kuvendit përmes Komisionit... Jo, s'po e arsyetoj askënd, por po tregoj qysh është praktika parlamentare.

Komisioni përkatës ka shqyrtuar raportin dhe komisioni s'ka nevojë ta ketë hiq guvernatorin e Bankës, por mbi bazën e raportit bën rekomandime dhe Kuvendi mbi bazën e rekomandimeve dhe të debatit që zhvillohet në Kuvend merr vendime, qëndrime dhe rekomandime të tjera të nevojshme në raport me atë që e ka raporti i Bordit të Bankës Qendrore. Prandaj, është apo s'është guvernatori, ne e kemi raportin dhe ne vendimet i marrim mbi bazën e raporteve dhe jo mbi bazën e pamjes fizike të guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës. Prandaj, mendoj se jemi këtu në rregull. Prandaj, nëse do komisioni, kryetari i komisionit le ta marrë fjalën, le ta thotë mendimin e komisionit, në mënyrë që të zhvillohet debati për raportin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Mendoj që kjo duhet të jetë procedura, s'kemi çka të merremi me individë të ndryshëm. Kush e do fjalën? Po jo për ligjet, as për Kushtetutën, për raportin. Kryetari dhe komisioni janë të obligueshëm t'i japin mendimet, qëndrimet e tyre për raportin. Për çështje të tjera mos të hyjnë se s'janë të tyre. Kush e do fjalën për raportin, mund ta marrë fjalën, sipas renditjes.

(Ndërhyrje)

Jo, në emër të grupit një herë, po edhe në emër të komisionit. Kryetari i komisionit, pastaj janë shefat e grupeve parlamentare. Fjalën e ka deputeti Gani Koci, edhe një herë, por jo për Kushtetutën, por për raportin që e keni shqyrtuar.

GANI KOCI: ... Unë po flas për rekomandimet e komisionit. Një nga rekomandimet është që të ftohet guvernatori i Bankës Qendrore këtu.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Unë nuk kam faj që anëtarët e Komisionit janë të papërgatitur për të diskutuar për raportin. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë do të flas në emër të Grupit Parlamentar, sepse në Komision e kemi shqyrtuar, ne e kemi pasur guvernatorin e Bankës. Kemi kërkuar që ta ftojme këtu, s'qenka këtu, unë po flas në emër të Grupit Parlamentar.

Raporti i Bankës Qendrore të Kosovës...

(Ndërhyrje)

Po, është dashur të vijë, sepse në Komision kemi vendosur të vijë dhe Kushtetuta e kërkon të vijë, por s'ka ardhur dhe tash po e kryejmë këtë punë.

Raporti i Bankës Qendrore ka një material përmbajtësor, është i përgatitur sipas standardeve ku është i përfshirë edhe Raporti i Auditorit të Pavarur.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës vlerëson të arriturat që janë bërë gjatë vitit 2008 e të cilat janë të përfshira edhe në këtë raport.

Ekonomia e Kosovës edhe përkundër krizës globale ekonomike, efektet e së cilës reflektojnë edhe në sektorët realë të ekonomisë, kishte një performancë relativisht të mirë, me një rritje ekonomike prej 5%. Kjo rritje ishte si rezultat i rritjes së konsumit, të investimeve publike dhe, çka është më e rëndësishmja, të shpenzimeve efektive të buxhetit të Republikës së Kosovës.

Sipas këtij raporti, sektori financiar ka shënuar një performancë relativisht të mirë duke shënuar rritje të profitit neto për 36.4 milionë euro, që është 8.7 më i lartë në krahasim me vitin 2007.

Të hyrat ishin 24% më të larta se në vitin 2007. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 16.5%, kurse kreditë e këqija janë zvogëluar në vitin 2008 në 3.3%, nga 4.1% sa ishin në vitin 2007, gjë që tregon se sektori bankar ka pasur shkallë të qëndrueshmërisë.

Bankat private kanë disponuar me kapital të mjaftueshëm për të menaxhuar me kriza. Ka pasur rritje të depozitave për 26.4% dhe kredive prej 32.7%, ku kryesisht janë financuar konsumi dhe investimet në sektorin privat.

Rritja e nivelit të depozitave dhe kredive është shenjë e mirë se biznesi po gjen përkrahje në sektorin bankar, se sektori bankar i Kosovës është duke u zhvilluar dhe duke e rritur rolin e tij në zhvillimin ekonomik edhe pse kjo rritje nuk është në nivelin që do të dëshironim, ashtu siç nuk është në nivelin e dëshirueshëm as struktura e kredive e cila nuk ndryshon nga vitet e kaluara.

Nëse shikojmë faqen 34 të Raportit, vërejmë se në kuadër të kredive dominojnë ndërmarrjet që merren me tregti, në 42.6%, nga gjithsej kreditë e sistemit bankar, gjë që dëshmon edhe strukturën e ekonomisë së Kosovës që dominohet nga ky sektor, kurse sektori me pjesëmarrje më të ulët në kreditë bankare vazhdon të mbetet sektori i bujqësisë, me vetëm 4.1%, në gjithsej kreditë, edhe pse vërehet një rritje vjetore prej 29% në kreditë e lëshuara këtij sektori.

Mbetet të bëhet më shumë nga ana e institucioneve përkatëse, por edhe nga ana e bankave që të vlerësojnë se çfarë reforma duhet ndërmarrë ashtu që të ulët kostoja e kredive, të përfitojë ekonomia, të përfitojnë qytetarët dhe të mos lëkundet afarizmi i bankave. Pra, të vlerësojnë mundësinë e krijimit të sektorëve tjerë prodhues që do të ndikojnë drejtpërdrejt në reduktimin e importeve dhe do të stimulonin eksportin, duke reflektuar në mënyrë direkte në përmirësimin e bilancit tregtar dhe në rritjen e ekonomike.

Kosova, është e varur prej deficitit të lartë tregtar rreth 43%, siç thuhet në këtë raport, që ka ndikuar në deficitin e llogarisë rrjedhëse, prandaj çfarëdo hapi që bëhet në këtë drejtim, do të japë efektet pozitive.

Siç shihet nga raporti, në Kosovë operojnë 8 banka komerciale, ku vetëm 2 prej tyre kanë pronësi vendore. Rritja e numrit të bankave ka arritur konkurrencën që ka ndikuar në ngushtimin e dallimit në mes të normave të interesit në kredi dhe në depozita. Megjithatë, është me rëndësi të ceket edhe një gjë, se sistemi bankar i Kosovës, megjithatë është i koncentruar në 3 bankat më të mëdha, ku janë të përqendruar 90% të asetëve, 88% të depozitave dhe 81.5% të kredive. Institucionet mikro-financiare mbulojnë 7.3% të gjithsej kredive të sektorit financiar në Kosovë. Sipas raportit, operojnë 16 institucione mikro-financiare, të cilat kanë lëshuar 50.127 kredi me vlerë prej 93.6 milionë euro në totalin e sistemit financiar. Nga këto shënime shihet se këto institucione janë mjaft prezent. Shtrohet pyetja- Sa arrin ta mbikëqyrë Banka Qendrore e Kosovës veprimtarinë e tyre? A është dashur të punohet më shumë në ndryshimet e ligjeve që të rregullohet statusi i tyre, që ato të kalojnë në organizata biznesi kur dihet se ato ushtrojnë aktivitet përfitues dhe duhet t'i nënshtrohen taksimit?

Banka Qendrore, vërehet se ka punuar në drejtim të bashkëpunimit ndërkombëtar në lëmin e mbikëqyrjes financiare gjatë vitit 2008 duke bashkëpunuar me Bankën Qendrore të Republikës së Shqipërisë, të Sllovenisë, Kroacisë, me Autoritetin Rregullativ të Mbikëqyrjes së Turqisë dhe Austrisë, por mbetet shumë për të dëshiruar në këtë drejtim.

Në këtë raport është përfshirë edhe raporti i Auditorit të Pavarur, ku sipas këtij auditivi, pasqyrat financiare paraqesin gjendjen e vërtetë financiare të Bankës, mirëpo sipas auditorit kapitali dhe llogaritë rezervë të përgjithshme duhet të jenë së paku të barasvlershme me 5% të shumës totale të gjendjeve kreditore të gjitha llogarive të mbajtura në librat e Bankës në fund të çdo viti financiar. Një gjë e tillë është e paraparë me Ligjin për Bankën Qendrore, por nuk është përmbushur një kërkesë e tillë nga ana e Bankës Qendrore të Kosovës.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës përkrah rekomandimin e Komisionit për Buxhet e Financa, duke mbrojtur qëndrimin se ka nevojë për të bërë sa më shpejt plotësim-ndryshimet e Ligjit për Bankën Qendrore, me të cilin do të evitoheshin zbrazësitë që i ka ky ligj. Duhet të hartohet Ligji për bankat komerciale, Ligji për sigurimet, Ligji për letrat me vlerë, Ligji kundër pastrimit të parave, Ligji për borxhet, Ligji për raportimet financiare, si dhe legjislacioni tjetër që rregullon fushën financiare. Faleminderit për vëmendjen!

KRYETARI: Më fal, Lutë, unë, rekomandimin e parë të Komisionit dua t'ua lexoj juve:

“I rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që në seancën plenare të miratojë Raportin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2008”. Është rekomandim i Komisionit, një.

Dy, ligji thotë: “Banka Qendrore i raporton Kuvendit”, por nuk thotë që është e domosdoshme prezenca e guvernatorit të Bankës Qendrore.

Jo, po e interpretoj qysh është. Sigurisht që është mirë t'i shikoni edhe praktikatat tjera parlamentare, a thua të gjitha agjencitë që i përgjigjen Kuvendit duhet të vijnë dhe të raportojnë në Kuvend? Unë nuk mendoj që është kështu. Pra, nëse komisioni ka rekomanduar që ky Kuvend ta miratojë raportin, atëherë çka po i duhet guvernatori i Bankës. Për mua është thjesht absurde. Fundi i fundit, kjo seancë ka të drejtë t'i pranojë këto rekomandime ose të hartojë tjera, por kjo bëhet mbi bazën e debatit. Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Lutfi Haziri. Po, ti e çove dorën, burrë! Urdhëro, Armend!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit! Është shumë e arsyeshme këmbëngulësia juaj, edhe si Kryetar i Kuvendit, edhe si Kryetar i Kryesisë që të këmbëngulni dhe ta interpretoni në formën tuaj, por ne gjithmonë po bazohemi në Kushtetutë dhe në ligj. Edhe si grup parlamentar e mbështesim raportin, e kemi shqyrtuar, e kemi mbështetur edhe në seancën e kaluar, zoti Kryetar, por për këtë raport duhet të raportojë guvernatori i Bankës Qendrore, pa marrë parasysh interpretimet apo rekomandimet e Komisionit për Buxhet e Financa.

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Raportin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2008. Raporti në fjalë i përmbush standardet teknike të raportimit. Pra, është gjithëpërfshirës dhe afron një pasqyrë të përgjithshme financiare në vend, në këtë rast, duke parë edhe raportin e Auditorit të jashtëm.

Grupi Parlamentar i LDK-së e vlerëson raportin për vitin 2008 si dhe zotohet se do të angazhohet maksimalisht që këtij institucioni, si kategori kushtetuese, t'i përgjigjet pozitivisht në përkrahjen e kërkesave dhe nevojave në plotësimin e zbrazësive ligjore dhe përgatitjen e ligjeve në fushën financiare. Faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Shkumbin Demaliaj e ka kërkuar fjalën.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Pjesëtarë të Kabinetit qeveritar, kështu të mangët, se pjesa tjetër në krye me Kryeministrin janë në fushatë zgjedhore, s'e kanë parë të arsyeshme sot të vijnë as në

seancë bile për t'iu përgjigjur të paktën pyetjeve të deputetëve. Kemi ardhur te kjo pikë e rendit të ditës, që në radhë të parë, në rreshtimin e saj kemi vërejtje. Vërejtja është e bazuar se ne si Kuvend mund ta shqyrtojmë secilindo raport që mund të vijë këtu, por nuk përfshihet edhe miratimi i këtij raporti nga Kuvendi, çka do të thotë se ne vetëm mund të humbim kohë. Shkruhet, thotë: Shqyrtimi i raportit të Bankës Qendrore dhe jo edhe miratimi i tij. Ne i humbim 5-6 orë kohë duke folur kush ka të drejtë, kush duhet të vijë dhe kush s'duhet të vijë. Ne kemi bërë qejf me drejtorin, ka qenë një herë këtu, s'di çka ka raportuar. Është e dyta herë që na vjen për 4 muaj raporti i të njëjtës bankë, ndërkaq herën e kaluar veç ka folur para foltores, ka shkuar dhe ka hipur në aeroplan dhe ia ka shkelur për Londër dhe ne kemi bërë zhurmë këtu edhe 5 orë tutje, çka do të thotë se nuk është serioze, nuk iu ka përgjigjur përfundimisht kërkesave të deputetëve dhe vërejtjeve të tyre. Unë konsideroj se, për mua personalisht dhe për Grupin ky është drejtor e jo guvernator, sepse dihet në çfarë forme ka ardhur dhe nuk është rregulluar me çështjeve të tjera procedurale. Raporti brenda metodikës së përpunimit të tij, krejtësisht si metodë krahasuese, është një kronologji e ngjarjeve që janë zhvilluar brenda këtij mekanizimi prej vitit 2000, 2007, 2008 dhe është më shumë një vështrim historik dhe ngërthen me vete – nuk pat faj ministri i Financave, sepse është krejt pjesë e raportit të punës së tij. Më mirë do t'i kishte thënë ministri këto çka i ka përfshirë ai, brenda këtyre segmenteve se sa të jetë një raport i Bankës Qendrore.

Kryesisht është biseduar shumë për Trustin e Kursimeve Pensionale në Kosovë gjatë dy vjetëve të fundit. Kah mesi i vitit 2008, thuhet në raport, kanë arritur që ta marrin një masë preventive Banka Qendrore dhe të takojë Bordin e Trustit Pensional dhe i ka dhënë rekomandime se mjetet e Trustit, mundësisht, të depozitohen në një nga bankat e Kosovës.

Dhe, përfundimisht, për të mos u marrë kohë më shumë, ne nuk e përkrahim këtë raport, sepse nuk dihet a do të miratohet a s'do të miratohet nga Kuvendi, si Grup Parlamentar dhe raporti nuk i është drejtuar Kuvendit, zoti Kryetar. Në faqen numër 1 të këtij raporti, ky raport destinacionin e ka te Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk thotë për Kuvendin, raport për Kuvendin e Republikës por për Presidentin, mund ta shihni të gjithë në faqen e parë të këtij raporti. Ne nuk jemi kundër që ky raport t'i shkojë edhe Presidentit por duke parë deri tash zhurmën se kush ka të drejtë e kush nuk ka të drejtë, ai nuk e pranon as Kuvendin si vend raportues vetë “guvernatori” apo drejtori i Bankës Qendrore në këtë rast.

Unë do ta ndërpres fjalën time këtu, duke ditur se në qoftë se kanë disponim edhe anëtarët e tjerë të Grupit Parlamentar të AAK-së të flasin për raportin, ta japin ndonjë qëndrim të tyre profesional rreth këtij raporti, këtu e ndërpres dhe jemi kundër, ose ta dimë paraprakisht a do të miratohet ky raport sot a jo dhe destinacioni i tij nuk është për Kuvendin? Kërkoj falje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Raporti është i destinuar për Kuvendin, një. Dy, Komisioni për Buxhet e Financa, që të gjitha grupet parlamentare i kanë anëtarët e vet në atë komision, thotë, rekomandimi kryesor i komisionit është:” I rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës – seancës plenare të miratojë raportin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2008”. Ky është pra rekomandimi i komisionit dhe askush nuk e kundërshtoi, asnjë anëtar i komisionit.

(Ndërhyrje)

Kjo është kryesorja. Këta e kanë rekomanduar miratimin e raportit, mua nuk po më duhet syreti i guvernatorit të Bankës. Shkojmë më tej. Kush e do fjalën në emër të Grupit Parlamentar. Myzejene Selmani, në emër të AKR-së.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje për ministrat prezentë dhe për të gjithë deputetët brenda kësaj seance!

Grupi Parlamentar i AKR-së shqyrtoi Raportin vjetor të Bankës Qendrore, e cila edhe në bazë të Ligjit të Bankës Qendrore, në koordinim me politikat e Qeverisë, Banka Qendrore ka autoritet të sigurojë likuidimin në sektorin bankar. Mirëpo, sa ka qenë i qëndrueshëm sektori bankar mund të themi se në këtë raport përshkruhet mjaft mirë, mirëpo edhe vërejtjet e Fondit Monetar Ndërkombëtar janë që sektori bankar ka qenë stabil, së paku në 2008-n dhe mund të qëndrojë edhe në vitin 2009.

Raporti tregon disa shifra dhe ashtu si duket, jo fort reale, ku parashihet llogaritja e GDP-së, e tregtisë së jashtme, tregtisë së brendshme, mirëpo të gjitha janë llogaritur në bazë të kostos së shpenzimit.

Rezultatet e Bankës Qendrore, në realitet, qëndrojnë ndryshe. Sa është mbikëqyrja nga Autoriteti Qendror i Bankës Qendrore në bankat e Kosovës, mbetet të shihet edhe pas miratimit të një varg ligjeve për të cilat, pasi sot është prezent këtu me ne ministri i Ekonomisë dhe Financave, duhet të ceket se infrastruktura ligjore për Bankën Qendrore duhet të kompletohet duke marrë parasysh Ligjin për sigurimet, që u cek edhe nga kolegja e mëparshme, Ligjin për letrat me vlerë, Ligjin për pastrimin e parave e cila ndikon absolutisht shumë në autoritetin qendror të bankave dhe ruajtjen e depozitave të cilën ende nuk e kemi.

Mirëpo, Banka Qendrore për Trustin, miratoi Bordin, fatbardhësisht dhe besoj se do të bëhet një rezultat i mirë, mirëpo gjasat mbeten të shihen ende. Por, te Fondi i Mirëbesimit ende Banka Qendrore e Kosovës nuk mund të luajë rolin e vet si autoritet i cili i përgjigjet këtij Kuvendi për humbjet të cilat mund të shkaktohen nga luhatja financiare e tregut botëror.

Grupi Parlamentar i AKR-së ka shumë vërejtje në këtë raport dhe shihet se në përgjithësi mund të bëhen përmirësime në raportin e autoritetit qendror të bankave të Kosovës për të mirën e gjithë sistemit financiar të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Së pari, Grupi Parlamentar i LDD-së nuk e përkrah një raport të tillë dhe e konsiderojmë të drejtë kërkesën e deputetëve që të jetë prezent guvernatori i Bankës, mirëpo për ne do të ishte e pajustificueshme në qoftë se një kërkesë e tillë nuk korrespondon njëkohësisht edhe me vlerësimin për këtë raport. E kemi bërë ne një vlerësim që Grupi Parlamentar i LDD-së e jep një vlerësim negativ, prandaj nëse i japim vlerësim pozitiv këtij raport atëherë edhe prezenca e guvernatorit të Bankës në këtë seancë nuk ka kuptim. Ne kërkojmë të jetë prezent për arsye se duhet t'i përgjigjet disa pyetjeve të cilat Grupi Parlamentar i LDD-së pretendon t'i adresojë në adresë të guvernatorit të Bankës.

Raporti si raport nuk përkon me raportin e një institucioni serioz. Dikush nga parafolësit u thirr që edhe ministri mund të japë përgjigje, mirëpo në bazë të këtij raporti mund të japë përgjigje edhe drejtori i Entit të Statistikave. Ky raport në qoftë se ia largojmë kopertinat, atë që e kam përsëritur edhe në seancën e kaluar, atëherë unë nuk di se në çka mund të thirremi apo në çka mund të përmbahemi në debatin tonë.

Ajo çka duhet të adresohet me këtë rast, janë dy-tri çështje të cilat do të duhej të pasqyroheshin në raportin e Bankës Qendrore.

Grupi Parlamentar i LDD-së kërkon që së paku në këtë raport - përgjigje nga ana e ministrit lidhur me mbikëqyrjen e sistemit bankar nga Banka Qendrore, për këtë duhet guvernatori i Bankës të jep përgjigje dhe të mos ofrojë statistika që i ka marrë nga institucionet tjera të cilat janë të njohura edhe ashtu për deputetët e Kuvendit të Kosovës. Kërkojmë përgjigje prej guvernatorit të Bankës lidhur me pasqyrën e menaxhimit të riskut kreditor duke ditur se të gjitha këto bëhen me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së sistemit bankar. Ajo çka duhej të japë përgjigje guvernatori i Bankës është lidhur me konstatimin se kemi sistem të qëndrueshëm bankar, ndërsa në anën tjetër rritja e përqindjes së kredive të këqija në vitin 2008 sa ishte 3.3% deri në maj të 2009 kemi rritje në 3.6%. Pra është një diskrepancë në mes të deklarimeve dhe asaj çka është faktike. Ajo çka duhej guvernatori i Bankës të përgjigjet në pyetjen kemi të bëjmë lidhur me menaxhimin e parasë së fondeve dhe të jep përgjigje në këto dy çështje.

I nderuar zoti Kryetar,

Nuk kemi çka të flasim për raport për arsye se nuk përkon me obligimet, i cili adresohet në bazë të ligjit për Bankën Qendrore të Kosovës dhe mund vetëm nëse shkojmë në nenin 6 – kompetencat e veçanta të Bankës Qendrore dhe nëse shkojmë dhe i lexojmë një pas një, atëherë asnjë përgjigje lidhur me kompetencat dhe punën që do të duhej të bënte Banka Qendrore nuk përfshihen në këtë raport. Prandaj unë nuk di çka do të diskutohej, prandaj patjetër se do të kërkohej llogari dhe përgjigje së paku gojore nga ana e guvernatorit të Bankës. Ajo çka mund të theksohet me këtë rast se pavarësisht synimeve dhe nuancave të ndryshme në mes të deputetëve të pozitës, guvernatori i Bankës Qendrore është zgjedhur nga Kuvendi me propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Prandaj edhe Qeveria e Republikës së Kosovës ka përgjegjësi që para këtij Kuvendi të ofrojë përgjigje lidhur me të gjitha këto çështje të cilat i ceka më parë. Grupi Parlamentar i LDD-së nuk e përkrah këtë raport dhe kërkojmë nga deputetët që këtij dokumenti t'i qasen, në mënyrë serioze në mënyrë që ta ruajnë autoritetin e Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe unë vërtet po kërkoj që të ruajmë autoritetin e Kuvendit, por për hir të shumë gjërave dua të them se kur është marrë vendimi që në Kryesi të mos të jetë guvernatori, kanë qenë të gjithë anëtarët e Kryesisë që vijnë nga të gjitha grupet parlamentare. Pra, kanë qenë edhe kryetarët e grupeve parlamentare dhe të gjithë janë dakorduar që të mos vijë, por të shqyrtohet raporti nga deputetët. Do të thotë, po ju them, kjo është kështu dhe asnjë kandidat nuk ka qenë kundër kësaj, një.

E dyta, askush nuk na tha që kur është shqyrtuar raporti në komision dikush nga anëtarët e grupeve politike ka qenë kundër këtyre rekomandimeve. Rekomandimet do të thotë janë të përbashkëta të të gjithë anëtarëve të grupeve politike që janë në Kuvend dhe për mua nuk është e arsyeshme që në komision, në Kryesi ku janë edhe shefat e grupeve parlamentare, të mos ketë asnjë qëndrim kundër dhe tash këtu bëjmë fushatë me qëndrime të kundërta. Mendoj që nuk po ua ruajmë autoritetin as grupeve parlamentare,

as komisioneve, as Kuvendit. Prandaj, unë vërtet po bëj ftesë që ta ruajmë këtë. Unë po e lexoj vetëm një fjali të anëtarit të Kryesisë që vjen nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, në mbledhjen kur është marrë ky vendim, në qoftë se një sektor i takon Ministrisë së Financave, Qeveria duhet t'i përgjigjet Kuvendit në parim, jo tjetërkush. Prandaj, po them vendimi ka qenë unanim i shefave të grupeve parlamentare, i anëtarëve të Kryesisë që guvernatori të mos vijë, por të shqyrtohet i raporti i autoritetit qendror ose Bankës Qendrore të Kosovës. Kjo ka qenë ajo që është dhe sot po dalin mendime të kundërta që njerëzit mund edhe t'i hanë fjalët e tyre.

(Ndërhyrje)

Vazhdojmë. Fjalën e ka Grupi” 7+”. Kush e ka kërkuar fjalën? Nuk ka.

Nga Grupi Parlamentar i SLS? Nuk ka.

Atëherë, vazhdojmë... Jo, komisioni e ka kryer fjalën, tash është radha e deputetëve.

(Ndërhyrje)

Atëherë, shkojmë rend. Fjalën e ka kërkuar deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Paraprakisht, sepse shpeshherë po tentohet që disa të tërhiqet nga përgjegjësia Qeveria duke shpërndarë përgjegjësinë me Kuvendin. Unë po e theksoj edhe një herë se drejtori menaxhues ka qenë propozim i Qeverisë, të cilin, siç e dimë, deputetët e koalicionit qeveritar e kanë votuar dhe e bashi me të shëndoshë, kështu që mos u mundoni të na qitni edhe ne të tjerëve se unë nuk e kam votuar, por edhe shumë nga opozita, andaj nuk marrim pjesë në këtë mëkat. Këtë duhet ta qartësojmë njëherë e përgjithmonë. Shumë gjëra desha t'i them, mbase u ndryshua pak, po them deputetët e koalicionit qeveritar, sepse edhe guvernatori e di që veç kjo qeveri e ka bërë atë guvernator se kurrkush tjetër me mend në krye s'e kishte bërë, andaj edhe me këtë raport ai mundohet që ta shpërblejë Qeverinë, i retushon statistikën, sidoqoftë.

Po kthehem tash për atë që desha ta them. Në këtë raport unë të paktën nuk pash asgjë të shkruar pse kamatat në Kosovë janë më të lartat në rajon? Çka ka bërë Banka Qendrore apo çka s'ka bërë Banka Qendrore duke i përdorur mekanizmat e saj për të ndikuar, qoftë në mënyrë direkte, qoftë indirekte në këto kamata. Siç dihet, norma mesatare e interesit në kredi konsumuese të industrisë financiare në Kosovë është 12.5%, ndërsa individualisht kjo normë shkon deri në 17.5%, madje për disa kredi konsumuese, disa banka aplikojnë madje edhe kamatë deri 24%, po them për afatet kohore 24 muaj. Ndonëse ky raport pak në faqet 31 e 32, nëse e lexoni, është munduar t'i arsyetojë kamatat, por në mënyrë shumë të zbehtë, duke përmendur se konkurrenca po rritet, përmend këtu këtë Bankën Turke, këtë TEB, që është futur, por megjithatë kamatat janë më të mëdhatë në rajon, pra, zoti ministër, se shpesh e përmendët tregun, konkurrencën në Kosovë, s'po jep rezultat. Mbase kemi të bëjmë me një situatë të oligopolit, pra kemi një marrëveshje në mes bankave apo secila e përcjell njëra shokun në aplikimin e politikave të tyre që është shumë normale. Çka tjetër të thuhet këtu, po them edhe një herë atë që e tha zoti Zeneli, se është një raport për“Shkup e Shkodër” i shkruar, ka gjithçka dhe asgjë. Nëse e merrni për shembull, e këqyrni faqen 13 dhe 15, ku na mbajnë ligjëratat për ekonominë globale, unë ma merr mendja se kur e kanë shkruar këtë, e kanë pasur parasysh ministrin e Ekonomisë dhe të Financave t'ia shpjegojnë se çka po ndodh për shkak se ai sa herë që del në foltore, shihet se nuk e ka kuptuar ende çka po ndodh në tregun global, sidomos me ato sihariqet e tij se si ministri i Ekonomisë së Gjermanisë e

ka huq prognozën për rritjen ekonomike e tjera, që shpresoj se përkthyesit nuk ua kanë përkthyer këtyre ndërkombëtarëve, se qeshin çka ndiejnë prej ministrit.

Pastaj, po them, në faqe 74 flet për Trustin, na flet gjithçka, na përshkruan, por jo se çka ka bërë Banka Qendrore duke iu referuar Ligjit për pensionet, që e ka atë autoritet, aty nuk na flet asgjë. Pastaj e kemi, tash të mos shkoj faqe për faqe, gjithmonë, po flas, në faqe 82 është edhe një sihariq, mos të them karakteristik. Flet për furnizimin e monedhave. Unë si qytetar i Kosovës asnjëherë nuk marr kusur 2 cent, as 1 cent. Asnjë biznes nuk ma kthen kusurin 2 cent e 1 cent, e këtu na thotë se Banka Qendrore me rregull e furnizon tregun me këto monedha, që praktika e demanton, nuk është e vërtetë. Pastaj shkojmë te faqja 92, flitet për strategjinë investuese, që kushdo mund ta lexojë faqen 92, po them gjithmonë, ku flet se 51% të letrave me vlerë Qeveria me afat të pjekurisë, jo më shumë se 3 muaj, i ka investuar, por nuk na tregojnë vlerën e kuponit, vlerën e kamatës as vërtetimet, cilat vërtetime, cilat certifikata janë investuar? Ndonëse na japin shumë informata të tjera që, po them, nuk na interesojnë fare, siç tha edhe parafolësi, janë më shumë statistika të Entit Statistikor. Unë e kam një informatë që edhe mediat e kanë publikuar, është auditori gjeneral, pikërisht sa i përket letrave me vlerë, thuhet se 266 milionë janë investuar në letra me vlerë, janë qitur jashtë, por nuk është marrë asnjë cent. Kjo është në kundërshtim me atë që flitet në faqen 92, domethënë kuponin e tjera. Këtu nuk le tjetër për të dyshuar, pos dikush është kah bën diçka jashtë ligjit. Pse nuk shpjegohet se ku janë investuar ato para? Madje, përfliten edhe përfaqësues këtu në Kosovë që janë të Bankës Botërore, se edhe ata janë të involvuar këtu, madje edhe familjarët e tyre, vëllezërit të cilët shpesh shihen në shoqëri me anëtarë të Kabinetit qeveritar dhe me bartësit e institucioneve të rëndësishme shtetërore. Unë po them, këtu duhet të involvohet menjëherë EULEX-i me organet e tyre dhe shpresoj se përkthyesit po e përkthejnë kështu tekstualisht çka po them, me ato institucionet e tyre të hetuesisë policore për shkak se është shumë e dyshimtë. Unë, zoti Kryetar, personalisht i kam shkruar nja 3-4 letra në Uashington Bankës Botërore për t'u ankuar për përfaqësuesit të cilët nuk sillen konform përshkrimit të punës së tyre. Mendoj se edhe Banka Botërore, me seli në Uashington, duhet të ndërmarrë, për shkak se janë shumë të dyshimta këto gjëra. Nuk kemi transparencë fare. Po them, ka shumë sende këtu për t'u folur, por i preka këto pak si, për mendimin tim, më delikate, më interesante për qytetarin e Kosovës. Edhe një herë po pyes, ku janë investuar ato para, në çfarë letra me vlerë, sa ka qenë kuponi, ku janë? Është shumë çështje e qartë, është një mekanizëm, duhet të jetë transparent. Në këtë raport nuk kam mundur ta gjej, për t'i ndalur dyshimet, për t'ia shëruar zemrat njerëzve, nuk janë para të vogla, janë 266 milionë. Po them edhe një herë, po iu referohem edhe një herë mediave publike, por edhe Auditorit të Përgjithshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! I kisha lutur deputetët që vërtet të jenë në rend të ditës. Deputet, unë kam respekt për fjalën tuaj, por nuk e di çfarë përgjigje keni marrë nga ata që u keni shkruar, por një gjë e di që të mos i bëni diskutimet për t'ua përkthyer, se mendoj që nuk është mirë. Vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti Naim Rustemi.

(Ndërhyrje nga deputeti)

NAIM RRUSTEMI: S'mund t'ia marr fjalën, se e kam shok atë. Driton, kërkoj falje, po më duhet të vazhdoj Driton, s'kam çka të bëj!

Në rregull, unë edhe herën e fundit kur kemi diskutuar për Bankën Qendrore, kam ngritur disa çështje që në shikim të parë nuk kanë treguar ndonjë interesim, megjithatë ata që

merren me ekonomi e dinë çka është hazardi moral. E kam ngritur si çështje, e kam ngritur edhe këtu, po shihet se edhe këto diskutime që po bëhen qysh në fillim të kësaj pike, po ngrenë dyshimet për moralin, hazardin moral që mbretëron në Bankën Qendrore të Kosovës.

Raportin e kam lexuar. Pajtohem me shumë prej kolegëve, por unë do të jem konkret dhe do të fokusohem vetëm në një pikë dhe kjo do të jetë tregu i sigurimeve.

Ky raport nuk është asgjë për tregun e sigurimeve. Ne e pranuan ose nuk e pranuan raportin, nuk kemi shumë çka të bëjmë, se ky raport është publikuar. Është publikuar në ueb-faqen e Bankës Qendrore të Kosovës, në dash pranoje, në dash mos e prano. Krejt çka mund të bëjmë ne, është që të japim disa sugjerime se çka mund të bëjmë në të ardhmen. Për shembull, unë mendoj se ky raport do të duhej shprehur qartë dhe në mënyrë transparente analizat për tregjet e sigurimeve dhe që të na japë një pasqyrë më të qartë se si është i ndarë tregu i sigurimeve, kompani për kompani sigurimesh.

Ky raport me asnjë shembull nuk e bën një shpjegim të tillë. S'e bën një shpjegim se kah është orientuar, nëpër të cilat kompani është i orientuar ky treg i sigurimeve.

Gjithashtu, edhe pse këtu në raport përmendet raportet – prime me dëme të shkaktuara dhe raporti i pagesave, prapë këtu do ishte shumë e arsyeshme që raporti t' i japë disa shpjegime apo të dhëna detale se cila kompani dhe sa paguan dëme kundrejt primeve të pranuar. Edhe pse raporti- prime me dëme të paguara është relativisht i ulët, është 31% në krahasim me të gjitha vendet evropiane, është mirë edhe për klientët dhe për qytetarët e Kosovës ishte dashur që këto raporte të bëhen për çdo muaj në ueb-faqen e Bankës Qendrore të Kosovës, sepse rregulla e parë e organizatave ndërkombëtare, siç është parim numër një, parim numër një i organizatave, siç është Asociacioni Ndërkombëtar i Mbikëqyrjes së Shoqatave të Sigurimeve, është që të ngritë transparencën dhe të shpalosë të gjitha informacionet për publikun. Me fjalë të tjera, transparenca në këtë proces është shumë e rëndësishme.

I tërë raporti i Bankës Qendrore të Kosovës, për shoqëritë e sigurimeve, atë që e mbulon e mbulon me një faqe e gjysmë. Një faqe e gjysmë, përkundër që qytetarët gati të gjithë familjarët e Kosovës kanë të bëjnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me sigurime, kanë të bëjnë në mënyrë të drejtpërdrejtë posaçërisht me ndonjë prej kompanive të sigurimeve. Kjo tregon se kompanitë e sigurimeve kanë shumë më shumë të bëjnë në drejtim të përmirësimit të shërbimit ndaj klientit. Që t' i shtyjme kompanitë e sigurimeve që të bëjnë më shumë ndaj klientit, duhet që Banka Qendrore ta luajë rolin e vet.

Dhe, duke u bazuar në standardet e OCD-së, konkretisht në praktikën e OCD-së, praktikën e mira të menaxhimit të pagesës së dëmeve nga kompanitë e sigurimeve, praktika numër 4, që është udhëzues për kompanitë e sigurimeve, raportimi dhe ofrimi i të dhënave me një kompletim adekuat të bazës së shënimeve, krijon mundësi në luftimin e pastrimit të parasë dhe normalisht detektimin më të lehtë të këtyre rasteve.

Në mënyrë hipotetike mund të themi se në rast se, për shembull, në rast se një dëm paguhet, është bërë dëmi prej 2.000 eurove dhe në rast se nuk ke data bazë të shënimeve dhe mbikëqyrje të vazhdueshme të kompanive të sigurimeve, atëherë mund të paraqitet mundësia që kompanitë e sigurimeve t' i afrojnë dëmin, të pranojnë dëm 5.000 euro, në mënyrë që i dëmtuari t' i marrë 2.500 euro. Këto janë praktika të OCD-së, nuk janë praktika që ne po i bëjmë. Kështu që kundër luftimit të këtyre dukurive që potencialisht

mund të paraqiten, forma më e mirë e kësaj dukurie që përmendet – pastrimi i parasë së pistë është që t'i publikojë raportet mujore se çka po ndodhë në tregun e sigurimeve.

Ky raport domosdoshmërisht është dashur të tregojë se qysh është i ndarë tregu i sigurimeve në Kosovë. Nuk po flasim për 1.000 euro, po flasim për qindra milionë, për dhjetëra milionë, po flasim.

Unë posaçërisht i shikova ueb-faqet e HNB-së Kroate, apo AZN-së Sllovene, apo edhe autoritetet AMF-së në Shqipëri dhe përderisa këto autoritete i kanë prej fillimit deri në fund, prej a) deri në zh) të gjitha instruksionet dhe informacionet për mbikëqyrje, që i jep bruto-prime për secilën kompani, për secilën kompani veç e veç dhe bëjnë shpalosjen e të gjitha informatave për bruto-primin dhe dëmet e paguara për secilin veç e veç, në Kosovë afrohet një raport i vitit 2008, në fund të 2009-tës. Kjo e ka njëfarë non-sensi në vetvete dhe ne po e shqyrtojmë. Asgjë, s'kemi çka të bëjmë, se është i botuar, është publik, është shtypur edhe në letër të fortë, është edhe në ueb-faqe të Bankës Qendrore të Kosovës. Ne vetëm mund të flasim e të flasim dhe disa prej ankesave tona, disa nga kërkesat tona që janë të hapura dhe të sinqerta është mirë t'i marrë Banka Qendrore e Kosovës, sepse na lë shumë për të dyshuar, që po dua për ta rrumbullakësuar edhe me atë fjalën fillestare që e thashë– hazardi moral që është si fenomen në Bankën Qendrore të Kosovës, na bën ne për të dyshuar se atje mund të ndodhin edhe gjëra të tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra Kuçi dhe Manaj,

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Lidhur me raportin unë nuk kam çka t'i shtoj diskutimit të koleges Hadergjonaj, e cila foli edhe në emër të Grupit, mirëpo unë dëshiroj të ngre vëmendjen e Kuvendit lidhur me një çështje e cila është ngritur edhe më herët, por që nuk është ndërmarrë asgjë në këtë drejtim. Fjala është për sigurimin shtesë, të cilin duhet ta paguajnë për veturat e regjistruara jashtë vendit e veçanërisht veturat e bashkatdhetarëve tanë të regjistruar në Evropën Perëndimore, të gjithë ata do duhet të paguajnë një taksë apo një sigurim shtesë me rastin e futjes në Kosovë. Kjo çështje është ngritur dhe është përcjell prej pas luftës në Kosovë dhe nuk është punuar absolutisht asgjë që të rregullohet kjo materie. Nuk është çështje që nuk mund të rregullohet, por do të duhet që Ministria e Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe me Autoritetin Qendror Bankar të punojnë dhe me një përkushtim të vogël unë e di që mund të rregullohet dhe Kosova mund të përfshihet në vendet ku vlen kartoni i gjelbër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Një sqarim, ju lutem! Ne si Kuvend nuk kemi obligim ta përmirësojmë raportin. Pra, ne e shqyrtojmë raportin, ju lutem, ta keni parasysh këtë. Fjala është për deputeten Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit!

I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministre, të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Mendoj që shqyrtimi i Raportit të Bankës Qendrore për vitin 2008 ka rëndësi për t'u informuar lidhur me gjendjen e sistemit financiar dhe është më se e rëndësishme që

ministri i Ekonomisë dhe Financave të jetë këtu, se po flasim për politikat ekonomike dhe ministri mund të përgjigjet në shumë pyetje të cilat unë do t'ia parashtoj. Megjithatë, konsideroj se ajo çka mungon, nuk është mungesa e guvernatorit, sipas ligjit, apo e drejtorit, sipas Kushtetutës, por mungesa e raportit të mirëfilltë, i cili duhet t'i plotësojë standardet ndërkombëtare të raportimit të një banke qendrore.

Sipas vlerësimit tim, raporti është i përgjithësuar, është voluminoz, më tepër me të dhëna statistikore, të cilat i ka edhe Departamenti Makro-Ekonomik i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave apo edhe Enti Statistikor, se sa një vlerësim i gjendjes së sistemit financiar.

Meqenëse ne po e shqyrtojmë në tetor të vitit 2009 dhe po flasim për raportin e vitit 2008, që në fillim e konsideroj të vonuar, prandaj, zoti Kryetar, cili është qëllimi që po e shqyrtojmë këtë raport?

Dhe, me qëllim që të jem sa më racionalë në fjalën time, do të mbështetem në tri pjesë.

Pjesa e parë, ka të bëjë me gjendjen e sektorit financiar. E dyta, është puna e Bankës Qendrore dhe, e treta, që i mungon plotësisht këtij raporti, janë rreziqet, sfidat dhe rekomandimet.

Sa i përket gjendjes së sektorit financiar, në qoftë se bazohemi në raport, thotë se në vitin 2008 ky sektor është rritur. Janë 8 banka komerciale nga të cilat 6 në pronësi të huaj, 2 vendore, kurse 91% të aseteve të përgjithshme të sektorit bankar u takojnë bankave në pronësi të huaj. E njëjta gjë është me sigurimet, janë 10 dhe shumica prej tyre u takojnë kompanive të huaja.

Një çështje me rëndësi që shtrohet është kriza globale. Edhe pse në raport thuhet se kjo nuk i ka prekur bankat vendore, meqenëse nuk kanë qenë direkt të ekspozuara efekteve të krizës, megjithatë nuk kemi parë një analizë apo edhe rreziqe, sepse dihet që në vitin 2009 efektet e krizës globale financiare do të ndjehen shumë mirë në Kosovë.

Po ashtu, meqenëse recesioni në pjesë tjera të botës është bartur edhe në ekonominë e Kosovës, ka ardhur deri te rënia e remitancave, por edhe të investimeve të drejtpërdrejta, investime këto që janë zvogëluar për 17.7% në krahasim me vitin 2007, patjetër që Banka duhet të bënte një rekomandim, por edhe sfidat lidhur me ndikimet e krizës globale. Në bazë të të dhënave, thuhet se ka pasur inflacion, i cili është rritur në 12.4%. Të gjitha këto të dhëna flasin për rritjen e ngadalësuar ekonomike.

E dyta, sa i përket pjesës për punën e Bankës Qendrore, unë do të përqendrohem në vëllimin e kredive. Thotë se vëllimi i kredive është rritur përmes depozitave, por kreditë kryesisht ishin afatgjata, kurse depozitat - afatshkurtra, që tregon shpërprurje të maturitetit.

Sa u përket normave të interesit, pra kamatat janë 13.8%. Të nderuar deputetë, edhe ekonomitë më të zhvilluara nuk do të mund ta duronin një normë kaq të lartë të interesit. Nga 900 milionë euro të investuara në Bankën Qendrore, gjysma e tyre, ekskluzivisht mjete të buxhetit, janë menaxhuar nga Banka Qendrore, e cila i ka investuar jashtë Kosovës. Sa i përket Trustit Pensional të Kosovës, vlera e kursimeve në këtë fond ka rënë 91 milionë euro apo 29%. Vetëm 20% të mjeteve të Fondit janë depozituar në Kosovë,

kurse pjesa tjetër jashtë Kosovës. Edhe pse Kosova shfrytëzon euron si valutë, megjithatë nuk ka politikë monetare.

Në raport është shkruar se menaxhimi i përgjegjësive të Bankës Qendrore ka qenë i mirë. Zoti ministër, në çka është bazuar ky vlerësim? Kush e ka bërë këtë vlerësim, sepse sipas mendimit tim, është bërë vetëvlerësim?

Dhe, pjesa e tretë, e cila i mungon plotësisht këtij raporti, që paraqet një pjesë të rëndësishme që flet për gjendjen e sistemit financiar, janë sfidat dhe rekomandimet. Raporti duhet të përmbajë të dhëna të sakta për përfitimet e qytetarëve të Kosovës dhe të institucioneve. Meqenëse, zoti ministër, jashtë vendit mbahen 1 miliard e 200 milionë euro, atëherë Kuvendit duhet t'i raportohet – sa janë investimet e mjeteve jashtë vendit nga Fondi i privatizimit, Trusti Pensional, buxheti i Kosovës, mjetet tjera të lira, rezervat e obliguara të bankave, mjetet e kompanive të sigurimit, mjetet tjera të depozitave? Meqenëse mjetet po mbahen jashtë Kosovës, niveli i kamatave për kreditë është i lartë. Po të ktheheshin në Kosovë, niveli do të binte, si – kur normat e interesit të ulen, huamarrja bëhet më joshëse, konsumatorët e kanë më të lehtë të blejnë një makinë apo një shtëpi. Blerja e shtëpisë rrit kërkesën për mallra, si mobile, pajisje elektrike, e tjera, duke i dhënë kështu shtytje nxitjes – rritës ekonomike.

Cilat janë, zoti ministër, politikat investuese? Ku janë investuar mjetet? Në cilat politika janë bazuar, kush i ka bërë këto politika? Çfarë kanë përfituar qytetarët e Kosovës për mjetet e investuara? Sa është reale humbja nga Trusti?

Keni obligim dhe përgjegjësi të raportoni se janë para publike. Sipas ligjit, me humbjet në Trust është dashur të intervenojë Banka brenda 30 ditëve, po ashtu edhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Për më tepër, për të mbrojtur sektorin financiar është dashur të ketë koordinim të ngushtë në mes të Bankës Qendrore dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave. Edhe ju, edhe Banka Qendrore, zoti ministër, keni qenë të fjetur.

A keni shikuar të krijoni politika dhe ndryshime për investimet për ekonominë kosovare? Çfarë ka bërë Banka Qendrore t'i sigurojë depozitat dhe në këtë mënyrë t' i joshë qytetarët? Kush dhe si i siguron këto depozita? Pse po vonohet aprovimi i Ligjit për sigurimin e depozitave?

Banka Qendrore, të nderuar deputetë, shërben, është agjent i Qeverisë, shërben si bankier, këshilltar e agjent fiskal i Republikës së Kosovës. Çfarë këshilla dhe rekomandime i ka dhënë Banka Qendrore Qeverisë?

Sa i përket harmonizimit me standardet ndërkombëtare, Banka Qendrore nuk është në sistemin modern financiar, sepse ende punohet si në vitin 2002. Derisa vendet tjera, si për shembull, Shqipëria ka këshillin mbikëqyrës, pastaj Sllovenia e Kroacia i kanë agjencitë e pavarura për mbikëqyrjen e bankave dhe të sigurimeve, vetëm Banka Qendrore e Kosovës dhe Serbia kanë këtë formë të mbikëqyrjes së bankave dhe të sigurimeve.

Në fund, për të përmbushur rolin e vet, zoti ministër, të nderuar deputetë, propozoj dhe rekomandoj:

1. Funkcioni i Bankës Qendrore duhet të jetë ndryshe, ashtu si është në Kushtetutë, dhe të bëhet harmonizimi si është në Kushtetutë dhe në ligj. Realisht, funksionimi i tanishëm

është si autoritetit bankar, vetëm se është ndërruar emri. Duhet të ndryshohet Ligji për Bankën Qendrore, ashtu që Banka Qendrore të mund t'i kreditojë bankat komerciale.

2. Banka Qendrore s'ka të drejta marrëdhënie kreditore,
3. Mungon përfaqësimi jashtë,
4. Banka Qendrore është larg modernizimit, sepse në botën moderne Banka Qendrore merret me sfidat, siç është koordinimi i politikës monetare fiskale dhe zhvillimore.

Në fund, nuk mund të përkrah një raport kaq të mangët, i cili nuk jep informata të mjaftueshme dhe sugjeroj dhe rekomandoj, zoti ministër, që në të ardhmen raporti i Bankës Qendrore t'i përmbajë të gjitha standardet ndërkombëtare të raportimit. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e rimerr anëtarin e Kryesisë, zoti Sabri Hamiti

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Raporti i Bankës Qendrore për vitin 2008, të cilin po e shqyrtojmë sot, është një raport gjithëpërfshirës, i cili përmban të dhëna të shumta për gjendjen e ekonomisë sonë, si për sektorin real, ashtu edhe për atë financiar. Këtij raporti i është bashkëngjitur edhe opinionin e kompanisë Kej Pi Emgie, e cila ka bërë auditimin e pasqyrave financiare të Bankës Qendrore të Kosovës.

Dhe, sipas kësaj kompanie, këto pasqyra financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Bankës Qendrore të Kosovës, më 31 dhjetor të vitit 2008.

Së pari, do të ndalem te sektori financiar, në të cilin sektor, sektori bankar luan rol më të rëndësishëm. Nga raporti shihet se gjatë vitit 2008, sektori bankar i Kosovës ka intensifikuar aktivitetin, duke rritur në masë të konsiderueshme si kreditë, ashtu edhe depozitat, gjë që është reflektuar edhe në rritje të profitit të bankave. Hyrja e bankave të reja në treg ka ndikuar në krijimin e kushteve më të favorshme për kredimarrësit e po ashtu edhe për depozituesit, si dhe në rritjen e cilësisë dhe sasisë së shërbimeve bankare. Në vitin 2008, dallimi në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita, qëndroi apo ishte 9.37%, ndërsa krahasuar me vitin 2007, kur ishin 11.56%. Domethënë ka ardhur deri te ulja e diferencës në mes të kredive, në të vërtetë, normave të interesit për kredi dhe për depozitë. Në dhjetor të vitit 2008, norma e interesit në kredi ishte rreth 14%, që paraqet një rënie prej 1.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2007. Shuma e kredive të lëshuara nga sistemi bankar është rritur për 33%, por struktura e kredive sipas sektorëve ka mbetur e ngjashme në vitet e mëparshme, që do të thotë se dominon sektori i tregtisë, me një pjesëmarrje prej rreth 43% në kreditë e gjithëmbarshe të lejuara nga sistemi bankar, por kjo pjesëmarrje në krahasim me vitin 2007 është ulur për 4.3%, ndërsa ka pasur rritje të kredive për ndërmarrjet që merren me shërbimet tjera. Domethënë edhe kjo paraqet një ecure pozitive. Edhe në vitin 2008 sektori me pjesëmarrje më të vogël në kreditë e sektorit bankar ishte bujqësia, me gjithsej 4.1% në kredi të gjithëmbarshe, edhe pse ky sektor ka shënuar rritje për 29% në kredi të shfrytëzuara në krahasim me vitin 2007. Me këtë pjesëmarrje të sektorit të bujqësisë nuk mund të jemi të kënaqur aspak, por rritja e kreditimit të këtij sektori varet edhe nga kushtet e kreditimit që ofrojnë bankat dhe nuk mund të pajtohem me konstatimin në raport se rritja e kreditimit për këtë sektor është e kushtëzuar nga ngritja e kapaciteteve absorbuesve të sektorit të bujqësisë. Me siguri edhe ky faktor ka ndikim, por mendoj që bankat duhet të ofrojnë

kushte më të favorshme të kreditimit për sektorin e bujqësisë dhe Banka Qendrore e Kosovës është ajo që duhet të merret me këto politika.

Një element tjetër, në të cilin do të ndalem në këtë raport, janë investimet e huaja direkte, të cilat në vitin 2008 kanë shënuar rënie për 17.7%, në krahasim me vitin 2007 dhe, çka është edhe më keq, rënia e këtyre investimeve vazhdon edhe në vitin 2009, sipas të dhënave për 6 mujorin e parë të këtij viti. Përkundër vlerësimit që është dhënë në raport, sipas të cilit vlerësim është pritur që me politikat ekonomike të cilat kanë hyrë në fuqi në vitin 2009, do të ndikojnë në rritjen e investimeve të huaja direkte.

Dhe, në fund, dua të cek se mjetet e Trustit të grumbulluara pas shtatorit të vitit 2008, sipas të dhënave, pra, që janë paraqitur në raport, thuhet se këto mjete nuk janë investuar jashtë vendit, pra ato gjenden në vend dhe pas shtatorit të gjitha mjetet grumbullohen në Bankën Qendrore. Por, duhet të gjenden apo të krijohen mundësitë që këto mjete në bazë ligjore t'u jepen në shfrytëzim bankave vendore dhe për këtë pra nevojitet që të ndryshojë edhe Ligji për Bankën Qendrore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka kërkuar deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Dy nota pozitive në fillim, ma merr mendja. Duhet të them se Kryetari i Kuvendit e ka interpretuar plotësisht saktë atë që ka ndodhur në mbledhje të Kryesisë, në mbledhjen e fundit të Kryesisë. Duhet të jesh fer dhe duhet përmendur, do të thotë, është ekzakt qysh ka ndodhur interpretimi i Kryetarit. Mendimi i shumicës në Kryesi ka qenë që duhet të jetë një autoritet politik në sallë për shkak se Kuvendi është organ politik. Unë nuk mendoj se të qenit politik është keq, po të kisha besuar që të jesh politikan është keq, nuk do të isha personalisht dhe nuk besoj se dikush prej jush mendon se është keq dhe ne merremi me autoritet politik. Edhe ligj nuk kërkon që këtu të jetë guvernatori, ai e dorëzon raportin, po nuk besoj se dikush prej jush do të kishte dëshirë ta ketë një autoritet jo politik, i cili vazhdimisht iu përgjigjet pyetjeve të deputetëve dhe duhet të jemi pak më të saktë se kush janë të gjithë ata njerëz që mund të flasin në foltore të Kuvendit. Mendimi im personal, besoj edhe i shumicës së deputetëve, është që në foltore të Kuvendit është një numër shumë i limituar i njerëzve që flet përpos deputetëve.

Çështja e dytë pozitive është, ndoshta ju kujtohet nga 15-16 muaj më përpara pata kërkuar që kjo lulja Guqia Armani, që ka qenë këtu, të hiqet dhe po më vjen mirë që u hoq, e në fund të fundit, në demokraci kush e vendos, edhe e heq dhe kështu ka ndodhur edhe kësaj radhe. Mendoj se është mirë, unë personalisht jam i kënaqur që ka ndodhur kështu, nuk e di për ju.

Tash është ajo pjesa tjetër, jo notë pozitive, definitivisht diçka tjetër. Më vjen keq që ministri doli. Më vjen keq që ministri doli dhe unë të bisedoj me autoritet politik, edhe një herë po e përsëris qysh thashë në fillim. Unë duhet ta pyes se çka ka ndodhur me diçka dhe qysh ka ndodhur? Për të mos i përsëritur shumë në detaje shumë kolegë të mi, unë duhet ta përsëris pyetjen. Faleminderit, zoti ministër, paske ardhur, pse ka ndodhur me kamata, çka ka ndodhur, pse janë kamatat kështu në Kosovë dhe duhet të ketë përgjigje dhe përgjigja nuk duhet të jetë arkaike, Përgjigja duhet të jetë – cilat masa i ka marrë politika e Kosovës që të ndërrojë gjendja? Në fund të fundit, a ka marrë ndonjë masë apo nuk ka marrë masa hiq? Unë dua të kem përgjigje, të na tregojë çka ka ndodhur në Kosovë ose çka kanë ndërmarrë autoritetet që kanë mundësi të ndërmarrin veprime, në mënyrë që kjo gjendje të ndryshojë. Një pyetje është shumë konkrete. Besoj

se edhe qytetarët e Kosovës donë ta dinë çka po bën shteti ynë që qytetarët tanë të jetojnë pak më mirë. Shumë thjesht, e thjeshtësuar deri në skaj.

Pyetja e dytë, është Trusti, prapë, përgjigje e saktë, taksative, pikë për pikë- Çka ka ndërmarrë pushteti për të ndodhur ajo që ka ndodh ose për të mos ndodhur ajo çka ka ndodhur, më mirë të them tash? Pra, ne duhet ta dimë cilat janë veprimet, cilat janë vendimet e njerëzve që kanë të drejtë të marrin vendime në bazë të parimeve tona të demokracisë, ata njerëz që janë zgjedhur.

Çështja tjetër është më kryesorja. Më kryesorja prej të gjitha çështjeve është- Ku janë 266 milionë euro të holla të popullit të Kosovës? Kemi pyetur për të mos e ekzagjeruar shumë minimum 10 herë në Kuvend. Deputetët e Kosovës kanë pyetur publikisht – ku janë 266 milionë euro të Kosovës? Asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje. Janë marrë letra me vlerë, krejt në rregull. Pyetja tjetër, pason – Në bazë të cilit ligj... Mua më vjen mirë që një deputet i Partisë Demokratike të Kosovës sot ka kërkuar të hartohet Ligji për letrat me vlerë. Me automatizëm po kuptoni që nuk ka ligj për letrat me vlerë. Cili ligj e ka lejuar Kosovën t'i nxjerrë jashtë vendit 266 milionë euro? Nëse doni t'ia përkthej se çka domethënë kjo, që po ua përkthej shkurt, me tri fjali. Kjo domethënë se qytetarët tanë marrin hua, mjete të huaja prej bankave dhe paguajnë kamatë 17%, përafërsisht. Domethënë, mjetet e veta ata neve na i huazojnë me një kamatë 17%, ndërsa mjetet tona, të popullit tonë, dalin prej Kosovës, në krizën më të madhe ekonomike, të paktën qysh se gjeneratat tona, të gjitha gjeneratat e mbajnë në mend, pa kamatë. 266 milionë euro janë shumë të mëdha për cilindo institucion financiar ndërkombëtar, jo vetëm për një shtet si Kosova që është shteti më i varfër në botë, mos ta ekzagjeroj, më i varfëri në botë, por në Evropë gjithsesi. Populli ynë e ka gjendjen ekonomike më të vështirë në Evropë dhe paratë tona dalin prej Kosovës pa interes, nuk e dimë ku është interesi i Kosovës. E keni nëpër raporte, kanë për të ardhur raporte tjera dhe keni për ta parë. A duhet dikush t' i tregosh Kuvendit të Kosovës që i përfaqëson këta njerëz, këtë popull të Kosovës, kush e ka marrë këtë vendim, në bazë të cilit ligj e ka marrë këtë vendim, për hir të kujt e ka marrë këtë vendim? Kjo është pyetja. Mendoj se nëse dikush nuk përgjigjet, në sytë e mi është bashkëfajtor, se kjo është plaçkë, kjo është plaçkitje e popullit të Kosovës. 266 milionë euro nuk janë vetëm 266 milionë euro, janë një aset i madh, me ato mjete krijohet profit i madh, shumë i madh. Pse populli i Kosovës nuk krijon profit me mjete të veta, ndërsa paguan kamatë për mjetet e atyre që mund të ndodhin se janë kah na japin hua mjetet tona dhe se për mjetet tona paguajmë kamatë?

Kjo që thashë, që ne paguajmë kamatë për mjetet tona, mund të jetë hipotetike, por totali iu del i njëjtë. Në vend që ne t' ia huazojmë vetvetes 266 milionë euro dhe të paguajmë 1% kamatë, ne paguajmë 17 ose 18% kamatë e mjetet tona i nxjerrim jashtë, pa kamatë. Këtë pyetje unë dua t'ia bëj ministrit të Financave, jo guvernatorit. Këtë pyetje ju duhet t'ia bëni ministrit të Financave. Nëse ndodh diçka kësisoj, të ndodhë një skandal kësisoj diku tjetër, unë po ju them, hapet një pavijon i veçantë, me njëfarë vendi që e ka emrin Dubravë a ku ta di unë, qysh e ka diku tjetër. Në Kosovë ndodh dhe tërë e mbyllin gojën. Krejt heshtin.

Mund t'ju them që si Kuvend i Kosovës, nëse aprovojmë këso dokumentesh, të gjitha transkriptet, të gjitha dokumentet që i kemi, të gjitha fjalët tona kanë për të mbetur në histori, dikush do t'i shohë edhe pas 50 vjetësh, edhe pas 60 vjetësh dhe pas 100 vjetësh. Edhe kur t'i shohin fëmijët tanë që ne e kemi mbyllur gojën dhe u kemi aplauduar vendimeve të këtilla, nëse dikujt vetëm i shkon mendja, nuk besoj se kishte për të vendosur me vetëdije të plotë të bënte kështu.

Edhe një herë, i lus deputetët e Kuvendit, duhet t' i këpusim këto praktika njëherë, duhet t' i këpusim. Mjaft është më. Po ju lus, mos e aprovonit këtë raport! Dikush le të shkojë në shtëpi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e merr deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Sot jemi duke diskutuar për një raport të një institucioni jashtëzakonisht të rëndësishëm për vendin tonë, një institucion i radhitur edhe si institucion në kategoritë kushtetuese. Po diskutojmë për raportin e Bankës Qendrore të Kosovës për vitin 2008. Këtu u përmendën, edhe pse debati filloi me një konfuzion të plotë në mes përgjegjësive të udhëheqjes së Kuvendit dhe të komisionit funksional, këtu u përmenden Kushtetuta, përgjegjësitë e Kryesisë së Kuvendit, kush duhet të raportojë, roli i komisionit funksional, rekomandimet e komisionit, që emërues të përbashkët – ka një konfuzion dhe një jo seriozitet institucional që po vazhdon t'i përcjellë debatet tejet të rëndësishme për institucione jetike të Republikës së Kosovës.

Një konfuzion tjetër është që raportet e një institucioni që i përgjigjen organit më të lartë legjislativ të vendit është – a shqyrtojmë në raport, apo e miratojmë apo s'e miratojmë? Miratimi e ka një mbështetje për punën apo udhëheqësin e atij institucioni që i ka marrë votat në këtë Parlament, mosmiratimi dihet epilogu, ai që nuk e merr miratimin për raportin vjetor në Kuvendin e Republikës së Kosovës, e ka adresën ta lëshojë atë institucion.

Organi më i lartë legjislativ i vendit është përfaqësuesi i vullnetit të qytetarëve. Ne jemi të zgjedhur politikë këtu dhe nuk merremi me statistika e me pasqyra deskriptive e ilustrative sipas dëshirës, përcaktojmë prioritetet politike dhe marrim vendime të rëndësishme nacionale. A po ndodhë sot kjo në këtë Kuvend të Kosovës dhe me çfarë qasje po diskutojmë dhe po marrim vendime për një organ tejet të rëndësishëm? Çka ka bërë Kuvendi i Kosovës, cilat janë prioritetet e Qeverisë në vakuumet e mëdha legislative që e përcjellin Bankën Qendrore të Kosovës në një spektër tejet të gjerë të legjislacionit që prekin shumë sfera, qofshin bankare, financiare dhe ligje të tjera që ndikojnë edhe në sigurinë e sistemit financiar dhe bankar të vendit tonë?

Çfarë klime iu kemi krijuar bizneseve, investimeve të huaja direkte dhe cili është stimulimi i tyre në raport me sistemin financiar dhe bankar të vendit? Është një gjendje e mirë e komunitetit të biznesit në Kosovë dhe shpresës për investime racionale dhe normale në një klimë të tillë që po i rrethon bizneset e vendit tonë.

Te raporti, mungesa e një raportimi substancial, pa arsyshmëri të veprimit apo mosveprimit, statistika dhe raport përshkruar shumë i zbehtë. Pastaj, ekonomia globale, tregu global nuk do të duhej të ishin pika referente dhe përshkruese dhe konstatim i gjendjes të raportit të Bankës Qendrore, që i dërgohet organit më të lartë legjislativ të vendit. Pastaj, ky raport lë hapur shumë dilema. Ku janë 266 milionë euro që janë pasuri e popullit të Kosovës, pastaj te tregu i sigurimeve lë dilema të theksuara, zotëri ministër, që do të duhej t'i jepnin përgjigje organit më të lartë legjislativ të vendit dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës ta thotë fjalën e vet.

Pa e zgjatur shumë, ne duhet ta ndryshojmë logjikën e debatit dhe përgjegjësisë që e kemi konform Kushtetutës dhe Rregullores së Punës të Kuvendit ndaj organizatave dhe përfaqësuesve të institucioneve të rëndësishme që zgjedhën nga ky Kuvend. Kuvendi është adresa ku ata duhet të raportojnë dhe ne jemi ata që e japim vlerësimin e performacës së punës së tyre.

Dhe, krejt për fund, emërues i përbashkët i këtij raporti, i konceptit dhe debatit të sotëm në Parlament për këtë institucion të rëndësishëm nacional dhe si kategori kushtetuese, është dështimi, papërgjegjësia institucionale, jo serioziteti i menaxhmentit të BQK-ës dhe mungesa e kapaciteteve institucionale dhe shtet ndërtuese. Kjo do të na kushtojë edhe në të ardhmen shumë. Kemi mundësi që shumë gjëra t'i vëmë në binarë institucional, qoftë në aspektin menaxherial dhe legjislativ dhe fatkeqësisht këto gjëra për agjencitë e pavarura, po trupat dhe mekanizmat e rëndësishëm nacional që japin llogari Kuvendit, po vazhdojnë kështu një punë ad-hoc dhe sipas dëshirës. Kjo po i dëmton shumë edhe sistemin financiar, edhe bankar, edhe politikat kreditore, por po e ulë edhe kredibilitetin e organit më të lartë përfaqësues të vendit. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e rimerr Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet Besa Gaxherri.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri Kryetar!

Zotëri zëvendëskryeministra, ministra dhe deputetë të nderuar,

Unë do t'i theksoj disa aksente që i kam potencuar edhe në Komisionin për Buxhet, që nuk kam marrë përgjigje, jo unë, po as komisioni, dhe konsideroj se janë kyçe.

Autoriteti bankar publik – Banka Qendrore nuk e ka bërë atë që ka mund ta bëjë dhe atë që është dashur ta bëjë, referuar borxheve të këqija. Fare mirë e di çdo kush, në detaje edhe ata që e quajnë veten ekspertë, se ekonomia, ndër të tjera, më e madhe e botës, e SHBA-ve, është shkallmuar nga borxhet e këqija. Borxhet e këqija kanë të gjitha bankat komerciale dhe ekziston dyshimi i bazuar se ato nuk janë shkaktuar, si të them, nga padia, mirëpo ekziston dyshimi i bazuar, ka të dhëna se ato janë krijuar nëpërmjet korrupsionit. Bie fjala, 500.000 euro ia ka kredithënëses – bankës, edhe të humbura në procedurë, i jepen edhe 500.000 tjera për t'u forcuar për t'i kthyer ato 500.000 të parat, nuk i kthen as ato, as këto. E kësisoj ka shembuj që dihen.

Më pastaj, normat interesante në kredi marrëdhënie, janë jashtëzakonisht të larta, ndoshta më të lartat në Evropë, që janë krejtësisht destimulative për ekonominë e tregut, sidomos për bizneset e vogla e të mesme, ndërsa normat interesante për depozitime janë shumë të ulëta, tepër të ulëta, që ndikojnë tepër keq në depozitime. Prandaj, kjo është, them, politika makro që Banka Qendrore ka instrumente dhe ingerenca për të bërë atë që ka mund dhe është dashur ta bëjë, nuk e ka bërë.

Ose, te Trusti i Pensioneve. Ju lutem, aty po e zëmë, po e quaj kështu, pak me ironi drejtorin e Trustit, që e merr 100 herë pagën më të lartë se sa pensionisti nga paraja e nëpërkëmbur e pensionistit, pa kurrfarë kriteri e merr, e merr sa 10 herë pagën që merr, ta zëmë, Kryetari i shtetit apo i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Nga paraja e pensionistit, qysh mund të tolerohet kjo? Do të mund të rregullohej kjo, nuk e ka rregulluar banka. Kam baza të dyshuara...

KRYETARI: Deputet, raportin e kemi.

RIZA SMAKA: Ju lutem, me respekt, konkretisht unë e kam atë raport. Më pastaj, në paratë që u përmendën këtu me vend, 266 milionë, kamatat janë më të ulëtat në Evropë. Ekziston dyshim i bazuar se dikush e merr një diferencë nga kamata që është, se kurrkush nuk i merr ato asisoj. Shoqëritë aksionare edhe bankat edhe të sigurimit, bëjnë abuzime sistematike sa i përket punësimeve. Si, po e zëmë? Në kundërshtim me normat elementare... E kemi Rregulloren për ligjin për punë që te të gjithë pothuaj se punësohen në kohë të caktuar, në 3 muaj dhe bëhen shantazhe më se amorale ndaj atyre që janë punëmarrës, t'i quajmë dhe në rastet kur nuk ka kurrfarë baze që të jetë i punësuar apo e punësuar në kohë të caktuar, punësohet gjithnjë me kohë të caktuar, dhe në çdo 3 muaj vazhdohet, vazhdohet, dikujt jo, dikujt po, e këtë Banka Qendrore, e them me kompetencë se e kam njoftuar në mënyrën më korrekte edhe me shkrim e me raporte e tjera, nuk ka bërë asgjë prej gjëje.

Te pastrimi i parasë, Banka Qendrore ka rol kyç. Nuk ka bërë kurrgjë, ose krejt pak. Edhe te pagat privilegjuese, në Komisionin për Buxhet kemi pyetur, ju lutem sa e keni pagën, nuk tregojnë. Po le të më pyet kushdo mua për pagë, i tregoj me cent, pse – përpiqem ta realizoj me meritë dhe tregoj, po kurrë nuk do ta kisha realizuar in-meritum, do të isha turpëruar për të treguar se sa e kam pagën, e nuk tregon. Po e zëmë, kërkojmë me shkrim, nuk përgjigjet me shkrim e as me gojë, as kurrsesi. Kjo nuk mund të tolerohet në shoqërinë politike kosovare.

Dhe, përfundimisht, me respekt, ju lutem atë që e tha zoti Koci në emrin e Komisionit për Buxhet, qëndron dhe është dashur të miratohet. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri, le të përgatitet deputeti Jakup Krasniqi.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë realisht sot nuk e kam pasur ndërmend të diskutoj për këtë pikë të rendit të ditës, sepse të gjitha ato vërejtjet e mia unë i kam thënë në Komisionin për Buxhet e Financa, por pikërisht ju më shtytë ta marr fjalën, duke u bërë këtu moskuptim ose keqkuptim, realisht rreth procedurës së paraqitjes së guvernatorit në Kuvend apo jo. Është e vërtetë që Komisioni e ka bërë rekomandimin që të jetë guvernatori, por unë personalisht vetë pajtohem që ne duhet të komunikojmë me autoritet politik, ndoshta në këtë rast me ministrin.

Por, në qoftë se duhet të jetë kështu, atëherë realisht ne si Kuvend, e ju si Kryesi, duhet të ndërmerreni që të ndryshohen procedurat. Dhe, në këtë aspekt, në qoftë se vërtet do ta marrë përsipër Ministria e Financave sistemin bankar, atëherë realisht edhe Kuvendit duhet t'i jepen kompetenca, që jo vetëm ta shqyrtojë një raport të tillë, por realisht duhet edhe të votohet apo aprovohet, sepse është një punë e kotë ne të merremi kështu, të debatojmë, të diskutojmë dhe në përfundim s' ka asnjë rezultat.

Sa i përket Komisionit për Buxhet e Financa, zoti Kryetar, unë e di se të gjitha komisionet, jo vetëm Komisioni i Buxhetit, çdo rekomandim që merret në komision, merret me shumicë votash. Në shumicën e rasteve, duke përjashtuar, jo gjithmonë, opozita ose unë personalisht që jam vetëm një deputete nga subjekti im politik, jam kundër, por me shumicë votash ai rekomandim aprovohet, andaj në atë moment kur na ftove se s'kemi reaguar asnjëri nga opozita, nuk e kam parë të arsyeshme të reagoj këtu

të them se unë kam qenë kundër ose kam thënë këtë e atë, sepse me shumicë votash Komisioni për Buxhet i ka dhënë këto rekomandime. Dhe, realisht, jo se do ta mbroj tash Komisionin për Buxhet në lidhje me rekomandime e veta, por unë jam e bindur që në rekomandimin e parë thuhet – i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës në seancën plenare të shqyrtojë, por sigurisht teknikisht është gabim – të miratojë, sepse fundi i fundit, duhet ta marrim edhe këtë si vendim për të gjitha komisionet. Komisionet nuk mund t'i referojnë Kuvendit për të miratuar ose të aprovojë çështje të caktuara, por ta shqyrtojnë, t'i japin rekomandimet e veta se, fundi i fundit, organi i Kuvendit është më i lartë se i komisionit.

Sa i përket këtij raporti, zoti Kryetar, unë i kam thënë ato vërejtjet e mia në Komision për Buxhet. Kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë e dha mendimin e vet për Lidhjen Demokratike të Dardanisë dhe shumë kolegë këtu i dhanë vërejtjet, të cilat unë nuk kam dëshirë t'i përsëris tash. Ndoshta nuk duhet të jemi shumë të padrejtë ose të ashpër, sepse vërtet ne jemi shtet i ri. Nuk mund të krahasohemi me shtetet në Slloveni, Kroaci, mos të flas për shtetet në Evropë, por realisht duhet t'i marrim këto vërejtje shumë sinqerisht, sepse ne duhet të lëvizim më shpejt, t'i bëjmë 3 hapa deri sa dikush e bën 1 hap për të qenë atje ku duhet të jemi ose për t'u integruar sa më shpejt. Unë po e theksoj vetëm një gjë që vërtet është e papranueshme, duke i mbështetur të gjithë kolegët për vërejtjet që i dhanë. Bie shumë në sy, është shumë transparente-interesat grupore të lidhura me Qeverinë e Kosovës, me Bankën Qendrore të Kosovës dhe me bankat komerciale në Kosovë. Po jap, përveç atyre tjerave që i thanë, po e jap një shembull. Postë-Telekomi i Kosovës ka shprehur vullnetin dhe ka bërë kërkesën, ndoshta jo veç tash, por edhe me vite, që të themelojë një bankë – postë- bankë, me para të pastra të qytetarëve të Kosovës dhe nuk është lejuar një gjë e tillë, pikërisht sepse cenohet interesi komercial i bankave dhe interesave të grupeve, të cilat janë të lidhura në mënyra të ndryshme në mes veti. Andaj, kjo është e papranueshme, sepse në futjen në treg të post-bankës do të kishte rënë në nivel shumë të madh interesi aq i lartë i kamatave që është në bankat e Kosovës dhe nuk ndodh një gjë e tillë. Ose, kohën e fundit ose momentin e fundit, me rishqyrtimin e buxhetit të Kosovës kur Qeveria e Kosovës pa hezituar, pa asnjë arsye, pa asnjë projekt konkret merr devidente në postë 200 milionë euro dhe i fut në buxhetin e Kosovës. Domethënë, këto janë gjëra të cilat janë të papranueshme, sepse mund të na ndodhin gabime, nuk mund të jemi ne të përkryer ose krah me shtetet e zhvilluara, por gjërat e tilla që shihen, siç thotë populli nga aeroplani, këto janë gjëra që nuk duhet toleruar.

Unë s'dua të zgjas më shumë, përveç të ritheksoj se Qeveria duhet urgjentisht ta kompletojë infrastrukturën ligjore edhe të sistemit financiar bankar, por edhe në përgjithësi të politikës fiskale në Kosovë. Faleminderit, zoti Kryetar!

KRYESUESI SABRI HAMITI: E ka fjalën Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI: Unë u lajmërova si deputet dhe vërtet do të flas si deputet. Fillimisht, mua më vjen keq që vërtet kryetari i Komisionit pati ngatërresa dhe ngatërresat nuk vijnë nga ajo pse e lexoi një nen të Kushtetutës ose të ligjit, por vërtet është krijuar një praktikë, mendoj e dëmshme edhe në mesin e anëtarëve tjerë të grupeve parlamentare. Kanë një alergji ndaj Kryesisë, si organ, dhe mendoj që krejt çështja ishte pse Kryesia nuk e ka përfillur rekomandimin e dytë të Komisionit, që mendoj se nuk është esenca e temës të cilën po e debatojmë. Esenca e temës mendoj që është Raporti i Bankës Qendrore dhe komisioni është dashur me një raport të vet të punës t'i arsyetojë

rekomandimet, ta thotë edhe për debatin që është zhvilluar në Komisionin parlamentar për Buxhet dhe Financa, që është një nga komisionet kryesore të Parlamentit.

Unë vërtet jam i shqetësuar, ndoshta, me përgatitjen profesionale të anëtarëve të Komisionit për Buxhet e Financa dhe dua t'i ngrejë disa çështje. U tha se ne kemi kërkuar shqyrtim. Ju lutem, ne administrojmë letra dhe në letra është kërkuar miratimi i raportit. Dhe, kur një komision rekomandon miratimin e raportit, do të thotë se raporti është në rregull, mund të ketë ndonjë vërejtje, por në përgjithësi është në rregull. Unë personalisht mund të them që nuk jam i kënaqur me gjendjen financiare në përgjithësi që ekziston në Kosovë dhe unë po i përmend disa fusha. Unë nuk di ku janë 2 tipa të mjeteve, ose lloje të mjeteve financiare që kanë dalë nga privatizimi – edhe 80% edhe 20%? Ne e dimë që një pjesë e 20% të punëtorëve nuk u është kthyer punëtorëve dhe dikush i shfrytëzon ato mjete dhe i shfrytëzon me një kamatë 0.1%, kurse ata që donë të merren me zhvillimin e biznesit në Kosovë, duhet të japin një kamatë prej 14%, diku rreth 14% dhe dallimet janë shumë të mëdha, një.

Nuk e dimë se cili do të ishte rekomandimi, në këtë rast po them, i Komisionit për fatin e mjeteve të Trustit Pensional të Kosovës dhe për një sërë mjesh që vërtet do të duhej komisioni në mënyrën më profesionale t'i raportonte dhe t'i propozonte Kuvendit për të marrë vendime të mëtejshme.

U përmendën edhe mjetet e shoqërive të sigurimeve civile. Realisht, unë pajtohem me diskutuesit për këtë segment, por megjithatë komisioni përsëri s'na ka thënë kurrëgjë, por na ka thënë të miratohet raporti. Do të thotë se raporti është krejt në rregull, kurse kur dalin deputetët dhe diskutojnë, realisht ka dallime të mëdha në këtë rrafsh. Prandaj, kisha kërkuar që komisionet përkatëse, në këtë rast Komisioni për Buxhet e Financa, të mos merret shumë se është apo nuk është këtu guvernatori i Bankës, por të merret me raportin. Ne merremi me raportin.

Çështje tjetër, thotë me Kushtetutë. Me Kushtetutë ai e ka respektuar Kushtetutën, e ka prurë raportin në Kuvend dhe Kuvendi merret me shqyrtimin e raportit. Dhe, përsëri po them, mua nuk më intereson pamja fizike e guvernatorit të Bankës. Mua më intereson raporti që e ka bërë ai. Cila është gjendja financiare në Kosovë, cilat janë perspektivat e saj? U tha se nuk ka krizë financiare në Kosovë për bankat, natyrisht nuk ka qysh të ketë aty, 14% e kanë fitimin, që s'është askund në botë. Ai s'ka qare pa qenë në profit, se natyrisht nuk është në krizë, krizë mund të ketë atje ku kamatat janë shumë herë më të vogla, prandaj kisha dëshiruar që komisionet të merren më seriozisht me detyrën dhe obligimin që e kanë edhe me Kushtetutë edhe me ligje. Tek e fundit, edhe komisioni ka obligime me Kushtetutë dhe me ligje, jo të merret – a paskemi marrë vendim si Kryesi të vijë apo të mos vijë në Kuvend guvernatori. Unë mendoj që vendimi dhe debati që është zhvilluar në Kryesi, më vjen mirë që deputeti Gjini e tha saktë atë, kemi debatuar dhe kemi ardhur në përfundim që jo çdo organ që i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës, drejtuesi i saj të vjen dhe të raportojë në Kuvend, se nuk është askund në botë ajo. Ata i raportojnë Kuvendit me raporte, me shkrim. Dhe, çka tjetër ka pasur sot guvernatori i Bankës, përveç raportit që e ka dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës? Mendoj që duhet ta shikojmë jo formën, por substancën e dokumentit, a vlen apo nuk vlen? Megjithatë, nga Komisioni për Buxhet e Financa për mua pikë qendrore është rekomandimi:” I rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që në seancën plenare të miratojë raportin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës” E njëjta fjalë është thënë edhe në gjuhën serbokroate – usvoji izveštaj. Do të thotë, është thënë të

miratojë raportin, prandaj në këtë aspekt, po të kishte qenë gabim në një gjuhë, nuk do të përsëritej në gjuhën tjetër.

Ne si Kuvend kemi një obligim ta përfillim rekomandimin e Komisionit për Buxhet e Financa, megjithatë nuk jemi të obliguar.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kryetar Krasniqi! Unë e shoh edhe një emër, Synavere Rysha. A e do fjalën?

KRYETARI: Regjia, fjalën deputetes Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti Kryetar! Ndoshta respekti i ndërsjellët, sepse unë kërkoja fjalën para juve, por megjithatë jeni Kryetar dhe me shumë respekt dhe nuk është problem. Unë pikërisht, pjesërisht e pata edhe atë që ju e thatë, zoti Kryetar.

E para, nuk e di ne si Kuvend a e kemi të qartë pse na vinë raportet në Kuvend dhe pse duhet të raportohet? Si duket është krijuar një praktikë e keqe, një praktikë e shablloneve, prandaj e kemi pak sa vështirë të dalim nga këto shabllone. Mendoj se raporti duhet të shqyrtohet për të vlerësuar ky Kuvend performancën e atij institucioni, që në këtë rast e kemi Bankën Qendrore, dhe në bazë të atij raporti që na ka sjellë Banka Qendrore, ne duhet të matim performancën dhe të shohim çka në fakt dhe si po vepron ky institucion, a është konform Rregullores, a është konform ligjit dhe çka ka në brendinë e saj? Dhe, ajo ndodh kur ata na raportojnë dhe ky raport domethënë na vjen me shkrim ose me gojë. Nëse na ka ardhur një raport me shkrim dhe jemi pajtuar që ta debatojmë një raport me shkrim, atëherë nuk do të thotë domosdoshmërisht se duhet të vijë edhe guvernatori apo drejtori që të na raportojë me gojë. Por, në të kundërtën nëse shihet shumë e arsyeshme dhe e domosdoshme, unë mendoj se jo në raportet vjetore, por në raportet tjera për politikën dhe avancimin e atij institucioni ndoshta është mirë që të vijë dhe thjesht të debatohet për një çështje që është e rëndësishme. Dhe, mënyra si po raportohet, unë nuk e di, a duhet të raportohet konform Rregullores, apo Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë apo kur dikujt i teket. Unë mendoj se shumë mirë e parasheh Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe raportimi duhet të përfundojë në maj të vitit në vijim. Nëse për vitin 2008 është dashur të kryhen raportimet të gjitha komisionet në Kosovë të përfundojnë në gjysmën e muajit maj, por jo ne si institucion i Republikës së Kosovës merremi me vitin 2008, kur jemi në fund të vitit 2009, ne gjithëherë të jemi të vonuar, prandaj kërkoj që nga ky Kuvend këto praktika të ndërpriten dhe nëse deri në muajin maj nuk janë përfunduar raportimet, atëherë duhet të ndërpriten. Unë edhe këtu e shoh një të metë apo një dobësi të Komisionit të Buxhet dhe Financa. Nëse në atë komision nuk ka ardhur ky raport deri në atë periudhë nuk është dashur të pranohet, është dashur të hiqet në të kundërtën me një notë proteste a me një notë nga Kuvendi pse është pranuar me vonesë ky raport.

E kemi edhe një konfuzion tjetër midis asaj që e tha kryetar, e mbështes shumë fuqishëm sepse vërtetë shpeshherë komisionet po na bien në lajthitje. Në një anë Komisioni për Buxhet e Financa është komisioni që është dashur t'i kanalizojë të gjitha çështjet që kanë qenë brenda në raport. Nga rekomandimi i parë shihet se këtu gjithçka ka shkuar në rregull dhe i sugjeron Kuvendit që ta miratojë raportin, në anën tjetër kërkon që guvernatori të jetë prezent. Edhe kjo po më duket pak sa tepër dhe Komisioni nuk e ka bërë punën e vet si duhet.

Mirëpo, në procedura shpresoj të jetë ky raport i fundit dhe në të ardhmen të mendohet pak më ndryshe rreth raportimit të Kuvend. Të jetë një periudhë kur duhet të raportohet dhe mënyra se si të raportohet të jetë një statistikë shumë strikte.

Si do që të jetë, shkurtimisht për raportin. Ajo çka mendoj se ka qenë e rëndësishme dhe prioritet për raportin e Bankës Qendrore, mendoj se është dashur të jetë mbikëqyrja e sistemit bankar në Kosovë nga Banka Qendrore e Kosovës dhe menaxhimi i riskut kreditor. Sa qytetarët mund të besojnë në bankat komerciale, kur dihet se në Kosovë kemi më tepër se 8 banka komerciale, kemi edhe organizata mikro-kreditore dhe kemi kompani të sigurimeve që vërtet po afarojnë në Kosovë, mirëpo nuk dihet se në çfarë kushte janë, sa ato banka auditohen nga Banka Qendrore, sepse shumë lehët vijmë te një skemë që më së paku e dom, ndoshta na përkujtojnë vitet e 90-ta skemat e piramidave në Shqipëri. Të paktën, ky raport është dashur të përmbajë detaje për afarizmin e bankave komerciale në Kosovë. Kreditë e këqija rriten nga 3.3% në fund të vitit 2008 në 3.6% në maj të vitit 2009. Kjo të paktën raportohet nga zyrtarët e Bankës Qendrore të Kosovës, mirëpo në raportin e Bankës për vitin 2008 që na vjen neve në Kuvend këtë informatë nuk e kemi. Ku janë mjetet e grumbulluara nga mjetet e privatizimit? Janë diku rreth 400 milionë euro që nuk u dihet fati i tyre. Mandej, çfarë politika ka ndërmarrë Qeveria dhe Banka Qendrore për kthimin e mjeteve nga Trusti i Kursimeve Pensionale që vërtet po shfrytëzohen me kamata të larta në vende të ndryshme? Këto do të ishin ndoshta prioritetet që mendoj se do të ishin dashur të ishin në Raportin e Bankës Qendrore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi deputetë të lajmëruar për debat. Tani kemi hyrë në procedurën e votimit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Në sallë kemi 72 deputetë. Votojmë tash.

Pa kartela “për” – 6 vota.

“Kundër”? – pa kartelë – 2 vota

Do të thotë, me 31 vota “për”, 31 “kundër”, 4 abstenime, miratohet Raporti ose rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Projekt-strategjisë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011

Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin kundër korrupsionit ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim në Kuvend Projekt-strategjinë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar Projekt-strategjinë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011 dhe ka rekomanduar për shqyrtim dhe miratim në Kuvend në seancën plenare.

Komisioni për Buxhet e Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës, ka shqyrtuar Projekt-strategjinë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011 dhe ka vlerësuar se nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

Projekt-strategjia së bashku me rekomandimin e Komisionit u është shpërndarë deputetëve.

Në emër të Qeverisë, kush po e prezanton? Zëvendëskryeministri Ramë Manaj e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: I nderuar Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të pranishëm të Kabinetit qeveritar,

Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar për luftimin e korrupsionit. Ky përkushtim është reflektuar edhe në Programin e punës të Qeverisë për periudhën 2008-2011 dhe në hapat konkret që ka ndërmarrë dhe po ndërmerr Qeveria e Republikës së Kosovës në këtë drejtim.

Luftimi i korrupsionit është në agjendën e prioriteteve të Qeverisë. Për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar nevojitet vullnet politik. Është përkushtim i Qeverisë së Republikës së Kosovës që të kemi zero tolerancë ndaj këtyre fenomeneve. Në këtë kontekst, kemi paraparë kompletimin e kornizës legislative në luftën kundër korrupsionit dhe strategjinë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011.

Qeveria në kontinuitet po mbështet iniciativat e ndërmarra të zhvilluara tashmë dhe po ndërmerr masa konkrete për të shtyrë përpara zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës institucionale e ligjore në funksion të luftimit të dukurisë së korrupsionit në çdo fushë.

Qeveria po bashkëpunon dhe forcon partneritetin me shoqërinë civile, me mediat për të fuqizuar rolin e tyre në zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e reformave kundër korrupsionit dhe në rritjen e transparencës e të llogaridhënies së organeve qeveritare dhe joqeveritare në Kosovë.

Draft-strategjia kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011, e cila po paraqitet sot për miratim para jush, të nderuar deputetë, synon të jetë një dokument që ofron hapa të nevojshëm që duhet ndërmarrë për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin në Republikën e Kosovës.

Hartimi i Projekt-strategjisë kundër korrupsionit është bërë nën udhëheqjen e Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit dhe si projekt dokument është pranuar nga Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë, më 25 nëntor të vitit 2008. Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Grupi punues ndërministror kanë analizuar këtë draft dhe kanë dhënë kontributin e tyre në finalizimin e këtij projekt dokumenti. Procesi i hartimit ka qenë transparent dhe gjithëpërfshirës, pasi në të kanë marrë pjesë, jo vetëm përfaqësues të institucioneve qeveritare por në këtë proces kanë dhënë kontribut edhe organizata të ndryshme ndërkombëtare e jo qeveritare.

Duhet cekur se situata e përgjithshme në Kosovë është e karakterizuar nga tiparet e vendeve në tranzicion. Bazuar në të dhënat e studimeve dhe raporteve të ndryshme të publikuara gjatë viteve 2007-2008, të cilat paraqesin një analizë të situatës, të perceptimit publik, shkaqeve dhe pasojave të korrupsionit, vihet re qartë se problemi i korrupsionit është ende shumë i përhapur dhe përbën një problem shumë serioz i cili minon mirëfunksionimin e institucioneve si dhe krijimin e imazhit të keq të vendit.

Qeveria mbështet iniciativat e ndërmarra në strategjinë kundër korrupsionit në Kosovë, të zhvilluara tanimë dhe do të ndërmarrë të gjitha masat konkrete për të shtyrë përpara zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës ligjore në funksion të luftimit të dukurisë së korrupsionit në çdo fushë.

Qeveria do të bashkëpunojë dhe forcojë partneritetin me shoqërinë civile dhe mediat për të fuqizuar rolet e tyre në zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e reformave kundër korrupsionit dhe në rritjen e transparencës e të llogaridhënies së organeve qeveritare e jo qeveritare dhe strategjia kundër korrupsionit që mbulonte periudhën 2004-2007 kishte një qasje shumë të përgjithshme e gjithëpërfshirëse duke u përpjekur që të prekte të gjitha fushat. Për shkak se strategjia kishte një qasje kaq të gjerë, në njëfarë mënyre rrezikonte zbatimin e plotë dhe efektiv të këtij dokumenti politikash në atë kohë, i pari dokument politikash kundër korrupsionit i hartuar në Kosovë. Megjithatë, u krijua kuadri përkatës ligjor dhe institucional kundër korrupsionit, një numër problemesh të cilat ndikuan në zbatimin jo të duhur të strategjisë kundër korrupsionit tanimë janë identifikuar.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit kundër korrupsionit, që parashohin çështjet të cilat lidhen me hartimin dhe zbatimin e strategjive, duke pasur parasysh se strategjia kundër korrupsionit dhe plani i veprimit mbulonte periudhën kohore 2004-2007 Agjencia ndërmoi iniciativën për të përpiluar dhe propozuar për miratim Projekt-strategjinë e re kundër korrupsionit. Strategjia aktuale është e përpiluar si një dokument gjithëpërfshirës dhe koherent i cili vendos objektivat e politikave kundër korrupsionit për Kosovën duke filluar nga viti 2009 deri në vitin 2011.

Në lidhje me gjendjen aktuale të reformave kundër korrupsionit dhe rezultateve të zbatimit të strategjisë kundër korrupsionit- 2004, kjo strategji fokusohet më tepër në fuqizimin e kapaciteteve institucionale dhe masave praktike, administrative për zbatimin e tyre si dhe në monitorimin e zbatimit të legjislacionit tashmë të miratuar. Pra, më tepër se iniciativat e reja legjislative dhe iniciativat e zbatimit të ligjeve.

Aty ku iniciativat legjislative janë të planifikuara, ato mbështeten nga masa organizative, që kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe trajnime për zbatimin e tyre.

Të nderuar deputetë,

Ju ftojme ta miratoni këtë Projekt-strategji kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011, e cila parashtrohet qëllime të qarta dhe realiste, të cilat do të realizohen përmes masave konkrete legjislative institucionale dhe organizative si do të paraqiten në planin e veprimit kundër korrupsionit. Kjo strategji momentalisht në staf drafti adreson qartë objektiva, mënyra dhe mekanizma veprues kundër korrupsionit pothuaj në të gjitha fushat apo sektorët. Në sektorin politik, administrativ, administratën gjyqësore, pastaj në sektorin gjyqësor, në agjencitë monitoruese të zbatimit të ligjit, në financat publike, në sektorin privat dhe në Shoqërinë Civile. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë e kam një kërkesë, të nderuar deputetë. Deri tash janë lajmëruar 19 deputetë për diskutim. Unë kisha propozuar për shefat e grupeve parlamentare dhe kryetarët e komisioneve nga 10 minuta, për deputetë nga 5 minuta. A jeni dakord?

Atëherë, ta bëjmë pra një votim formal.

Kush është “për” propozimin tim? Faleminderit shumë!

Kush është “kundër”? Po, ka të drejtë Kuvendi të marrë vendim.

Kundër janë 3 vota, konstatohet se shumica vendosi për propozimin e Kryetarit të Kuvendit. Vazhdojmë. Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Tani mendoj se do ta kemi pak më lehtë, sepse rekomandimet që i ka bërë komisioni në njëfarë mënyre i arsyetoi zëvendëskryeministri dhe fatbardhësisht që jemi në rrugë të njëjtë se, përndryshe, po të kishte bërë rekomandime komisioni pak më ndryshe, mandej do të vinin në dilemë deputetët se cilin rekomandim do ta mbështesin, në këtë rast.

Komisioni e ka shqyrtuar me vëmendje strategjinë antikorruption dhe me rastin e shqyrtimit të strategjisë ka pasur prezent edhe anëtarët e Qeverisë, por edhe njerëz që kanë ardhur nga antikorruptioni për ta mbrojtur strategjinë para Komisionit.

Kanë qenë dy aspekte për të cilat anëtarët e Komisionit janë pajtuar që të rekomandojmë në Kuvend që të aprovohet strategjia. Aspekti i parë është që ky dokument që është para nesh i plotëson të gjitha kriteret që të aprovohet si strategji, duke marrë parasysh që nuk është hera e parë që institucionet e Kosovës e kanë një strategji. Ju e dini që ka qenë një strategji e vitit 2004-2007 dhe ndoshta nuk ka pas nevojë që kjo strategji të mos kishte kaluar edhe në seancën atëherë kur kemi vendosur që edhe një herë të kërkojmë strategjinë, që të hartohet strategjia.

Një vështrim i përgjithshëm për dokumentacionin flet, natyrisht se të gjitha shoqëritë të cilat kanë dalë pas luftës e kanë prezent dukurinë e korrupsionit, mirëpo shteti në të cilin po jetojmë ka bërë disa preventiva që kjo dukuri negative në shoqëri të luftohet apo të bëhet preventivë që të luftohet si dukuri negative. Preventivat kanë qenë të orientuara në tri aspekte, nëse mund të flas. Aspekti i parë, pra është plotësuar deri diku infrastruktura ligjore dhe në momentin kur po debatojmë për strategjinë, ne jemi në përfundim të tre ligjeve bazë, të Ligjit kundër korrupsionit, Ligjit për deklarimin e pasurisë dhe kontrollin e pasurisë, Ligjin për konfliktin e interesit kemi përfunduar dhe, natyrisht që po pritet, në planin e veprimit janë paraparë edhe ndryshimi dhe plotësimi për Ligjin për qasje në dokumentet zyrtare, e kështu me radhë. Do me thënë, në aspektin e parë institucionet e Kosovës kanë plotësuar dhe janë në rrugë të mbarë që ta plotësojnë infrastrukturën ligjore.

Aspekti i dytë, konsideroj që ka ndikuar pozitivisht, sepse opinioni publik është njoftuar nga të gjitha institucionet për efektet negative që i ka korrupsioni në shoqëri dhe dukuritë tjera negative dhe pothuaj të gjitha institucionet së paku në atë aspektin, ka ekzistuar vullneti politik për ta luftuar këtë dukuri negative. Aspekti i tretë, që konsiderojmë ka qenë sukses, është që ju ka kushtuar një rëndësi e veçantë Agjencionit që të forcohen edhe kapacitetet që i ka brenda vetes me burime njerëzore, duke e shtuar sado pak edhe buxhetin, por duke trajnuar edhe njerëzit të cilët punojnë aktualisht në Agjencionin Antikorruption dhe duke e lënë një hapësirë që të bëjë një punë të pavarur.

Nga dokumenti aktual që flet për një strategji për vitin 2009-2011, në parime të përgjithshme janë përfshirë 5 objektiva apo 5 kapituj të cilët flasin për objektiva të ndryshme. Kapitulli i parë flet për parimet, do me thënë flet për transparencën, për qeverisjen e mirë, për shtetin e së drejtës, qasjen në dokumentet zyrtare, do me thënë parimet për të cilat në të shumtën e rasteve, institucionet së paku në atë aspektin e përgjithshëm janë duke u munduar t'i zbatojnë.

Objektiva e përgjithshme e strategjisë flet se si institucionet gjyqësore duhet të kenë një angazhim më të sinqertë për të luftuar dukuritë negative të cilat raportohen. Mandej, institucionet tjera të hartojnë plane të veprimit të qarta për ta luftuar korrupsionin si dukuri negative dhe, natyrisht, të rritet edhe roli i shoqërisë civile dhe roli i mediave që të bëjnë luftë më permanente për me luftuar dukurinë negative që po flitet që është aktuale dh natyrisht është aktuale për shkak edhe të disa raporteve që vijnë nga mekanizmat e ndryshëm.

Parimi apo, nëse mund të themi, objektiva e tretë, ka qenë forcimi i institucioneve në qeverinë lokale dhe qendrore. Aktualisht edhe qeveria lokale, pas nxjerrjes së Ligjit për vetëqeverisje lokale i ka forcuar mekanizmat që të jetë në shërbim të qytetarëve dhe ato dukuri negative qoftë të raportuara nga qytetarët apo në forma të ndryshme, i ka nxjerrë mekanizmat që t'i bëjë sa më të evitueshme dhe të ketë sukses. Një veprim të tillë e ka përdorur edhe Qeveria qendrore, së paku me at vullnetin politik që e ka para qytetarëve dhe para institucioneve që të luftohet me zero tolerancë apo të ketë një luftë shumë të ashpër ndaj dukurive negative pavarësisht ku paraqiten ato në secilin institucion, duke filluar edhe nga vetë institucioni më i lartë për të cilën po flasim.

Objektiva e katërt që flet në dokumentacion janë marrëveshjet ndërkombëtare, që në njëfarë mënyre, natyrisht, unë e thashë edhe në hartimin e këtij dokumentacioni kanë marrë pjesë shumë mekanizma, duke filluar nga Qeveria, Agjencioni, shoqëria civile, mediat, por edhe organizatat tjera joqeveritare të cilat e kanë ndihmuar Kosovën dhe po e ndihmojnë që të luftohet kjo dukuri negative. Dhe, ndoshta kapitulli i fundit, që për ne është shumë i rëndësishëm, është miratimi dhe monitorimi i kësaj strategjie dhe planit të veprimit nëse aprovohet në këtë Kuvend. Natyrisht që edhe këtu është paraparë një punë e kujdesshme që do të jetë edhe e Agjencionit Antikororupsion, por edhe e institucioneve tona me rastin e hartimit të planit që ta monitorojnë, do me thënë, jo vetëm ta aprovojmë si strategji, por edhe një kohë ta harxhojmë rreth monitorimit të zbatimit praktik të strategjisë antikorupsion, por edhe të planit të veprimit. Anëtarët e komisionit kërkojnë edhe një herë nga deputetët që të mos ndodhë ajo që ka ndodhur në të kaluarën, që ndoshta pa ndonjë arsye shumë të madhe të kthehet strategjia antikorupsion, është një dokument i cili ndoshta nuk është shumë ideal, por në parimet të përgjithshme i rregullon të gjitha fushat, së paku lë hapësirë që institucionet të cilat dëshirojnë me të vërtetë të luftojnë kundër korrupsionit, ia lë mundësinë dhe i hap rrugët që të nxjerrin planet e veprimit dhe, natyrisht, përmes këtyre planeve të veprimit ta luftojnë këtë dukuri negative.

Strategjia e ka edhe në një përparësi, se tani mbrapa e ka komplet planin e veprimit. Plan i veprimit në mënyrë detale parasheh kohën, afatet në të cilat duhet të aprovohen ligjet, ligjet që i përmenda pak minuta më parë, por parasheh edhe mënyrën e ekzekutimit në praktikë të Planit të veprimit për të gjitha institucionet. Prandaj, ne ju kishim lutur që deputetët ta aprovojnë strategjinë, sepse kjo ka qenë një mangësi e madhe edhe për ne, duke pasur parasysh që ne kemi humbur shumë, sepse të gjitha institucionet duhet t'i hartojnë planet e veprimit duke u mbështetur në këtë strategjinë e përgjithshme për ta luftuar korrupsionin, por kjo nuk do të mjaftonte nëse ne sot bëjmë sot vetëm kritika dhe të mos kemi vullnet politik ta aprovojmë strategjinë, do të ishte mangësia më e madhe nëse deputetët sot vetëm e kritikojnë strategjinë dhe planin e veprimit dhe nuk do të kenë vullnet për ta aprovuar këtë strategji dhe të japin mundësinë që institucionet me të vërtetë ta luftojnë këtë dukuri negative. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Kisha kërkuar nga komisionet vërtet të prezantojnë qëndrimin e komisioneve përkatëse, shefat e grupeve të prezantojnë qëndrimet e grupeve.

A e do fjalën kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Gani Koci e ka fjalën në emër të komisionit.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa në pjesën e vet e ka shqyrtuar Projekt-strategjinë dhe ka ardhur te përfundimi se nuk përmban implikime buxhetore dhe si e tillë duhet të miratohet. Prandaj, kërkoj që të respektohet ky rekomandim i komisionit nga Kuvendi.

Më lejoni të them vetëm edhe një çështje, gati sa i përket Projekt-strategjisë kemi të njëjtin dokument që e kemi pasur edhe më herët dhe atëherë është refuzuar për vetë faktin se nuk ka pasur në plan të veprimit dhe tani e kemi atë planin e veprimit që e përmendi edhe parafolësi, një plan shumë të përgjithësuar, që ndoshta nuk kanë mundur të përfshihen edhe shumë mekanizma tjerë institucional në atë plan. Prandaj, u mbetet të gjitha institucioneve që nuk e kanë parë veten në atë plan të veprimit, t'i bëjnë planet e tyre të veprimit në përputhje me këtë strategji dhe, në fund të fundit, Agjencioni Antikorrupsion është institucion që mbikëqyrë realizimin e atyre planeve. Po që se mbetemi vetëm në këtë plan të veprimit, gjë që Ligji nuk e kërkon se duhet të ketë një plan të veprimit që të miratohet në Kuvend, sepse institucionet i bëjnë planet e tyre, mirë që e kemi, por mos të bazohen vetëm në këtë plan të veprimit, sepse është shumë i përgjithësuar, por le të merret si bazë për realizimin e planeve konkrete të tyre në mënyrë që vërtet si fenomen për të cilën po flitet aq shumë, që së paku të bihet në përmasa të asaj që nuk është e tolerueshme, po të themi kushtimisht të menaxhueshme më lehtë për institucionet tona. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Më lejoni kryetarë të komisioneve t'i them vetëm dy-tri fjalë për juve. Ju lutem, kur raportoni në emër të komisioneve, raportoni për qëndrimin e komisionit, a është arritur ai qëndrim unanim apo me shumicën e votave, është mirë për opinionin të dihet kjo. Nëse është unanim, të thuhet - unë po e jap fjalën unanime të komisionit, ose komisioni ka vendosur me shumicën e votave. Kjo ka shumë rëndësi, se nëse në dy komisionet është arritur me unanimitet të plotë, qëndrimi i 21 deputetëve e sa janë paraqitur, vërtet për mua është diçka jo normale. Prandaj, fjalën e kanë në emër të grupeve parlamentare. Jo, jo nuk ka sqarim. Unë ju thashë qysh duhet raportuar. Tani e tutje keni kujdes çka raportoni.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë të respektuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës me vëmendje të përqendruar e ka shqyrtuar Projekt-strategjinë kundër korrupsionit në periudhën 2009-2011, sikurse edhe rekomandimet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe pas shqyrtimit ka ardhur në përfundim se, duke pasur parasysh që kjo Projekt-strategji ka qenë në këtë Kuvend dhe është debatuar pothuaj se një ditë për të dhe në fund është kthyer për shkak të mungesës së Planit të veprimit, Grupi Parlamentar i

Partisë Demokratike të Kosovës konsideron se kjo strategji duhet të aprovohet dhe konsideron se debati lidhur me Projekt-strategjinë është i shterur në seancën e qershorit, kurse tash mund të bisedojmë vetëm për planin e veprimt, i cili tash, pas rikthimit në Kuvend, i është shtuar strategjisë, ku janë përfshirë një gamë e aktorëve të cilët do të jenë të involvuar në luftën dhe në luftimin e korrupsionit si një dukuri mjaft kancerogjene, jo vetëm e shoqërisë sonë, por e çdo shoqërie.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës mbështet rekomandimet e komisioneve dhe ju bën thirrje kolegëve deputetë që ta aprovojnë strategjinë antikorrupsion, sepse jemi vonuar me aprovimin e saja, që do të na kushtojë edhe në Raportin e progresit që do të paraqitet nesër. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kush e do fjalën? Kolë Berisha e ka fjalën. Regjia, fjalën deputetit Kolë Berisha, me kartelën e Lutfi Hazirit.

KOLË BERISHA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Projekt-strategjinë për luftimin e korrupsionit në Kosovë dhe ka nxjerrë këto përfundime:

Grupi Parlamentar i LDK-së, mirëpret çdo përpjekje për krijimin e mekanizmave për ndërtimin e strategjive të këtilla që garantojnë rezultatet e prekshme në luftimin e korrupsionit në Kosovës. Në këtë kontest, ne e përkrahim Projekt-strategjinë kundër korrupsionit, e cila sot po na ofrohet për shqyrtim dhe miratim. Po në të njëjtën kohë jemi shumë të shqetësuar për praninë, qoftë edhe nëpër këto përmasa çfarë është tani, të kësaj dukurie që minon të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës.

Megjithatë, Grupi Parlamentar i LDK-së shpreson se me kompletimin e infrastrukturës ligjore, e cila është në fazën përfundimtare, do të krijohen premisa të mjaftueshme për ndërmarrjen e masave më efikase për luftimin e korrupsionit.

Grupi Parlamentar i LDK-së shpreh gatishmërinë e tij që përmes mekanizmave përkatës, aty ku ai përfaqësohet, të japë kontributin e tij në luftë kundër kësaj dukurie të zezë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Fillimisht, për të gjithë ata që e kanë marrë këtë dokument, që është strategji kundër korrupsionit e Qeverisë së Kosovës, nuk është e Agjencionit Antikorrupsion për shkak se ne na vjen me nënshkrim të Kryeministrit të Kosovës. Duhet të thuhet që nuk është në stad të draftit, por është në stad të dokumentit, i cili sot do të votohet ose nuk do të votohet në Kuvendin e Kosovës. Këtë stad të draftit po e përmendi, se përmendi zëvendëskryeministri. Stad drafti nuk është kur vjen para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, është një dokument zyrtar i Qeverisë.

Ju kisha lutur të gjithë juve që e keni dokumentin, të shkoni te faqja 8 dhe ta lexoni se si Qeveria e Kosovës na sjellë ne një dokument, në të cilin na thotë që perceptio për korrupsion në Kosovë është se Kuvendi është institucioni më i korruptuar në Kosovë.

Po na lut neve t'ia votojmë një dokument, në të cilin na quan institucioni më i korruptuar. Na të gjithë e dimë që asnjëri prej nesh as nuk japim licenca, as nuk hapim tenderë, as nuk po mbërrijë t'ia caktojmë vetit rrogën e asnjë send tjetër, as nuk po mund ta shtimë dikë në punë, diçka që kishte mundur të kualifikohej si korrupsion i Kuvendit. Këtë na e sjell ne Qeveria dhe na thotë - votoni këtë dokument se është i mirë.

Pika tjetër është se Projekt-strategjia nuk ka ndryshuar. Të na thuhet sot neve - votoni një projekt-strategji që nuk e keni votuar një herë, pa asnjë ndryshim, është njëjtë sikur të na thuhet - ju nuk keni ditur çka keni folur herën e kaluar, ju nuk keni ditur ju deputetët e Kuvendit të Kosovës as çfarë vendimi keni marrë, do me thënë ju nuk jeni serioz edhe mbledhni mendtë dhe votoni. Këto dy pika që i thashë mund të kualifikohen si fyerje serioze për Kuvendin e Kosovës dhe është thyerje e sistemit të parlamentarizmit. Kur Qeveria me të njëjtin dokument dy herë e fyen rëndë Kuvendin e Kosovës. Na quan të korruptuar dhe na thotë - shikoni se keni gabuar herën e kaluar, nuk po e ndryshojmë hiq na dokumentin, votoni ju se nuk jeni në veti, ju jeni gabim, ju deputetët.

Këto të dyja e bëjnë arsyen për ta kthyer dokumentin mbrapsht edhe më të fuqishëm se sa që ka qenë herën e fundit që e kemi kthyer. Po do t'ua jap edhe disa arsye të tjera pse duhet kthyer këtë dokument prapësht.

Me 24 prill ka ardhur në Qeveri, e kemi diskutuar, e kemi refuzuar këtë dokument dhe atëherë ka ekzistuar njëfarë forme, njëfarë plani i veprimt, kanë ekzistuar disa veprime të cilat Qeveria e Kosovës kryesisht, por edhe disa institucione tjera është dashur t'i ndërmarrin për ta realizuar strategjinë. Tani, në këtë strategji që e keni ju para vetit, shkruan që ekzistojnë disa veprime që duhen të kryhen në qershorin e kaluar. Qysh mundemi ne ta aprovojmë strategji sot, në të cilën parashihen veprime për qershorin që ka kaluar.

Kolegë të mi të nderuar deputetë dhe deputete,

Na jemi Kuvendi i Kosovës dhe mundemi të themi, hajde se dikush e ka shumicën, sikurse që e kaluam raportin e Bankës së Përgjithshme, na e kemi kaluar, votohen edhe njerëzit që kanë votuar, ne mundemi ta kalojmë prapë, por prapë po them që nuk po e bëjmë serioz institucionin në cilin po shërbejmë edhe po thoni që po i shërbejmë popullit, e nuk jemi serioz hiq. Nëse kalojnë kesi farë dokumentesh dhe themi që janë të mirë, le të më tregon mua, nëse di dikush, se qysh mundet të quhet një institucion i tillë serioz.

Në fund të fundit, nuk është strategji, kjo që na ka ardhur nuk është strategji, ne nuk e kemi kthyer për asnjë arsye tjetër, por kemi thënë që nuk është strategji hiq, është njëfarë dokumenti i çuditshëm, që nuk ka të bëjë fare me luftën kundër korrupsionit, është një dokument që në esencë ia heqë dhëmbët shoqërisë kosovare për ta luftuar korrupsionin, e lë, e bë të paaftë për ta luftuar korrupsionin, e topitë trurin e njerëzve dhe i bën njerëzit të mendojnë se çka do që të bëhet në botë, është korrupsion, kështu që çka po merrni kohë për ta luftuar këtë farë korrupsioni dhe njerëzit nisin të besojnë që nuk ke çka i bën, është shoqëri korruptive që nuk ka njerëz të ndershëm këtu se gjithkush është i korruptuar e tjera, e tjera që e bëjnë vendin tonë që t'i vijë marre dikujt t'i thotë prej kah është.

Tani duhet parë këto farë afatesh që i përmenda, qysh mundet të ketë strategji në cilën parashihen veprimet në qershor, e ne sot jemi në tetor. Çfarë strategjie mund të jetë ajo,

se është strategji dyvjeçare, sikur të kishte qenë 50 vjeçare, dikush thotë - hajt se ndoshta i kompensojmë diqysh një gjysmë viti, por nuk kemi qysh e kompensojmë një gjysmë viti, kur krejt strategjia është për dy vjet, çereku i kohës ka kaluar.

Çështje tjetër është që duhet të dalim te disa pyetje, ekzistojnë disa pyetje të cilat ne duhet t'i bëjmë. Meqenëse kemi mbërri deri këtu edhe është aprovuar Raporti i Auditorit Gjeneral, a i referohet diku kjo strategji raportit të auditorit. Raporti i auditorit përmend në faqe 14 ose 13, e kemi, gjejeni, keq menaxhimin sa i përket prokurimit, vjedhje, humbje të mjeteve çka nuk përmend, kurse dokumenti kundër korrupsionit i Qeverisë së Kosovës, strategjia kundër korrupsionit nuk i referohet hiq. Tash, a po rren auditori apo diçka nuk është në rregull me këtë strategji. Qysh mundet mos t'i referohet një dokumentit, një institucioni tepër valid për çdo shoqëri demokratike. Strategjia që po prodhohet sot, kurse raporti ka dal më moti, mos harroni, nuk ka dal dje raporti i auditorit. Askund nuk i referohet dhe kjo është një pyetje pse nuk iu ka referuar, kjo për shkak se është i vonuar, do me thënë një pyetje. Një pyetje tjetër është, cilat janë mësimet që i ka nxjerrë ndërkohë Qeveria e Kosovës, a ka nxjerrë ndonjë mësim apo është ekzakt njëjtë çdo gjë qysh ka qenë në vitin, shembull ta marrim, në mes të vitit 2008, para një vit e gjysmë. A ka ndonjë ndryshim në shoqërinë kosovare, apo mos janë kah rrejnë edhe Komisioni Evropian, që po thonë që në Kosovë ka rritje korrupsioni, që ka degradim të jetës institucionale, a mos e kanë edhe ata gabim dhe veç Qeveria jonë e ka mirë. Krejt bota janë qorra, nuk po shohin, nuk po dinë, vetëm këta njerëz që i bëjnë këto farë strategjitë, vetëm këta dinë.

Unë po ju them edhe një herë, po kthehem, po e përsëris vetveten. Vetë fakti që një dokument i Qeverisë, që kërkon prej nesh ta aprovojmë na quan neve të korruptuar, vetë fakti që nuk ka ndryshuar drafti prej kohës kur na e kemi kthyer mbrapsht, duhet të na thonë ne deputetëve - merreni bre këtë dokument, kapeni, bëni të paktën ndërrojani disa fjali, mos na fyeni kështu kaq shumë, mos na thoni neve që nuk kemi lidhje. Edhe një herë po them, e di që koalicioni e ka shumicën, e di që mund ta votojë, por e keni nderin e juaj, na votojmë kundër. Ju faleminderit!

(Reagime nga salla)

KRYETARI: Replikë 2 minuta.

BAHRI HYSENI: Të gjithë jemi deputetë dhe së paku nuk duhet nga ky Kuvend t'i rrejme qytetarët e Kosovës. Të gjithë dimë të lexojmë, absolut, por duhet të kenë kujdes edhe ata të cilët deklarojnë se në këtë dokument na kanë qitur institucion më të korruptuar. Nuk na shkon për nder. Ku po e lexoni? Unë nuk po di si po lexohet dhe ku po fillohet të lexohet ashtu mbrapshtë, në cilin nen? Ne po i dëgjojmë njerëzit tërë ditën këtu duke bërë pallavra, por së paku mos të na bindin se në këtë strategji Kuvendi shkruan. Nuk e di çfarë dokumente kanë, por në këtë dokument që e kemi ne në Komision, askund Kuvendi nuk del si institucion më i korruptuar. Nëse e keni fjalën te objektivat e përgjithshme të strategjisë, ju lutem, dëgjoni nuk shkruan. Te objektivat e përgjithshme kërkon që institucioni i lartë nga legjislativi të jetë më transparent, natyrisht t'iu jep llogaridhënie qytetarëve, që është krejt në rregull. Prandaj, është mirë mos të lexohen shtrembët. Ju faleminderit!

(Reagim i deputetit Ardian Gjini)

KRYETARI: Unë ia tërhoqa vërejtjen, realisht ia tërhoqa vërejtjen dhe përsëri po dua t'ua tërheq vërejtjen të gjithëve. Korrupsioni nuk është vetëm financiar, korrupsioni është edhe moral, edhe politik edhe kulturor dhe nëse flitet për korrupsion moral, edhe politik, ndoshta kemi, kanë të drejtë ata që na quajnë ashtu. Korrupsioni financiar është diku tjetër. Urdhëro Ardian, një minutë e ki kundër replikën.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Mund të të them zoti Bahri Hyseni që ta kam borxh të ta gjejë, se nuk po mundem shpejt t'i gjejë këto. Dëgjomë tash, se e kam vetëm një minutë dhe mund të të them se unë nuk rrej, po rren ti, nëse do bash qashtu, ti rren me krejt kolegët e tu, prej fillimit deri në fund ...

(Ndërhyrje e Kryetarit – Ardian! Atij ia tërhoqa vërejtjen, po ta tërheq edhe ty. Keni kujdes në gjuhën parlamentare, a!)

.... atëherë kërko le ta tërheq fjalën, pra!

(Kryetari: Atëherë, ne vend duhet ta tërhiqni fjalën të dy deputetët. Urdhëro, lexoje)

... faqe 9, “Sektorët prioritarë dhe objektivat specifik, pika (i) - Sektori politik”, informacion i përgjithshëm. Faqe 9: “Studimet e realizuara gjatë vitit 2007, tregojnë se në Kosovë partitë politike dhe Kuvendi janë perceptuar nga publiku si sektorët më të prekur nga korrupsioni”.

KRYETARI: Ju lutem, ju lutem! Vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Gashi e ka fjalën.

(Reagime nga salla)

KRYETARI: Ani, ata mos ta qesin dorën në kapuç.

IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

E kuptoj shumë mirë se tema për të cilën po bisedojmë në një kohë të vonshme të ditës, kur jemi lodhur pas shumë pikave, nga pak prodhon edhe kësi lloj frustrimesh, por në fakt është shqetësimi për temën që po e bisedojmë dhe gjendjen në të cilën ndodhet Kosova dhe mua nuk po më pëlqen aspak që edhe para meje ka shumë pak deputetë kur po diskutojmë për këtë pikë, edhe mbrapa ameje ka shumë pak qeveritarë kur po diskutojmë, e të cilët janë më të thirrurit që të jenë prezentë për t'i dëgjuar vërejtjet e deputetëve. Natyrisht, ata që po na përcjellin, ndoshta më të rregulltit dhe më të disiplinuarit janë qytetarët dhe opinionin publik, i cili po e paguan tagrin e këtij korrupsioni mbi supet e veta pashmangshëm.

Kam vetëm një vërejtje të udhëheqja e seancës të pjesës së para ditës nga kryesuesi, kolegu im zoti Sabri Hamiti, i cili ma mori fjalën pa të drejtë. Zoti Kryetar, nuk ishe këtu, ma mori fjalën pa të drejtë se unë i lash vend një replike e cila konform Rregullores duhej t'i leja vend dhe nuk ka të drejtë në asnjë mënyrë të ma marrë, se unë prapë e kërkoja fjalën dhe ai nuk ma dha. Ju faleminderit, që më dëgjuat.

Sa i përket Projekt-strategjisë lidhur me korrupsionin, unë mendoj që bëhet fjalë për një dokument që e kemi përtypur edhe një herë më herët dhe kemi pasur vërejtje të

mjaftueshme, kemi kërkuar një plan veprimi i cili na ka ardhur në formë të përgjithësuar mjaft. Them të përgjithësuar, sepse sipas mendimit tonë dhe të grupit që e përfaqësoj, do të duhej që plan-veprimi të veçantë të paraqesin të gjitha institucionet që në njëfarë mënyre janë të përfshira në këtë projekt-strategji për ta luftuar korrupsionin. Nuk mundet një plan veprimi për të gjitha institucionet, se bëhet një lëmsh i madh dhe ai lëmsh aktualisht qëndron në këtë plan veprimi.

Objektivat:

Më duhet se Projekt-strategjia është shumë ambicioze dhe shumë dëshirore dhe nuk ka masa konkrete të realizimit, aq më pak mekanizma implementues. Tregues i suksesit janë disa formulime, janë aq të përgjithësuar dhe aq afirmative, sa që edhe vendet që këtë temë e kanë në top prioritetet e politikës së tyre, nuk mundën t'i mbërrijnë ato parametra të realizimit të luftës kundër korrupsionit, e aq më pak Kosova e cila..., kjo do të duhej të na shërbejë si shqetësim dhe, në fakt, grupi im parlamentar nuk është i gatshëm këtë projekt-strategji ta aprovojë kështu që është edhe për një arsye shumë madhore, sepse në kohën kur po bisedojmë për këtë projekt-strategji, për fat të keq kemi edhe një rivlerësim të Komisionit Evropian përmes raportit më të fundit të progresit negativ në fushën e korrupsionit dhe ne nuk kemi reflektuar shumë pozitivisht për një vit, aq më tepër që kemi një projekt-strategji e cila nuk ka avancuar së paku në mënyrë, do me thënë në mënyrë deklarative të jemi më konciz dhe më serioz. Aq më tepër që është një konstatim i Komisionit Evropian, kur thotë se nuk korrespondon pjesa e zotimeve dhe të deklarimeve të Qeverisë me veprimet konkrete për shumë aktivitete dhe aty përfshihet edhe çështja e korrupsionit.

Sigurisht që një vërejtje që Grupi Parlamentar i AKR-së e ka pasur me rastin e miratimit të Ligjit antikorrupsion po reflekton tash në gjendjen edhe në këtë raport, sepse i vetmi mekanizëm monitorues për luftimin e korrupsionit është Agjencioni Antikorrupsion. Ju e dini, atëherë kemi qenë kundër që ligji i dedikohet vetëm këtij agjencioni dhe nuk ka mekanizëm tjetër dhe, në fakt, ky agjencion tash mbetet mekanizmi i vetëm monitorues dhe zbatues i kësaj strategjie, e na jemi duke e parë për çdo ditë fuqinë implementuese, fuqinë, si të them imponuese të këtij agjencioni, e cila është shumë minore në rrethanat aktuale, në rrethanat që në njëfarë mënyre pashmangshëm e përshkojnë krejt strategjinë, krejt shoqërinë, përkatësisht shtetet në tranzicion, qysh është Kosova. Duhet mekanizma pak më serioz dhe një suport më i madh institucional edhe nga Shoqëria Civile për të mundur të bëhet një agjencion të tillë që të marrë mbi barrën e vet.

Në rrethanat e Kosovës, as strategjia e as Ligji antikorrupsion nuk premtan se Kosova do të mund ta përmirësojë, kam frikë edhe Raportin e vitit 2010 të Komisionit Evropian për Progresin dhe konsekuencat nuk dua t'i përmend këtu, nuk dua të jem ogurzi, por kanë për të qenë të këqija për Kosovën. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, i nderuar deputet!

Një sqarim. Ju duhet ta dini, e besoj se e dini, që fjalën e merr ose e jep Kryetari i Kuvendit ose kryesuesi i seancës. Prandaj, nëse deputeti që e merr fjalën, do ta japë fjalën, e humb të drejtën për të folur vet.

Vazhdojmë. Në emër të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, fjalën e ka deputeti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Zoti kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,
Anëtar të Kabinetit qeveritar,
Ne për herë të dytë brenda disa muajsh e kemi Projekt-strategjinë e luftës kundër korrupsionit. Është një projekt-strategji e hartuar një herë dhe e sjellë dy herë në Kuvend, ku nuk është bërë asnjë ndryshim i vetëm në të.

Arsyet për ta shqyrtuar për herë të dytë do të duhej të ekzistonin në faktin që aty do të duhej të ishin bërë ndryshime dhe ato ndryshime të na shtyjnë që ne edhe një herë të debatojmë dhe ta shqyrtojmë, e në fund edhe ta miratojmë.

Në fakt, e ka një plan të veprimit, i cili mendoj se nuk i përfshin as aktorët kryesorë që do të duhej të ishin të kyçur aktivisht në luftë kundër korrupsionit, as segmentet kryesore në të cilat shfaqet korrupsioni dhe duhet të luftohet ai.

Të nderuar kolegë deputetë,
Ne të gjithë do ta kishim paramenduar se kjo projekt-strategji do të ishte e fokusuar në luftimin e korrupsionit në segmentet qeveritare ku ka tenderë dhe mundësia e keqpërdorimit të parasë publike është më e madhe. Korrupsioni gjithkund në rajon, pra edhe në botë, dhe nuk është specifikë e jona, më së shumti shfaqet aty ku ka tenderë dhe bëhen pazare me përqindje, pastaj te kompanitë publike, të cilat menaxhojnë fonde të mëdha publike dhe nuk janë të mbikëqyrura sa duhet, mandej në dogana, në gjykata, në prokurori, segmente të caktuara të shëndetësisë, të arsimit e tjera.

Projekt-strategjia kundër korrupsionit veçanërisht te ne do të duhej të ishte fokusuar në Ministrinë e Transportit dhe Post-telekomunikacionit, sepse aty është përqendruar një pjesë e madhe e buxhetit për investime kapitale, mirëmbajtje e tjera dhe logjikisht, ku ka investime, ka edhe tenderë dhe aty ka edhe korrupsion. Kjo nuk është specifikë vetëm e Kosovës, por është edhe në rajon dhe gjithkund në botë.

Gjendja katastrofale e rrugëve të asfaltuara në vitin e kaluar tregon se në këtë segment ka korrupsion, i cili i tejkalon shumëfish kufijtë e korrupsionit të viteve të kaluara. Unë e kam dëshmuar këtë me qindra foto të bëra nëpër terren dhe e dëshmoj kurdo që dikush e kërkon këtë. Por, ky segment ku më së shumti shfaqet korrupsioni, nuk është përmendur askund në këtë projekt-strategji.

Në Projektplanin e veprimit kot do ta kërkonte këtë Ministri dhe, realisht, në të do të duhej të ishte fokusuar gati 50% e luftës kundër korrupsionit. Pra, nuk është askund, nuk është përmendur fare. Ose ta marrim vetëm një shembull në Ministrinë e Arsimit, ku përsëri çështja lidhet me tenderë. Kjo ministri ka paguar 15 euro për botimin e një abetareje, e cila realisht nuk ka mundur të kushtoj më shumë se 2 ose 3 euro. Pra 12 deri 13 euro kanë shkuar në xhepat e zyrtarëve të ndryshëm të Ministrisë dhe në këtë projekt-strategji sërish nuk kemi asgjë në këtë drejtim dhe as që lidhet me këtë Ministri, as me format e paraqitjes së korrupsionit.

Kjo nuk i ka penguar, pra, zyrtarët e kësaj Ministrie ta bëjnë këtë veprim dhe ne nuk kemi, edhe një herë po e përsëris, asnjë formë strategjie që ta luftojmë këtë. Ky veprim nuk është i vetëm, ky veprim është vetëm maja e kodrës së akullit, të cilën ne arritëm ta shohim. Nën ujë fshihet një kodër e madhe e korrupsionit, e cila noton e qetë pa e trazuar askush.

Në fund, po e bëj një rekapitullim. Projekt-strategjia e luftës kundër korrupsionit për tri vite, pra 2009-2011 dhe deri në vitin 2012 ka gjithsej 16 faqe. Prej tyre 8 faqe përfshijnë hyrjen, objektivat, parimet, përkufizimin e korrupsionit, pra krejt gjëra të përgjithshme pa asgjë konkrete. Vetëm një 6 faqe pretendojnë të merren me luftimin e korrupsionit për tri vitet e ardhshme. Viti 2009, tashmë po shkon, ndërsa askush ose dikush siç duket do të “mendojë” ta luftojë korrupsionin për vitin që po shkon.

Segmenti kryesor të cilin shfaqet më së shumti korrupsioni, pra Administrata Qendrore, përfshin vetëm një faqe, aq sa përfshin edhe luftimi i korrupsionit në shoqërinë civile. Pra, me këtë projekt-strategji vlerësohet se në shoqërinë civile ka po aq korrupsion sa në të gjitha segmentet e Administratës Qendrore në Kosovë. Kjo është logjika e dhënies së hapësirës në këtë dokument. Kjo është qesharake dhe nuk ofron asnjë mundësi serioze për luftimin e korrupsionit. Sipas kësaj projekt-strategjie, korrupsioni nuk është fare i përqendruar aty ku ne e kemi menduar. Pra, në Qeverinë, por krejt diku tjetër, ku ne as që e kemi imagjinuar. Këtu e thanë disa kolegë, por unë do ta citoj konkretisht një fjalë, që është në këtë projekt-strategji dhe e cila u citua këtu dhe mendoj se nuk prish punë të përsëritet.

Në faqen 9, të Sektorit politik, thotë: “Studimet e realizuara gjatë vitit 2007, tregojnë se në Kosovë partitë politike dhe Kuvendi janë sektorët më të prekur nga korrupsioni”. Të nderuar kolegë deputetë, kjo jo vetëm që është tepër cinike, por edhe fyese. Këtu pohohet se partitë politike dhe Kuvendi janë sektorët më të prekur nga korrupsioni, pra jo Ministria e Transportit, jo ajo e Arsimit, jo ajo e Shëndetësisë, jo Doganat, Administrata Tatimore, gjykatat dhe prokuroritë, por partitë politike dhe Kuvendi i Kosovës. A mund ta shpjegoj dikush se si deputetët e Kuvendit të Kosovës janë të korruptuar ose punojnë në institucionin më të korruptuar. Unë mendoj se ai që e ka bërë këtë Projekt-strategji, është tallur me Kuvendin e Kosovës, duke e fyer në mënyrë shumë cinike. Kjo nuk do koment dhe këto institucione bashkë me Qeverinë, sipas kësaj projekt-strategjie nuk e kanë ndërmend ta luftojnë korrupsionin e as të bëjnë asnjë lloj strategjie, por e kanë bërë këtë sa për sy e faqe, në mënyrë që së paku të duket sikur dikush për e lufton korrupsionin. Për fat të keq, nuk e ka bërë as këtë.

Me këtë projekt-strategji vetëm sa mbrohet korrupsioni. Asnjë segment i kësaj projekt-strategjie nuk siguron që do të kemi një luftë reale kundër korrupsionit. Prandaj, ne si Grup Parlamentar nuk mund ta përkrahim këtë projekt-strategji, sepse kjo do të ishte vetëm një farsë dhe asgjë tjetër. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Gani Koci, ju faleminderit, deputet!

Po dua të them që vërtetë, nëse thuhet partitë politike, partitë politike janë edhe në pozitë edhe në opozitë dhe janë edhe në Qeveri edhe në Kuvend, por unë po frikohem që jam shumë i sinqertë me juve, edhe kalimi i deputetëve nga një grup parlamentar në tjetrin është një lloj korrupsioni, kështu që duhet ta pranojmë edhe këtë fakt.

(Të qeshura dhe reagime në sallë)

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, kush e do fjalën? Fjalën e ka deputeti Xhazair Murati!

DŽEZAIR MURATI: Vidim da ste raspoloženi predsjedniče, znači dobro teče tok Nacrta strategije protiv korupcije i mi se, drage kolege, nalazmo u periodu izborne

kampanje i mislim da sada smo podgrejali atmosferu i sada svaljujemo jedni na druge, ne znam metode kako je, dok jedni umanjuju, drugi uvećavaju i tako dalje i to je možda normalno kada se radi o demokratiji. Mi smo pri kraju godine i mi možemo govoriti o strategiji za 2010. i 2011. godinu. Ne možemo u ovoj kratkom periodu nešto efikasno drugo da uradimo. Pred sobom imamo preporuke Komisije za zakonodavstvo i sudstvo i ona u svom sastavu ima članove iz svih političkih partija, odnosno svih parlamentarnih grupa. Kao što vidimo ovde u ovom nacrtu strategije, odnosno u ovom dodatku memoranduma, predlog strategije je odobren od strane Komisije za zakonodavstvo. Dakle, te mre se smatraju efikasnim, znači svi smo im dali na neki način prolaznost, a samim tim nacrt strategije nam je prosledjen danas ovde na Skupštini. Ako već Komisija nije mogla da da veće primedbe, onda je pitanje zašto se oko nekih stvari ovoliko razlikujemo.

Ovaj dokumenat koji je pred nama, on sadrži određene ciljeve i prioritete koji se javljaju ispred naših institucija na svim nivoima, dakle i na izvršnom i na zakonodavnom i na sudskom, kako bi smo sprečili sve negativne pojave koje se u našem društvu pominju. Korupcija nije fenomen kosovskog društva, ona je fenomen društava koje imaju dug demokratski razvoj. Uzimamo samo Italiju, kao primer, a mi smo imali i međunarodne izveštaje, gde je naša država u donjem uglu korupcije. Sada, koji su bili njihovi parametri utvrđivanja negativnih pojava na Kosovu, mi to ne znamo, ali je činjenica da su oni bili objavljeni u našoj štampi, tako da mi svakako nismo imuni od korupcije, ali nismo na onoj tabeli tamo ne znam nekih zemalja koje malo duže razvijaju svoja društva i tako dalje. Tako da ovoj strategiji je dat jedan plan delovanja. Mi možemo oko njega da se sporimo, ali je činjenica da ima određenih rešenja. Koliko ćemo da ih iskoristimo i koliko ćemo današnju sednicu Skupštine da iskoristimo da neka nova rešenja borbe protiv korupcije usvojimo, to je opet stvar rada ove plenarne sednice ili narednih koje budu posvećene analizi ovog fenomena.

Za naredne dve godine, svakako da je cilj Vlade da nezadovoljstvo građana Kosova, od prilike učini sve što je moguće kako bi naše društvo postalo zdravije sa smanjenim negativnim pojavama koje su приметne, nažalost. Na neki način, opet nismo imuni kao i drugi, ali mi u celini kao Parlamentarna grupa, analizirajući i ove predloge koje se nalaze pred nama, mi usvajamo ovaj plan strategije, ali se nadamo da će današnja sednica da da još neka rešenja, rešenja a ne kritiziranje. Kritiku da, ali ta rešenja moraju biti ovde izneta i argumentovana, pa ćemo prihvatiti ona rešenja koja su bolja, ali u celini ovaj je predlog, kao početni strateški plan borbe protiv korupcije, mi ga kao Parlamentarna grupa prihvatamo. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, a e do dikush fjalën? Nuk ka. Vazhdojmë. Deputeti Naim Rustemi e ka fjalën.

NAIM RRUSTEMI: Unë, para se të nisë diskutimin, kisha vetëm dy fjalë, që kur flasim për korrupsion, ta kemi parasysh që nuk ka parti politike. Korrupsioni është fenomen që i prek të gjithë. Me fjalë të tjera, nuk ka dikush çka hatërohet, sepse nuk të ndahen njerëzit që janë të korruptuar të asaj partie apo të kësaj partie. Ata janë individë që për beneficione të veta marrin veprime të caktuara, kështu që nuk desha të keqkuptohem nga të tjerët në diskutimin tim, por një gjë është shumë me rëndësi se kjo strategji nuk ka qenë e vlefshme të vijë në Kuvend.

Pika e parë, është shumë e vonuar, është fundi i vitit 2009, e ne flasim për Strategjinë 2009-2011. Me fjalë të tjera, ne mund t'i mbyllim sytë e të themi, në rregull atëherë,

plani i veprimit që ka pasur data qershor e korrik, arritja e objektivave në muajt që veç kanë kaluar, mund t'i mbyllim sytë e të themi, në rregull, paskan gabuar mund ta bëjmë një përmirësim, por përgjegjësia është te Agjencioni i antikorrupsionit. Ata është dashur pak t'i japin respekt Kuvendit të Kosovës pra se ta bien këtë strategji, para se ta bien këtë plan të veprimit, ta bëjnë një rregullim të planit të veprimit.

Gjithashtu, unë kam shumë vërejtje në Projekt-strategjinë. Për shembull, kjo projekt-strategji me fjalë të tjera, për të mos u lëshuar në diskutime akademike herë, herë ndodhë që po flasim dhe disa prej deputetëve bëjnë diskutime pezull, që unë po e kam të vështirë t'i përcjell, strategjia është analizë, është një lëvizje prej një gjendje në një gjendje të caktuar. Analiza që iu ka bërë gjendjes aktuale në Kosovë, kryesisht nga kjo strategji del se iu ka bërë dhe është e bazuar në një organizatë, që e ka emrin Fridem Haus. Atë raport për Fridem Haus e ka realizuar vetëm një njeri, vetëm një njeri personalisht dhe të gjithë ata që i kanë lexuar raportet e Fridem Haus, e dinë që dokumenti është i prodhuar nga një person dhe autor individualisht dhe e tërë kjo analizë e gjendjes aktuale reflekton gjendjen e vitit 2007 sepse, sipas citateve që i kanë bërë, janë raportet e vitit 2008 që reflektojnë gjendjen e vitit 2007. Kur e shohim dhe e lexojmë me vëmendje gjendjen aktuale, e shohim që nuk e reflekton realitetin. Pse? Sepse e njëjta organizatë edhe në këtë vit e ka botuar Raportin për gjendjen në Kosovë të vitit 2008. Me fjalë të tjera, një raport, një strategji që kish për të ardhur në Kuvend, ish dashur të bëjë ap date, ishte dashur të jetë cituar në të dhënat më të reja, në mënyrë që të ngrihet validiteti i strategjisë, sepse kur diskuton për korrupsion, aty thotë se korrupsioni në Kosovë është në gjendjen 5.75 dhe ka tendenca të rënies, kurse e njëjta organizatë në raportin e ngjashëm për vitin 2008, thotë se nuk ka tendenca të rënies, por ka tendenca të ngritjes. Me fjalë të tjera, e kretë baza e këtij raporti shembet.

Nëse kishte për t'u cituar vetëm një herë, prapë do t'i mbyllim sytë, por kjo strategji e citon këtë organizatë 5-6 herë, me fjalë të tjera më shumë ka në këtë strategji për atë raport, se sa në raportin konkret. Kështu që, unë personalisht mendoj dhe i sugjeroj edhe të tjerëve t'ia tërheqin vërejtjen në mënyrë shumë serioze Agjencisë ose t'i jepen rekomandime për ngritjen e kapaciteteve intelektuale, për ngritjen e kapaciteteve vepruese brenda Agjencisë, sepse kjo strategji sipas Ligjit antikorrupsion është përpiluar për Qeverinë dhe sillet në Kuvend dhe ka të drejtë Agjencioni ta amendamentojë strategjinë antikorrupsionit.

Por, sido që të jetë, unë do të shkoj edhe nëpër disa vërejtje që i kam pasur rreth kësaj strategjie.

Kur flasim në kapitullin e parë - Përparimet, flasim për qeverisjen e mirë, zero tolerancë. Të nderuar, ku flasim për zero tolerancë, me momentin që e bëjmë gishtin zero, me fjalë të tjera kemi thënë që është rreth koncentrik, me fjalë të tjera që kemi thënë që kemi për t'ia nisur prej vetes, me fjalë të tjera kemi thënë që kemi për t'ia nisur prej rrethit tonë të parë, personalisht, familjarisht, por edhe bashkëpunëtorëve më të ngushtë. Tendenca është që korrupsioni të mos luftohet në rrathët e fundmë. Atje, për shembull, del publikisht, ne jemi luftëtar të denjë të korrupsionit edhe e gjejmë një polic i cili është korruptuar me gjysmë kilogrami djathë. Kjo është humor.

Unë kërkoj edhe po i ngriti si brenga të mia që korrupsioni të fillojë prej këtu. Unë iu kam drejtuar edhe Kryesisë së Kuvendit me një letër, në vend të pyetjes parlamentare, sepse nuk e kam gjetur arsyen se si t'i drejtohem Kryesisë së Kuvendit ndryshe. Ne, si Kuvend i Kosovës, kur duam ta luftojmë seriozisht korrupsionin, atëherë duhet t'ia nisim

prej këtu. Mirë e tha Kryetari i Kuvendit se korrupsioni nuk është veç transaksion financiar, çfarëdo lloj benificioni, e kemi edhe në definicionet e strategjisë, privat për përfitim personal. Çfarë do lloj përfitimi personal që jepet, ndoshta nuk është paraja mjet transaksioni i përfitimit personal drejtpërdrejt, mund të jenë edhe beneficione të tjera. Gjithashtu, edhe në partneritetin publiko- privat, te parimet - E drejta e qytetarit në qeverisje. E kemi një kapitull në të cilin...

KRYESUESI SABRI HAMITI: Përfundoje, të lutem, se edhe ashtu... përfundoje!

NAIM RRUSTEMI... gjithashtu kjo strategji askund nuk e përmend EULEX-in. EULEX-i me aktin e veprimit, me aktin e Bashkimit Evropian për vendosjen e EULEX-it, në një prej pikave, thotë pikave të saktë, në nen i ka të përcaktuara se do të bëjë, ndihmojë, bëjë implementimin e Planit të veprimit të antikorrupsionit. Askund nuk është përmendur. Këto janë detyra të dhëna të sakta, detyra që i ka marrë nga Bashkimi Evropian, detyra që edhe qytetarët e Kosovës me një ë mikpritje të vetën e kanë pranuar ashtu si e kanë pranuar, por normalisht që ata do të duhej të jenë konkret dhe veprues në luftimin e antikorrupsionit.

Të nderuar, nuk mund të flasim për demokracinë dhe të mos kemi parasysh sundimin e ligjit. Ne kot flasim, unë po flas, më jepet fjala, u jepet edhe të tjerëve. Këto janë veç vlera të lirisë së të shprehurit. Kot flasim, është fuqia e votës. Është fuqia e votës, por vota nuk jepet, nuk merret nga qytetari, nuk e vendos demokracinë pa sundim të ligjit. Me fjalë të tjera, kushdo që i fiton votat, nuk do të thotë - hajde të matim vota, por je obligativ të vësh në veprim dhe të bësh që ligji të jetë pikë strategjike dhe pikë ku sundon, me fjalë të tjera, gjithkush të jetë i barabartë para ligjit, sepse unë mendoj se po e përfundoj me këtë fjalë, unë mendoj se koha në Kosovë ka ardhur që rruga deri në Dubravë, tash edhe me kësi gurë vullkanikë, mund të shtrohet më lirë. Dikush duhet të paguaj për dëmin që ia bë vendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Unë ju sjell në vëmendje deputetëve që i kanë 5 minuta, i sjell në vëmendje edhe regjisë që koha për diskutime është 5 minuta.
Fjalën e merr deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Ju faleminderit zoti kryesues!

Po, më lejoni të kthehem edhe një herë në pikën e pestë, se kryetari më hyri në hak, replikoi me mua, por nuk ma dha mundësinë që të qartësohem. Unë atë që e ngrita në pikën e pestë, e kam bërë duke u mbështetur në dyshimin e bazuar që gjithkund në botë mjafton për organe gjyqësore për të nisur procedura, do me thënë edhe silogjizmin gjyqësor. Pra, nuk kam hapur për askënd fate ..., nuk kam kërkuar kokën e askujt, më mjafton e imja, por thjeshtë duke pasur parasysh dyshimin e bazuar dhe silogjizmin, pra, përfundimin logjik, kam bërë atë që e kam bërë. Sidoqoftë, kthehem tash te kjo pika që po e flasim.

Të nderuar të pranishëm,

Strategjinë të gjithë e dimë, është e sata herë veç u tha që po na vjen nëpër dorë, por mua po ma qon mallin, po sikurse edhe të ishte me e sofistikuar se ajo thënia “më mirë luaje derën, badihava mos rri” nga fakti se pa marrë parasysh nivelin e strategjisë, kjo do të jetë e kotë. Këtë e kemi eksperiencën deri më tani dhe arsyeja është thjeshtë se kjo Qeveri nuk është e interesuar ta luftojë korrupsionin, pos me fjalë, pra në atë stilin “Dëgjo çka po të them, mos më këqyr çka po bëj”. Pra, edhe zoti zëvendëskryeministër

në fjalimin e tij e pati plotë me zero tolerancë të korrupsionit, me transparencë, me luftë kundër nepotizmit, për llogaridhënie e tjera e tjera, por sa herë që në këtë Parlament ngrihen çështjet konkrete, pra të bazuara në dyshim, apo dyshimin e ashtuquajtur të bazuar, përgjigjen anëtarët e Kabinetit, na e japin se nuk jemi Qeveri etatiste, se ne nuk përzihemi në punët e ndërmarrjeve publike e tjera, e tjera, për ato ndërmarrje publike të cilat opinioni i Kosovës është shumë i interesuar të dijë se çka apo ndodhë dhe, po ndodhë gjithçka.

Këtu e përmendi edhe parafolësi EULEX-in. T'ju them të drejtën, edhe EULEX-it ia zë për të madhe që deri tash asgjë nuk ka bërë në Kosovë, a ka ardhur për ta luftuar korrupsionin. Të paktën, unë këtu e kam këtë planin për veprim të përbashkët, që thotë për Misionin e Unionit Evropian në sundimin e ligjit në Kosovë - EULEX, që është i datës 4 shkurt 2008, dhe amendamentimin e tij në qershor të vitit 2009. Pra, kur është themeluar EULEX-i, janë pikat, është statuti i shkruar shumë qartë pse ka ardhur EULEX-si në Kosovë. Është misioni, do me thënë, kemi nenin 3, më falni 2, sidomos neni 3 pikat a,b,c e tjera, e tjera, të cilat në mënyrë konkrete ia sqarojnë, domethënë e obligojmë EULEX-in ta luftojë korrupsionin dhe deri më tani EULEX-i kurrë nuk ka bërë. Krejt çka ka bërë, e ka bërë një liflet, edhe këtë kohën e fundit disa reklama se për çka ka ardhur këtu, na tregon misionin e tjera, e tjera.

Andaj, po them, kjo strategji, nuk po them se e ka nivelin çfarë është dashur ta ketë, po edhe sikur ta kishte, do të ishte e kotë se thjeshtë Qeveria nuk është e interesuar, të paktën deri më tani, aq më pak edhe EULEX-i, që sinqerisht shpresoj se janë kah na dëgjojnë, zgjohen nga gjumi se kanë ardhur për ta luftuar korrupsionin në Kosovë, për atë edhe paguhen. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryesues,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Agjencioni Antikorrupsion ka prurë ne para shumë kohe një strategji për luftimin e korrupsionit, por kanë ndodhur vonesat dhe ne tani jemi në muajin e dhjetë dhe po flasim për vitin 2009, edhe pse na kanë mbetur edhe dy muaj për përfundimin e këtij viti.

Në bazë të raporteve që kemi ne, del se si sektor më të korrumpuar në Kosovë janë gjyqësori, ministritë, KEK-u, Agjencioni Kosovar i Privatizimit, shëndetësia, doganat dhe kjo jep për të kuptuar se kjo sëmundje e cila e ka emrin korrupsion, ka zënë rrënjë në Republikën e Kosovës, por edhe në Ballkan.

Problem kryesor për zbatimin e Ligjit të antikorrupsionit dhe kundër korrupsionit në Kosovës është lidhja e ngushtë e këtij fenomeni me krimin e organizuar dhe mafinë. Kjo shkakton frikë te të gjithë që të lajmërojnë korrupsionin dhe mungon guximi edhe i prokurorive që të ndërmarrin masa dhe aksione për arrestimin e atyre që inkurajojnë dhe krijojnë korrupsionin në Republikën e Kosovës. Unë do t'i them disa rekomandime që i kam bërë, sepse e kam lexuar mirë këtë strategji. Mungon liria e informimit, e cila siguron qasje të qytetarëve në informatat e Qeverisë. Do të duhej të kishte një ueb faqe ku qytetarët do të kishin mundësi të informohen për çdo gjë që ndodhë rreth tenderëve, ta zëmë. T'u shpërndahen informata organizatave joqeveritare me kohë se çfarë po

ndodhë dhe çfarë vendime po merr Qeveria e Kosovës, qoftë për KEK-un, për Postën, për tenderët jashtë Kosove, ta zëmë, të postës apo të tjera.

Ne do të duhej ta miratonim Ligjin për shpалosjen e financave të gjithë deputetëve, por edhe ministrave, si dhe të atyre drejtorëve të cilët Qeveria e Kosovës i ka zgjedhur në poste, si në KEK, Aeroport dhe në Post-telekomunikacion, si dhe në Hekurudhat. Ne kemi probleme, gjithashtu, edhe te tenderët. Të nderuar, ekziston fjala popullore: "Ai që është nën dardhë, hanë dardha", të gjithë e dinë, por ta marrësh dardhën, ta shkulësh nga vendi ta qosh në shtëpi, kjo nuk duhet të ndodhë, sepse këtu te ne po ndodhin fenomene të tilla jo vetëm të hajë dardha ai që është në dardhë, por ta marrë krejt dardhën.

Luftimi i korrupsionit duhet të bëhet edhe në nivelin e Parlamentit, duhet të krijohen rregulla për luftimin e konfliktit të interesit, të cilin ne e kemi evident në tërë Republikën e Kosovës. Kuvendi i Kosovës do të duhej të krijonte komisione ad-hoc për të hetuar secilën ministri apo edhe për t'i hetuar financat publike, të Post-telekomunikacionit apo edhe të Aeroportit, por kjo nuk po ndodhë. Ta zëmë, derisa ne kemi tentuar ta formojmë një komision për hetimin e Radiotelevizionit të Kosovës, dikush iu ka bërë presion deputetëve, edhe ky është korrupsion, që ata të tërhiqen nga lista e nënshkrimit të tyre dhe një tjetër korrupsion është edhe vet Presidenti i Republikës së Kosovës, kërkon nga deputeti Arsim Rexhepi që të tërhiqet nga nisma për formimin e Komisionit ad-hoc për hetimin e... Ju deputetë, para 10 minutave më keni thënë vetë dhe më keni thënë merre ti, sepse unë nuk po mundem. Një shembull, do të thotë, kjo është korrupsion, edhe ky është korrupsion, bilën e bilës mjaftë mirë kryetari i Kuvendit e përmendi më herët, po them sinqerisht, sepse kam dëshmitarë aty pranë ku kanë qenë edhe të tjerët.

Transparenca. Duhet të ketë një transparencë në lëshimin e lejeve, në lëshimin e licencave. Duhet të njoftohen me kohë ata që nuk marrin leje, sepse nëse nuk marrin leje dhe nuk njoftohen dhe për arsye pse nuk kanë marrë, po kërkohen para, mito dhe më vonë po jepet leja.

Të nderuar deputetë, ne jemi pranë fushatës elektorale. Duhet të ndalohet rreptësisht korrupsioni gjatë fushatës para dhe pas fushatës elektorale. Të gjitha kompanitë e mëdha duhet t'i shpалosin financat e tyre një vit para dhe pas fillimit të fushatës, sepse po e dinë mirë se të gjitha kompanitë e mëdha që marrin tenderë, japin para të mëdha për financimin e fushatave që janë në kundërshtim me ligjet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Arsim, një minutë Arsim, mos e zgjatë!

ARSIM REXHEPI: Këto që i tha kolegu im, zoti Geci, do të ishin krejt në rregull sikur mos të ishte kjo pasazhi që e përgojoi Presidentin, pa të drejtë, pa asnjë të drejtë, jo pse unë dua ata luaj tash këtu avokatin e Presidentit, por nuk kishte të bënte fare as me kontekstin e pikës së rendit të ditës. Mendoj se për një çështje kaq të ndjeshme, të cilën do të mund ta përthekonte kjo pikë e rendit të ditës, ishte shumë joserioze prej kolegut që të më involvojë në një kontekst të tillë krejtësisht tjetër.

Çështja, sa për njoftim të opinionit, çështja e komisionit hetimor, nesër do të vjen në Parlament, e ka përkrahur fuqishëm edhe Presidenti, kjo është e vërteta dhe mendoj se këtu nuk ka asnjë vend për një formë mohuese të diskutimit, çfarë e pati më parë në sintaksë kolegu Gani Geci.

KRYESUESI: Gani, shkurt, 1 minutë.

GANI GECI: Ju faleminderit!

Unë kam dëshmitarë, është dëshmitar Naim Rustemi, është dëshmitar Driton Tali dhe të dytë, para të dyve më tha - a po e merr ti, se mua nuk po më lë, thashë Presidenti. Ma dha dorën. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Tjera herë, kur të bëni intimitete, dini që bëhen publike. Fjalën e merr kolegu, deputeti Naim Maloku.

(Reagime nga salla)

KRYESUESI: Lëreni atë punë, e ka përmendur. Bëhuni serioz, ju mund t'ia përmendni emrin për lojë njëri-tjetrit 10 orë kot. Bjeri shkurt, të lutem shumë, mos na ik prej teme. Mos përmend emra tjerë se... Naim Rustemi. Po, është jashtë, por ti hyre në kontekst.

NAIM RRUSTEMI: Unë veç desha të shprehë dashamirësinë time se edhe Presidenti tash qenka në favor të krijimit të komisionit hetues dhe e falënderoj edhe Presidentit dhe do t'ia plotësojmë atë dëshirë.

KRYESUESI: Tani e ka fjalën kolegu, Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministër, ministra

Të nderuar deputetë,

Unë nuk isha lajmëruar për fjalë, po të mos kishte qenë fjala shumë domethënëse e zëvendëskryeministrit Ramë Manaj, që disa here e potencoi - Qeveria do ta luftojë me këmbëngulje korrupsionin dhe të mos ishin deklaramet që dy vite që i dëgjojmë - zero tolerancë kundër korrupsionit.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni vetëm t'i them para jush dhe opinionit disa të dhëna të sjella dhe të fituara nga Doganat e Kosovës për mallrat që kanë lëvizur në doganat e Kosovës 2007 – 2008.

Benzina 124.5 milionë litra – 2007; 116.9 milionë litra – 2008. 7. milionë pikë 6 litra i kanë harxhuar qytetarët e Kosovës në vitin 2008 më pak. Kafe e pjekur 4.167 tonë – 2007; 3.275 tonë – 2008 për minus 892 tonë kafe i kanë harxhuar qytetarët e Kosovës më pak në vitin 2008.

Bitumeni nga 1.276.000 kilogramë, ka rënë në vitin 2007 në 338.252 kilogramë. Keni parasysh se thuhet që janë ndërtuar 600 km rrugë në vitin 2008.

Të nderuar deputetë,

Argjendi në vitin 2007, - 94 kilogram janë zhdoganuar në Kosovë, 38 në vitin 2008. Ari - 4.82 kilogram në vitin 2007, - 6.8 në vitin 2008. Këto sasi i gjeni në cilëndo argjendari këtu në rrugën “Nëna Terezë”, që i kanë momentalisht në gjendje këtë sasi të arit edhe argjendit, pra një argjendari. Pse po e them këtë? Në vitin 2008, më 21 prill kur është debatuar 100 - ditshi i Qeverisë së Kosovës, ministri i Financave atë ditë pati deklaruar që brenda 6 muajve do të vihen arkat fiskale në këta dy sektorë, që ishte kërkesa ime. Pra, në tregun e naftës dhe të arit dhe deri me sot nuk është marrë asnjë veprim dhe në Kuvendin e Kosovës nuk ka ardhur as Ligji për arkat fiskale. Pse ndodhë kjo? A është Qeveria e kapur direkt me kontrabandën e naftës, pra me Petrol- mafinë në Kosovë, a

është e kapur direkt? Pse nuk i vënë arkat fiskale, kur në të gjitha lokalet, një kafe kur pihet 50 cent, qytetari e merr tiketën sa paguan TVSH që e ka pirë një kafe. Pse nuk kontrollohet tregu i naftës, që është me vlerë prej 350 milionë euro në Kosovë dhe tregu i arit, sipas vlerësimeve të jashtme, mbi 100 milionë euro.

Këto janë dyshimet për korrupsion që Qeveria është e kapur në te, nuk e akuzoj. Hejja jashtë vendit e 266 milionë eurove duke blerë letra me vlerë, pra nga Buxheti i Kosovës, pa vendim të Kuvendit dhe pa sqaruar se çfarë letrash janë me vlerë, sa është kamata, kush fiton. Janë dyshime, të nderuar deputetë, për kapjen në flagrancë të Qeverisë së Kosovës në korrupsion. Mos të flasim për të hollat e Postës, të hollat e privatizimit të cilat i përmendi edhe Kryetari i Kuvendit. Këto sqarime duhet t'i japë Qeveria e Kosovës dhe pastaj t'i besojmë që ka zero tolerancë kundër korrupsionit dhe që është aleat në luftimin e korrupsionit. A është kapur Qeveria në këto marifete dhe malverzime me kontrabandë, pra, me këta artikuj në Kosovë? Ju faleminderit!

KRYESUSEI: Ju faleminderit, zoti Maloku! Fjalën e ka deputetja Sanije Aliaj.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti zëvendëskryeministër,

Të respektuar deputetë,

Edhe pse Kosova është shtet i ri, institucionet e Kosovës, ndër të tjera prioritet e kanë përkushtimin për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, si veprimtari e keqpërdorimit të resurseve publike për interesa individuale.

Zbatimi i Strategjisë 2004-2007, tregon një të arritur kryesisht në tri fusha: Në fushën e miratimit të politikave, në fushën e miratimit të tri ligjeve kundër korrupsionit dhe në fushën e krijimit të dy mekanizmave për luftimin e kësaj dukurie. Mirëpo, Komisioni Evropian ka identifikuar një varg dobësish në këtë fushë, që për ne është e ditur edhe përmes Raportit të progresit për vitin 2008, por edhe përmes raporteve vjetore 2007-2008, të ofruara nga Agjencioni i Kosovës kundër Korrupsionit. Prandaj, nevoja për një strategji të re justifikon domosdoshmërinë për miratimin e saj, sepse mundëson aplikimin e reformave kundër korrupsionit. Derisa strategjia e kaluar kryesisht ishte e fokusuar në politikë dhe politikanët, Strategjia e re 2009-2011 mbulon sektorin publik, partitë politike, sektorin e biznesit privat, OJQ-të dhe shoqërinë në përgjithësi.

Përveç kësaj, objektivat e Strategjisë 2009-2011 krijojnë balancin midis qasjes së parandalimit dhe qasjes së ndëshkimit, të renditura në 5 kapituj, që së bashku me planin e veprimit precizojnë qëllimet e qarta, por është shumë esenciale që këto qëllime duhet të zbatohen.

Të nderuar deputetë,

Strategjia që sot po e shqyrtojmë dhe plani i veprimit për zbatimin e saj, ka afat zbatimi vetëm 2 vjet, edhe pse është precizuar për 3, plus edhe mbi 10 ligje që duhet miratuar. Kjo nënkupton se strategjia 2009-2011 ka afat zbatimi vetëm 2 vjet, pra nuk shkon në hap me kohën dhe dinamikën e duhur. Në kapitullin 2 të strategjisë, objektivat e përgjithshme, ku ndër të tjera parashihet parandalimi dhe luftimi i korrupsionit në sektorin publik përmes llogaridhënies dhe transparencës, ditë më parë, kohë më parë, pra, Agjencioni i Kosovës kundër Korrupsionit është prezantuar me një numër përfaqësues të institucioneve që nuk e zbatojnë Ligjin kundër korrupsionit.

Pyes: Pse mekanizmat institucional përkatës nuk i marrin masat ligjore për të gjithë ata persona që nuk e kanë deklaruar pasurinë? Shteti funksional nuk nënkupton vetëm evidentimin e parregullsive, por edhe zbatimin e masave ndaj keqpërdoruesve.

Edhe në këtë strategji paraqitet kompleksiteti i korrupsionit për nga natyra dhe laramania e faktorëve që ndikojnë në të. Prandaj, bashkëpunimi mes institucioneve qendrore, lokale me qytetarë dhe media, konsiderohet se është një faktor kryesor i precizuar në objektivat e veçanta të kësaj strategjie. Propozoj që Qeveria e Kosovës këtë strategji ta zbatojnë në radhë të parë në kompanitë e mëdha, që janë: KEK-u, Posta, Doganat dhe në të gjitha institucionet ku njëra prej veprimtarive të tyre është ndarja e tenderëve. Aty i ka rrënjët korrupsioni dhe aty duhet parandaluar dhe luftuar.

Për ta zbatuar Strategjinë 2000-2011, Agjencioni kundër Korrupsionit, në bashkëpunim me institucionet vendore ka hartuar edhe planin e veprimit si dokument vizionar, ku paraqiten ndër të tjera objektivat, veprimet konkrete dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtyre veprimeve si dhe afatet kohore.

Strategjia dhe plani i veprimit ngritin përgjegjësinë edhe te Kuvendit, pra duhet zënë afatet kohore për miratimin e atyre ligjeve që parashihen në planin e veprimit, por edhe ngritin përgjegjësinë e deputetëve për të monitoruar zbatimin e strategjisë dhe planin e veprimit.

Në fund, përkrah strategjinë si një dokument që parandalon dhe lufton këtë dukuri, me një shpresë shumë të madhe që...

KRYETARI: Ju faleminderit! Jo kemi, për debat kemi, për votim nuk kemi kuorum të mjaftueshëm. Edhe kjo mënyra se si ne po sillemi ndaj seancave, është njëfarë lloj korrupsioni, prandaj mos mendoni se veç ku hynë dora në xhep për para është korrupsion. Është mirë të lexoni më mirë për korrupsionin dhe ta dini që ka korrupsione edhe më të rënda se korrupsioni financiar. Korrupsioni politik dhe moral është edhe më i rëndë se ai financiar. Ka edhe forma tjera. Mendoj se keni mangësi të njohurisë për korrupsionin. Fjalën e ka Huset Cakolli.

HESET CAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

(Kryetari: 34 veta janë në sallë)

Projekt-strategjia kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011 ka për qëllim krijimin e politikave dhe masave për parandalimin e korrupsionit në Kosovë. Në bazë të raporteve të ndryshme të publikuara gjatë viteve 2007- 2008, të cilat japin një analizë të situatës, të shkaqeve dhe të pasojave të korrupsionit, shihet se problemi i korrupsionit është ende shumë i përhapur në shoqërinë tonë dhe ky fenomen po ndikon në krijimin e imazhit të keq për vendin tonë.

Edhe Komisioni Evropian ka identifikuar shumë dobësi në fushën e politikave në luftën kundër korrupsionit dhe Komisioni Evropian i parashtron si prioritet afatshkurtër për Kosovën ndjekjen e politikës më tolerancë zero kundër korrupsionit.

Të nderuar deputetë,

Ne jemi dëshmitarë se sipas perceptimeve të qytetarëve të Kosovës ka korrupsion në shumë institucione shumë të rëndësishme për ndërtimin e shtetit tonë, për shembull, në këtë rast kisha përmendur gjykatat, doganat, Administratën Qendrore, KEK-un, Postën e të tjera dhe kjo dukuri jo e mirë për shtetin tonë i ka irrituar shumë qytetarët tonë. Edhe pse ekzistojnë instrumente ligjore për parandalimin e korrupsionit, si duket nuk ka mekanizma të mjaftueshëm për ta luftuar këtë dukuri jo të mirë deri në fund.

Problemet më të theksuara të cilat ndikojnë në zbatimin e strategjisë kundër korrupsionit, janë, në raport janë precizuar atje, mungesa e vullnetit politik, mungesa e personelit me përvojë, mungesa e kontrollit dhe mbikëqyrjes e tjera. Edhe pse Agjencioni kundër Korrupsionit ka filluar punën prej muajit shkurt të vitit 2007, deri më sot kur po debatojmë ka arritur t'i hulumtojë disa raste të dyshuara korruptive, por unë nuk e di se sa raste janë të vërtetuara se ka pasur korrupsion dhe nëse po, sa persona juridikë dhe fizikë kanë marrë dënimin sipas ligjeve në fuqi. Unë mendoj se kriterium për vlerësimin e suksesit të arritur në luftën kundër korrupsionit duhet të jetë - sa persona kanë marrë dënime në gjykata dhe pastaj të vlerësohet se sa ka filluar të zvogëlohet korrupsioni, e nuk mjafton vetëm të thuhet se ka korrupsion, e mos të kemi të dhëna konkrete dhe të sakta.

Në pikën 5 të kësaj projekt-strategjie është dhënë një tabelë e planit të veprimit kundër korrupsionit për periudhën dyvjeçare në të ardhmen, ku janë paraparë objektivat, veprimet, institucionet përgjegjëse, treguesit e suksesit dhe është paraparë buxheti për përmbushjen e këtyre synimeve, por mbetet të shihet sa do të zbatohet dhe monitorohet ky plan i veprimit nga Agjencioni kundër Korrupsionit. Kjo projekt-strategji në këtë formë, unë mendoj se nuk garanton sukses në luftën kundër korrupsionit. Por, megjithatë, shpresoj se në të ardhmen gjendja do të përmirësohet për të mirën e qytetarëve dhe të vendit tonë në përgjithësi. Ju faleminderit, zotërinj!

KRYETARI: Unë po i thërras deputetët që të kthehen në sallë. Fjalën e ka deputetja Mimoza Ahmetaj.

MIMOZA AHMETAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Nuk e pata ndërmend ta marrë fjalën, sepse u fol e u përfol shumë, por më nxiti debati i deputetit Adem Salihaj me vërejtjet e tij të adresuara në adresën e Ministrisë për Transport dhe të Telekomunikacionit, si dhe me vërejtjet në adresën e Ministrisë së Arsimit e në përgjithësi, të Qeverisë.

Do ta pyesja zotin Adem Salihaj, si e shpjegon ai blerjen e postit, po flasim për blerjen e postit të zëvendëskryeministrit në kohën e qeverisjes së tij dhe madje për këtë ka qenë e ngritur procedura gjyqësore. Si e shpjegon ai diplomimin në moshën 60 vjeçare, mos të na thotë që është bërë më i mençur në atë kohë, por sigurisht që tregues është real i blerjes së diplomës si dhe, si e quan ai mbylljen e korridorit të rrugës në Kaçanik për muaj të tërë për një kamion dhe. Mos të na thotë se ka qenë shumë e vështirë të hapet rruga për atë kohë.

Po e kthej edhe një herë në fillim debatin, kur u përmend që është përfolur apo nuk është përfolur ose në këtë raport përmendet që Qeveria apo një mekanizëm i caktuar i adreson vërejtjet në drejtim të Kuvendit të Kosovës për faktin se disa apo deputetët janë të korruptuar. Unë vetëm desha ta sqaroj edhe një herë. Vërejtjet i adresohen Qeverisë dhe atë në periudhën nga 2004 deri në 2007 dhe jo aspak kësaj Qeverie dhe është mëkat të akuzohen deputetët kur dihet fare mirë se të paktën deputetët janë ata të cilët më së paku

korruptohen dhe të jesh deputetë është nder dhe një përgjegjësi shumë e madhe. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Naser Rugova e ka fjalën. Mirë, vazhdojmë. Replikë, Adem Salihaj, dy minuta.

ADEM SALIHAI: Mua më vjen keq me të vërtetë për nivelin e deputetes Mimoza Ahmeti, është në një nivel që nuk i përket asnjë deputeti, as Kuvendit. Partia e juaj, zonja Ahmeti, ka bërë një mal shpifjesh dhe akuzash që nuk janë vërtetuar kurrë dhe ju po i përsëritni sot në Kuvend, në institucionin ku nuk duhet të jenë këto.

Për blerjen e postit është një akuzë, por jo kundër meje, është kundër atij që ka shpifur. Çështja tjetër që ju e thoni, që është bajagi e turpshme, por nuk e di si e thoni, unë kam diplomuar para disa vjetësh, por kam diplomuar vërtet në moshë të shtyrë, por nuk kam mundur më herët për shkak se kam qenë 3 herë i burgosur nga Serbia dhe kam pasur 5 procese gjyqësore prej Serbisë kundër meje. Jam njeriu më i torturuar në Kosovë për çështje të Kosovës, e besoj se ju nuk jeni, besoj se ju nuk jeni. Edhe çështjen e kodrës do të vijë koha, unë do të kërkoj një komision hetues parlamentar për këtë çështje dhe do ta ndriçojmë në mënyrën më të mirë të mundshme, do të shihet që unë nuk kam asnjë lidhje me atë çështje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Vetëm kisha kërkuar që fjalorin parlamentar ta kontrolloni se nuk e keni në nivelin e duhur. Fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kur po diskutojmë për një Projekt-strategji tejet të rëndësishme, e cila ka një rëndësi tani në proceset integruese dhe në fazën kur Bashkimi Evropian kërkon hapa konkretë nga institucionet e vendit, vërtet edhe mungesa e deputetëve në sallë, edhe prezenca e Kabinetit qeveritar këtu, tregojnë për një joseriozitet. Unë do të ndalem në strategjinë, në këtë draft-strategji dhe dua të citoj kapitullin 3, - Sektorët prioritarë dhe objektivat specifike.

Masat antikorrupsion të sektorit politik do t'ju adresohen, po citoj: "Partive politike, deputetëve të Kuvendit ose legjislativit, anëtarëve të Qeverisë dhe anëtarëve të kabineteve politike". Është shumë racionale kjo që ju adresohem partive politike, pse? Partitë politike i përbëjnë institucionet, Kuvendi, nëse legjislativin, po edhe ekzekutivin, edhe mekanizmat tjerë i përbëjnë partitë politike, andaj është imediate që të krijohet një legjislacion i përshtatshëm adekuat që mund të zbatohet për rrethanat nëpër të cilat kalon vendi ynë, si Ligji për partitë politike, Ligji mbi konfliktin e interesit e të tjera, ligje të cilat pa arsye, nuk kanë ndonjë arsye racionale pse nuk janë proceduar deri më tani.

Te deputetët e Kuvendit dhe të legjislativit, Kryetari e tha një fjalë shumë të qëndrueshme: korrupsioni nuk është vetëm me para, korrupsioni politik është ende më i dëmshëm. Vendime të caktuara në këtë Kuvend janë marrë dhe Kuvendi shpesh është bërë pre e grupeve të interesit, të klaneve të caktuara politike, që me vendimet e veta thjeshtë janë involvuar me vendime të caktuara me benifite dhe përfitime të paligjshme ekonomike. Pastaj, edhe transferet politike dhe vetitë e tjera që cenojnë etikën politike ose trafiqet politike, janë korrupsion politik. Ne kemi njerëz që nuk është dashur të zgjedhen në institucionet më të larta të shtetit, në borde dhe në agjencione të pavarura të cilat kanë ardhur në ato pozicione si pasojë e korrupsionit politik, shantazheve të

caktuara në partitë politike dhe përfaqësues edhe të këtij legjislativi. Për këto, sigurisht në një debat tjetër.

Sa i takon planit të veprimit, është një diskrepancë e madhe në mes të hartimit të legjislacionit për masat e ndërmarra në këtë plan veprimi dhe kalendarit legjislativ me veprimet që duhet ndërmarrë si pjesë e kësaj strategjie. Vetë mesi i muajit 10 të vitit 2009, e kur ne po diskutojmë për Propozim-strategjinë kundër korrupsionit 2009-2011, tregon që jemi vonuar 10 muaj.

Këtë projekt-strategji e paraqiti para deputetëve zëvendëskryeministri Manaj. Unë dua të citoj faqen 10, të Administrata Publike Qendrore dhe emërimet që bëhen në institucionet shtetërore. Megjithëse masat e ndërmarra normative dhe institucionale në sektorin e administratës publike, zbatimi i strategjisë për reformën në administratën publike 2006-2011, nëpunës civil në Kosovë janë ende të prekur nga ndërhyrjet politike, praktikat korruptive dhe nepotizmi. Shikojeni regrutimin e stafit diplomatik. Del, flet zëvendëskryeministri - zero tolerancë kundër korrupsionit, e vëllanë e vet e çon sekretar në Ambasadë në Itali. Çfarë morali politik, çfarë logjike dhe çfarë mesazhi ju dërgoni qytetarëve të Kosovës, çfarë komisioni vlerësues për stafin diplomatik që po përzgjidhet tani për ambasadat tona? Këtu ka vëllezër të deputetëve që janë pranuar, djem tezesh, nipash e hallash në misionin diplomatik që kanë për ta mbrojtur interesin diplomatik dhe nacional të Kosovës. Mos të hyjmë te politikat sektoriale, tek trafiqet dhe kontrabandat me karburante, me cigare, mosvënia e arkave fiskale, kontrabanda në sektorin farmaceutikë, hajnitë enorme që po ndodhin në këta sektorë dhe një krim i organizuar me shtetet përreth, që ka një adresë - ekzekutivin e Kosovës dhe këtu duhet që kjo strategji t'i propozojë masat që duhen të ndërmerren, sepse është një strategji me masa administrative boshe, e cila në realitet nuk do të mund ta arrijë misionin dhe qëllimin për të cilin ka ardhur në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kështu si po vazhdohet, me këto strategji të cekëta dhe pa veprime konkrete, frikoj që edhe për vite të tëra Evropa do të na shikojë...

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën!

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar! Gjylnaze, a e do fjalën? Ju faleminderit! Desha pak ta respektoj gjininë e kundërt. Ju faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë, sot po e diskutojmë Strategjinë kundër korrupsionit. U tha shumë çka, tha edhe kryetari për Komisionin për Legjislacionin e Gjyqësi, pjesë e të cilëve jemi edhe ne. Është shumë e qartë dhe duhet të jemi të kujdesshëm edhe në përdorimin e fjalorit, edhe në përgjithësimin e gjëra që kanë të bëjnë me të gjitha nivelet institucionale.

Sot kemi një strategji përpara. Është e domosdoshme që ata që kanë mendime më të mira, të japin komente më të mira, ta begatojnë, por mos ta nënvlerësojnë pa marrë parasysh, sepse kjo flet për luftimin e dukurive negative dhe të gjithë me gojën plot dakordohemi, së paku kështu publikisht, që dëshirojmë ta luftojmë korrupsionin dhe t'i japim zero tolerancë. Prandaj, nuk duhet që perceptimi i qytetarëve apo perceptimi i monitoruesve që të përfshijë ndonjëherë të gjitha kategoritë, për shembull, siç ishte rasti me raportin e vitit 2007, ku është një perceptim i Fridem Haus, ndërsa ka njerëz që këtu nuk kanë qenë deputetë, për shembull në vitin 2007, dhe ndoshta e ndiejnë veten keq.

Prandaj, ajo çka është më se e domosdoshme dhe e cila i plotëson edhe kërkesat, është mbështetja ligjore që Kuvendi duhet të marrë përsipër që ta mbështesë edhe këtë

strategji me ligje mirë të hartuara, sidomos që është shumë e domosdoshme dhe që pritet që sa më shpejt që Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik do të sillet sa më shpejt, veç është i gatshëm për lexim të dytë. Prandaj, mendoj që me hyrje në fuqi të këtij ligji do të qartësohen shumë gjëra edhe për zyrtarët e lartë publikë edhe të gjithë ata që, besoj që nuk ka njerëz të korruptuar, zyrtarë të lartë, por sigurisht që do të bëhet një kontroll i prejardhjes së pasurisë së tyre. Prandaj, ata të cilët deklarohen publikisht me gojën plot dhe tregojnë elemente tjera korruptive, duhet ta dinë që infrastruktura ligjore po plotësohet dhe në një të ardhme të afërt ndoshta vetë pikë së pari ata do të ndeshen me deklarimin e pasurisë së fituar në mënyrë të ligjshme apo të paligjshme.

Është më se e domosdoshme që duhet qartë ne, unë e thashë edhe në fillim që ndoshta institucioni kryesor kundër korrupsionit, si organ i formuar nga Kuvendi është Agjencioni Kosovar kundër Korrupsionit dhe Qeveria, në këtë rast, edhe këtu në raport, edhe në planin e veprimit, i ka dhënë veç përkrahje apo mbështetje këtij raporti që sot është, apo kësaj strategjie që është para nesh. Unë do të kisha edhe një vërejtje për Agjencionin Antikorrupsion, që duhet të jetë edhe i kujdesshëm dhe të ketë edhe këtu riformulime të qarta, sepse në njërin anë mund të ketë, ta them, mund të ketë përshkrime të ngjarjeve të kohëpaskohshme, që tash nuk përkoinjë me realitetin, prandaj edhe pse ndonjë herë raportet mund të jenë të vonuara, por duhet të jenë me qasje të drejtë kohore.

Se sa është përkufizimi i korrupsionit, ne e dëgjuam që edhe nga kolegët tjerë deputetë, çdo njëri në formën e vetë nganjëherë po mundohet t'i japë kahe. Është e vërtetë që e dimë edhe definicionin e qartë të korrupsionit, por ne dëgjuam edhe më herët, pati edhe diskutime publike që dikush edhe brenda Kuvendit i ka nga katër-pesë pozita, dikush mbaron, për shembull, shtëpia shumëkatëshe dhe është deputet edhe nuk i frikohet as ligjit, as Policisë për krime ekonomike, as Prokurorisë, as organeve tjera gjyqësore.

Si deputet i jap përkrahje jo vetëm kësaj strategjie, po çdo iniciative që ka të bëjë me luftimin e dukurive negative dhe korrupsionit dhe plani i veprimit është i përfshirë shumë qartë, pavarësisht përshkrimit këtu të strategjisë që çdoherë edhe çdo kush mund të ketë...

KRYETARI: Ju faleminderit! Gjylnaze Sylja e ka fjalën!

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, Kryetar!

E nderuara zonja ministre,

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar deputetë,

Nevoja për ta luftuar korrupsionin është urgjente, sepse është problem serioz dhe po aq i rëndësishëm është parandalimi i korrupsionit. Edhe pse Kryeministri me shumë pompozitet pati deklaruar - zero tolerancë për korrupsionin, deri më sot kjo ka ngelur vetëm deklaratë. Përndryshe, po ta kishte prioritet, ashtu siç ka deklaruar, do të zhvillonte politika antikorruptive që qëndrueshme dhe strategji efikase kundër korrupsionit. Do të flas me fakte. Është e vërtetë dhe dëshmi se cili është rezultati i luftës së Qeverisë për dy vjet kundër korrupsionit - zero. Dëshiroj t'ia kujtoj kësaj Qeverie se mandatin e ka marrë pikërisht për ta luftuar këtë fenomen. Po ta kishte seriozisht, do të fillonte me marrjen e masave antikorruptive që kur e ka marrë pushtetin, do të thotë që 2 vjet. Po ta kishte seriozisht, në seancën e kaluar Qeveria do të ishte prezente kur Kuvendi i Kosovës e pati në agjendë diskutimin e antikorrupsionit. Po ta kishte seriozisht Qeveria, që dy vjet sukseesi nuk do të mungonte.

Fakti tjetër. Për ta përpiluar një strategji mbi korrupsionin, duhet ditur shkaqet, nivelin e shtrirjes dhe burimin. Për ta zbatuar, duhet vullnet politik dhe vënien e mekanizmave antikorrupsiv, veprimet në interesin e përgjithshëm dhe jo personal. Po ashtu, projekt-strategjia duhet të definojë qartë objektivat dhe planin e zbatimit. Dyshimi im për suksesin e kësaj lufte, është edhe në vet mekanizmin, ndoshta, qendror të luftës kundër korrupsionit, që është Agjensioni Antikorrupsion për arsye se zëvendëskryeministri e pati thirr drejtorin e Agjencionit në bisedë politike kur u deklaruan të dhënat se cili dikaster është më i korruptuari.

Është e vërtetë dhe fakt se në Raportin e Agjencionit 2008, thuhet se korrupsioni ka shpërndarje më të madhe në Qeveri, gjykata, qeverisje lokale dhe ndërmarrje publike. Nëse është kështu, punohet me prioritet. Në qoftë se Qeveria është më e korruptuara, atëherë lufta kundër korrupsionit duhet të bëhet aty ku është më e korruptuara. Në qoftë se buxheti i Kosovës më i madhi i takon Ministrisë të Transportit dhe Telekomunikacionit, mundësitë e korrupsionit, sidomos tenderët, gjë që është e njohur për të gjithë, është më e madhe dhe aty duhet të fillojë lufta. Kjo i mungon kësaj strategjie. Sipas mendimit, tim secili dikaster i ministrisë, do të thotë, secila ministri e veçantë duhet të ketë mekanizmat e qartë në luftën kundër korrupsionit, në qoftë se i besojmë, natyrisht, Agjencionit Antikorrupsion.

Sektori tjetër, Ministria e Administratës Publike. Dëshiroj t'ia kujtoj një ngjarje shumë të afërt dhe të vërtetë Kuvendit, se ky Kuvend ka marrë vendimin për mos renovimin e Rilindjes. Qeveria e ka shkelë vendimin e Kuvendit, e ka marrë për sipër dhe e ka bërë renovimin, i cili është nga vetë Qeveria, ka thënë se kushton diku 5 milionë, doli se me tenderë 15 milionë, tani edhe dy milionë tjerë, meqenëse është dashur t'i paguaj dëmshpërblimin për shkak të shkeljes së kontratës Kompanisë "Shlirimi", do të thotë 17 milionë.

Tash po iu referohem pak edhe vetëvlerësimeve nga jashtë, me Komisionin Evropian po filloj. Komisioni Evropian ka identifikuar një numër boshllëqesh dhe dobësish në fushën e politikës, duke përfshirë këtu Administratën Publike dhe politikat kundër korrupsionit. Kjo shkruan në raport. Për zbatimin praktik të antikorrupsionit, rolin qendror duhet ta ketë Qeveria, jo aty një zyrë e vogël për qeverisje të mirë, për të cilën ju të gjithë e dini se nuk e ka kapacitetin e duhur për ta luftuar antikorrupsionin. Në qoftë se mendoni se korrupsionin mund ta luftojë një zyrë e vogël për qeverisje të mirë, atëherë mendoj që Qeveria në një mënyrë është tallur me ne dhe, natyrisht, nuk e ka seriozisht. Po i referohem edhe një herë Komisionit Evropian, ku në Raportin e progresit për vitin 2008, Komisioni Evropian vlerëson se korrupsioni është i përhapur dhe mbetet problem kryesor në Kosovë. Ky raport thotë se Zyra e Auditorit Gjeneral në raportin e fundit tregon humbje të pashpjegueshme të Buxhetit të Kosovës prej 05 deri 5 milionë euro në çdo ministri në vit. A nuk është ky fakt se duhet filluar me masa të veçanta për çdo ministri.

Vlerësimi im është se qëllimi i Qeverisë është që më tepër të krijojë përshtypjen se po e lufton korrupsionin, por në realitet nuk po...

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Hajdin Abazi.

HAJDIN ABAZI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Jemi sot duke debatuar rreth Strategjisë kundër korrupsionit, gjë që kemi diskutuar edhe në qershor të këtij viti dhe është e vërtetë se ky fenomen meriton përqendrimin dhe përkushtimin tonë, sepse po e dëmton shoqërinë në përgjithësi, mirëpo është një çështje që duhet ta kemi parasysh. Këtu u prezantua strategjia e antikorrupsionit si strategji e Qeverisë, ndërkaq shumë qartë të gjithë ne deputetët e kemi në dokumentacionin tonë se këtë strategji kundër korrupsionit e ka përgatitur Agjencioni Antikorrupsion, kurse sipas Ligjit shkon përmes miratimit të Qeverisë që të vijë tek ne si deputetë dhe kjo është krejt e arsyeshme për arsye se duhet shumë mekanizma qeveritarë të angazhohen për ta realizuar këtë strategji me qëllim që të jenë efikas.

Çështja e dytë që dua ta theksoj sa i përket përkufizimit të korrupsionit, Agjencioni këtu shumë në mënyrë të qartë e ka përkufizuar korrupsionin si keqpërdorim të pushtetit, përkatësisht të përgjegjësive dhe kjo është për interesat personale, qoftë në vendet publike, qoftë në ato private, gjë që e ka përkufizuar se për cilën sferë duhet të përqendrohet kjo strategji dhe lufta kundër cilit lloj të korrupsionit dhe ndoshta ne jemi pikërisht në këtë nivel, ku hapi i parë duhet të bëhet në këtë drejtim, që të mund të kemi sukses pastaj për të vazhduar edhe me ato segmentet më të thella, që i përmendët edhe ju, zoti kryetar, do të thotë edhe aspekti moral e të tjera. Mirëpo, sot për sot nevoja urgjente është në aspektin praktik dhe në aspektin e keqpërdorimit të pushtetit dhe të përgjegjësive që shfaqen dhe bëhen në Kosovë.

Një çështje tjetër që është mjaft e dhimbshme është fakti se nga qershori deri në tetor janë muaj të humbur për arsye se sikurse ta kishim aprovuar strategjinë në qershor, ne veç do të kishim filluar të shohim implementimin e saj më herët, mirëpo tani ne, nëse sot do ta votojmë dhe do ta miratojmë, përsëri do të jemi të vonuar dhe për këtë arsye unë do të dal me një propozim konkret, por para se të shkoj tek ajo, do ta them edhe një gjë, se u përmend këtu çështja e farefisnisë, e cila ka një lloj përparësie në punësim dhe kjo është shumë e ndjeshme. Mirëpo, këtu duhet t'i dallojmë dy gjëra, njëra është: A ka personi në fjalë kompetencën adekuate, sepse nuk kemi të drejtë ligjore askënd ta privojmë nga e drejta që të jetë pjesëtar i një institucioni vetëm që është një farefis i një ministri ose i një deputeti ose i dikujt tjetër. Nëse ai e ka kompetencën adekuate, konkurren në mënyrë ligjore, ka të drejtë, por nëse i mungon ajo kompetencë dhe përsëri ka ardhur në shprehje, atëherë mund të flasim për elemente të dyshimta.

Është e vërtetë se në shumë segmente ka nevojë që të luftohet fenomeni i korrupsionit dhe unë shpresoj që edhe opozita tash ta ketë të qartë se sa më shpejtë që ne ta aprovojmë këtë strategji, aq më e efektshme do të jetë mundësia për ta luftuar këtë fenomen. Meqenëse ne veç jemi të vonuar për rreth 4 muaj, unë propozoj konkretisht që këtë ta quajmë jo strategji e vitit 2009-2011, por strategji kundër korrupsionit të vitit 2010-2012, sepse kështu do të jepet mundësia që kjo strategji vërtet të realizohet, pasi që ne veç po na humb shumë kohë në këtë drejtim. Ju faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Vërtet u diskutua rreth kësaj çështjeje, por realisht ky fenomen ka peshën e vet dhe rëndësinë e vet dhe kam parasysh që kolegët janë të lodhur, megjithatë secili kemi obligim, fundi i fundit. Unë nuk dua ta marrim këtu as në këtë çështje të jemi pozitivë e opozitivë. Këtë fenomen, në qoftë se duam ta luftojmë, duhet mos ta personalizojmë, por realisht duhet ta gjejmë forcën ta denoncojmë, ta luftojmë dhe mos të presim raporte

çfarë po presim që të na vijë nga Bashkësia Evropiane që është vërtet shumë dëshpërues për qytetarët e Kosovës.

Këtë material, të quajtur strategji, ky Kuvend vërtet e ka debatuar edhe në qershor dhe nuk e ka votuar me arsyen se duhet kompletuar në planin operativ. A e ka sjellë Agjencioni kundër Korrupsionit a Qeveria, natyrisht, Qeveria e ka aprovuar dhe Qeveria e ka prezantuar sot para Kuvendit të Kosovës me të cilin material, sepse unë nuk mund ta quaj strategji, pretendon ta luftoj korrupsionin.

Të nderuar kolegë deputetë, ky material i quajtur Strategji kundër korrupsionit është një shembull konkret se kjo Qeveri korrupsionit i ka shpallur luftë vetëm në mënyrë deklarative, por as që e ka ndërmend që ta luftojë realisht, tek e fundit, njerëzit e korrumpuar nuk mund dhe nuk duan ta luftojnë korrupsionin.

Është e papranueshme se si e kupton Qeveria Planin operativ. Kush është tashmë 10 vite pas lufte në Kosovë që nuk e di se cilat institucione të themeluara janë kompetent për ta luftuar korrupsionin dhe për t'u marrë me vepra penale. Të gjithë e dinë, por sa po funksionojnë ato dhe sa Qeveria i koordinon punët me këto institucione dhe sa, kushtimisht, kjo strategji ka menduar të caktojë afate, kritere se kur çështja e caktuar duhet të shqyrtohet, si për shembull, ne kemi shembuj konkret, që në organet e drejtësisë nuk shqyrtohen lëndët e krimeve të rënda të cilat dosje janë të mbyllura e që janë duke u rritur çdo vit nga viti 2001 deri në vitin 2009 dhe në këtë qeverisje është thyer edhe dhoma e dëshmive. Jo që ka filluar të merret kush me këto dëshmi, e me këto krime kaq të rënda, qofshin korruptive, qofshin krime të tjera, por realisht në këtë Qeveri është thyer edhe dhoma e dëshmive, pikërisht në Polici dhe askush ende nuk është shkarkuar, askush ende nuk ka marrë asnjë përgjegjësi ndaj këtij krimi, po e quaj unë, që ka ndodhur në vetë organet e Policisë.

Çka shohim na sot, ose jemi dëshmitarë, tenderomaninë, kush merret me te, merret vërtet Qeveria e Kosovës. Çka të shohim, është vërtetë kontrabanda, kontrolli pastaj i institucioneve mbi të gjitha këto institucione relevante të cilat ishte dashur të koordinohet puna për luftimin e korrupsionit. Përkundrazi, Qeveria nuk i lë, siç janë mediat, biznesi, gjykatën, Prokurorinë, Policinë, ndërmarrjet publike, Universitetin e tjera, këto duhet të funksionojnë si organe të pavarura, por Qeveria që të gjitha i ka në kontroll dhe absolutisht këto janë të ngulfatura dhe nuk e kryejnë punën ashtu siç duhet kryer dhe siç duhet vepruar. Unë nuk e kuptoj Qeverinë të ketë kontroll çfarë e ka, por realisht duhet të kërkojë përgjegjësi prej këtyre institucioneve dhe në mënyrë transparente duke na prurë strategji konkrete, se nga ky institucion kërkohet në këtë afat kohor ky realizim i këtij fenomeni ose i këtij projekti.

Natyrisht, tash jemi dëshmitarë që në Kosovë ka edhe pastrim të parave dhe gjëra të tjera dhe mos të fokusohemi veç te kontrabanda dhe krimi i organizuar në Veri të Kosovës. Fatkeqësisht, krimi tashmë është instaluar në institucionet e Kosovës edhe kontrabanda dhe fatkeqësisht në Kosovë nuk funksionon shteti ligjor dhe këtë nuk mund ta bëjë një institucion vetëm i darë nga tjetri. Ky Kuvend, natyrisht që duhet të kërkojë përgjegjësi nga Qeveria e Kosovës dhe unë kisha qenë shumë e lumtur në qoftë se do ta kishte sjellë një dokument konkret që vërtet na pas disa muajsh do të kishim kërkuar rezultate konkrete, por me një dokument të tillë, me të cilin përshkruhet ose vërtet është i njëjti, të cilin e kemi refuzuar në qershorin e këtij viti, unë nuk di që mund të luftohet korrupsioni me një dokument të tillë. Megjithatë...

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti, Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari zotëri Kryetar,
Të nderuar qeveritarë, deputetë,
Unë do të orvatem që konkretisht të jap një kontribut modest në tekstin të cilin e debatojmë.

Korrupsioni në faqen e gjashtë nuk është definuar si duhet as për afërsisht. Unë vetëm do të përpiqem kështu për ta dhënë një shembull, e nga ky mund të nxjerrjen një varg definicionesh. Dy molla nëse janë njëra e shtypur, mollë e korruptuar, ose kur thotë “jena”, “kena”, gjuhë e korruptuar, e rrjedhimisht, do të thotë, do të duhej të definohej, se nëse nuk është definuar, ju lutem, në këtë dokument si duhet, atëherë natyrisht krejt shkon strategjia, si të them, në drejtim joadekuat. Ose, shteti i së drejtës, në faqen 8, nuk është e saktë që shteti i së drejtës është shteti në të cilin ligji nuk është nën askënd, por mbi çdokënd. Është tjetra, bile këtë doktrina juridike gjermane e ka definuar para dy shekujsh, është ndarja edhe kontrollimi reciprok i të tri formave fundamentale të pushteteve. Kjo është substanca e shtetit të së drejtës. Prandaj, definicionin do të isha angazhuar që ta ridefinojmë këtë.

Te objektivat e strategjisë, te faqja 8, thuhet ndër të tjera: “synimi, objektiva është rritja e integritetit e llogaridhënies e transparencës”. Ky është me të vërtetë definim i korruptuar, se kurdoherë po të isha, po e zamë, pushtetar, do të kisha thënë - është rritur dhe mund të rritet, po nuk është synimi - rritja, po është sigurimi, sigurimi është synimi i strategjisë, i integritetit, i llogaridhënies, i transparencës, ama jo rritja.

Te masat antikorrupsion, në faqen 9, që u adresohen subjekteve të caktuara, po thuaj se lihen anash prokuroritë publike dhe gjykatat, Gjyqësori. Është tepër, si të them, e habitshme si kur mbi qindra mijëra lëndë, raste, që janë të paprekura fare, e tash aty ka shkaqe të shumta edhe objektive edhe subjektive, ama gjithsesi ka shumë subjektive. Aty kurrfarë strategjie nuk është afuar se çfarë të bëhet në mënyrë që ato raste gjyqësore..., se mburrja më e madhe e një shteti është kur e ka Gjyqësorin si duhet ta ketë edhe është arritje ndër më të mëdhatë kur Gjyqësori i një shteti funksionon ashtu si duhet, ama te na nuk funksionon, e për të qenë e keqja më e madhe, jepen edhe interpretime korruptive po në këtë parlament, jo Gjyqësori s’na përgjigjet. Ne po e dimë që nuk na përgjigjet, po ka instrumente edhe mekanizma politike që gjyqësori medoemos nolens volens duhet t’i përgjigjet Parlamentit, se Parlamentit, Kuvendit të Kosovës duhet t’i përgjigjet edhe Gjyqësori, natyrisht, edhe Prokuroria edhe kështu me radhë.

Thuhet - plotësimi i infrastrukturës ligjore për pagesat e funksionarëve politike. Po edhe nëse do të plotësohej, nuk do të zgjidhej çështja. Këtu dua të them kësisoj: “Krijimi i infrastrukturës ligjore për pagat unike, sipas kriterëve të objektivizuar” dhe le ta ketë kush pagën aq sa e meriton, askush që është normal, nuk do të ishte aspak xheloz. Mirëpo. sot aktualisht, ju lutem, kemi shumë laramani, jo në bazë të kriterëve të objektivizuar, por në bazë të hireve, të pozicioneve, të funksioneve dhe të favoreve korruptive.

Ose, po e zëmë, tekstin e lexoj: “Plotësimi i kuadrit ligjor për financimin e partive politike”. Po, ne nuk kemi kuadër ligjor për financimin po thuaj se, do të duhej “Krijimi i infrastrukturës legale për subjektet politike”. Këtu është fjala edhe për financimet. Ose formulacion: “Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje në komunë”, do të duhej të

reformulohej: “Pjesëmarrja e organizuar e publikut” dhe më pastaj do të duhej të elaborohej se me çfarë mënyrash, çfarë metodash do të realizohej pjesëmarrja e publikut...

KRYETARI: Ju lutem, të jeni brenda materialit dhe brenda pikës së rendit të ditës për të cilën po bisedojmë. Unë e kam një përshtypje se shumëkush nuk e ka lexuar materialin. Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj – Bujupi.

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Kryetar, faleminderit, që të prajti zemra në fund të ma japësh fjalën.

Përshendetje, edhe një herë, për gjithë kolegët deputetë,

Edhe për zëvendëskryeministrin, se qenka kthyer,

Diskutimin tim do ta hap me pjesën hyrëse të këtij dokumenti, ku thuhet që Qeveria e Kosovës i ka dhënë prioritet sektorit të korrupsionit dhe do të tërheq një paralele në lajmin e mbrëmshëm, lajmi kryesor, realisht, në mediat tona, i cili ka cituar Raportin e progresit, në të cilën thuhet se në Kosovë ka pak të arritura dhe shumë korrupsion. Realisht, strategjia apo ky dokument i paraqitur para nesh, është konfirmim i një të vërtete, të cilën e dimë të gjithë, ashtu siç e dinë edhe qytetarët e Kosovës, të cilët po e paguajnë faturën e keqpërdorimit të taksave të tyre, të cilat po gllabërohen nga fenomeni i quajtur korrupsion.

Është shumë e vërtetë që kjo Qeveri prioritet ka korrupsionin, por jo edhe luftën kundër tij. Pasi që përveç deklaratave verbale dhe disa ndërhyrjeve për profile të ulëta të korrupsionit, ky Kuvend dhe as qytetarët e Kosovës nuk kanë parë ndonjë rast konkret kur është luftua korrupsioni në vepër.

Për shkallën e lartë të korrupsionit në Kosovë nuk është alarmuar vetëm opozita e këtij vendi ose Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, siç pretendohet shumë herë. Janë alarmuar edhe Brukseli dhe Washingtoni, të cilët në baza ditore dërgojnë raporte me shqetësime shumë të mëdha për korrupsionin në rritje, e ky raport do të vjen edhe ditën e mërkurë, ku thuhet që në Kosovë kemi rritje të korrupsionit, në Kosovën e pavarur.

Raporte të tjera janë ato të UNDP, Transparency international, Raporti i progresit, do të thotë flasin të gjitha bashkë që në Kosovë kemi një rritje të korrupsionit, atëherë kur Kosovës më shumë se kurrë i duhet zbatimi i rendit dhe i ligjit.

Një pikë tjetër, në pjesën e dytë të këtij raporti, flet për nevojën e partneritetit të Qeverisë së Kosovës me media, që janë mbikëqyrës të punës së Qeverisë. Kjo është një pjesë e bukur e shkruar teorikisht, por që në praktikën e qeverisjes Thaçi po përkthehet në një presion dhe kontroll të informatës me qëllim të ruajtjes sadopak apo fshehjes së realitetit të qeverisjes, të mënyrës së qeverisjes Thaçi.

Një element tjetër që thuhet në këtë strategji, është rritja e transparencës. I pari i Qeverisë në pyetjet e deputetëve, edhe sot e kemi pasur një rast konkret, sigurisht ka shkruar diku në fushatë zgjedhore dhe nuk ju është përgjigjur mbi 20 pyetjeve të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, pyetjet të cilat kanë pasur të bëjnë pikërisht me korrupsionin dhe transparencën e parave të tatimpaguesve kosovarë. E kemi parë shumë herë edhe në raste të tjera injorimin që i është bërë opinionit, rasti më eklatantë është në pyetjen për ndërhyrjen eventuale në RTK, ai thotë se s’ka pyetje politike.

Çka mund të themi për transparencë dhe përgjegjësi, kur 6 muaj pas vjedhjes së dhomës së dëshmive në Policinë e Kosovës, kjo Qeveri nuk jep llogari dhe nuk kemi transparencë sa i përket hetimeve.

Në kapitullin 3 të kësaj strategjie qëndron ajo fjala popullore “ta them i pari, sa s’më ke thënë”, ku në pikë të dytë perceptimi për korrupsion i referohet Kuvendit. Paramendoni, derisa Qeveria Thaçi kryen pagesa të paligjshme në natën e Vitit të Ri, pasi që është mbyllur Thesari, këtë e kam pasur edhe sot pyetje për ministrin i cili mungon, ndërkaq ministri tjetër, Shala, i cili ka nënshkruar këtë pagesë të paligjshme pas mbylljes së Thesarit, nuk ka qenë i gatshëm të japë përgjigjen.

Derisa kemi 65% të bizneseve të cilat deklarojnë që s’mund të marrin punë pa dhënë ryshfet, Qeveria na sjell një strategji ku thekson se perceptimi për Kuvendin e Kosovës na qenka se ky Kuvend është i korruptuar. Ky është një koncept jo demokratik, sidomos në një Republikë parlamentare, ku qeverinë e zgjedh Kuvendi, të cilit edhe duhet t’i japë llogari dhe jo anasjelltas, kolegë të nderuar, deputetë, të partisë në pushtet.

Prioritetet tjera që përmenden në strategji janë agjencitë monitoruese të zbatimit të ligjit dhe të Gjyqësorit, me theks të veçantë - Policia.

Si mund ta quajmë prioritet të një sektori, të cilit vit për vit i zvogëlohet buxheti. Policia në Kosovë punon me rroga minimale, këta njerëz e kanë konkën në thes dhe ballafaqohen me krim të organizuar, pas të cilit shumë shpesh dyshohet që qëndrojnë jakat e bardha, e dini për çka e kam fjalën. Ndryshe nuk mund të shpjegohet fakti që ka ardhur deri te një degradim sa iu përket hetimeve dhe vjedhjes së dhomës së sigurt të dëshmive në Policinë e Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ju përshëndes, të nderuar ministra dhe ju kolegë deputetë,

Me të vërtetë është shumë argëtuese të jesh në këtë Parlament, sidomos kur trajtohen tema të cilat ju përkasin të gjithë qytetarëve e Kosovës dhe i brengosin të gjithë qytetarët e Kosovës, kur i dëgjojmë disa kolegë si mundohen të derdhin lot krokodili gjoja se po ia qajnë hallin shumë qytetarëve të Kosovës, e në fakt problemin e kanë krejtësisht personal.

Unë do të jua tregoj në fillim një anekdotë, ku një dhelpre iu kishte djegur bishti dhe vraponte dhe lebetite duke thënë se po digjet dynjaja, kurse qytetarët i thanë, zonja dhelpër, vetëm ty po të digjet bishti, se dynjaja është në rregull. Edhe unë mund t’ju them disa zotërinjve këtu, të cilët jo i japin zjarr, jo për këta, t’ju them të drejtën, se s’kisha pasur nevojë as të diskutoj për këta, por kam respekt për votuesit e tyre, që mos t’i hutojnë votuesit në Kosovë, më shumë po iu drejtohem atyre se sa këtyre kolegëve, të cilët po mundohen me çdo kusht të vinë në pushtet duke shikuar Kosovën vetëm me projeksionet e tyre negative dhe në këtë mënyrë i bëjnë një dëm të madh Kosovës dhe shumë raporte, shumë raporte të cilat shkruhen, qoftë në Bruksel, qoftë nga organizatat joqeveritare ndërkombëtare kanë për bazë pikërisht këto diskutime këtu në Kuvend dhe disa organizatave joqeveritare që pak a shumë sponsorizohen nga opozita në mënyrë të fshehtë edhe financohet prej tyre.

Dhe, desha t'ju them se fenomenin të cilin po e trajtojmë sot këtu në Kuvendin e Kosovës, nuk është fenomen që fillon me këtë Qeveri, as nuk do të jetë fenomen që do të përfundojë me një qeveri të ardhshme, kurdo qoftë ajo. Ky fenomen ekziston prej që ekziston njerëzimi dhe ekziston edhe në ato shtete prej nga vinë raportet që të na drejtohen neve këtu. Në Evropë korrupsioni është shumë i lartë, krimi i organizuar është shumë i lartë, mirëpo evropianët shpesh nuk e shohin korrupsionin në shtëpi të vet edhe nuk e shohin krimin e organizuar në shtëpi të vet. Po ju them, merrni vetëm shikoni lajmet, televizionet italiane dhe shikoni të gjitha lajmet qendrore fillojnë me krim të organizuar, kjo është më se e vërtetë...

KRYETARI: Strategjinë antikorrupsion e kemi në rend dite.

...Strategjinë antikorrupsion. Unë po ju them, të nderuar kolegë, se ky fenomen burimin e ka te varfëria në Kosovë dhe këtë farë varfërie nuk e ka shkaktuar kjo Qeveri. Ky fenomen e ka burimin te pagat e ulëta të cilat nuk janë stimuluese për punëtorë dhe ky është realiteti nëpër të cilin po kalon Kosova. Unë, si deputet i Kuvendit të Kosovës, i Partisë Demokratike të Kosovës, përshëndes Agjencioni Antikorrupsion që ka hartuar një strategji për luftimin e korrupsionit, që nuk ka ekzistuar më herët dhe njëkohësisht përshëndes Qeverinë që e ka aprovuar këtë strategjinë dhe e ka sjellë në Kuvend dhe t'i lëvizim gjërat në drejtimin e duhur. Mirëpo, mos të jemi aq të sigurt se me këtë Qeveri do të përfundojë lufta ndaj korrupsionit. Lufta ndaj korrupsionit do të jetë shumë më e gjatë se që pretendojnë disa kolegë të nderuar këtu.

Perceptimi ndaj korrupsionit, perceptimi ndaj korrupsionit zotëri të nderuar dhe ju qytetarë, që po na dëgjoni, është njësoj sikur perceptimi i opozitës që e percepton veten në pushtet, e percepton nesër veten në pushtet dhe ju shumë mirë e dini, edhe qytetarët edhe na këtu, se ky perceptim është irracional. Edhe perceptimi i korrupsionit në Kosovë në shumtën e rasteve është irracional dhe vjen nën ndikimin e propagandës, qoftë organizatave joqeveritare, qoftë të mediave, qoftë të opozitës. Opozita tërë kohën e percepton veten se ka për të ardhur nesër në pushtet, mirëpo ju të gjithë e dini që nesër s'ka për të qenë opozita në pushtet. Kështu është edhe me korrupsionin në aspektin gjeneral të kësaj fjale. Se në Kosovë ka korrupsion, është e vërtetë, se në Kosovë duhet lufta ndaj korrupsionit të ashpërsohet, është e vërtetë, mirëpo, shtrohet pyetja, në gjykatat tona a fillon drejtësia, a fillon padrejtësia në këto gjykata? Unë e shtroj si problem, funksionimi i gjykatave, unë kam përshtypjen se në gjykatat tona në vend që të fillojnë të zgjidhen padrejtësitë, aty fillojnë padrejtësitë për qytetarët e Kosovës...

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Drita Kadriu, veç mundësisht në temë.

DRITA KADRIU: Faleminderit, Kryetar!

Sigurisht se diskutimi im do të jetë në temë për arsye se dokumentin për të cilën po diskutojmë sot e kam lexuar me vëmendje dhe diskutimin tim do ta nis pikërisht me përkufizimin për korrupsionin. Duke respektuar shumë kolegun Riza Smaka, jep një përshtypje timen se nëse korrupsioni në Kosovë është përkufizuar me këtë thënie se "korrupsion quajmë keqpërdorimin e pushtetit për përfitime personale", mendoj se është një definicion shumë i qëlluar edhe definicion i cili është hartuar sipas shkallës dhe perceptimit të korrupsionit në Kosovë. E ky definicion është hartuar, mendoj, qysh herët pas lufte kur ka filluar me të madhe të paraqitet dukuria, po edhe është themeluar Agjencioni Antikorrupsion.

Çështja tjetër të cilën unë do ta qes sot në këtë seancë, është se ne sot, kam menduar se të gjithë do të orientohejmë të diskutojmë rreth Planit të veprimit të strategjisë për arsye se ne kemi diskutuar rreth Strategjisë antikorruption në seancat e mëparshme. E kam të qartë se perceptimi i njerëzve për të diskutuar, edhe i kolegëve deputetë, për dukurinë e korruptionit duhet të orientohej në një mënyrë tjetër, ndërsa sot kish qenë e rrugës që të na krijojnë mundësitë më të mëdha që të bisedojmë për strategjinë.

Sa i përket planit të veprimit, mua më ka bërë përshtypje shumë matrica e këtij plani të veprimit, ku në shtyllën vertikale janë paraqitur tetë objektivat, të cilat shoqërohen me përshkruesit e shtyllës vertikale dhe në të cilat, përveç tjerave, janë paraqitur veprime që duhet të ndërmerren për secilën objektivë. Institucionet përgjegjëse të cilat janë të përfshira në këto veprimtari dhe këtu janë të përfshira të gjitha institucionet, ku shumica e diskutuesve paraqitën dilema se nuk është kjo ministri ose ajo ministri. Pastaj, janë paraqitur afatet kohore, sepse Agjencioni vazhdon të kryej aktivitetet e veta, si dhe ajo që është më e rëndësishmja, për mua dhe besoj për të gjithë lexuesit e këtij dokumenti, janë treguesit e suksesit. Sipas këtyre treguesve të suksesit, të cilat unë i mbështes, ne duhet si deputetë të orientohejmë në matjen e këtyre treguesve gjatë zbatimit të strategjisë.

Unë, për hir të kuptimeve që kam rreth dokumentit, kisha dashur ta marr vetëm një shembull. Te qeverisja lokale, për shembull, në tregues të suksesit thuhet ndër të tjera: “administrim më profesional dhe efektiv i shërbimeve ndaj publikut”, dhe e shihni, ne vetëm këtë vit kemi pasur rritje të cilësisë së shërbimeve ndaj publikut. U cek në fillim të kësaj seance se njerëzit këtë vit kanë pritur shumë pak për marrjen e dokumentacioneve. Prandaj, po them që interesi ynë është që ta votojmë strategjinë dhe pastaj të kemi mundësi të çelim rrugë që ne ta monitorojmë arritjen e strategjisë dhe të nxjerrim përfundimet tona, pavarësisht prej të dhënave që i servojnë institucionet dhe organizatat tjera, qofshin ato ndërkombëtare ose vendore. Faleminderit!

KRYETARI: Pasi ta ka përmendur emrin, mund të kesh deputet replikë, po realisht për përkufizimin nuk ke pasur të drejtë. Megjithatë, urdhëro, e ke fjalën. Deputeti Riza Smaka, e ka fjalën, replikë 2 minuta.

RIZA SMAKA: Nuk pretendoj se kam pasur të drejtë absolute, mirëpo pikëpamjen time e kam mbështetur në një rezolutë të OKB-së për korruptionin dhe në deklaratën e Limës për korruptionin edhe për miton... Edhe aty janë dy definicione shumë simpatike, shumë përmbajtësore që asnjëri as për korruptionin, as për miton apo ryshfetin nuk përkojnë me këtë që është dhënë këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Shkubin, dy minuta, me qenë se s’di pse, nuk t’u ka përmendur emri, por hajt fol!

SHKUMBIN DEMALIAJ: Nuk jam për replikë, por fjalën e rregullt, kështu, se s’kam folur hiq në këtë pikë.

KRYETARI: Jo, për fjalë jo!

SHKUMBIN DEMALIAJ: Unë po lëshohem, zoti Kryetar, në pikëpamje tjera, unë të falënderoj ty më së pari që je këtu Kryetar i Parlamentit edhe nuk e ke dëgjua zotin Thaçi për të shkuar e të bëhesh kryetar i Drenasit, se nuk duhet dëgjua edhe anëtarët e tjerë të PDK-së këtu, se për riparimin e korruptionit...

KRYETARI: Faleminderit, që po më mbron...

SHKUMBIN DEMALIAJ: ...e dimë fare mirë kush qëndron në krye të top listave. Asnjëri nga udhëheqësit e kompanive të sigurimeve në Kosovë, të kompanive të mëdha që sot marrin tenderët në Kosovë: gurthyesve, tregjeve të automobilitave e të tjerë, nuk e ka mbiemrin më ndryshe se të gjithë ata që e udhëheqin sot Qeverinë e Kosovës prej kreut e deri në fund. Të lëshohemi dhe ta shantazhojmë komunitetin, në këtë rast popullin e Kosovës, qytetarin tonë, mirëfilli dihet dhe është duke e ditur qytetari në cilën kahe kemi shkuar ne dhe jemi duke shqyrtuar Strategjinë antikorruption, por me këtë dokument e kemi parë se jemi vonuar, se në kuadër të strategjisë përcaktohen afatet kohore prej kur dhe ku dhe na ka mbetur më pak se një vit që të mund ta implementojmë, e kjo ende s'ia ka fillua. Ne sot humbëm kohë duke dëgjuar këtu, shumë u tha edhe nga vet njerëzit, po bëhen pallavra këtu, sepse mungon gjuha parlamentare dhe komunikimi parlamentar. Pikërisht në këtë rast mendojmë se koha është ta kthejmë edhe një herë këtë strategji edhe të përpilohet një tjetër, por kryesisht mekanizmat institucionalë janë të pafuqishëm për ta bërë këtë gjë. U tha shumë edhe nga anëtarët e pozitës, në këtë rast, të cilët i falënderoj dhe i lus ata të mos e votojnë këtë strategji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Unë dua t'i them dy-tri fjalë nga kjo pozitë që e kam, por më tepër si deputet. Ju lutem, ne kemi përpara një dokument, që quhet -Strategjia antikorruption, i hartuar nga Agjencioni Antikorruption dhe, natyrisht, në Kuvend ka ardhur përmes Qeverisë. Sigurisht që nuk mund të pretendojmë si shoqëri në tranzicion, që jemi të liruar nga dukuritë negative që i kanë përcjellë gjithë shoqëritë në tranzicion, por vërtet nëse ne duam të bëhemi realistë dhe të nisemi nga vetvetja, konsideroj që vërtet në Kosovë nuk ekziston ndoshta një vullnet i përkryer politik për të luftuar korrupsionin, as nga partitë në koalicion, po aq më pak nga partitë në opozitë. Mendoj që shpeshherë duhet ta shikojmë veten edhe mënyrën se si kemi ardhur deri në Kuvend, a është krejt jokorruptive. Mendoj që edhe në Kuvend kemi ardhur bukur shumë në rrugë korruptive.

Pastaj, unë kam respekt për ty, Shkumbin Demaliaj, por është mirë ta zhvilloni një debat në subjektin tënd politik për luftën e korrupsionit brenda subjektit politik, se korrupsioni duhet të luftohet edhe brendapërbrenda subjektit politik edhe tëndin, unë brenda subjektit tim politik. Do të thotë, të gjithë kemi nevojë ta luftojmë korrupsionin, por ta luftojmë vetveten tonë. Kur ta luftojmë vetveten tonë, mendoj që kemi më lehtë ta luftojmë te të tjerët.

Mendoj që Strategjia e afruar, sidomos Plani i veprimit është një dokument i mirë që duhet ta miratojë ky Kuvend. Bile unë kisha bërë ftesë që edhe ju si opozitë do të duhej ta kërkonte një plan të veprimit kundër korrupsionit dhe ky plan është dhe mendoj që duhet pastaj t'u japim hapësirë institucioneve që janë për ta luftuar korrupsionin, që nuk është Agjencioni për Antikorruption për ta luftuar korrupsionin. Ju e dini që Agjencioni Antikorruption është më tepër për t'i mediatizuar disa çështje dhe t'i çojë në prokurori e jo të flasë shumë rrugëve, por edhe ajo ndodh. Do të thotë, organi i vërtetë për të luftuar korrupsionin janë Prokuroria, është Gjyqësia dhe Policia hetuese apo kriminale që ka për obligim t'i hetojë këto dukuri, se këto janë të fshehta dhe nuk shihen prej aeroplanit.

Prandaj, mendoj që Qeveria e Kosovës dhe Kosova ka nevojë ta ketë një strategji antikorruption, është një plan i veprimit dhe mendoj që si i tillë mund t'i shërbejë luftës kundër korrupsionit. Por, edhe një herë po them, lufta kundër korrupsionit varet shumë nga vullneti politikë i partive politike, por edhe nga vullneti i çdo deputeti veç e veç për

ta luftuar korrupsionin ndoshta edhe në vetvete, se mos të flasim në subjektin politik që ka shumë nevojë.

Kosova është e vogël. Nuk është mirë që ata që janë në ndërtesë të çeltë, bile të kristalit, që me një kokallë mund të shembet e të bëjnë shumë zhurmë. Kjo është një dukuri që duhet luftuar dhe duhet luftuar në mënyrë institucionale, jo me zhurmë. Ne si Kuvend mendoj që kemi obligim ta miratojmë këtë strategji të antikorrupsionit.

Kisha kërkuar nga deputetë që vërtet të përgatiten për votim dhe ta votojmë këtë plan strategjik.

Urdhëro, Shkumbin Demaliaj!

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Me gjithë respektin që kam për ty, po krejt në rregull është, ne brenda subjektit tonë politik mund të jemi të korruptuar për shkaqe të konkurrencës të brendshme, ndoshta, e sa i përket asaj që dëshirojmë të bëjmë për vendin, shihet sa jemi të konstituuar drejt qëllimit tonë për Kosovës. Në këtë rast shihet pjesëmarrja jonë si opozitë gjatë gjithë kohës në Kuvend, kush ka ardhur i kontrabanduar edhe i korruptuar në Kuvend shihet, ne e bëjmë kuorumin për mbajtjen e seancës plenare. Gjithë kohën deputetët janë vetëm makineri votimi, deputetët e PDK-së, them edhe të koalicionit, vetëm thirren me mesazhe. Kam dashur që në seancën e ardhshme, në kuadër të transkriptit ta them një gjë. Ke thënë sot, sot zoti Kryetar gjatë fjalimit tënd në seancë thua, kur është aprovuar Raporti për Bankën Qendrore të Kosovës thua se janë 72 deputetë prezentë, ndërkaq dalin 74 votues, sepse pikërisht këta deputetë për mungesën e deputetëve që janë në sallë i shtypin sustat e tyre. Kemi thënë edhe në transkripto, ajo ka për t'u regjistruar se është e regjistruar, dalin 39, 31 plus 4 abstenime, 74 dalin a 72 thua janë prezentë, sepse e kanë filluar këtë makineri, janë vërtet të korruptuar edhe me ardhjen këtu. Faleminderit shumë, të respektoj!

KRYETARI: Faleminderit, shumë! Ndërkohë, ju po lëvizni, kanë mund të vijnë, është çështje e tyre, po prezenca fizike mendoj se ka qenë e saktë.

Diskutime të bashkëngjitura

MARK KRASNIQI: I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra dhe deputetë,

Për nevojën e luftës kundër korrupsionit kemi diskutuar disa herë në këtë Kuvend. Madje, kemi prur dhe ligjin përkatës e sot po diskutojmë për Strategjinë e kësaj lufte. Mjerisht, kjo luftë e proklamuar këtu, deri tash ka mbetur vetëm në letër. Korrupsion, siç dihet, ka edhe në shtetet e zhvilluara. Mirëpo, korrupsioni në Kosovë aktualisht ka peshë më të madhe se në çdo vend tjetër, sepse ne jemi ende në fazën e tranzicionit, në fazën e konsolidimit të Republikës së Kosovës, shtet të pavarur, sovran e demokratik. Faktori ndërkombëtar na kërkon këtë luftë si një nga standardet e rëndësishme, si kusht për integrimin e shtetit tonë në strukturat relevante evro-atlantike. Por, Kosova me këtë shkallë shumë të lartë të korrupsionit, vështirë që do ta ketë një përkrahje të tillë Nga ana tjetër, as investitorët ndërkombëtarë nuk do të vijnë në një vend të tillë, ku mbretëron plaçka e hajnia. Prandaj, korrupsioni është pengesë shumë e madhe për stabilitetin dhe përparimin e Kosovës nga çdo aspekt dhe për njohjen ndërkombëtare të pavarësisë së saj.

Qeveritarët tanë disa here kanë deklaruar botërisht se për korrupsion do të ketë zero tolerancë. Por, asnjë i korruptuar nuk u dënua deri tash për këtë vepër kriminale. Sot, në diskutimin e shumë e deputetëve u përmendën disa raste konkrete të korrupsionit. Madje raste edhe nga qarqet e larta të pushtetit. Kjo situatë është shumë e rrezikshme për fatin e Kosovës. Këtu u tha se tenderët për ndërtimin e rrugëve janë burimi kryesor i korrupsionit, (siç kanë qenë edhe më parë) krahas me doganat, gjyqet dhe shumë burime të tilla të tjera. Korrupsion nuk është vetëm përvetësimi i mjeteve financiare, por edhe nepotizmi, familjarizmi, regjionalizimi, uzurpimi e sidomos partitizimi. Korrupsion është edhe keqpërdorimi i mjeteve financiare të popullit për fushatën parazgjedhore, duke ia rritur rrogën 100% një strukture e duke lënë pas dore strukturat e tjera me të ardhura minimale, madje poshtëruese, ndër të cilat struktura ka edhe të tilla me rëndësi e përgjegjësi të pakrahasueshme më të madhe se struktura e privilegjuar, siç është p.sh. mjekësia. U përmend këtu edhe vjedhja e organizuar e dëshmimeve mu në qendër të policisë. Të gjitha këto raste kriminale të korrupsionit janë prezent në Kosovë në përmasa shumë të gjera.

Strategjia e cila po diskutohet sot, mund të jetë formuluar mirë, por si shihet nga diskutimi, edhe ajo ka shumë mangësi. Por edhe sikur të ishte formuluar shumë më mirë, ajo do të mbetet vetëm në letër, pra kurrfarë efekti, sepse korrupsioni këtu, siç shihet, i paska rrënjët shumë të thella. Është një fjalë e urët popullore “Korbi, korbit s’ia nxjerrë sytë”. Përkatësisht, i korruptuari nuk është kundër të korruptuarit. Në situatën politike dhe ekonomike aktuale të Kosovës, të gjithë ata që janë të korruptuar, në realitet janë armiq të atdheut të vet, pa marrë parasysh ligjëratat e deklaratat boshe të tyre kombëtare, demokratike, humane etj. I korruptuari s’ka moral, s’ka dinjitet njerëzor, s’ka vetëdije kombëtare as shtetformuese. Kosovari i korruptuar është njëri i deformuar nga çdo aspekt, i verbëruar nga instinkti shtazarak, nga opsioni për t’u pasuruar në mënyrë të pandershme, duke vjedhur e plaçkitur Kosovën e varfër, ku të paktën 50% e popullsisë janë pa punë dhe 18% në varfëri të skajshme.

Në këtë situatë është iluzion të shkruajmë strategji të ndryshme për të luftuar korrupsionin. Prandaj, mendoj se këtë luftë duhet ta marrë në dorë faktori ndërkombëtar, konkretisht policia “Guardia di financa” dhe “Interpoli” ose ndonjë organizatë tjetër policore, për ta shpëtuar Kosovën nga kosovarët e pandershëm, të cilët me miliona të vjedhur po ndërtojnë pallate nëpër Prishtinë dhe po pasurojnë trezorët e bankave në Zvicër, në Lihtenshtajn, në Monako etj. Këta hajdutë duhet të ndiqen pa mëshirë kushdo qofshin ata, sepse ata po ia bëjnë varrin Kosovës. Diskutimi i sotëm i argumentuar tregoi se gjendja është kritike dhe alarmante për fatin e Kosovës.

Kuvendi është institucioni më i lartë shtetëror dhe ka përgjegjësinë më të madhe për fatin e Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

MYRVETE PANTINA: Ka apo nuk ka korrupsion në Kosovë, nuk ka nevojë të diskutohet. Projekt-strategjia kundër korrupsionit, të cilën po e shqyrtojmë sot, na jep fakte për ekzistimin e korrupsionit, duke u thirrur në të dhënat e studimeve dhe të raporteve të ndryshme të publikuara gjatë viteve 2007-2008, nga të cilat raporte vihet re qartë se korrupsioni është ende shumë i përhapur dhe përbën një problem shumë serioz, i cili pengon funksionimin e mirëfillt të institucioneve shtetërore.

Raporti i progresit për Kosovën për vitin 2008 i Komisionit Evropian vlerëson se nëpunësit civilë janë ende të prekur nga ndërhyrjet politike, praktikat korruptive dhe nepotizmi. Ndërsa, dokumenti i Partneritetit Evropian parashton si prioritet afatshkurtër

për Kosovën ndjekjen e politikës së tolerancës zero kundër korrupsionit. Andaj, duke u nisur nga këto konstatime, shumë qartë kuptohet se ka nevojë të luftohet korrupsioni. Për këtë arsye Projekt-strategjinë kundër korrupsionit, të hartuar nga Agjensioni kundër Korrupsionit, e shoh si një dokument të nevojshëm për të filluar luftën kundër korrupsionit, por të cilin ne mund ta begatojmë me vërejtjet dhe propozimet tona konkrete. Mirëpo, sukcesi i luftës kundër korrupsionit varet nga përkushtimi i Qeverisë sonë për të luftuar korrupsionin dhe për të zbatuar këtë strategji. Dyshimi në mos përkushtimin e Qeverisë për të luftuar korrupsionin bazohet në fakte, konkretisht në mos zbatimin në masë të duhur të Strategjisë kundër korrupsionit për periudhën 2004-2007, ku si problem kryesor është identifikuar mungesa e vullnetit politik për të luftuar korrupsionin.

Sipas mendimit tim mangësia kryesore e Projekt -strategjisë së propozuar është mungesa e matjes së treguesve të suksesit dhe caktimi i afateve kohore të qarta dhe realiste për vlerësimin e rezultateve të arritura. Në debatin e sotëm kam pritur që diskutimi të përqendrohet pikërisht në këto çështje. Për disa aktivitete të parapara në këtë dokument duhet të kufizohet afati brenda të cilit duhet të kryhet ai aktivitet dhe të bëhet vlerësimi për atë periudhë, si p.sh. kur thuhet që të ofrohen shërbime të mira dhe cilësore e me kohë të dhëna, në raste të tilla mendoj që matja e treguesve të suksesit do të duhej të bëhet çdo gjashtë muaj dhe jo afati të jetë i pacaktuar. Dobësi tjetër e këtij dokumenti është se për disa aktivitete, të parapara me planin e veprimit, afati veç ka skaduar, prandaj ky dokument është i vonuar për vitin 2009.

KRYETARI: Vazhdojmë, jemi në procedurën e votimit, diskutimet kanë përfunduar.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

A ka pa kartela? 64 deputetë janë prezentë.

Konstatoj se me 36 vota “për”, 26 vota “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi Strategjinë antikorruption. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e radhës:

- **Debat për gjendjen tregtare në vend dhe raportet tregtare të Kosovës me shtetet tjera**

(Sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë)

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, në pajtim me dispozitat të Rregullores së Punës së Kuvendit ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që në seancën plenare të debatohet lidhur me gjendjen tregtare në vend dhe raportet tregtare të Kosovës me shtetet të tjera.

Kryesia e Kuvendit në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës së Kuvendit ka proceduar kërkesën në fjalë dhe ka kërkuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë një informatë me shkrim mbi gjendjen tregtare në vend dhe raportet tregtare të Kosovës me shtete të tjera.

Kërkesa e Grupit Parlamentar të lidhjes Demokratike të Dardanisë dhe informatat me shkrim të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë u është shpërnda deputetëve.

Radha e diskutuesve, fjalën e ka kryetari ose përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, si propozues për të debatuar mbi gjendjen tregtare në vend dhe raportet tregtare të Kosovës me vende të tjera.
Fjalën e ka deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Me datën 8 maj 2009, bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Rregulla 25.1, Grupi Parlamentar i LDD-së ka kërkuar debat parlamentar për çështjet tregtare në vend dhe raportet tregtare të Kosovës me shtete të tjera. Dhe, sot, me datën 12 tetor, fatmirësisht në fund po debatojmë një çështje të tillë, e cila për ne është konsideruar kruciale dhe vazhdon të mbetet.

I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritarë,

Shqetësimi për gjendjen ekonomike, reformat e ngadalësuara, gjendjen e rendë energjetike, korrupsioni, mostransparenca e Qeverisë së Kosovës për shpenzimin e parasë publike janë vërejtje tejet serioze të Parlamentit Evropian të përfshira në Rezolutën e miratuar muaj më parë në vitin 2009. Po ashtu, edhe Banka Botërore i sugjeron Qeverisë së Republikës së Kosovës se Qeveria duhet të punojë në ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe individuale në eliminimin e burokracisë dhe raportet me investitorët.

Të nderuar deputetë,

Këto janë dy vërejtje serioze nga Parlamenti Evropian dhe Banka Botërore në mesin e shumë porosive tejet brengosëse që ne sot do t'i fuqizojmë me disa karakteristika të zhvillimeve negative dhe që fatkeqësisht po përcjellin ekonominë e Kosovës.

1. Deficiti tregtar tepër i lartë prej një miliardë e 65 milionë euro për vitin 2008, praktikisht në Kosovë importi mbulohet me eksport vetëm 10%. Duke pas parasysh se në strukturën e këtij eksporti pjesëmarrjen më të lartë më tepër se 60% e mbulojnë mbeturinat e metaleve, hekurishtet, të cilat kapin një vlerë prej 100 milionë euro dhe duke larguar këtë komponentë, atëherë vijmë në përfundim se eksporti do të ishte edhe më i lartë dhe eksporti do të ishte në fakt shumë më i ulët dhe do të mbulonte importin vetëm me 5%.

2. Inflacioni i madh në vitin 2008 arrin kulminacionin në vlerë prej 9.4%.

3. Pengesat për zhvillimin e ekonomisë së tregut dhe mos respektimi i Marrëveshjes së CEFTA-s, edhe pse Kosova është anëtare fuqiplote e këtij mekanizmi.

Të nderuar deputetë,

Materiali i paraqitur nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë jep një përshtypje që para vetes kemi një punim diplome. Raporti i dërguar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është një përshkrim teorik dhe si duhen të jenë në mënyrë ideale politikat e tregtisë së Kosovës i përpiluar, siç shihet, nga konsulentët kryesisht jashtë kësaj Ministrie.

Ky raport nuk përmban objektivat e detajuara, bartësit e aktiviteteve, dinamikën kohore si dhe koston e këtyre aktiviteteve. Por, shprehet në formë të një dëshire se si duhet të jetë idealja, duke u bazuar në punimet teorike dhe duke i cituar njëkohësisht edhe autorët e huaj.

Raporti në fjalë fatkeqësisht konfirmon deklaratimet e më hershme të Grupit Parlamentar të LDD-së për mungesën e vizionit dhe të politikave operationale në sektorin e tregtisë, për mungesën e programeve dhe kapaciteteve qeverisje të kësaj Qeverie, ku në këtë dokument Ministria e Tregtisë dhe Industrisë fatkeqësisht nuk paraqet një kornizë të veprimeve konkrete se çka është duke ndërmarrë në drejtim të përmirësimit të faktorëve që avancojnë pozitën tregtare të Kosovës në rajon.

Nuk paraqet se çka është duke ndërmarrë në drejtim të përmbushjes së kritereve që dalin nga Marrëveshja e CEFTA-s si mekanizëm tranzitor për anëtarësimin e Kosovës në Organizatën Botërore të Tregtisë.

Nuk paraqet se çka është duke ndërmarrë në drejtim të përmirësimit, të përfaqësimit meritohet dhe profesional të autoriteteve të Republikës së Kosovës në mekanizmat e CEFTA-s, siç janë komitetet e ndryshme.

Nuk paraqet se çka është duke u ndërmarrë në drejtim të rinegociimit të marrëveshjeve tjera, si pasojë e transferit të vendimmarrjes nga UNMIK-u tek autoritetet kosovare.

Si rezultat i një politike të papërgjegjshme dhe si rezultat i një qasje neglizhente të autoriteteve kosovare duke filluar nga nivelet politike, sot Kosova fatkeqësisht po ballafaqohet me probleme si: mos përmbushje të këtyre kritereve në mënyrë profesionale, përfaqësim me njerëz jokompetentë në këto mekanizma si dhe aspekte tjera të cilat dëmtojnë seriozisht procesin si dhe kanë pamundësuar reflektimin...

KRYETARI: Dhjetë minuta e ka fjalën, regjia.

LULZIM ZENELI: ...dhe përfaqësim me njerëz jokompetentë në këto mekanizma si dhe aspekte tjera të cila dëmtojnë seriozisht procesin, si dhe kanë pamundësuar reflektimin e efekteve pozitive nga kjo marrëveshje si dhe marrëveshje të tjera.

Të nderuar deputetë,

Duke ditur se qëllimi i Marrëveshjes së CEFTA-s ka qenë dhe mbetet krijimi i një tregu më të madh rajonal për bizneset kosovare, përmbushja e kritereve që dalin nga Plan i Punës së Partneritetit Evropian, si dhe aspekte tjera të rëndësishme, por siç shihet, po ndodh tek ne e kundërta, si pasojë e një qasje joserioze, si pasojë e një qasje joprofesionale dhe kryesisht e bazuar në raporte të jashtme.

Autoritetet kosovare nuk janë duke reflektuar dhe përfaqësuar Kosovën me mekanizma të ndryshëm ashtu siç duhet dhe kërkon procesi. Autoritetet kosovare nuk janë duke shprehur vullnetin politik në bashkëpunim me autoritetet në Bruksel që të gjejnë një rrugë që do të shtynte përpara proceset politike dhe do të rezultonte pa dyshim me efekte pozitive tregtare dhe në përgjithësi ekonomike.

Në institucionet e Kosovës në lidhje me këto çështje është duke u punuar në mënyrë ad-hoke, pa ndonjë qasje analitike, pa ndonjë analizë konkrete në raportet e Kosovës me secilin vend që do të mund të krijonte këmbime tregtare të qëndrueshme dhe aktivitete të tjera.

Mungon koordinimi dhe mungon bashkëpunimi konkret dhe nuk është duke u shfrytëzuar sa duhet mundësia e shfrytëzimeve të lidhjeve rrugore tashmë të krijuara me Republikën e Shqipërisë.

Një gjë është edhe më tutje evidente që prodhuesit kosovarë ende po ballafaqohen me bllokada nga Republika e Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës.

Prodhuesit vendorë jo vetëm që nuk po përkrahen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, por për çudi po pengohen duke mos ndërmarrë asnjë masë. Është krijuar përshtypje se janë në pyetje interesat e ngushta qeveritare duke deklaruar se nuk bën të ndërmerren masa reciprociteti, sepse nuk është në frymën e tregtisë së lirë. Ka një vit që prodhuesit kosovarë po përballen me bllokimin e eksportit në Serbi dhe në Bosnje dhe në vende të tjera. Pos dëmeve që po u shkaktojnë prodhuesve vendorë, dëmtohet edhe me miliona euro buxheti i Kosovës dhe së fundi atakohet drejtpërdrejt zhvillimi ekonomik i vendit.

Sa për informim, të nderuar deputetë, raportet import - eksport të Kosovës me Serbinë, Bosnjën dhe Malin e Zi për shtatë muajt e parë të vitit 2009 janë tejet brengosëse. Në shtatë muajt e parë të vitit 2009, Kosova ka importuar 111 milionë euro nga Serbia, kurse ka eksportuar vetëm 0.5 milionë, kurse nga Bosnja në shtatë muajt e parë ka importuar 27 milionë mallra dhe ka eksportuar vetëm 0.4 milionë. Nga kjo shihet se Serbia dhe Bosnja thuaj se kanë bllokuar tërësisht eksportin nga Kosova me arsyetim se nuk pranojnë Kosovën si shtet, nuk i pranojnë vulat e Republikës së Kosovës në dokumentet e doganave, nuk pranojnë targarat e automjeteve të Republikës së Kosovës. Ka një kohë të gjatë që Serbia dhe Bosnja nuk lejojnë as kalimin transit të prodhimeve nga Kosova për në vendet e bashkimit evropian. Ndërsa, në anën tjetër kemi qindra kamionë që hynë nga Serbia në territorin e Kosovës legalisht edhe ilegalisht, ndërsa Qeveria e Kosovës respektivisht Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë nuk janë të interesuara të ndërmarrin masa reciprociteti me arsyetim se nuk dëshirojnë t'i përgjigjen politikës së Serbisë me sjellje të njëjtë. Ky nuk mund të quhet ndryshe, përpos naivitete i skajshëm dhe papërgjegjësi totale.

Pajtohem me faktin se për ne partnerë të rëndësishëm janë të gjitha vendet e rajonit. Mirëpo, Maqedonia pajtohem plotësisht me faktin se Maqedonia paraqet një partner mjaftë të rëndësishëm në këmbimin tregtar. Por, ky vend eksporton në Kosovë 300 milionë euro në vit dhe importon nga Kosova vetëm 14 milionë euro, që praktikisht është një gjendje e debalancuar.

Grupi Parlamentar i LDD-së vlerëson se Republika e Kosovës ka nevojë për një rishqyrtim të marrëdhënieve ekonomike në mes të këtyre dy vendeve në mënyrë që të krijohet një partneritet i qëndrueshëm dhe jo të kemi marrëdhënie të thjeshta tregtare.

Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh supermacinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës në raport me Kuvendin, si institucioni më i lartë i vendit, duke qenë të vetëdijshëm për pamundësinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës për të ndikuar në kursin e politikave qeveritare, konsiderojmë dhe besojmë se ky debat së paku do të trokas në ndërgjegjen e Qeverisë duke bërë me dije se është momenti i fundit që Republika e Kosovës të krijojë politika shtetërore në mbrojtje të interesit qytetarëve të vendit, në mbrojtje të prodhuesit dhe fermerit kosovar.

Prandaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, ftoj të gjithë deputetët ...

KRYETARI: Faleminderit!

Sipas radhës, fjalën e ka ministri për Tregti dhe Industri, zoti Lutfi Zharku. 10 minuta i ke, a jonë mjaftë? Hajde 20, pra.

LUTFI ZHARKU: I nderuar Kryetar,

Ministra, të nderuar deputetë,

Ekonomia kosovare ka shënuar rritje që nga viti 1999, edhe pse me oscilime të shumta. Gjatë këtyre viteve janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm makro ekonomikë për ngjalljen e ekonomisë kosovare, mirëpo sfidat mbesin ende të shumta si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në atë social.

Një tregues i tillë është edhe bilanci i lartë negativ tregtar, i cili është rritur vazhdimisht që nga viti 1999, edhe pse me ritme më të ngadalta në vitet e fundit. Ky pozicion tregon nivelin e ulët të eksporteve në raport me importin. Kosova është tejet e varur nga importi dhe trendet tregojnë se në një afat të shkurtër është vështirë të priten ndryshime të mëdha.

Institucionet e Kosovës janë të vetëdijshme se ndryshimi i këtij realiteti kërkon qasje dhe reforma gjithëpërfshirëse ekonomike dhe politike në mënyrë që të ndryshohet mjedisi operues në Kosovë me qëllim të përmirësimit të pozitës konkurruese të Kosovës në tregun botëror.

MTI ka aktivizuar në tërësi kapacitetet e saj për të ndryshuar këtë realitet dhe të bëjë të mundur avancimin e sektorit të ndërmarrjeve, veçanërisht të atyre të cilat janë të përfshira në aktivitetet eksportuese.

MTI është e vetëdijshme se ndryshimet e tilla nuk mund të bëhen vetëm, por më tepër çështjet e trajtuara në kontest të avancimit të sektorit të jashtëm janë shumë dimensionale. Ato përfshijnë institucione të ndryshe qeveritare, joqeveritare, sektorë ekonomikë, ndërmarrje të profileve të ndryshme dhe aktorë të tjerë relevantë. Si rezultat MTI ka intensifikuar kontaktet me institucionet e tjera relevante, komunitetin e biznesit, donatorët dhe të tjerët të rëndësishëm për procesin me qëllim të ngritjes së aktiviteteve eksportuese.

MTI para së gjithash është dashur të ekzaminojë situatën reale në sektorin e tregtisë së jashtme. MTI këtë e ka bërë duke prodhuar një seri raportesh vjetore ose gjashtëmujore, të cilat kanë përshkruar në hollësi lëvizjet në tregtinë ndërkombëtare.

Ky raportim para jush sot bazohet pjesërisht në dy raportet e fundit përshkruese të tregtisë ndërkombëtare të Kosovës. E para përshkruan rrjedhat e tregtisë së jashtme në vitin 2008, ndërsa tjetra paraqet raportet e tregtisë së jashtme për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009.

Për më tepër, gjatë vitit 2009 MTI ka hartuar dokumentin e politikës tregtare të Kosovës, një dokument gjithëpërfshirës i cili propozon masa specifike të cilat targetojnë ngritjen e konkurrueshmërisë si në tregun e brendshëm, ashtu edhe në atë të jashtëm.

Në fund të gushtit ky dokument është aprovuar nga Qeveria e Kosovës dhe MTI tanimë ka filluar me krijimin e infrastrukturës së nevojshme për implementimin e rekomandimeve të dala nga dokumenti i politikave tregtare.

Në fund të vitit 2009, MTI do t'i fillojë me draftimin e strategjisë për promovimin e eksporteve, i cili bazohet në premisat e dokumentit të cekur më lartë.

Të nderuar deputetë,

Në kohën kur ekonomia globale po kalon nëpër recesion të thellë, Kosova ka shënuar progres të rëndësishëm ekonomik. Rritja ekonomike në vitin 2008 është vlerësuar të ketë qenë 5.4%, duke tejkaluar kështu mesataren e vendeve të Ballkanit Perëndimor, për të cilat Komisioni Evropian vlerëson rritje shumë më të ulët. Por, në vitin 2009 dhe në vitet në vijim, rritja pritet të jetë më e ngadalshme. Kriza ekonomike globale nuk e ka anashkaluar as Kosovën, mirëpo efektet e saj janë shumë më të vogla. Sido që të jetë, rreziqet mbesin. Që tani shihen tendenca për ulje të dërgesave nga diaspora, importeve, kredive në sektorin privat dhe investimeve të jashtme direkte.

Në vitin 2009 ulja në këto parametrash është shoqëruar edhe me rënie signifikante të eksporteve dhe kjo si rezultat i rënies së kërkesës për shkak të krizës globale. Për gjashtë muajt e parë të vitit 2009, Kosova ka eksportuar rreth 40 milionë euro më pak se sa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke shënuar kështu rënie prej 40%, importet kanë shënuar një rritje prej 1,6% në raport me gjashtëmujorin e parë të vitit 2008. Rënia më e madhe e eksportit se ajo e importit ka rritur edhe më tutje bilancin negativ tregtar të Kosovës, i cili për gjashtëmujorin e parë është shënuar të jetë 780 milionë euro.

Në vitin 2008 importet kanë arritur shifrën prej afro 2 miliardë, ndërsa eksporti është përafërsisht 10 herë më i ulët.

Një pasqyrë më premtuese paraqitet nëse konsiderojmë të ashtuquajturën eksport virtual, që përfshinë konsumin e ndërkombëtarëve në Kosovë, sipas të cilit eksporti mbulon 20% të importit. Më pak se gjysma e eksportit në vitin 2008 është eksporti i rregullt, ndërsa pjesa tjetër kryesisht është eksport pas përpunimit të brendshëm. Në anën tjetër, importet gati janë në tërësi të rregullta, pra rreth 95%.

Sa i përket strukturës së eksporteve, ato kryesisht janë në formë të lëndës së parë dhe të produkteve të papërfunduara. Eksportet janë të dominuara nga metali bazë dhe produktet minerale të cilat në periudhën 2002-2008 kanë mbuluar mesatarisht rreth 60% të totalit të eksportit.

KRYETARI: T'i vazhdohet fjala ministrit!

LUTFI ZHARKU: Në vitin 2008 Kosova ka eksportuar mbi 140 milionë të këtyre dy grupeve të produkteve, që përbën afër 75% të totalit. Makineritë dhe pajisjet përbëjnë një komponentë tjetër në rritje të eksporteve të Kosovës, sidomos pas vitit 2005.

Gjithashtu, edhe produktet ushqimore mbulojnë një përqindje të rëndësishme të eksportit. Më tutje, lëkura dhe produktet e ngjashme, si dhe industria e gomës kanë pjesëmarrje të rëndësishme në strukturën e eksporteve të Kosovës.

Duhet theksuar se produktet e lëkurës janë të vetme produkte të cilat kanë bilanc ...

KRYETARI: Në sallë janë 52 deputetë, po ju njoftoj që të mos zgjaten ata lart të këqyrin.

LUTFI ZHARKU: Struktura e importeve në vitin 2008, ashtu edhe në gjysmën e parë të vitit 2009 mbetet përafërsisht e njëjtë. Pjesëmarrja e produkteve ushqimore ka dominuar importin nga mbarimi i vitit 1999, duke mbuluar mesatarisht 21% të totalit. Kjo pjesëmarrje ka qenë edhe më e madhe në vitet e para të pasluftës, gjë që është e

kuptueshme duke pasur parasysh nevojat e popullatës pas lufte edhe kolapsin ekonomik në Kosovë.

Në vitin 2004 shënon ndryshim substancial në strukturën e importeve me ç'rast të mira të tjera zëvendësojnë produktet ushqimore si më të kërkuarat nga tregu i importit. Vendi e tyre e zënë produktet minerale, si dhe makineritë dhe pajisjet. Në strukturën e importeve të Kosovës viteve të fundit pjesëmarrje signifikante kanë edhe mjetet transportuese, produktet, pjesë e industrisë së gomës, si dhe ato kimike. Ky ndryshim është indikativ për një tendencë të re të ringjalljes dhe të forcimit të sektorit prodhues në Kosovë.

Në këtë kontekst duhet diskutuar për importet sipas kategorive të përgjithshme të produkteve, pra sipas produkteve konsumuese të... dhe të mirat kapitale. Të dhënat tregojnë lëvizje pozitive në këtë drejtim, sidomos v nga viti 2005 deri më 2008. Importet e të mirave kapitale dhe produkteve për përpunim të mëtejshëm janë duke i zëvendësuar produktet e konsumit. Prej 2005 dhe në 2008 importi i të mirave për konsum ka pësuar rënie prej 4.9% në favor të të mirave kapitale dhe atyre të ndërmjetme. Ky ndryshim kualitativ është indikacion për një trend të ri në ekonominë kosovare, që synon rimëkëmbjen dhe fuqizimin e sektorit prodhues në Kosovës. Gjithashtu, ky është një indikacion se ekziston një proces i zëvendësimit të importeve, në të vërtetë tregon një tendencë të ngritjes së konkurrueshmërisë së ekonomisë kosovare në tregun e jashtëm.

Sa i përket strukturës së eksportit dhe importit sipas partnerëve tregtarë, BE-ja dhe vendet e CEFTA-s janë partnerë kryesorë të Kosovës në tregtinë e jashtme. Mbi 3/4 e importeve dhe të eksporteve janë realizuar me këto grupe shtetesh gjatë periudhës 2003 – 2009. Në kontekst të BE-së, Gjermania dhe Italia mbeten një nga partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës që nga mbarimi i luftës. Gjithashtu, partnerë të rëndësishëm tregtarë sa u përket importeve mbesin Greqia dhe Sllovenia. Në këtë kontekst duhet potencuar humbjen e tregut të Belgjikës në vitin 2009, tregun kryesor të eksporteve të metaleve bazë në vitin 2008. E njëjta situatë raportohet edhe për Indinë. Arsyet për këtë zhvillim janë të lidhura me rënien e kërkesës si pasojë e krizës financiare dhe është e besueshme se rikthimi në këto tregje është i mundur me kalimin e krizës.

Sa i përket tregtisë me vendet e CEFTA-s në periudhën e lartpërmendur, Maqedonia dhe Serbia janë partnerët kryesorë regionalë, duke mbuluar rreth 1/3 e eksporteve, respektivisht të importeve të Kosovës. Në rastin e Serbisë, sivjet eksportet kanë shënuar rënie drastike, si rezultat i mosnjohjes së dokumentacionit të Republikës së Kosovës nga Serbia. Vendet tjera kanë pjesëmarrje më të ulët. Rëndësia e Shqipërisë si partner tregtar është në rritje, sidomos pas ratifikimit dhe funksionalizimit të Marrëveshjes së lirë të vitit 2004 dhe zhvillimeve të fundit infrastrukturore në këtë vend, të cilat e bëjnë këmbimin tregtar më të lehtë.

Jashtë vendeve të BE-së dhe CEFTA-s partnerë të rëndësishëm tregtarë janë Turqia, Zvicra dhe Kina. Viti 2009 shënon një zhvillim të rëndësishëm në tregtinë e jashtme të Kosovës. Në këtë vit shënojmë eksportet e para drejtë Shteteve të Bashkuara të Amerikës që nga mbarimi i luftës. Për gjashtë muajt e parë të vitit 2009, janë eksportuar 4.6 milionë euro, që përbëjnë mbi 7% të totalit të eksporteve të Kosovës. Ky zhvillim besojmë se është rezultat i përfshirjes së Kosovës në sistemin gjeneral të preferencave nga SHBA-të, një hap tjetër i rëndësishëm në përfshirjen e Kosovës në tregun global.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni me këtë rast t'i kthehem shkurtimisht Marrëveshjes CEFTA në kontekstin e raporteve me Serbinë. Besoj se të gjithë pajtohemi që pa dyshim se Kosova përfiton nga Marrëveshja CEFTA, përkundër asaj se ekzistojnë mendime të ndryshme të ekspertëve se a kemi qenë të përgatitur për të. Megjithatë, Kosova si pjesë e marrëveshjes CEFTA ka përgjegjësi të caktuara, ekzistojnë shumë aspekte pozitive të këtij procesi. Një nga këto përfitime së pari është rrjedhja e lirë e mallrave dhe shërbimeve. Qëllimi i CEFTA-s është krijimi i rregullave dhe mekanizmave me anë të cilave qeveriset tregtia e jashtme në rajon. Këto rregulla kanë qenë të harmonizuara me principet e Bashkimit Evropian dhe të Organizatës Botërore të Tregtisë.

Përvojë e fituar në tregtinë me rajonin do të bëjë produktet e Kosovës konkurruese për tregun e BE-së dhe më gjerë. Gjithashtu, Kosova në këtë proces do të mundësojë institucionet e politikat që janë në përputhje me kërkesat e OBT-së.

Një tjetër qëllim i CEFTA-s është krijimi i një tregu tërheqës rajonal, i cili do të krijojë mundësi të reja për bizneset vendore apo investitorët e huaj. Ky dimension është veçanërisht i rëndësishëm për Kosovën pasi investimet e huaja direkte janë të një rëndësie kapitale për përmirësimin e pozitës konkurruese të industrive kosovare në tregjet e huaja.

Mirëpo, ashtu siç tanimë dihet, që nga dhjetori i vitit të kaluar Serbia dhe Bosnja e Hercegovina po shkelin në mënyrë arbitrare Marrëveshjen CEFTA, duke mos lejuar mallrat kosovare të hyjnë në tregjet e tyre apo duke ngarkuar me tarifatat të plota doganore gjegjësisht duke mos njohur origjinën e mallit ashtu siç përcaktohet me marrëveshje.

Si pasojë e kësaj është edhe rënia po thuaj se në zero e eksporteve tona në Serbi. Qeveria e Kosovës që nga fillimi ka ndërmarrë të gjitha veprimet që kjo çështje të zgjidhet në frymën e bashkëpunimit të ndërsjellë. Në këtë aspekt, në fillim të janarit jemi drejtuar me kërkesë zyrtare kryesuesit të CEFTA-s për shqyrtimin e kësaj çështjeje nga ana e Komitetit të përbashkët të CEFTA-s, si organi më i lartë përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes.

Ministri malazez për Zhvillim Ekonomik, në cilësinë e kryesuesit të CEFTA-s për vitin 2009, ka refuzuar kërkesën tonë me arsyetimin se ne nuk jemi nënshkrues të marrëveshjes, por UNMIK-u. Aktivitetet më tutje kanë vazhduar në koordinim me institucionin ndërkombëtarë në Kosovë për zgjedhjen e kësaj çështjeje.

Me këtë rast dua të theksoj se Marrëveshja CEFTA në mënyrë decitive nuk parasheh masa të reciprocitetit, por lejon masa kundër balancuese, si veprime të fundit kur shteren të gjitha mundësitë për zgjedhjen në mënyrë miqësore të problemeve eventuale.

Ne që nga fillimi kemi qenë të përkushtuar për zgjidhjen ...

KRYETARI: Ministër, faleminderit! Përmbylle. Ju lutem, materialin e keni dorëzuar përmbylleni, i bini pak më shkurt.

LUTFI ZHARKU: Ne që nga fillimi kemi qenë të përkushtuar për zgjidhjen e këtij problemi pa përdorimin e masave kundërbalancuese, si shenj e përkushtimit të Kosovës për respektim të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe aspiratave tona për liberalizim të plotë dhe anëtarësim në OBT, por pa e përjashtuar edhe këtë opsion.

Fatkeqësisht, palët tjera, gjegjësisht Serbia dhe Bosnja e Hercegovina deri më sot nuk kanë treguar vullnet të mirë për zgjidhjen e kësaj çështje në mënyrë miqësore. Ne ende japim shans dialogut dhe zgjidhjes së kësaj çështje në marrëveshje, me përkrahje të lartë, të fortë të institucioneve ndërkombëtare në Kosovë. Natyrisht që opsioni i masave kundër balancuesve me qëllim të evitimit të humbjeve në ekonomi ka qenë dhe është një opsion i mundshëm. Ne besojmë në përpjekje të pareshtura të partnerëve ndërkombëtarë se kjo çështje do të zgjidhet në përputhshmëri me marrëveshjen. Por, problemet aktuale me Serbinë nuk duhet të na shtyjnë në mohimin e rëndësisë së Marrëveshjes CEFTA për Kosovën dhe regjionin si tërësi dhe shkeljet individuale të ndonjë pale nuk duhet të përgjithësohen si dështim i marrëveshjes, si tërësi. Kryetar, unë kam shumë, por po e kryej. Ju faleminderit!

KRYETARI: I nderuar ministër, e ke dorëzuar materialin, biri pak më shkurt, se mendoj që deputetët e kanë lexuar.

Tani është radha e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të PDK-së, kush është lajmëruar? Safete Hadergjona, përpikuni që mos t'i kaloni 5 minutat. Ai që nuk thotë diçka për 5 minuta, edhe një orë nëse flet, kot e ka.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike përkrah raportin të cilin e dha ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm se Kosova pas luftës ka trashëguar një ekonomi po thuaj se në kolaps. Procesi i privatizimit me problemet me të cilat është përballur nuk i ka dhënë efekte të duhura në ringjalljen e ekonomisë. Niveli i investimeve të jashtme nuk ka qenë i kënaqshëm që të kontribuojë në rritjen e eksportit. Prezenca e ekonomisë informale dhe shumë çështje të tjera, që s'do t'i përmend me radhë, kanë bërë që Kosova që nga viti 1999 të përballlet me deficit të lartë tregtar.

Importet përbëjnë rreth 50% të GDP-së dhe lëvizjet në treg tregojnë se Kosova nuk mund të pres ndryshime në një periudhë afatshkurtër. Megjithatë, në Kosovë po bëhet përpjekje që të ndryshohen dhe të plotësohen politikat ekzistuese ekonomike dhe të përmirësohet funksionaliteti institucional, gjë që vërehet qartë edhe përmes Kornizës afatmesme të shpenzimeve të vitit 2009 – 2011, që është njëherësh dokumenti bazë dhe udhërrëfyes i zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Kosova është përcaktuar për liberalizimin e tregtisë. Edhe pse për shumë vite nuk ishte pjesë e nismave rajonale që synon liberalizimin për shkak të statusit të pazgjidhur politik, megjithatë Kosova ka qenë nënshkruese e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me Shqipërinë, Maqedoninë, Bosnjën e Hercegovinë dhe Kroacinë, kurse në vitin 2006 i është bashkangjitur iniciativës së vendeve të Evropës Juglindore për krijimin e tregut të lirë duke qenë nënshkruese e Marrëveshjes së Evropës Qendrore për tregti të lirë apo CEFTA-s.

Në Kosovë në vitet e pasluftës ka pasur vështirësi, por edhe të arritura sa u përket politikave tregtare, por fatkeqësisht ende ka vështirësi për komunitetin e biznesit, sidomos gjatë kohëve të fundit kur janë përballur me barriera politike, ekonomike nga shtetet nënshkruese të CEFTA-s, sidomos Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës.

Megjithëse edhe shtetet tjera nënshkruese të CEFTA-s në përpjekje për të shpëtuar veten nga recesioni dhe kriza financiare botërore kanë vënë barriera ndaj njëra tjetrës, barriera

këto që po e pengojnë sidomos importin e produkteve bujqësore, do me thanë i kanë vënë njëra-tjetrës barriera për produkte të caktuara për t'u mbrojtur nga kriza.

Të gjitha vendet e rajonit pretendojnë që bashkëpunimin tregtar ta ngrehin në nivel të vendeve të Bashkimit Evropian, por siç po shihet, niveli i bashkëpunimit tregtar me vendet e rajonit është tejet i ulët dhe nuk po reflekton potencialet dhe mundësitë të cilat i kanë shtetet e rajonit.

Edhe përkundër debateve të shumta të cilat bëhen shumë skeptike në disa raste, gjendja në tregti nuk duhet parë krejt zi. Ka pasur angazhime serioze për të ndërtuar një treg të volitshëm dhe miqësor për biznese, si në kuptimin e fuqizimit të mekanizmave rregullativ dhe monitorues të tregut të brendshëm, ashtu edhe në luftimin e dukurive monopoliste dhe të konkurrencës jolojale në tregun e Kosovës.

Do të doja të veçoja disa nga të arritura shumë të rëndësishme që janë bërë për zhvillimet tregtare në Kosovë në këto dy vitet e fundit.

Së pari, ndryshimi i politikave fiskale tatimore, që është përcjellë edhe me rregullativën ligjore, është një arritur jo e vogël në këtë drejtim. Fillimi i procesit të futjes së arkave fiskale, themelimi dhe funksionalizimi i Komisionit Kosovar të Konkurrencës, bëhet një trajtim po thuaj se i barabartë i të gjithë investitorëve, edhe të huajve dhe të atyre vendorë, është rritë fleksibiliteti i tregut të punës përmes zgjerimit të rrjetit të shkollave profesionale, është hapur mundësia e transferit të përvojave dhe të praktikave dhe të njohurive nga universitetet të njohura ndërkombëtare përmes funksionalizimit të Këshillit për akreditim të institucioneve të arsimit të lartë, privat dhe publik, janë funksionalizuar programet e ndihmës së shtetit, si zhvillimi i paqeve të biznesit në pjesë të ndryshme të Kosovës, skema Vauçer e trajnimeve dhe këshillimeve për ndërmarrës, mësimi i ndërmarrësisë, programi INTSH biznesi e tjera në drejtim të stimulimit dhe përmirësimit të aftësive konkurruese, promovimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe transferimin e njohurive dhe teknologjive moderne.

Është bërë një riorganizim dhe transparencë më e madhe procedurave administrative, ka ndodhur një progres shumë i madh në përdorimin më efikas të burimeve publike, po implementohet Udhëzimi Administrativ i MTI-së mbi etiketën e mallrave dhe duhet theksuar se aprovimi i tri ligjeve bazike, siç janë Ligji për shoqëritë tregtare, ai i koncesionit dhe partneritetit privato-publik dhe Ligji për zonat ekonomike, kanë hapur të gjitha forcat e mundshme për investimet e huaja dhe bashkë investime në sektorin publik e privat. Kurse një çështje mjaft e rëndësishme të cilën e ceku edhe ministri, është aprovimi nga ana e Qeverisë të dokumentit për politika tregtare, i cili veç është aprovuar zyrtarisht.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është i mendimit se duhet bërë më shumë që të respektohet parimi i reciprocitetit në raport të shkëmbimit dhe të lëvizjes së mallrave me vendet tjera, sidomos me vendet fqinjë. Të bëhen elaborime se si do të jetë qasja ndaj tregjeve të vendeve të ish-Jugosllavisë, të cilat për afro një shekulli kanë qenë partnerë kryesorë ekonomikë. Të ketë orientim të qartë të politikave qeveritare ndaj investimeve të huaja, ka apo nuk ka dhe a duhet apo nuk duhet nga aspekti strategjik të kemi kufizime të investimeve të huaja në disa operacione biznesi, si industria e furnizimeve ushtarake, lojërat, sigurimet pensionale, sigurimet shëndetësore, pastaj në sektorin financiar, bankar dhe të sigurimit e të tjera, të cilat duhet të lidhen po ashtu me prioritetet e politikave zhvillimore të ekonomisë së Kosovës. Të ketë angazhime të Qeverisë për pranimin e

linjave të detyrueshme tarifore, çmontimin e barrierave tarifore dhe angazhime tjera specifike, të mos mungojë përcaktimi i pozicionit të Kosovës sa i përket regjimit të importit, kufizimeve të importeve, rregullimit të importeve në raport me sigurinë publike, shëndetin dhe mjedisin, administrimin e kuotave tarifore në bujqësi, barrierave jotarifore e tjera. Faleminderit, për vëmendjen!

Drejtimin e seancës e merr anëtar i Kryesisë, zoti Sabri Hamiti

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Për Grupin Parlamentar të LDK-së, shefi i grupit, Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues i seancës!

Të nderuar ministra, zëvendëskryeministër,

Grupi Parlamentar i LDK-së, natyrisht, e mbështet dhe e falënderojmë ministrin Zharku për paraqitjen dhe për raportimin edhe në formë të shkruar, edhe deklarativ para kësaj seance, duke e falënderuar angazhimin e tij që t'i njoftojë deputetët edhe për të arriturat dhe sfidat që i ka resori i tij ministror dhe politika që ai përfaqëson.

Besojmë që me një mbështetje më të madhe tonën në të ardhmen do ta arrijë, rezultatet nuk do të mungojnë dhe sfidat do t'i përballojë me sukses. Faleminderit!

KRYESUESI: Lutë, i shkurtër, i saktë, lapidar. Faleminderit!

Deputeti Ethem Çeku, për AAK-në.

ETHEM ÇEKU: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi ynë Parlamentar e mirëpret këtë debat dhe më vjen keq që ndoshta nuk janë edhe një pjesë e kolegëve tanë për të debatuar për një nga çështjet më të rëndësishme që ka të bëjë me zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

Ne po ashtu mund të falënderojmë ministrin për një material që e ka sjellë dhe një material i cili i ka potencuar mjaftë edhe vështirësitë edhe gjendjen aktuale me të cilën po ballafaqohet vendi ynë.

Edhe pse progreset e bëra pas luftës realisht janë progrese, mirëpo vendi ynë mbetet prapë një nga vendet më të varfra në Evropë, do të thotë, kur flasim për progres, atëherë shohim se në çfarë shkalle të zhvillimit ekonomik gjendet Kosova.

Bilanci negativ është vetëm njëri nga problemet ekonomike me të cilin po ballafaqohemi dhe ky bilanc me këto politika çfarë i kemi, çfarë i ka Qeveria, është vështirë të tejkalohet. Kur them këtë, them duke parë strukturën zhvillimore në Kosovë. Do të thotë, me ndërmarrje të vogla dhe të mesme është e vështirë të eliminohet bilanci negativ.

Dikur sektori i Energjisë dhe i Minierave ishte njëri nga sektorët më të fuqishëm zhvillimor në Kosovë. Të gjithë e dinë se ai sektorë në një periudhë të kaluar kohore i sillte 2/3 e të hyrave devizore në Jugosllavi apo të barabartë me 100 milionë dollarë në Kosovë. Sot ajo strukturë paraqet anën negative, sepse kemi ndërprerë projektet zhvillimore, janë ndërprerë projektet e mëdha të cilat do të kishin ndërruar strukturën dhe bilancin mes eksportit dhe importit. Llogaritni, ne sot në Kosovë të vetmet produkte jashtë vendit që i çojmë, atë e përmendën edhe disa koleget më herët, janë mbeturinat metalike dhe disa produkte të tjera. Në qoftë se e shohim bilancin, shohim se i kemi 2

miliardë importe, kurse i kemi 200 milionë eksporte. Jemi në një pozitë ndoshta më të pafavorshme në aspektin e tregjeve të jashtme apo të plasimit të bilancit.

Mendoj që Qeveria ka bërë jo aq sa duhet në këtë drejtim, sidomos kur ka të bëjë me politikat e CEFTA-s, me tejkalimin e raporteve me CEFTA-n. Përpos taksave të transitit që paguajnë njerëzit tanë, edhe me taksa të tjera ballafaqohen eksportuesit tanë dhe në këtë drejtim eksportuesit ynë gjendet në një pozitë tepër të palakueshme.

Më vjen mirë që ne duhet t'i rishikojmë edhe politikat që ka të bëjë me CEFTA-n. Ne po flasim shumë me një lloj pompoziteti se ne do të hyjmë në këto marrëveshje ndërkombëtare dhe t'i nënshkruajmë këto marrëveshje ndërkombëtare, duke ditur që institucionet e Kosovës posaçërisht me largimin e numrit të madh të ekspertëve nuk jemi të gatshëm të përballemi me kushtet të cilat janë vendosur, prandaj edhe në këtë drejtim Qeveria, Ministria duhet t'i ndërrojë politikat, duhet t'i sheh implikimet që kanë të bëjnë me këto marrëveshje në raport me zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

Ne si Grup Parlamentar do të ftojmë Qeverinë që shumë më tepër të përkushtohet që t'iu ndihmojë kompanive për gjetjen e mundësive të tyre për dalje në tregje të jashtme, posaçërisht në tregjet me Bashkimin Evropian sepse, në fund të fundit, ne jemi duke bërë përpjekje për integrimet në BE dhe raportet me Bashkimin Evropian, me vendet e Bashkimit Evropian, në aspektin ekonomik për Kosovën janë shumë më të lehta, shumë më të favorshme, shumë më të mira se sa ndonjëherë politikat që kanë të bëjnë në raport me vendet fqinje apo me vende të caktuara në këtë drejtim.

Prandaj, Grupi ynë Parlamentar kërkon nga Qeveria që t'i hartojë sa më shpejt planet zhvillimore në radhë të parë, nën një, t'u përgjigjet strukturave të zhvillimit ekonomik të vendit, të cilat ndikojnë në ndërrimin e bilancit, të heqim konceptin se me disa ndërmarrje apo vetëm me një lloj infrastrukture mund të ndërrojmë bilancin negativ në aspektin e tregtisë së përgjithshme. Faleminderit, për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet Çeku!
Për AKR-në flet deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Faleminderit ministër për prezantimin tënd të politikave të shkëmbimeve tregtare të Kosovës për gjashtëmujorin e parë, ku në realitet Grupi i Aleancës Kosova e Re ka bërë shqyrtimin e këtij materiali, i cili në përgjithësi mund të them se deri diku paraqet gjendjen faktike me të cilën përballlet Kosova, mirëpo për politikëbërjen për zhvillimin ekonomik të Kosovës mbetet ende ngecje për Qeverinë e Kosovës.

Fatkeqësisht, si pasojë e mos zhvillimit ekonomik, Kosova ka këmbim tregtar më të lartë në vend dhe në rajon, që do të thotë se shumë pak është stimuluar veprimtaria prodhuese në vend. Këtu vinë në radhë të parë çështjet e politikës tregtare me të cilat Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është e ngarkuar.

Edhe pse bashkëpunimi i mirë ekonomik në mes të vendeve të rajonit ka sjellë përfitime, edhe pushteti i Kosovës një gjë të tillë duhet ta avancuajë dhe duhet ngritur nivelin i këmbimit tregtar që Kosova të mos mbetet edhe më tej vend më shumë importues se sa eksportues. Për fat të keq, Kosova ka një deficit tregtar me të gjitha vendet e rajonit dhe nuk janë marrë fare masa stimuluese për të ndryshuar gjendjen e bizneseve tona në Kosovë. Shembulli konkret është Maqedonia, eksporton në Kosovë 300 milionë euro në

vit dhe importi nga Kosova rreth 14 milionë euro, që praktikisht është një gjendje e debalancuar. Kjo ka nevojë për një rishqyrtim të marrëdhënieve ekonomike mes këtyre dy vendeve në mënyrë që të krijohet partneritet i qëndrueshëm dhe jo të kemi marrëdhënie thjeshtë tregtare për nevojat e shtetit fqinj.

Edhe me vende të tjera, si me Shqipërinë dhe Kroacinë, Kosova ka këmbim tregtar deri në 40 milionë euro, edhe këtu kemi deficit. Një problem më vete është se Kosova nga Serbia importon në formë të rregullt produkte të ndryshme në vlerë prej 200 milionë eurosh në vit, ndërsa Kosova nuk eksporton asnjë produkt në këtë vend për shkak të bllokadës që iu ka bërë produkteve të Kosovës. Përgjithësisht më pak se 50% e këmbimeve tregtare të Kosovës bëhen me vende të rajonit, një pjesë e madhe bëhet me Unionin Evropian, pastaj me Turqinë. Faktet tregojnë më së miri se në çfarë gjendje tregtare është Kosova dhe në çfarë deficiti gjendet vetë Kosova.

Në fakt, rajoni në vitin e kaluar ka shënuar një ngritje të shkëmbimeve që mund të thuhet se është rezultat i CEFTA-s, por problemet që kanë ndodhur me Serbinë dhe me Bosnjën kanë krijuar probleme serioze me Kosovën dhe këmbimet tregtare me vendet e rajonit. Dhe, këtu Qeveria, definitivisht Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë është treguar shumë neglizhente pasi që Ministria është dashur të jetë zbatuese e marrëveshjes së CEFTA-s, kur dihet mjaftë mirë se pas 17 shkurtit kompetencat për vendimmarrje i ka Qeveria e Kosovës, ekskluzivisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe për zbatueshmërinë e Marrëveshjes së CEFTA-s në rast se është nevoja, atëherë edhe unë si deputet i këtij Kuvendi parashoh masa reciproke për vendet për arsye se nuk mund t'i ndihmoni bizneset në Kosovë dhe bizneset të cilat prodhojnë në Kosovë, atëherë ato mund të dëmtohen. Ku janë masat ndihmëse të Qeverisë për bizneset Kosovare, ku edhe Qeveria e di mjaft mirë se edhe në bazë të Kushtetutës së Kosovës, nenit 119 thuhet shumë qartë se Republika e Kosovës është shteti për konkurrencë të lirë dhe tregti të lirë, atëherë cilat janë masat e juaja, ministër, pasi sot jeni prezent këtu. Për një gjendje më të mirë ekonomike të zhvillimit të Kosovës parashihet që të jetë një strategji e zhvillimit ekonomik, në strategji të merren edhe të gjitha masat për marrëveshjet me të cilat janë nënshkruar në kohën e UNMIK-ut, me rishqyrtimin e këtyre marrëveshjeve që pas 17 shkurtit ju jeni ekzekutivi, i cili merr të gjitha përgjegjësitë për marrëveshjet e nënshkruara më parë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!
Për LDD-në, flet deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar kolegë deputetë,
Do të mundohem ta ruaj ose të jem e shkurtër, ta ruaj kohën e çmuar të juaj, se vërtet tashmë edhe jemi lodhur.
Megjithatë, përshëndetje zoti ministër dhe shumë respekt. Po ju them shumë sinjerisht, kam pritur diçka më konkrete, sepse ne e kemi marrë këtë dokumentin e juaj, i cili quhet politika tregtare e Kosovës, për të cilën pikërisht për këtë politikë jo të mirë ne kemi ngritur këtë debat dhe kemi menduar që vërtet do të na afrosh diçka konkrete, që vërtet të ndryshojë gjendja reale shumë e rëndë tregtare në Kosovë.

Të nderuar kolegë deputetë,
Sipas disa analizave që unë kam mund t'i mbledh, realisht Kosova po thellohet në deficit, në deficit shumë të lartë me tregtinë e jashtme. Përqindja e mbulimit të importit me eksportin është zvogëluar ndjeshëm. Nëse e marrim analizën nga muaji nëntor i vitit

2008, ku vetëm 6% të importit mbulohej me eksport, ndërsa ky deficit thellohet në dhjetor të vitit 2008 në 5.3%.

Ecuria negative ka vazhduar edhe gjatë këtij viti, të nderuar kolegë. Nëse marrim muajin korrik, vetëm 8% e importit të përgjithshëm mbulohet me eksport, që është 1.5% në rënie nga muaji paraprak. Nëse ju referohemi të dhënave të Entit të Statistikës së Kosovës, tregojnë për një deficit tregtar për muajin korrik të këtij viti prej 155.6 milionë euro krahasuar me deficitin prej 154.6 milionë euro sa ishte gjatë korrikut të vitit të kaluar. Kemi pra parasysh, eksporti në muajin korrik të vitit 2009 kishte vlerën 13.5 milionë, ndërsa importi 169.2 milionë euro. Po çka është më shqetësuese për fillimin e vitit 2009, është se ka rënie edhe të eksportit, edhe të importit. Nëse i referohemi muajit korrik të vitit 2009, duke krahasuar me vitin paraprak, eksporti ka rënie 28.3%, kurse importi ka rënie 2.5%.

Ndër shumë shkaktarët, që i thanë edhe kolegët e mi, të neglizhencës, të pa aftësisë dhe të pagatishmërisë dhe papërgjegjësisë së kësaj Qeverie që të merret me seriozisht me këto çështje, është edhe diskriminimi që po i bëhet Kosovës me marrëveshjen e CEFTA-s, sidomos nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, pa përjashtuar në disa raste edhe Malin e Zi.

Dua t'i jap prapë disa statistika që në japin për ta kuptuar se sa është e pandërgjegjshme kjo Qeveri që ta ndryshojë këtë realitet për dy vitet në qeverisje. Sipas të dhënave nga doganat e Kosovës, destinacioni më i rëndësishëm për eksport të Kosovës është Shqipëria, që absorbon 25% të eksporteve të përgjithshme. Ndërsa, importet nga Shqipëria krahasuar me shtetet e rajonit janë vetëm 2.2%, të importeve të përgjithshme.

Gjatë periudhës janar – korrik 2009, listës së shteteve që importojnë në Kosovë i prin Maqedonia me 157 milionë euro, pason Gjermania rreth 129 milionë euro, i treti vend është Serbia me 110.5 milionë euro. Pastaj, natyrisht, është Turqia, Kina, por ndër vendet e rajonit e fundit është Shqipëria me vetëm 19.7 milionë euro. Kjo na jep shumë për të kuptuar sa kjo Qeveri ka bërë plane konkrete, sa janë respektuar memorandumet e tjera, e tjera.

Përveç kësaj analize, kur shtojmë analizën mbi tregtinë ilegale, kontrabandën dhe kriminalitetin e organizuar në Kosovë, atëherë mund të themi se deficitin tregtar i Kosovës është shumë më i thellë apo më i lartë se sa ky që na japin qoftë institucionet e Kosovës, qoftë edhe statistikën me të cilat ne mund të shërbejemi.

Nga realiteti që kemi sot në Kosovë, që është nga kjo fushë, na jep të kuptojmë se kjo Qeveri me papërgjegjësinë dhe me pa aftësinë e saj është duke dëmtuar vendin dhe popullin e saj dhe duke e zhytur vendin në varfëri të thellë.

Zoti ministër,

Pa asnjë keqkuptim dhe pa asnjë personalizim, ne edhe një herë ju lusim në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë që urgjentisht të bëhen projekte konkrete për ndryshimin e gjendjes reale shumë të rëndë, për të cilën edhe ju nuk bëtë asgjë më shumë sot se sa e pasqyruat gjendjen reale në Kosovë sa i përket tregtisë me jashtë. Faleminderit për vëmendje, të nderuar deputetë!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Gaxherri!

Grupi “7+”, nuk është paraqitur, Grupi SLS, nuk ka paraqitje.

Atëherë, fillojmë me diskutimet e deputetëve. Luljeta Shehu e ka kërkuar fjalën.

LULJETA SHEHU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Gjendja tregtare në Kosovë ka marrë hov zhvillimi duke ju falënderuar iniciativave të bizneseve private. Por, në mungesë të ligjeve, zhvillimi i tregtisë është bërë jo i drejtë. Kemi shtrirje pa kriter të pikave të shitjes së karburanteve, gjë që ka bërë që të zihen sipërfaqet e tokës bujqësore dhe, në anën tjetër, shumë biznese të kësaj lëmie kanë falimentuar. Një gjë e tillë mund të ndërpritet me ligjet e nxjerra nga Qeveria e Kosovës, respektivisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe në këtë mënyrë do të ruhej toka bujqësore dhe do të kurseheshin biznese të shumta.

Sa i përket rrjetit tregtar, shqetësues është fakti se pjesa më e madhe e tregtisë është e orientuar nga prodhimet e huaja, duke iu dhënë shumë pak hapësirë prodhimeve vendore. Ndërsa, sa i takon raportit të tregtisë me vende tjera, mbetet për t'u dëshiruar, pos raportit tregtar me Shqipërinë, që ka probleme të vogla, por shkëmbimi tregtar është shumë i ulët.

Në këtë çështje unë do të ndalesha në marrëdhëniet tregtare me Serbinë dhe Maqedoninë. Raporti tregtar me Serbinë kap shifrat rreth një miliardë euro në vit, ndërsa nga Serbia në Kosovë hynë mallra me vlerë prej 700 deri 800 milionë euro në vit, kurse vlera e mallit që hynë nga Kosova në Serbi nuk e kalon shifrën 150 milionë euro. Gjendja e ngjashme është edhe Maqedoninë. Është shqetësues fakti se ky këmbim tregtar me këto dy vende është aq i madh kur dihet se këto vende shpesh krijojnë pengesa dhe barriera të ndryshme duke bllokuar hyrjen e prodhimeve kosovare në këto vende.

Sa i përket Marrëveshjes së CEFTA-s me këto vende, Qeveria e Kosovës duhet të rishikojë këto marrëveshje ose të vendos marrëdhënie të reciprocitetit.

Një çështje tjetër, ku do të fokusohesha unë, e që është shqetësim edhe i bizneseve, është çështja e mbështetjes së eksporteve të prodhimeve vendore. Gjersa shtetet në regjion përpos që mbështesin, subvencionojnë prodhimet e tyre, ato i stimulojnë eksportet deri në 5% të fitimit. Në Kosovë ndodh e kundërta, eksportuesit paguajnë 3% të taksave të fitimit. Akoma më shqetësues është fakti, kur kjo ndodh me eksportet e prodhimeve bujqësore.

Unë e kuptoj Qeverinë se e ka të pamundur subvencionimin e prodhimeve për shkak të buxhetit të limituar që ka Kosova, por nuk e kuptoj arsyen e ngarkesës me tatimin në fitim prej 3% për prodhimet e eksportuara. Me këtë rast do ta ngreh edhe një shqetësim nga bizneset për certifikatat sanitare. Ditëve të vikendit, për shembull, bizneset nga Prizreni duhet të shkojnë në Pejë për të marrë certifikatën fito – sanitare ose anasjelltas. Pse të ndodh kjo, kur dihet se rrjeti i inspektorëve fito – sanitarë është i shtrirë në të gjitha regjionet dhe kjo certifikatë ka një kosto, e cila do t'i mbulonte shpenzimet për kompensim për punën jashtë orari të këtyre inspektorëve. E ceka këtë gjë, sepse prodhimet bujqësore janë të ndjeshme dhe nuk qëndrojnë gjatë, andaj Qeveria duhet t'u krijojë lehtësira këtyre bizneseve. Nëse nuk ka mundësi të subvencionohen bizneset dhe prodhuesit, të paktën le t'u sigurohen lehtësira. Faleminderit, për vëmendje!

Drejtimin e seancës e merr Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Faleminderit! Radha është e deputetëve. Fjalën e ka deputeti Gani Geci, nuk është këtu. Vazhdojmë, fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Kosova që nga paslufta ka një deficit tregtar, i cili vazhdon edhe tani në vitin 2009. Po ashtu, Kosova mbetet vendi me deficitin më të lartë tregtar në rajon dhe një ndër vendet që eksporton më së paku.

Me qenë se kryesisht në vitin 2009, për shkak të krizës globale ka pasur efekt edhe në shkëmbime tregtare, përqendrimi im kryesisht do të jetë në vitin 2009, duke i përcjellë këto këmbime tregtare në nivelin global rajonal dhe atë vendor.

Rrethanat në nivelin global kanë bërë që kriza financiare kryesisht ka goditur vendet në zhvillim, por të cilat tani kanë një rritje më të madhe dhe për të cilat supozohet se do të vjen deri te përmirësimi dhe rritja ekonomike. Megjithatë, sipas FMN-së ende procesi duhet të vazhdojë.

Ndërsa, sa i përket ndikimit të krizës globale në rajon ose në vendet tranzicion dhe në vendet në zhvillim, importet kanë rënë diku prej 9.6%, kurse eksportet 6.5%. Sa i përket Kosovës, kjo krizë ka ndikuar në rënien e remitancave, por po ashtu edhe të investimeve.

Importet dhe eksportet në vitin 2009 kanë rënë. Një ndër komponentët me rëndësi të importeve, pa dyshim është energjia elektrike, por rënia e eksportit ka rritur gjithashtu edhe më tepër deficitin ose ka shkaktuar bilancin e mëtejshëm negativë tregtar.

Kosova kryesisht ka importuar produkte minerale, ushqime, makineri e tjerë, ndërsa ka eksportuar kryesisht metale bazë, lëkura, makineri të ndryshme e tjerë.

Zoti ministër,

Ju patët thënë se faktori kryesor që ka ndikuar në rënien e eksportit të produkteve të Kosovës është kriza ekonomike botërore dhe se ju po synoni që përmes politikave të reja tregtare të ndikoni në zvogëlimin e deficitit tregtar, të nxitni eksportin dhe ta zëvendësoni me importin me prodhime vendore.

Zoti ministër,

Cilat janë ato politika, si do t'i stimuloni prodhuesit vendorë, ashtu që në vend të importeve nga jashtë të konsumohen prodhime vendore, cilat janë ato masa stimuluese, sidomos duke marrë parasysh se në buxhetin e vitit 2009 dhe në Kornizën afatmesme të shpenzimeve Qeveria nuk ka paraparë përkrahje të ndërmarrjeve të vogla të mesme dhe as subvencionimin e agrobiznesit.

Përveç krizës globale financiare, në zvogëlimin e eksportit ka ndikuar edhe bllokada e Serbisë dhe e Bosnjës e Hercegovinës. Unë ju dëgjova me vëmendje në prezantimin tuaj sot në Kuvend dhe ju thatë se edhe pse Kosova është nënshkruese e Marrëveshjes së CEFTA-s, megjithatë nuk keni marrë masa të reciprocitetit dhe se më tepër preferoni masa kundër balancimit.

Unë ju ftoj, zoti ministër, që të mendoni më shumë për interesin e qytetarëve të Kosovës, sepse po humbin shumë dhe e them një fakt se importimi ose shkalla e lartë e importit po

shkakton jo vetëm varësinë nga ky import, por edhe varësinë politike dhe ekonomike. Prandaj, mendoj që sa më shpejt duhet t'i merrni këto masa për ta mbrojtur vetë shtetin dhe qytetarët e Kosovës.

Me qenë se Kosova konsumon 80% të produkteve të importuara, atëherë cilat masa ka për t'i marrë Qeveria ashtu që së paku prodhimet, siç janë: pemët, perimet, pastaj qumështi dhe produktet e qumështit të bëhet konsumi nga prodhuesit vendorë dhe jo të importohet nga shtetet tjera.

Me qenë se deficitin tregtar i Kosovës çdo muaj është duke u rritur, atëherë duhet të ketë një strategji për të zvogëluar deficitin, përkatësisht për të rritur eksportin, a ka Ministria një strategji të tillë? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina, le të përgatitet Berat Luzha.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në periudhën e pasluftës gjendja reale e ekonomisë së Kosovës karakterizohet me disa shpërpjesëtime makro-ekonomike si: bilanci tregtar negativ, norma e lartë e papunësisë dhe struktura e pavolitshme ekonomike.

Edhe pse eksportet e Kosovës gjatë periudhës 2001 – 2008 kanë shënuar një rritje impulsive, si thuhet në dokumentin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, pasi që është shënuar rritje prej 60% mesatarisht në vit, por duhet ta kemi parasysh që baza prej të cilës ka filluar eksporti i Kosovës ishte zero. Ndërsa, gjatë të njëjtës periudhë importet kanë shënuar rritje prej 15% mesatarisht në vit. Mirëpo, edhe në këtë rast duhet të kemi parasysh se baza e fillimit të importeve prej fillimit ka qenë shumë e lartë.

Në vitin 2008 vlera e importeve arriti në rreth 2 miliardë euro, kurse vlera e eksporteve rreth 200 milionë euro. Ndërsa, sipas të dhënave për gjashtëmuorin e parë të vitit 2009, importet kanë arritur vlerën prej 845 milionë euro, me një rritje mbi 4% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kurse, eksportet arritën vlerën prej 28 milionë euro, që paraqet një rënie prej 45% në krahasim me gjashtëmuorin e parë të vitit 2008. Do me thënë, kemi një përkeqësim të gjendjes në vlerën e eksporteve, gjë që mund t'i përshkruhet krizës ekonomike dhe financiare globale dhe mos respektimit të Marrëveshjes së CEFTA-s nga palët nënshkruese, konkretisht nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, gjë që ka ndikuar në rritjen e deficitit tonë tregtar.

Por, përveç këtyre faktorëve të cekur, duhet të cekim edhe faktorët tjerë, që vite me radhë kanë ndikuar që deficitin tregtar të jetë i lartë. Në radhë të parë, mbi 50% të ndërmarrjeve të regjistruara në Kosovë merren me tregti, derisa me prodhim vetëm rreth 9% të ndërmarrjeve të regjistruara. Arsyeja për këtë disproporcion kaq të madh në mes të sektorit të tregtisë dhe të prodhimit qëndron në atë se ndërmarrësit nuk e shohin interesin e tyre në sektorin e prodhimit, do me thanë, është vështirë të realizojnë afarizëm profitabil në sektorin e prodhimit.

Por, nuk mund të jemi të kënaqur as me strukturën e mallrave të importuara dhe të eksportuara, pasi që mallrat e konsumit përbëjnë pjesën më të madhe të importeve, konkretisht produktet ushqimore, pastaj produktet minerale dhe më pas vinë makineritë.

Ndërsa, në strukturën e eksporteve dominojnë metalet bazë ose mbeturinat e metaleve, më pas vinë produktet minerale, ushqimet e përgatitura e të tjerë. Andaj, me anë të politikës monetare dhe fiskale duhet të ushtrojmë ndikimin e duhur në ndryshimin e strukturës së ekonomisë sonë dhe të stimulohet prodhimi vendës, në mënyrë që me anë të inkurajimit të industrisë së prodhimit vendës të krijohen kushtet për zvogëlimin e shkallës së varësisë nga tregu i jashtëm, të ofrojmë më shumë lloje të produkteve në tregun e jashtëm dhe kështu të zvogëlojmë deficitin tregtar, me çka do të vijë edhe deri te rritja e punësimit.

Mirëpo, për të ndryshuar gjendjen në bilancin tregtar, kërkohet angazhim shtesë jo vetëm nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, por edhe nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Bujqësisë dhe të tërë Qeverisë. Konkretisht, Qeveria e Kosovës duhet të hartojë strategjinë e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik, ku do të mundësohet aplikimi i masave stimuluese për prodhuesit vendorë, posaçërisht për prodhuesit bujqësorë.

Po ashtu, edhe unë përkrah aplikimin e masave të reciprocitetit me vendet anëtare të CEFTA-s. Është edhe një element që duhet të ceket, se kreditë që ofrohen nga bankat komerciale janë të përballueshme nga sektori i tregtisë, por jo nga prodhuesit, më konkretisht nga prodhuesit bujqësorë. Prandaj, edhe në këtë drejtim duhet të bëhen ndryshime, apo thjeshtë Banka Qendrore të parasheh politika më të favorshme për sektorin e bujqësisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka Berat Luzha, le të përgatitet, Naser Rugova, po para Naserit është Driton Tali.

BERAT LUZHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Pasqyra për këmbime tregtare të Kosovës me shtete të rajonit tregon një s'përputhje të madhe. Me Shqipërinë, ta zëmë, importi arrin 24.3 milionë, kurse eksporti vetëm 10 milionë. Me Serbinë pasqyrat tregojnë një fytyrë krejt tjetër, krejt diskriminuese. Importi me Serbinë arrin 92.3 milionë, kurse eksporti vetëm gjysmë milioni. Dyshoj se nuk ekziston as ky gjysmë milioni për shkak se nuk ka gjasa që mallrat e Kosovës të shiten në Serbi.

Proporcioni mes këmbimeve, sidomos me Shqipërinë dhe Serbinë, do të duhej të ishte krejtësisht ndryshe. Pse nuk krijohet një baraspeshë në këmbimet e Kosovës me Serbinë. E kuptoj Marrëveshjen e CEFTA-s, por kjo marrëveshje duhet të vlejë për të gjitha shtetet nënshkruese. Pse lejon diskriminimin kaq brutal nga Serbia, e cila pos që nuk importon nga Kosova, i pengon mallrat për kalim transit. Kjo, si duket, është edhe shkaku i rënies së eksportit të Kosovës, sado i vogël që është.

Theksoj se në 10 vjetët e fundit në Shqipëri janë ndërtuar kapacitete industriale me teknologji bashkëkohore. Prodhimet shqiptare, sidomos ato ushqimore, sot janë dukshëm më cilësore se prodhimet e Serbisë dhe të shteteve të rajonit.

Ministrin do ta kisha pyetur se çka bën Ministria, të cilin e udhëheq, për heqjen e të gjitha pengesave për qarkullimin e mallrave mes Kosovës e Shqipërisë, në mënyrë që të krijohet një zonë e përbashkët e lirë tregtare në mes dy vendeve. Prodhimet kosovare edhe ashtu kanë probleme të plasmanit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, për kohën e kursyer. Fjala është për Driton Talin, diskutuesi i fundit është Naser Rugova.

DRITON TALIN: Faleminderit, zoti Kryetar!

Dola këtu se jemi lodhur e ndoshta bëhem më atraktiv. Shumë sende u thanë, edhe unë do të jem në anën e atyre deputetëve që nuk u pajtuan me ministrin në lidhje me Marrëveshjen e CEFTA-s, kur u tha se në mënyrë njëanshme apo reciprociteti nuk pranohet. Mendoj se kjo nuk është në aspektin strategjik në interes të Kosovës. Vetë CEFTA kur është krijuar, është krijuar duke pasur parasysh interesat e vendeve veç e veç, të cilat shërbejnë më mirë duke bashkëpunuar. Në momentin kur një palë nuk e respekton kontratën, atëherë edhe pala tjetër është e lejueshme që të silllet ngjashëm, aq më shumë kur kemi parasysh se raporti, që veç u cek disa herë këtu, me Serbinë eksport-import është shumë në favor të Serbisë. Do me thënë, është jo në interes të Serbisë ta humbë tregun kosovar nga fakti se tregu kosovar për ndërmarrjet e Serbisë është shumë me rëndësi. Andaj, unë mendoj se kjo strategji e Qeverisë hesht dhe prit që ndërkohë gjërat të ndryshojnë, mendoj që nuk është e qëlluar. Mendoj se nuk duhet edhe t'i çlirojmë ndërmarrjet serbe, por duhet edhe atyre t'u japim presion që ata pastaj të japin presion në qeverinë e tyre që një budallallëk të këtij llojit ta ndërpresin, gjithmonë duke pasur parasysh se edhe në interes të Kosovës edhe të Serbisë është që të integrohemi në Unionin Evropian.

Shikoni, këtu i kemi të gjitha shënimet. Unë veç e mora punën e gushtit. Në gusht nga Bosnja dhe Serbia kemi importuar diku, në gusht flas para një muaji, kemi importuar rreth 27.624.000 euro, gjersa kemi eksportuar 182.000 euro, do me thënë raporti është 0,65%, përndryshe për një euro që kemi shit atje, kemi blerë 154 euro këtu në Kosovë produktet e tyre. Dhe, të thuash se CEFTA-n ne do ta respektojmë, mendoj se nuk është strategji e qëlluar, gjithmonë duke pasur parasysh edhe kontrabandën në pikat doganore 1 dhe 31. Sipas Bankës Botërore, kontrabanda në Kosovë në vitin 2006 ishte 370 milionë, kurse në vitin 2008 për shkak të pikës doganore 1 edhe 31 është rritur në 1.2 miliardë, do me thënë, po t'ia shtojmë edhe këtë shifër, e shohim se sa interesant është tregu i Kosovës për ndërmarrjet e Serbisë, andaj po them, të heshtim, të rimë duarkryq, mendoj se po dëmtohem më shumë.

Unë edhe një çështje tjetër do ta ngritsha këtu, që shihet ashikare se është e pranishme - luftimi i kontrabandës, sidomos prej institucioneve ndërkombëtare në Kosovë, që e kanë në hall, e kanë eksperiencën, siç po shihet, siguria e Kosovës apo lufta kundër korrupsionit dhe kontrabandës është futur në pazar me sigurinë e Kosovës, sepse këta daitë të cilët janë të involvuar në kontrabandë, me... garantojnë sigurinë në Kosovë dhe, siç po shihet, për momentin siguria është më në interes për institucionet ndërkombëtare se sa që është luftimi i korrupsionit, po se sa do të zgjasë kjo, jam shumë skeptik.

Unë po them edhe një herë, më falni se edhe kjo është me interes t'ia rikujtoj Qeverisë, se më 15 korrik 2008, është bërë pyetja nga ana ime për pikat 1 dhe 31 dhe ministri i Ekonomisë dhe Financave, zoti Ahmet Shala, ja se çka thotë, do ta lexoj. Do me thënë, kjo është më 15 korrik 2008, thotë: Hapat konkrete në këto 2 – 3 javë të ardhshme, 2008 është, një vit e gjysmë gati. “Në këto 2 – 3 javët e ardhshme janë rivendosja e kamerave, të cilat ishin shkatërruar nga djegia dhe kemi alokuar buxhetin e tjera. Hapi tjetër është Ligji mbi procedurat e administratës tatimore, administrata do të ketë më shumë fuqi, e cila, do me thënë, ligji do të aprovohet në shtator të vitit të kaluar, të gjitha këto, kjo është në interes, të gjitha këto, ne jemi të vetëdijshëm se së shpejti do t'i fusim në kontroll pikat

doganore 1 dhe 31 dhe ky premtim është dhënë nga Qeveria më 15 korrik 2008. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pak e kalove kohën, por ne jse. Deputeti i fundit për sot, për këtë pikë të rendit të ditës është deputeti, Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritarë,

Po debatojmë sot për sektorin e tregtisë, për gjendjen e rëndë në këtë sektor, për bilancin negativ me përmasa shqetësuese të këmbimeve tregtare të vendit tonë, për ambientin e vrazhdë dhe tejet të pafavorshëm për prodhuesin kosovar, për politikat fiskale dhe kreditore diskriminuese, për marrëveshjen e CEFTA-s dhe për bojkotin e prodhimeve të Kosovës nga ana e disa vendeve të rajonit.

Lidhur me këtë çështje, me kërkesën e Grupit Parlamentar të LDD-së, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka dërguar një draft material, i emëruar si - Politikat tregtare të Kosovës.

Zoti ministër, është ky një draft tejet i varfër që merret me përshkrimin e gjendjes, me konstatimin se gjendja është e rëndë dhe komplekse, që është e njohur për të gjithë ne. Një draft që nuk ka analizë të mirëfilltë, as statistika zyrtare dhe që bien ndesh me Kornizën afatmesme të shpenzimeve 2009 – 2012.

Për plan veprimi konkret qeveritar, për plane konkrete në fushat sektoriale as që bëhet fjalë, kurse strategjia nacionale e Kosovës për politikat tregtare, këmbimet tregtare dhe tregtinë e jashtme, liberalizimin dhe strategjitë për negociata për anëtarësim në OBT, janë ende shumë larg ose në mënyrën dëshirore.

Zoti ministër, cili është niveli i investimeve të huaja direkte, sidomos në këtë vit? Ekonomia e zezë po e dërmon sektorin e tregtisë në vend me mbi 30% të bruto produktit vendor ose me mbi 700 milionë euro në vit, është ky konstatim i dokumentit që ju na e keni sjellë në Kuvend.

Pse me Marrëveshjen e CEFTA-s ende prezantohemi si UNMIK-Kosovo dhe jo si Republikë e Kosovës, ku është parimi i reciprocitetit politikave të marrëveshjeve të tregtisë së lirë dhe marrëveshjen së CEFTA-s, pse po bojkotohen prodhimet dhe prodhuesit kosovarë, pse nuk merrni masa mbrojtëse si institucione të një shteti të pavarur, pse nuk keni përgjigje me masa institucionale ndaj vendeve që bojkotojnë prodhimet tona dhe nënçmojnë prodhuesit dhe shtetin tonë? Deri kur do të zgjasë kjo gjendje agonie për prodhuesin kosovar, askush nuk e dinë përgjigjen.

Në faqen 15, te tregjet potenciale për prodhimet, në dokumentin që ju na keni sjellë, thuhet haptas që do të ketë rritje deri në vitin 2012 për 50% të eksportit, por që bie ndesh me kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe nuk ceken produktet se kush do ta rritë eksportin e prodhimeve vendore.

Pastaj, te anëtarësimi në OBT, në faqen 23, po e citoj dokumentin - Qasje pro aktive në të gjitha politikat sektoriale, që na mungojnë në strategji të politikave sektoriale, por duhet ta keni në mendje që edhe vendet anëtare të OBT do t'i kenë qasjet e veta dhe vërejtjet e veta kur të fillojnë negociatat e mundshme me organizatën botërore të tregtisë.

Zotëri ministër, cilat janë politikat që ndihmojnë dhe subvencionojnë sektorin e bujqësisë dhe të agro-prodhimeve në Kosovë, çfarë konditash të kreditimit kemi sot në Kosovës për bizneset kosovare, çfarë hapash konkret kanë ndërmarrë Qeveria për subvencionimin e sektorit të bujqësisë, të formës së politikave të kutisë së gjelbër, pse nuk kemi dëgjuar si deputetë dhe institucione që 20 muaj të kësaj qeverie për një trupë koordinuese qeveritare për hartimin dhe koordinimin e politikave të tilla ndërsektoriale, sepse pa politika të tilla, pa strategji të tilla sektoriale nuk pranojnë as që ta hapim debatin e negociatave për anëtarësim në OBT. Cila është gjendja e industrisë në vend, në veçanti të sektorit të minierave dhe mineraleve, që janë kritere të rëndësishme për negociim për anëtarësim në OBT, bashkë me bujqësinë dhe agroproduktet?

Për fund, zoti ministër, duke konstatuar një gjendje të rëndë të sektorit të tregtisë dhe fushave sektoriale të ndërlidhura ngushtë me të, e në veçanti të bujqësisë dhe të industrisë, që kanë impakte direkte në rritjen e bruto produktit vendor, zbutjen e papunësisë dhe varfërisë enorme në vendin tonë, ju rekomandoj që të ndërmerrni këto hapa konkretë:

1. Rishqyrtim detal dhe përmbajtjesor të politikave tregtare të vendit, bazuar në statistika dhe parametra të besueshëm;
2. Të formohet një grup ekspertësh vendorë dhe ndërkombëtarë, kredibil dhe me një mekanizëm multidisiplinor qeveritar, që do të fillonte hartimin e një strategjie nacionale të politikave tregtare të vendit pas vlerësimit të të gjithë sektorëve ex ante;
3. Analizë të kornizës ligjore për këtë sektor dhe fushat tjera sektoriale, përfshirë plotësimin, amendimin dhe hartimin e legjislacionit adekuat;
4. Zbatim në tërësi të legjislacionit ...

KRYETARI: 5 minuta i ka shefi i grupit tuaj parlamentar, fjalën përfundimtare. Lulzim Zeneli e ka fjalën. Cili e thatë fjalën përfundimtare, në emër të Grupit? Urdhëro, thuaje!

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Një gjë është e sigurt se atë çka prezantoi ministri, ishte vetëm nëse mund ta quaj një fjalë popullore - vajtim apo konfirmim i asaj që gjendja është e rëndë, mirëpo në anën tjetër nuk shprehu apo nuk tha diçka konkrete në këtë Kuvend se çka është duke bërë Qeveria e Kosovës në ndryshim të kësaj politike aktuale, në ndryshim të realitetit.

Një gjë është shumë e sigurt se çka është duke u ndërmarrë në drejtim të përmirësimit të faktorëve që do ta ndryshojnë pozitën tregtare të Kosovës me vendet fqinje, këtë nuk e tha ministri.

Ministri u thirr në statistika për të cilat për deputetë të Kuvendit të Kosovës janë të njohura për arsye se dikush tjetër i përgatit dhe, fatmirësisht, në mënyrë periodike informon institucionet e vendit, ai është Enti i Statistikës. Mirëpo, ajo çka është dash ministri të përgjigjet në pyetjet të cilat i ka marrë muaj më parë, ka të bëjë - cilat janë masat konkrete të Qeverisë së Republikës së Kosovës për t'ju kundërvë bojkotit që po ju bëhet prodhimeve kosovare, për t'ju kundërvë një politike të disfavorshme që po aplikohet në raport me Kosovën, në raportet e këmbimit tregtar.

Nëse ta quajmë se ministri ka sjellë një dokument, atëherë unë nuk di se në qoftë se një dokument që i sillet Kuvendit të Kosovës dhe përshkruan në mënyrë shumë të qartë atë çka dominon në punimet shkencore të autorëve të huaj, se si definohet liberalizimi i tregut të lirë, duke i cituar edhe autorët shifër, unë nuk di se si mund ta quaj politikë operacionale nga ana e Qeverisë së Kosovës në raport me temën që po e diskutojmë.

Në fund, zoti Kryetar, vetëm dy çështje të cilat konsideroj se duhet të adresohen nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

E para, ka të bëjë me zbatimin e parimit të reciprocitetit me të gjitha ato vende të cilat po i bllokojnë prodhimet, depërtimin e prodhimeve kosovare.

Të rinegociohet marrëveshja në mënyrë të veçantë me të gjitha vendet me të cilat për momentin ekzistojnë raportet e disfavorshme të debalancuara në raport me Kosovën dhe

Të vendoset në kontroll të plotë pika 1 dhe 31 kufitare, në mënyrë që të ndërpriten një herë e përgjithmonë trafiqet ilegale, të cilat po e dëmtojnë buxhetin e Kosovës dhe po e dëmtojnë ekonominë kosovare.

Konsiderojmë se këto tri parime, tri pika, këto tri kërkesa në qoftë se do të vihen në shprehje, atëherë realiteti mund të ndryshojë nëpër masa pozitive për arsye se një gjë është shumë e sigurt. Në qoftë se vazhdohet me politika të inferioritetit në raport me gjithë këtë që është duke ndodhur, atëherë nuk mund të presim ndryshim të gjendjes dhe nuk mund të presim se do të ndryshojnë raportet tregtare të Kosovës me vendet tjera.

Prandaj, një temë e cila po e rëndon ekonominë kosovare, po i rëndon prodhuesit kosovarë, në Kuvendin e Kosovës fatkeqësisht nuk është trajtuar me seriozitetin çfarë e meriton kjo temë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Me këtë mendoj që kjo pikë e rendit të ditës përfundoi. Konstatoj se vërtet debati ishte mjaft përmbajtjesor, por dua ta them që edhe informata që ka sjellë ministri, ishte mjaft e plotë. Ministri ka sjellë një informatë mbi bazën e mundësive që i ka Kosova dhe institucionet e saj, në këtë rast edhe Ministria. Sigurisht që dëshirat edhe të ministrit dhe të Qeverisë janë më të mëdha se sa që janë këto mundësi që janë, por megjithatë sigurisht që ministri dhe ministria, por edhe Qeveria do t'i ketë parasysh të gjitha ato mundësi që i ka në dispozicion për t'i shfrytëzuar edhe të gjithë këto diskutime që në një masë ishin përmbajtjesore. Natyrisht, në diskutime gjithnjë ka dëshira më të mëdha se që ka mundësi. Ne i kemi dëshirat, Ministria i di mundësitë e veta, kështu që për sot e mbyllim këtë pjesë të seancës, për të vazhduar nesër në ora 10,00. A jeni dakord? Nesër, në ora 10,00.

E premte, më 13.10.2009, ora 10:00

Vazhdimi i punimeve të seancës plenare

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra,
I nderuar Kabinet qeveritar,

Vazhdojmë punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar me 12 tetor 2009, për pikat e mbetura.

Konstatohet se në sallë janë të pranishëm 83 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punën.

Vazhdojmë me debatin për pikën e 8-të të rendit të ditës. Po, jemi në vazhdim të seancës. Ta kryejmë këtë seancë, pastaj vazhdojmë tjetrën. Nëse keni ndonjë çështje ta shtroni, e shtroni në seancën e re, që e vazhdojmë. Po mendoj se nuk është nevoja të ndërhyjmë në seancë. Kemi tri kërkesa- të Ramadan Avdiut, të Agim Veliut dhe të Berat Luzhës. Nuk është seancë e re, është vazhdim i seancës.

Vazhdojmë me rendin e ditës. Në seancën e re mund t'i shtroni kërkesat që i keni.

8. Shqyrtimi i Raportit për monitorimin e Ligjit për mbeturinat

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës, ka barë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbeturinat.

Komisioni ka hartuar raportin dhe ka rekomanduar që i njëjti të shqyrtohet në seancë plenare.

Raportin me rekomandime iu është shpërndarë deputetëve. Radha për diskutues është. Falën e ka kryetari i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor...

(Reagim nga salla)

KRYETARI: ...Jo, ky është vazhdim i seancës veç me pikën e rendit të ditës.

Kush e do fjalën?

Fjalën e ka Berat Luzha.

BERAT LUZHA: I nderuar, zoti Kryetar!

Zoti zëvendëskryeministër,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Duke u bazuar në Rregullën 53 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në kuadër të fushëveprimit të vet ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për mbeturina dhe i ka identifikuar problemet mjedisore.

Ligji për mbeturina është miratuar më 22 korrik 2005, kurse ka hyrë në fuqi më 5 maj 2006. Komisioni ka vendosur më 14 prill të këtij viti të mbikëqyrë zbatimin e këtij ligji për çka ka formuar grupin punues prej 5 anëtarëve.

Me qëllim të mbledhjes së të dhënave për nivelin e zbatimit të ligjit, Grupi punues ka zhvilluar veprimet e nevojshme, vizita nëpër komuna, vizita në ndërmarrjet publike, takime pune me strukturat komunale, dëgjim publik kuvendor, grumbullim materialesh nga qarqet e interesuara e tjerë.

Vizitat e Grupit punues në terren janë shoqëruar edhe nga zyrtarë të Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, të Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina, të misionit të OSBE-së, të cilët i falënderojmë për ndihmën që na kanë dhënë. Falënderojmë posaçërisht misionin e OSBE-së, i cili mundësoi materialisht dhe ndihmoi profesionalisht mbikëqyrjen e ligjit.

Gjatë punës, Grupi punues ka mbledhur mjaft shënime për lartësinë e zbatimit të ligjit dhe ka identifikuar problemet, të cilat në formë të rekomandimeve ia ka propozuar Kuvendit për shqyrtim dhe për ndërmarrjen e masave konkrete. Duhet theksuar se problemi i hedhurinave në kuadër të mbrojtjes së mjedisit është tejet shqetësues, madje me tendencë të rritjes. Grumbuj mbeturinash dhe deponi të egra apo ilegale gjenden kudo, anës së rrugëve, nëpër lagje e fshatra, pranë shtëpive tona. Përveç problematikës me hedhurinat e përditshme urbane, me të cilën kryesisht është marrë grupi punues i komisionit funksional, kemi edhe probleme të trashëguara të hedhurinave me materie të rrezikshme për shëndetin e njeriut, si në: Mitrovicë, në Kastriot, në Drenas, pastaj kemi ndotje enorme të ajrit në përmasa alarmuese nga makinat, nga termocentralet në Kastriot, nga Ferronikeli në Drenas, nga Çimentorja në Han të Elezit e tjerë. Kemi ndotje pothuaj se të gjitha rrjedhave ujore në përmasa shqetësuese, si dhe kemi ndotjen dhe degradimin e tokës dhe të mjedisit në tërë Kosovën, veçanërisht në rrethinën e Kastriotit. Kështu, mund të përfundojmë se administrimi me hedhurina paraqet një gjendje aspak të mirë, apo më mirë të themi një gjendje alarmuese, e cila kërkon reagimin dhe veprimin e menjëhershëm institucional.

Në zonat urbane hedhurinat administrohen në masën rreth 90% , ndërsa në zonat fshatare rreth 20%, që domethënë se fshatrat janë shumë pak të mbuluara me shërbim.

Në tërë Republikën, grumbullimin dhe bartjen e hedhurinave e bëjnë 7 ndërmarrje publike rajonale, kurse në një masë të vogël janë të angazhuara edhe 10 kompani private. Pas luftës, Agjencia Evropiane për Rindërtim ka ndërtuar deponi rajonale, të ashtuquajtura sanitare, për mbeturina urbane në: Prizren, në Gjilan, në Kastriot, si dhe një deponi kaluese në Ferizaj, të cilat administrohen nga kompania për menaxhimin e deponive të mbeturinave, shkurt KMDM e quajtur shkurt me akronimin anglisht si KLMS, e cila vepron në kuadër të Qeverisë, përkatësisht të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave. Pa deponi sanitare kanë mbetur ende komunat e rajonit: të Mitrovicës, të Pejës, të Gjakovës e tjerë.

Në Kosovë ende nuk bëhet klasifikimi i hedhurinave, përpos hedhurinave nga metalet, të cilat grumbullohen kryesisht nga persona të paautorizuar, kurse ndërmarrjet nuk kanë as të drejtë ligjore t'i dërgojnë hedhurinat për riciklim.

Problemet për administrimin e hedhurinave janë grumbulluar me vite e dekada. Njëri nga problemet kryesore që rëndon gjendjen e përgjithshme në trajtimin e hedhurinave është shkalla e ulët e arkëtimit, që sillet nga 20 deri 50%. Për ta ngritur këtë shkallë, kërkohet krijimi i mekanizmave mbështetës dhe të atyre detyrues, si dhe kërkohet zbatimi i gjobave për ndotësit. Kjo shkallë e ulët e arkëtimit krijon vështirësi në mënyrë zinxhirore për funksionimin e ndërmarrjeve që trajtojnë hedhurinat si dhe problemet mjedisore.

Në këtë mënyrë pamundësohet veprimi i ndërmarrjeve për grumbullimin, bartjen dhe trajtimin e mëtejshëm, krijohen deponi ilegale, hedhen mbetjet vend e pa vend, kryesisht anës së rrugëve, në kënde të vendbanimeve, në afërsi të shtëpive e tjerë. Për shkak të

borxheve të ndërmarrjeve regjionale, shpesh vjen deri te mbyllja e deponive dhe kështu krijohet gjendje kaotike mjedisore nëpër qendrat e banimit. Ndodh që ndërmarrjet publike rajonale të paguajnë më shumë për deponimin e hedhurinave se sa që arkëtojnë mjete nga qytetarët. TVSH-ja atyre u llogaritet, jo në masën e arkëtimit si do të duhej të ishte, por në bazë të faturimit, që krijon borxhe joreale dhe të pambuluara në afarizmin e tyre.

Në disa komuna, edhe pse nuk janë të parapara me ligj dhe nuk janë të licencuara, janë të angazhuara me kontrata kompanitë private për grumbullimin dhe bartjen e hedhurinave. Ndërmarrjet për administrimin e hedhurinave, përpos me problemet e arkëtimit dhe të borxheve të papërbalueshme, përballen edhe me problemin e mekanizmit të pamjaftueshëm, jo përkatës dhe të stërvjetruar. Komuna e Hanit të Elezit nuk është e mbuluar fare me shërbimin mjedisor. Deponitë janë niveli i dytë i administrimit të hedhurinave. Edhe pse disa prej tyre janë moderne, të ndërtuara viteve të fundit sipas standardeve më të larta, të quajtura edhe deponi sanitare, tashmë ndodhen në gjendje mjaft të rëndë të funksionimit dhe paraqesin ndotje enorme të mjedisit.

Rrjedhja e ujërave nga ato, qofshin mbitokësore apo nëntokësore dhe pastaj ndotja e rrjedhave natyrore të ujërave, ndotja e tokës dhe e ajrit pranë tyre, paraqesin problem jetik për lagjet apo fshatrat në afërsi të drejtpërdrejtë. Deponitë nuk mirëmbahen sa e si duhet, hedhurinat nuk sistemohen sipas kriterëve përkatëse, në to nuk ka mekanizëm të mjaftueshëm dhe përkatës, nuk punojnë pompat për riciklimin e ujit, nuk funksionojnë filtrat e ajrit e tjerë.

Operimi në deponi bëhet nga firmat private të kontraktuara nga KMDM-ja. Kompania për menaxhimin e deponive të mbeturinave është një agjenci qeveritare nën kompetencat e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, e cila udhëheq me deponitë e ashtuquajtura sanitare të ndërtuara nga AER-, deponitë e Prizrenit, të Gjilanit dhe të Prishtinës, si dhe deponinë kalimtare në Ferizaj. Ajo, siç është parë, nuk i udhëheq dhe nuk i mirëmban si duhet deponitë e përmendura të cilat gjenden në një situatë vërtet kaotike. KMDM nuk mund të ndërhyjë për përmirësimin e gjendjes së tyre për shkak të mungesës së mjeteve. Ndodhë që kjo kompani t'i mbyllë deponitë për shkak të mospagesës së borxheve që i kanë kompanitë rajonale dhe atëherë krijohet kaos i vërtetë mjedisor nëpër qytete e vendbanime. Edhe KMDM nga ana e saj u ka borxh firmave private që operojnë nëpër deponitë e saj. Është paradoks që kjo kompani, në vend se në Ministrinë e Mjedisit që e përcakton veprimtarinë e saj, vepron në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave.

Ligji për mbeturina është i mirë përgjithësisht, por i paqartë në disa pjesë dhe në masë të madhe i pazbatueshëm. Nuk përcaktohet saktë roli dhe përgjegjësia e komunave, madje mund të themi se komunat nuk kanë fare kompetenca dhe përgjegjësi për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Në ndërmarrje publike ato përfaqësohen vetëm me anëtarë të bordeve të përbashkëta të komunave të rajonit, kurse anëtarët caktohen sipas madhësisë populluese të komunave.

Komunat e vogla marrin pjesë me një apo edhe pa asnjë anëtarë në bordet e këtyre ndërmarrjeve. Nga ana tjetër, komunat asnjëra prej tyre nuk i ka hartuar planet mjedisore dhe raportet vjetore të përcaktuara me ligj. Nuk përcaktohet as roli i Qeverisë, përkatësisht i dy ministrive të thirrura me ligj të Ministrisë së Mjedisit dhe të asaj për Ekonomi dhe Financa. Edhe Ministria e Mjedisit nuk ka kompetenca dhe përgjegjësi të mjaftueshme, në mënyrë që të veprojë më shumë institucionalisht për mbrojtjen...

KRYETARI: Ju faleminderit! 10 minuta i keni, pra racionalizoni kohën ju lutem. Urdhëro vazhdo, edhe një minutë, por jo më shumë!

BERAT LUZHA: ... Ligji paraqet hallka të shkëputura në relacionet qytetar – ndërmarrje publike – deponi, Zyra e Rregullatorit – Ministri apo Qeveri. Nuk dihet sakët se kush duhet t'i licencojë operatorët dhe kush t'i caktojë tarifat e shërbimit, komuna, Zyra e Rregullatorit apo Ministria e Mjedisit? Ligji ndeshet edhe me disa rregullore që janë në fuqi. Pra, ky ligj kërkon intervenime rreth kompetencave apo ndoshta edhe ndryshim të ligjit në tërësi për shkak se tashmë janë krijuar rrethana të reja dhe disa norma të tij janë të tejkaluara.

Është e nevojshme që sa më parë të nxirret edhe Ligji për deponitë e hedhurinave, ku do të normoheshin çështjet të cilat tash janë të paqarta dhe që paraqesin pengesa në funksionimin e tyre. Për të funksionuar mirë strukturat për mbrojtjen e mjedisit, si dhe për t'u qartësuar kompetencat dhe përgjegjësitë institucionale, duhet ndryshuar dhe plotësuar Ligjin për...

KRYETARI: Përfaqësuesi i Qeverisë, përkatësisht ministri për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, zoti Mahir Yagcilar e ka fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kryetar,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Administrimi i mbeturinave në Republikën e Kosovës është një fushë problematike për mjedisin, e cila është rregulluar me Ligjin për mbeturina dhe me akte tjera nënligjore të cilat dalin nga ky ligj.

Gjenerimi i mbeturinave është drejtpërsëdrejti i lidhur me trendin e konsumit nga popullsia, si dhe me numrin e shtëpive dhe nga aktivitetet që zhvillohen në prodhimtari, industri dhe bujqësi, si dhe përgjithësisht nga performanca e zhvillimit ekonomik të shoqërisë.

Mbeturinat e prodhuara janë të shumëllojshme, ashtu që administrimi i tyre duhet të shqyrtohet nga aspekti mjedisor, teknik, socio-ekonomik, tregtar e të tjerë. Në Kosovë infrastruktura për trajtimin e mbeturinave është ende e pamjaftueshme, gjithashtu administrimi jo i mirë i mbeturinave është ndër problemet me rëndësi të veçantë. Nuk ekzistojnë instalime adekuate dhe të mjaftueshme për trajtimin e mbeturinave dhe në veçanti mbeturinave të rrezikshme. Gjendja e vështirë materiale e popullatës, niveli i ulët i arkëtimit për shërbimet e bëra lidhur me mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave e vështirëson edhe më tepër situatën për administrimin e mbeturinave.

Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, tash për tash është në proces të kompletimit të legjislacionit për mbeturina. Gjithashtu jemi në fazën e hartimit të planit strategjik për mbeturina, por gjithashtu edhe përmes Inspektoratit të Ministrisë mbikëqyr administrimin e mbeturinave nga aspekti mjedisor, ajo nuk i administron kompanitë publike regjionale të mbeturinave. Kompanitë publike komunale të mbeturinave dhe ato regjionale ose të nivelit qendror, më herët kanë qenë nën administrimin e Agjencisë për Privatizim dhe të licencuara nga Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina, kurse

tani janë nën administrimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave ose komunave.

Në Kosovë, sasia e mbeturinave çdo ditë shtohet, kurse infrastruktura për administrimin e mbeturinave ende nuk është e mjaftueshme. Në zonat urbane mbeturinat administrohen nga ndërmarrjet publike dhe janë të mbuluara deri 90%, ndërsa zonat rurale, që paraqesin mbi 60% të vendbanimeve janë shumë pak të mbuluara me shërbim, diku 10 deri 15%, por ekziston një tendencë e ngritjes së përqindjes. Sipas analizave tjera në Republikën e Kosovës prodhohen rreth 05 deri 06 kilogramë mbeturina shtëpiake për banor për një ditë. Mbeturinat tash, jashtë te tjerave, jashtë ekonomive familjare prodhohen në sasi prej 1 deri 1.2 kilogram në ditë.

Sa i përket raportit nga ana e Komisionit për Mjedis dhe Bujqësi, unë mendoj se është një raport konstruktiv i drejtë, kështu që unë së pari dëshiroj të falënderoj për raportin, por gjithashtu dëshiroj të ritheksoj se si Ministri kemi qenë pjesë e hartimit të raportit edhe kemi qenë pjesë aktive, kështu që besojmë se raporti është i pranueshëm dhe gjithëpërfshirës. Por, në të ardhmen, krahas rekomandimeve të propozuara, sigurisht të gjithë së bashku duhet të punojmë në promovimin dhe riciklimin e mbeturinave, në vetëdijesimin e popullatës lidhur me hedhjen e mbeturinave dhe kryerjen e obligimeve sidomos ndaj kompanive shërbyese. Ndoshta duhet të bëhet tatimi shtesë për ambalazhin jo riciklues si qese ta najlonit edhe të tjera. Të përfundohet sa më shpejtë, kërkojmë përkrahje për përfundimin e planit strategjik për mbeturina. Por gjithashtu në të ardhmen, në fazën e përmirësimit ligji sigurisht duhet të harmonizohet edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sepse kanë ndodhur disa ndryshime, sidomos nga aspekti - kompetencat e pushtetit lokal.

Gjithashtu duhet të harmonizohet edhe Ligji për mbeturina me Ligjin për, siç kam cekur edhe me pushtetin lokal, por gjithashtu edhe me Ligjin për Zyrën e Rregullatorit. Gjithashtu, duhet të evidentohen se të cilat janë nenet eventualisht vërtet pengesë për menaxhimin e mbeturinave. Të cilat ligje tjera mund të jenë kufizuese për ndryshime eventuale në Ligj, gjithashtu të cilat janë ato kompetenca ose çfarë vërtetë një krieriarki duhet të bëhet për një menaxhim më të mirë.

Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor prej krijimit ka bërë disa projekte, disa projekte në fushën e administrimit të mbeturinave, janë bërë disa projekte me donacione, sidomos këto deponitë regjionale. Për këtë vitit gjithashtu i kemi bërë disa projekte në sanimin e deponive të vjetra, gjithashtu do të hartohet së shpejti edhe projekti për deponi me materie të rrezikshme. Për këtë vit besoj se janë në përfundim tri projekte për deponitë në materiale sanitare dhe për vitin e ardhshëm do të vazhdohet në projektet e sanimit të deponive me materialet infektive, por gjithashtu deponitë të vjetra. Në të ardhmen, unë besoj që me një angazhim të gjithëve do të kalojmë edhe në fazën e hartimit e impianteve ndoshta edhe më të mëdha për riciklimin e mbeturinave.

Duke ju përshëndetur, unë prapë dëshiroj të ritheksoj se në këtë fushë, duhet një koordinim dhe një angazhim i të gjithëve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër! Tani radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Elheme Hetemi e ka kërkuar fjalën.

ELHEME HETEMI: Ju faleminderit, i nderuar Kryetar!

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah çdo iniciativë të ndërmarrë që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit. Në këtë kuptim e vlerëson kontributin e Komisionit Parlamentar për monitorimin e Ligjit për mbeturinat. Vërejtjet lidhur me moszbatimin e ligjit si dhe rekomandimet e Komisionit i merr si një hap pozitiv për ngritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve, ngritjen e cilësisë së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve.

Në raportin e Komisionit vërehet se vite me radhë ka pasur një menaxhim të keq dhe papërgjegjësi institucionale, duke filluar nga monitorimi i projekteve të deponimeve të ndërtuara para luftës në Kosovës. Si anëtare e Komisionit dhe anëtare e Grupit punues dhe mbështetur në raportin e Komisionit, konstatojmë se jemi të vonuar në marrjen e masave konkrete për sanimin e situatës së krijuar dhe pasojat janë ekonomike, ku për riparimin e këtyre pasojave, kostoja e shpenzimeve është mjaft e lartë. Ndërsa, krahasuar me këtë, pasojat tjera që janë ekologjike, mjedisore dhe që shkaktojnë ndotjen e ambientit nga këto deponi dhe nga mbeturinat e hedhura vend e pa vend që reflektojnë në shëndetin e qytetarëve dhe gjallesave tjera janë të pariparueshme, nëse nuk merren hapa konkret në kohën e duhur. Unë e përshëndes iniciativën dhe masat që i ka ndërmarrë Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor për hartimin e strategjisë të administrimit të mirë dhe menaxhimit të mbeturinave, por kemi një situatë të krijuar në deponitë regjionale në Kosovë, ku nuk premtim koha, dhe pasojat ekologjike që do të ndikojnë në shëndetin e qytetarëve janë çdo ditë e më të vona. Prandaj, një kërkesë e veçantë që duhet të rrjedhë edhe nga Kuvendi edhe nga Komisioni dhe nga qytetarët, domethënë është thirrje edhe e qytetarëve. Te deponia regjionale në Gjilan kemi ndotje të ujit nëntokësor ku ata qytetarë po furnizohen me ujë të pijshëm nga ato zona. Nuk e di sa është e kontrolluar dhe nuk e di çfarë hapash ka ndërmarrë Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor në atë zonë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të LDK-së, Armend Zemaj

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Zëvendëskryeministra,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar shumë me kujdes monitorimin e Ligjit për mbeturinat dhe njëkohësisht vlerëson punën e komisionit dhe të grupit që kanë bërë monitorimin e këtij ligji. Shihet qartë se sipas raportit të ofruar, administrimi i mbeturinave në Republikën e Kosovës është një fushë problematike për mjedisin ku jetojmë, prandaj edhe në raport është paraqitur një gjendje jo e mirë. Edhe pse në zonat urbane mbeturinat administrohen nga ndërmarrjet publike dhe janë të mbuluara pothuaj se për 90%, në zonat rurale mbetet një problematikë shumë më e theksuar, duke marrë parasysh se përbën përmbi 60% të vendbanimeve, ka shumë pak shërbime të mbuluara. Prandaj, ky është ndoshta edhe një ndër problemet kryesore, prandaj ne si Grup Parlamentar shprehim edhe shqetësimin tonë.

Komentet tona, duke marrë parasysh edhe raportin edhe ligjin, shihet qartë se Ligji për mbeturina ka qenë i hendikepuar rënd për shkak të tjetërsimit të nenit 13 të këtij ligji, me ç'rast nuk mundësohet që Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe komunat t'i kryejnë kompetencat e tyre siç është aprovuar ky ligji nga Kuvendi i Kosovës.

E dyta, mos aprovimi i Udhëzimit administrativ për licencimin, administrimin e mbeturinave, është me rëndësi të veçantë për mbeturina dhe ende mungon infrastruktura për përpunimin e tyre. Duke marrë parasysh se këtu është paraqitur, se në deponitë e mbeturinave pranohen mbeturinat e paklasifikuara të të gjitha llojeve, mbeturinat urbane, komerciale bashkë me to edhe mbeturinat me veti të rrezikshme.

Kjo paraqet rrezik drejtpërdrejt në mjedisin dhe shëndetin publik apo shëndetin e njeriut.

Përpos rekomandimeve që ka dhënë grupi punues, në këtë rast, që janë shumë të drejta, drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës, Grupi Parlamentar e sheh të arsyeshme dhe emergjente që Bordi ndërministror duhet që të urdhërojë pagesat e borxheve që t'u bëhet e mundur edhe kompanive private dhe të gjithëve që të zgjidhin këtë çështje e cila paraqitet shumë emergjente.

E dyta, duhet të fillojë procedura që kompanitë e specializuara për menaxhimin e mbeturinave të merren dhe të kenë kompetencat e plota, ndërsa organet mbikëqyrëse të emërohen nga komuna.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike edhe një herë shpreh shqetësim për të gjitha këto probleme të paraqitura dhe një çështje që duhet të rishikohet me kujdes është te plani strategjik për administrimin e mbeturinave ku përfshin periudhën kohore 2010 -2020. Domethënë, paraqitet që do të rishqyrtohet pas 5 vjetëve, ndërsa sipas raportit shihet që 5 vjet do të jenë shumë të vonshme dhe kjo paraqet problem esencial.

Edhe këtu ne kemi një rekomandim që kjo të ketë rishqyrtim emergjent dhe jo rishqyrtim pas pesë vjetëve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Naim Maloku e ka fjalën.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Unë e di që shumë deputetëve dhe personelit të Kabinetit qeveritar kjo temë iu duket paksa jo e rëndësishme dhe diçka e nivelit të ulët tash të merremi, pasi jemi mësuar të merremi me tema të mëdha. Por, unë po ju them se mbajtja e gjendjes së tillë sa i përket menaxhimit të mbeturinave në Kosovë para një kolapsi total, nuk iu bën nder as institucioneve qendrore, as atyre lokale. Ajo i ka dhënë diku rreth 25 milionë euro në ndërtimin e tri deponive më moderne në rajon, ajo regjionale në Prizren, Gjilan edhe në Prishtinë dhe për disa vite ato deponi praktikisht nga mos menaxhimi i duhur i tyre, praktikisht janë të papërdorshme më dhe po shkaktojnë probleme serioze në ndotjen e ambientit, posaçërisht për fshatrat që janë rreth këtyre deponive, Landovica në Prizren dhe disa fshatra rreth deponisë së Gjilanit. Maqedonia nuk e ka asnjë deponi të tillë të ndërtuar deri më sot. Ne mund të shkojmë edhe të shohim se si është gjendja e ambientit në Maqedoni dhe këtu.

Në qoftë se nuk jemi të zotët të organizohemi në 10 mijë kilometra katrorë dhe 2 milionë banorë, t'i menaxhojmë mbeturinat dhe t'i trajtojmë që i prodhojmë vetë, me cilat tema do të merremi ne dhe çka do të themi para të tjerëve? Kjo çështje është shumë serioze me të cilën duhet të merret niveli qendror, lokal dhe të gjithë qytetarët e Kosovës.

Unë propozoj që Kuvendi t'i miratojë këto rekomandime. Përsëritës raportimin e deputetit Berat Luzha, por i sugjeroj Qeverisë që urgjentisht ta ngritë grupin punues

qeveritar të mos them Task-forcë, të përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Financave për shkak se Ministria e Financave e ka nën kompetencë kompaninë për menaxhimin e deponive qendrore në Kosovë, se janë asete qeveritare.

Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor- përfaqësues, për shkak se kompetencë e kësaj Ministrie është monitorimi i zbatimit të Ligjit për mbeturina, Ministrisë së Pushtetit Lokal, për shkak të ndërthurjes së kompetencave – pushtet lokal dhe harmonizimit të kompetencave. Pushtet lokal në nivel qendror dhe normalisht edhe kompanitë të cilat menaxhojnë, pra kompanitë publike të cilat menaxhohen nga komunat për grumbullimin e mbeturinave.

Të nderuar deputetë, nga ajo çka kemi parë në teren, diku rreth 30% e faturave paguhen për shërbimet e pastrimit ose të grumbullimit të mbeturinave, qoftë nga personat juridikë ose fizikë.

Unë jam i bindur që në asnjë vend të BE-së, në qoftë se mos pagesa e faturave nuk do të kishte pasojë për personin juridik ose fizik, nuk do të kishte një përqindje të tillë të pagesave, asnjë individ, person juridik ose fizik për mos pagesë të faturave nuk i nënshtrohet pasojave në Kosovës, pra janë pagesa vullnetare edhe unë jam, ne duhet të jemi tepër të kënaqur me këtë vullnet të qytetarëve të Kosovës për t' i paguar edhe pse është 30%, për t' i pagur faturat për të cilat praktikisht, edhe në qoftë se nuk i paguajnë, nuk përjetojnë kurrfarë pasojash, nuk kanë kurrfarë detyrimi.

Niveli qendror edhe lokal, pra komunat edhe Qeveria duhet të ndërhyjnë në ligje dhe t' i bëjnë që çdo mos pagesë e faturës për personin juridik ose fizik, që nuk i paguan, të ketë edhe pasojë dhe të ketë edhe detyrime. Komuna duhet ta marrë përgjegjësinë në faturimin për shkak se kompanitë publike nuk kanë mekanizma detyrues për t' i detyruar qytetarët ose personat juridikë për t' i paguar faturat.

Çështja është, sipas mendimit tim, shumë serioze, duhet të merremi seriozisht me ambientin, përndryshe jemi para një kolapsi total me këtë nivel të trajtimit të mbeturinave në Kosovë.

Lus Qeverinë që me vëmendje ta shohë transkriptin, ta lexojë dhe t' i përmbahet rekomandimeve dhe kësaj çka po debatohet në këtë Kuvend në lidhje me këtë çështje. Faleminderit, Kryetar!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të AKR-së, deputeti Heset Cakolli, e ka kërkuar fjalën.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Ministra, të respektuar kolegë deputetë,

Ju para vetes keni Raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të mbeturinave, të përgatitur nga Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Komisioni funksional, më 14.04.2009, vendosi të mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për mbeturina dhe ky ligj është mbikëqyrur në pesë faza. Në fazën e tretë komisioni ka paraparë që të vizitojë pesë komuna që korrespondojnë edhe me vendndodhjen e deponive regjionale të mbeturinave.

Komisioni ka vizituar komunën e Prishtinës, të Prizrenit, të Drenasit, të Shtimes dhe të Gjilanit dhe gjatë gjithë vizitave komisioni është mbështetur nga zyrtarët e Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, Zyrës së Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, përfaqësuesit e OSBE-së dhe ndërmarrjeve publike për mbledhjen e mbeturinave.

Gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për mbeturina, Grupi punues ka arritur të mbledh të dhënat e shumta për shkallën e zbatimit të këtij ligji dhe ka arritur të identifikojë shumë probleme të cilat ndikojnë në zbatimin e Ligjit për mbeturina. Dhe, unë me këtë rast po përmend vetëm disa prej tyre.

Nuk bëhet grumbullimi i mbeturinave sipas llojeve, mungon strategjia për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme, mungesa e kapaciteteve administrative dhe inspektuese, nuk bëhet ndarja e mbeturinave infektive nga mbeturinat tjera medicinale, mos përcaktimi i taksës ekonomike dhe participimi nga buxhetet komunale në nivele lokale për grumbullimin, deponimin dhe trajtimin e mbeturinave, si dhe shumë e shumë probleme tjera.

Pra, deri më tani nuk është plotësuar qëllimi i Ligjit për mbeturina, sepse gjendja e mbeturinave në terren nuk vlerësohet e mirë, kryesisht shprehet me prezencën e mbeturinave në hapësira dhe në vende të ndryshme dhe paraqesin rrezik permanent për shëndetin e njeriut, si dhe kohëve të fundit nuk bëhet trajtimi i duhur në deponitë sanitare, siç janë në Prizren dhe Gjilan nga operatorët e kontraktuar, nga KMDK-ja, respektivisht Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë.

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim, Rural Mjedis dhe Planifikim Hapësinor del me rekomandime konkrete për Kuvendin e Republikës së Kosovës, Qeverinë e Kosovës dhe për institucione tjera.

Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re i mbështet në tërësi këto rekomandime dhe kërkon që në afatin sa më të shkurtër të përmbushen të gjitha këto rekomandime nga të gjitha institucionet me qëllim të zbatimit të Ligjit për mbeturina dhe udhëzimet administrative, me të vetmin synim që gjendja e grumbullimit të trajtimit të mbeturinave në trend të përmirësohet.

Unë me këtë rast desha të cek se ka mjaftë udhëzime administrative të cilat rregullojnë fusha të caktuara sa i përket trajtimit të mbeturinave dhe grumbullimit të tyre.

Unë do ta përmendja Udhëzimin administrativ për mbeturina nga bateritë dhe akumulatorët e shpenzuar, Udhëzimin administrativ për administrimin e automjeteve të hedhura dhe mbeturinat e tyre. Këto dy udhëzime administrative mendoj i rregullojnë mjaftë mirë këto fusha për të cilat janë të destinuara, por si duket mungojnë edhe kapacitetet e inspektorëve që kishin për t'i inspektuar këto, për t' i zbatuar këto udhëzime në terren. Për shembull, te udhëzimi për automjetet e hedhura, atje është i paraparë deponimi i vajrave, motorëve, vajrave për ndërrimin e shpejtësisë, vajrave për transmetues diferencial, vajrave për sistem të frenimit, vajrave për sistem drejtimi, domethënë çdo gjë specifikohet dhe me udhëzim administrativ është e paraparë që asnjë automjet nuk guxon të demontohet apo të prehet deri sa nuk bëhet çregjistrimi në organin kompetent. Prandaj, është një fushë mjaft e ndjeshme dhe mendoj që institucionet e vendit tonë duhet t'i qasen dhe të marrin hapa konkretë me qëllim që gjendja në terren të përmirësohet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!
Në emër të LDD-së, Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë mbështet plotësisht raportin e komisionit funksional për mbeturina, duke konsideruar se është një raport i cili në mënyrë eksplicite e adreson të gjithë problematikën sa i përket deponive – menaxhimit, por edhe gjendjes së përgjithshme në kuadër të këtij sektori.

Ajo çka do të duhej sot të përcillet si porosi nga ky debat se në qoftë në një vend demokratik, në një vend ku ka për bazë edhe prioritet shëndetin e qytetarit, ka për bazë dhe prioritet interesin e vet shtetit, çështje të tilla apo debate të tilla duhet të alarmohen dhe duhet të përcillen nga ana e Qeverisë me një seriozitet jashtëzakonisht të madh. Këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me deponi, nuk kemi të bëjmë vetëm me mbeturina të zakonshme shtëpiake, këtu kemi të bëjmë me mbeturina që janë tejet të rrezikshme për shëndetin e qytetarit të vendit. Kolegu parafolës nga AKR-ja e shprehu në mënyrë eksplicite se cilat janë ato mbeturina.

Të nderuar kolegë,
Ajo çka ndodh dhe është prezente në zonat që dikur ishin të njohura për zhvillimin e industrisë, si: Peja, Gjilani, Mitrovica dhe zona tjera, ka mbeturina dhe ekzistojnë sot që janë tejet të rrezikshme. Vetëm një shembull, atje ekzistojnë PSB-të, dikush, profesionistët duhet ta kuptojnë, polikloror- bifenilet janë substanca tejet të rrezikshme. Skandali në Japoni është i njohur edhe për Ministrinë e Shëndetësisë. Prandaj, në qoftë se kjo Qeveri nuk e adreson drejt problematikën e menaxhimit të mbeturinave dhe deponive, që është një konfuzion në legjislacion, atëherë do ta kemi dhe do të përcillet një situatë edhe në të ardhmen. Ajo çka sot kërkohet në rekomandimin e komisionit që në afat kohor prej 6 muajve Qeveria e Republikës së Kosovës të krijojë mekanizma për adresimin e përgjegjësisë dhe respektimin e ligjshmërisë në këtë sektor.

Unë besoj dhe jam i bindur se komisioni funksional pas afatit gjashtëmuor, do ta iniciojë procedurën se sa po respektohen këto rekomandime të Kuvendit. Prandaj, edhe një herë duke përkrahur plotësisht në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, kërkoj nga deputetët e Kuvendit të Kosovës t'i përkrahin këto rekomandime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të Grupit “7+”, deputetja Shpresa Murati e ka kërkuar fjalën.

ŠPRESA MURATI: Hvala, predsedniče!
Pozdrav svima,
Parlamentarna Komisija za poljoprivredu, šumarstvo ruralni razvoj, prostorno planiranje i životnu sredinu, obavila je značajan i ozbiljan rad prilikom poseta na terenu, održanih javnih rasprava i prikupila je dovoljno podataka o nivou sprovođenja Zakona o otpacima.

Funkcionalna komisija predložila je i konkretne preporuke i mere koje treba preduzeti u cilju poboljšanja stanja i efikasnije implementacije Zakona o otpacima.

Naime, čitavo se Kosovo suočava sa problemom dispozicije, odlaganja otpatnih materija različite vrste, oblika i porekla. Naravno, neke opštine i sredine imaju daleko većih

problema od drugih, što smo mogli uvideti i iz zapisnika komisije prilikom poseta određenim opštinama.

Mi iz Prizrena možemo biti zadovoljni, jer je stanje u našem gradu na zavidnijem nivou u odnosu na ostale opštine, ali moramo svi posvetiti više pažnje očuvanju životne sredine svude na Kosovu, a samim tim i zdravlja ljudi.

Trebamo učiniti napore da javna preduzeća pokrivaju veći procenat ruralnih sredina, da se poveća procenat na plativosti usluge u vezi sakupljanja i otpremanja otpadaka i insistirati na upotrebu materijala koji se mogu reciklirati.

Da bismo svi bili odgovorniji kada je u pitanju zaštita životne sredine, od ogromnog značaja su kanznene odredbe, ali nažalost, i pored brojnih odluka od strane Inspektorata za životnu sredinu, nije izrečena nijeda kazna predviđena ovim zakonom.

Neophodna je i bolja kordinacija između Ministarstva za životnu sredinu, Kancelarije regulatora za vode i otpatke i opština.

Parlamentarna grupa „7+“ u potpunosti podržava prepuruke funkcionalne komisija i one koji se odnose na Skupštinu, Vladu i ostale institucije koje se bavu ovom problematikom, naročito one koje se odnose na izmenu i dopunu Zakona o otpacima, u nadi da će svako od nas dati svoj doprinos u sprovođenju ovih preporuka u praksi. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Nga SLS, nuk ka.

Vazhdojmë, deputetë. Deputeti Ibrahim Gashi, e ka kërkuar fjalën. Nuk është. Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Ministra të nderuar,

Kolegë deputetë,

Një nga objektivat e Kuvendit të Kosovës, por edhe një nga çështjet që më së tepërmi është diskutuar në opinion, ka qenë çështja e zbatimit të ligjeve në praktikë. Prandaj, si komisione parlamentare mendoj që jemi në rrugë të mbarë në këtë vit, sepse shumica e komisioneve parlamentare kemi marrë për obligim së paku që disa nga ligjet të cilat i aprovojmë në Kuvend, t'i monitorojmë.

Unë në fillim e përgëzoj komisionin në fjalë dhe anëtarët e komisionit që kanë bërë një punë jashtëzakonisht të mirë rreth monitorimit të Ligjit për mbeturinat, mirëpo meqë ligjet monitorohen për të sqaruar se sa po zbatohet ligji në praktikë, a janë problemet e dispozitave ligjore të cilat janë të paqarta, a janë problemet buxhetore, apo është çështja që shumica e fushave ka mbetur pa u rregulluar me ligj, ndoshta është mirë që në raportet të cilat ofrohen para Kuvendit të Kosovës t'i përcaktojmë qartë.

Është një raport jashtëzakonisht i mirë, mirëpo nëse e lexojmë si raport, e kemi vështirë të konstatojmë a ka shkelje të dispozitave ligjore, apo është një konstatim i gjendjes së përgjithshme për mbeturinat në Kosovë.

Nga ajo që shihet në praktikë, Ministria përkatëse ka nxjerrë shumë udhëzime administrative që ta rregullojë këtë çështje dhe për këtë duhet respektuar, mirëpo nga gjendja që del nga raporti shihet se çështja rreth mbeturinave është çështje shumë

urgjente që duhet intervenuar, sepse në shumicën e rasteve ndoshta çështja nuk është e rregulluar me ligjin që është në fuqi.

Unë do të isha ndalur vetëm te rekomandimet, sepse krejt qëllimi i monitorimit të ligjit është të konstatojmë se sa po zbatohet në praktikë ligji dhe cilat rekomandime duhet t'i aprovojë Kuvendi i Kosovës me qëllim që Qeveria e Kosovës, Kuvendi apo institucione tjera të marrin obligim ligjor që t'i rregullojnë.

Komisioni ka dalë me tri rekomandime. Janë rekomandimet për Kuvendin, rekomandimet për Qeverinë dhe rekomandimet për institucione të tjera. Konsideroj që si komisione nuk kemi nevojë të obligojmë veç e veç, sepse rekomandimet e marrin fuqinë ligjore vetëm pas aprovimit në Kuvend dhe nëse i marrim i shikojmë rekomandimet, po thuaj se janë të ndërlidhura dhe nuk duhet ndoshta t'i aprovojim veçmas, sepse nëse e kemi rekomanduar që Kuvendi i Kosovës, për shembull, ta nxjerrë ligjin, atëherë nga rekomandimet që do t'i aprovojim do ta lirojmë Qeverinë që të mos marrë një iniciativë të tillë. Prandaj, ndoshta e vetmja vërejte që është, është mirë ne t'i votojmë si rekomandime të përgjithshme dhe pa i ndarë në institucione të veçanta, sepse ju e dini që në praktikën parlamentare që e kemi deri më tash, Kuvendi i Kosovës ka marrë vetëm dy – tre nisma ligjore dhe nuk do të kemi mundësi ndoshta vetë si Kuvend i Kosovës të fillojmë as plotësimin dhe ndryshim, por as të nxjerrim ligje.

Prandaj, si deputet e përkrah raportin, por ndoshta është mirë që këto rekomandime t'i votojmë si rekomandime të përgjithshme dhe të votohen si obligim për të gjitha institucionet, sepse ligji është monitoruar se si zbatohet në tërësi dhe jo në pjesë të veçanta nga institucionet përkatëse. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

I patëm veç dy të paraqitur, tash na u shtuan edhe tre. Fjalën e ka deputetja Sala Berisha – Shala, le të përgatitet Gjylnaze Sylja.

SALA BERISHA – SHALA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Menjëherë pas amendamentimit të projektligjeve, mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve duhet të jetë një ndër prioritetet kryesore të komisioneve parlamentare.

Raportin e monitorimit të Ligjit për mbeturina e kam lexuar me vëmendje. Është për ta përsëndetur punën e Komisionit parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim, Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor. Ajo çka dua të them, është se gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për mbeturina komisioni ka arritur të mbledhë të dhëna të mjaftueshme se në çfarë niveli zbatohet ligji dhe në çfarë gjendje kemi ambientin në Kosovë.

Nga ky raport del se në Kosovë gjendja ambientale është më se alarmante. Një situatë e tillë është sidomos në komunën e Drenasit. Kjo shihet edhe në raportin e komisionit në fjalë ku thuhet se komuna është dyfish e brengosur në këtë drejtim, ngase përveç mbeturinave nga qytetarët, Drenasin së tepërmi e ndotin edhe mbeturinat e fabrikës së Ferronikelit. Kështu, mbeturinat industriale të Ferronikelit ndotin shumëfish ujin, ajrin dhe tokën. Ndotja alarmante e ajrit në Drenas shihet edhe me një shembull ilustrativ në raport, ku thuhet se nëse e vëmë një shishe afër fabrikës për 24 orë shihet se gjysma e asaj shishe mbushet me grimca metali. Ky fakt nuk do koment.

Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor duhet urgjentisht ta rishqyrtojë lejen ambientale për Ferronikelin.

Problem numër një në ndotjen e ambientit në Drenas, pra, janë mbetjet industriale të Ferronikelit dhe ndotja që vjen nga fabrika që punon pa filtra në oxhakët e shkrites.

Problem tjetër këtu është se deponia regjionale e mbeturinave është në Kastriot, domethënë një distancë bukur e madhe nga komuna. Këtu rekomandoj të ndërtohet një deponi kalimtare ose transite për shkak të largësisë së madhe nga deponia regjionale e Kastriotit. Për këtë arsye, Drenasi detyrimisht është i obliguar që mbeturinat t'i hedh në deponinë industriale të Feronikelit për ç'arsye ata shpesh kanë probleme dhe refuzohen nga pronari i kësaj fabrike se, siç dihet, ato parcela janë të privatizuara.

Mandej, dihet se ekziston një bord për menaxhimin e mbeturinave dhe kriter për të qenë ose për të pasur një komunë përfaqësues në bord, është numri i banorëve, që mendoj se nuk është kriter i cili do të përfaqësonte çështjen për të cilën po flasim.

Mendoj se duhet të kemi parasysh edhe faktin se cili është rreziku potencial i ndotjes në ato komuna që ta kenë edhe përfaqësuesin e vet në bord. Sidomos rrezik potencial të ndotjes në komuna janë fabrikat, industrinë, siç është rasti me: Kastriotin, Mitrovicën, Drenasin e tjerë.

Përderisa ambienti ka të bëjë direkt me shëndetin, dhe e dyta, mbrojtja e mjedisit është kriter i rëndësishëm për futjen në BE, për një përkujdesje të tillë në këtë drejtim mendoj që obligohemi që të gjithë. Andaj, në këtë rast kërkoj t'i mbështesim rekomandimet e komisionit parlamentar si dhe rekomandimet tjera që dalin nga diskutuesit nga ky debat. Faleminderit, për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla, le të përgatitet Riza Smaka.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Deputetë të nderuar,

Unë dëshiroj të përgëzoj komisionin që ka bërë mbikëqyrjen e një ligji shumë të rëndësishëm për qytetarët e Kosovës, që nga aspekti socio-ekonomik e deri te ai shëndetësor.

Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për mbeturinat ka një rëndësi të madhe për vetë mbrojtjen dhe shëndetin e qytetarëve të Kosovës, prandaj fjalimi im kryesisht do të sillet rreth raportit dhe ndikimit në shëndet.

Po ashtu, dëshiroj të theksoj se e përkrah këtë raport duke marrë parasysh edhe vërejtjet të cilat u dhanë nga deputetët.

Raporti në përgjithësi ka identifikuar problemet të cilat janë gjetur, qoftë ato ligjore apo në praktikë, në terren, po ashtu ka bërë konkludimet dhe rekomandimet lidhur me zbatimin e ligjit. Është e qartë se mangësitë të cilat janë paraqitur, janë mungesa e planit strategjik për administrimin e mbeturinave, pastaj kompetencat jo të qarta në nivelin qendror dhe lokal, qoftë edhe në mes të vetë dy ministrive; Ministrisë së Ambientit dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, si dhe të kompetencave të vetë Zyrës së

Rregullatorit për Mbeturina dhe Ujë, që në një mënyrë e ka monopolin për licencimin e kompanive publike.

Unë kisha shtuar se mungon ndoshta një mbikëqyrje më e madhe e vetë inspektorëve dhe të punës së tyre dhe propozoj që puna e inspektorëve të rritet shumë më tepër në terren. Ndërsa, sa u përket deponive, është e qartë se edhe ato deponi që ekzistojnë, sidomos deponitë sanitare, nuk administrohen si duhet dhe se nuk i kanë të gjitha komunat ose nuk i ka e gjithë Kosova deponitë sanitare.

Tani ngreh shqetësimin sa i përket shëndetit. Meqenëse në deponitë e mbeturinave nuk bëhet klasifikimi i mbeturinave, por futen në të njëjtin vend edhe ato mbeturinat urbane, komerciale, bashkë me ato me veti të rrezikshme, siç janë: vajrat e përdorura, bateritë e ndryshme, mbeturinat spitalore, substancat dhe ambalazhi i substancave të rrezikshme elektrike dhe elektronike, të gomës dhe të plastikës industriale.

Zoti ministër, pyetja ime është se lidhur me vajin disulfurik çka keni bërë, kush e ka porositur, për çka?

Në fund, mendoj se të gjitha rekomandimet të cilat i ka dhënë komisioni, duhet të përkrahen. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar qeveritarë,

Deputetë,

Fillimisht konsideroj se Komisioni kuvendor për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka bërë një punë të mirë dhe bile do të isha angazhuar që edhe komisionet tjera të veprojnë ngjashëm. Ka punuar metodikisht mirë, ka nxjerrë konkluzione reale, mjerisht të sakta. Do të thotë, do të kishim pasur dëshirë të mos ishin të sakta, por janë, madje- madje janë edhe më banale, në realitet.

Do të kisha edhe një vërejtje parimore në punën e komisionit, me qëllimin më të mirë që ndoshta ishte dashur të identifikohen dispozitat e Ligjit aplikativ për mbeturinat, të cilat nuk aplikohen. Do të thotë, kjo është puna primare e komisionit, të identifikohen dispozitat të cilat nuk aplikohen, ose nuk aplikohen ashtu si duhet, si dhe vakuumet juridike, sepse kjo do të ishte punë tepër e dobishme dhe konkrete dhe ndihmëse për Ministrinë dhe për Qeverinë.

Konsideroj se duhet urgjentisht Ligji për mbeturinat të merret në punë dhe të rishikohet me një analizë kritike dhe të amendohet në pikat të cilat duhet të jenë në kompozicion të dispozitave dhe, natyrisht, me këto ndryshime e plotësime do të duhej medoemos që Ministria për Mjedis të ketë më shumë autorizime, më shumë autorizime konkrete në mënyrë që kur është fjala për komunat, të kenë pushtet, autoritet për t'i realizuar dispozitat.

Do të duhej medoemos të bëhet definimi i qartë i autorizimeve, i ingerencave të Ministrisë për Mjedis dhe i Zyrës për Rregullatorin e Ujërave dhe të Mbeturinave, edhe i komunave, krejt në koherencë. Domethënë, të definohet qartë cili subjekt është për çka, taksativisht, sipas enumeracionit, por krejt në koherencë, në mënyrë që të mos jenë ato të ndara, si të them, kjo nuk është me ne e tjera, por krejt të jetë në një funksion integral.

Plani strategjik do të duhej të bëhej, jo është duke u bërë e do të bëhet. Ky është dashur të bëhet menjëherë pas ligjit, bile-bile brenda një muaj , dy, hajde nuk është punë e madhe ajo. Këtu ia adresoj një vërejtje Ministrisë, ju lutem! Kjo punë është dashur të bëhet, s'po them se do të ishte realizuar, ama është dashur të bëhet.

Dhe, planet operative – komunat. Ama tash, me këto ndryshimet e plotësimet që do t'i bëjmë, që të ketë autorizime Ministria që ato komuna në qoftë se nuk i bëjnë planet operative në koherencë dhe në koekzistencë me planin strategjik, atëherë të ketë autorizime për të ndërmarrë masa ligjore.

Me ndryshimet e Ligjit për mbeturinat duhet që edhe policia, ju lutem, të autorizohet. Pra, të autorizohet dhe të obligohet, po edhe inspektoratet përkatëse. Ne duhet të bëjmë edhe edukacion te qytetarët, prej filloristit deri te Universiteti.

Te riciklimi, konsideroj se do të duhej Qeveria, me planin e vet strategjik apo me ndonjë dokument tjetër adapt, të caktojë bonuse, të caktojë subvencione dhe lehtësira tatimore për ato organizata biznesore apo ndërmarrje, si do të quheshin, që do të merreshin me riciklime, se sa di unë, nuk janë produktive, e duhet të jenë se janë në dobinë e ambientit dhe të shëndetit.

Sa u përket tarifave, tarifat do të duhej të ishin unike në Kosovë, një. E dyta, do të duhej ose të inkludoheshin në sistemin tatimor ose ngjashëm me dispozitat e sistemit tatimor të ishin të inkriminuara dhe të sanksionuara, se ndryshe, e tha zoti Maloku, 30% nuk paguhen faturat për higjienë. Kjo është tepër ulët dhe tepër keq. Ju falënderohem!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e merr deputeti Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Nuk është asgjë e re në qoftë se themi se nuk zbatohet Ligji për mbeturinat në Kosovë, sepse një sindrom i tillë, mos të them, një sëmundje e tillë e moszbatimit të ligjeve në përgjithësi ekziston në Kosovë.

Në gjendjen ekzistuese që kemi në infrastrukturën ligjore, Kosova nuk qëndron shumë mbrapa, mirëpo në zbatueshmërinë e ligjeve vërtet qëndrojmë mbrapa. Nganjëherë kemi mbetur rob të normave apo rregulloreve që ka sjellë UNMIK-u, nganjëherë të ligjeve pozitive nga periudha e kaluar e më së paku ka zbatueshmëri të ligjeve që ka aprovuar ky Parlament. Një gjë e tillë qëndron edhe te Ligji për menaxhimin e mbeturinave.

Fakti i ekzistimit të deponive të tipit të vjetër si gropa të mbyllura apo të gjelbra, si njihen me termin “grinfillde” të cilat ishin gati të imponuara nga programet dhe donacionet që kishim nga shtetet e huaja, nuk është zgjidhje për menaxhimin, respektivisht për tejkalimin nga problemi i ndotjes së ambientit. Duhet të kemi të qartë se ato gropa, respektivisht ajo formë e konservimit të mbeturinave dhe tretjes së tyre është e tejkaluar, bile është mënyra e menaxhimit të shekullit XIX dhe shekullit XX të vendeve tjera. Një gjë e tillë na u ka imponuar, sidomos i është imponuar, qoftë pushtetit lokal, qoftë niveleve regjionale. Andaj, mosekzistimi i kapaciteteve për riciklim të mbeturinave dhe përpunimin e tyre, transformimin e tyre në energji elektrike apo forma tjera, faktikisht është diagnoza më e mirë dhe shkaktari më i mirë i cili na mundëson që edhe t'i menaxhojmë më mirë mbeturinat në të ardhmin, andaj të mos presim një menaxhim,

respektivisht një zbatueshmëri të ligjit me gjendjen ekzistuese që kemi në procesin e menaxhimit të mbeturinave.

Sa i përket raportit, raporti është përshkrues, deskriptiv. I mungon elementi i krahasimit midis zbatimit të ligjit në saktësi, në cilat pjesë, dhe realitetit objektiv. Në qoftë se nisemi nga përshkrimi i gjendjes ekzistuese, në çdo fushë mund të gjejmë situata të tilla, veçanërisht në gjendjen e mjedisit në Kosovë. Unë e përshëndes raportin në përgjithësi, mirëpo kërkoj që raportet tjera që bëhen nga komisionet funksionale, të jenë më konkrete, më pak përshkruese dhe të na japin neve rekomandime të qarta, jo ne vetëm si legjislativ çka të vendosim, por ekzekutivit t'i japim orientime të sakta çka të bëjë në atë fushë. Një gjë e tillë i mungon këtij raporti.

Sa për fund, vetëm do të dëshiroja , dhëntë Zoti që këto rekomandime mos të përfundojnë këtu në këtë Kuvend, siç ishte fjala për rekomandimin për menaxhimin, respektivisht rekomandimet që u bënë për shkatërrimin e pyjeve të Kosovës. Pra, ne e aprovuam këtu një rekomandim shumë të qartë si legjislativ, ndërsa në terren kemi gjendjen alarmante në aspektin edhe të menaxhimit të pyjeve, edhe të prerjes së tyre në mënyrë joracionale dhe në anën tjetër edhe të pyllëzimit. Vetë fakti i gjendjes së tillë ekzistuese, qoftë në fushën e mbeturinave, qoftë në fushën në përgjithësi të ambientit, tregon se Kosova është duke e kaluar një periudhë shumë anarkike në këtë fushë. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e merr deputeti Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Më lejoni që ta përshëndes zëvendëskryeministrin Kuçi, ministrat, natyrisht edhe zonjën deputete dhe zotërinjtë këtu deputetë – kolegë,

Të them të drejtën, unë e shoh menaxhimin e mbeturinave si një problem jashtëzakonisht të rëndësishëm dhe kyç, madje po marr guximin ndoshta të tepruar, që nuk mungojnë raste të tilla, domethënë kur kam një guxim të tepruar dhe të pavend, por do të rrezikoj edhe kësaj radhe dhe të them këtu në Parlament se në fakt niveli i civilizimit të një vendi matet në rend të parë nga menaxhimi i mbeturinave. Dhe, ku jemi ne si Kosovë, si shoqëri kosovare këtu, kjo është një pyetje delikate? Natyrisht ne po vijmë nga sisteme totalitare antinjerëzore, qoftë komuniste, qoftë nacional-komuniste, ku ka qenë krejt e pritshme në mbeturina të gjesh edhe gjymtyrë njerëzore. Krejt e pritshme, dhe jo e pritshme, ajo u realizua, fundi i fundit.

Së këndejmi, unë e kuptoj ndoshta ndasinë e shoqërisë kosovare, më mirë të them të institucioneve që e kanë për detyrë menaxhimin e mbeturinave që kërkojnë një kohë më të gjatë deri sa të kalojë nga faza kur kemi pritur të gjejmë gjymtyrë njerëzish nëpër mbeturina, në këtë fazën tjetër të menaxhimit të mbeturinave për të dëftuar civilizimin tonë. Mirëpo, për këtë arsye janë institucionet që t'i përshpejtojnë këto faza, të përshpejtojnë vetëdijen e nënshtetasve të vet. Në këtë aspekt unë kisha të them se, natyrisht, nuk është punë veç e kësaj Qeverie, madje edhe veç e qeverive lokale, po kisha thënë se është një proces pak më i gjatë. Dhe, unë këtu do të rekomandoja që edhe Ministria e Arsimit të merret intensivisht me këtë çështje duke futur edukatën e rreptë në shkollat fillore të fëmijët, duke futur në njëfarë forme edhe reagimin e distancimit me neveri të fëmijëve ndaj atyre, qofshin edhe prindërit, që nuk kujdesen. Unë e kam vesesë, ndoshta është njëfarë lloj frustrimi pa lidhje, nëse më mbetet diçka në dorë s'di ku ta lë dhe ku ta çoj, ndoshta është frustrim, ndoshta s'është në rregull. Unë di kolegje

private që kanë masa jashtëzakonisht të suksesshme në edukimin e të fëmijëve që janë në ato kolegje për menaxhimin e mbeturinave. Tash, për fat të mirë, kemi hapësirë shkollore të mjaftueshme, sepse hapësira e ngushtë nuk ta lejon luksin që të futesh në edukatë dhe gjëra të tilla. Këtu besoj se edhe në këtë aspekt do të duhej vepruar dhe, si tha zoti Luzha, në emër të komisionit, për gjendjen e lumenjve. Zonja e zotërinj, a ka mundësi Kosova të ketë një lumë për të qenë? Në qoftë se themi se jo, s'kemi asnjë lumë për të qenë, e ky është alarmi më i madh për nivelin tonë civilizues. Shikoni çka ndodh me pasojat, në qoftë se s'kemi lumenj asnjë, madje as Lumbardhin në Prizren, absolutisht nuk është më e as nuk ka shanse hë për hë për t'u kthyer, në qoftë se nuk ... Dhe, çfarë janë tash pasojat e këtyre. Për pak kohë ne nuk do të kemi ujë të pijshëm në tërë territorin e Kosovës, përpos në ambalazh. Në vend që të kursejmë me të gjitha forcat dhe ta shënojmë në hartë të Kosovës ku mund të gjesh ujë të pijshëm në ujësjellës, ne sillemi në mënyrë të pakujdesshme. Nuk po dua ta fajësoj askënd këtu, po unë po dua të them, sa më përket mua si deputet i këtij Parlamenti, do të votoja për të gjitha fondet e mundshme që t'i ketë Qeveria ose Ministria përkatëse për menaxhimin sa më të shpejtë të mbeturinave. Zotëri Luzha përmendi edhe kompanitë të cilat nuk kanë para. Shikoni, këtu diçka unë nuk e kam të qartë. Ndoshta çdo gjë është në rregull. Taksa që e marrin ato kompani të huaja, ka qenë enorme, shokuese ka qenë për standardin e Kosovës dhe tash po del se s'kanë para fare as t' i mirëmbajnë ato. Po dua të them se një ndër masat le të mbetet edhe kjo e kontrollit ku po çalon puna. Në qoftë se vërtet mungojnë fondet, atëherë unë e thashë qëndrimin tim. Do të isha në gjendje të përkrah çfarëdo nga pozicionet buxhetore, çfarëdo shume të madhe për t'u marrë me menaxhimin.

Dhe, s'po di, ndoshta kam pasur edhe diçka tjetër të them, mirëpo kryesore edhe një herë po them, është një pasqyrë shumë e keqe, besoni, madje edhe në Prizrenin e bukur për kah peizazhi. Keni për të parë në çdo pjerrinë të dekoruar me qese plastmase. Nuk e keni idenë çfarë neverie zgjon kjo pamje te mysafirët tanë perëndimorë. Nuk e keni idenë! Thuaja se ne jemi mësuar me këto. Ne jemi mësuar me këto, prandaj ka shumë punë për të bërë. Dhe tash, unë personalisht po kaloj bashkë me miqtë perëndimorë pranë atyre ekspozitave plastmase, më vjen marre të flas ndonjë fjalë të mençme, se thotë, dëgjo ti, po lere more, po e sheh në çfarë niveli, e po më shet mend, qe ku e ka qesen e plastmasës, nuk e heq nga pjerrina. Faleminderit dhe po më vjen mirë që u bëra edhe me humor, zoti kryesues. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, për relaksimin që na e krijoi zoti Kryeziu! Fjalën e kërkon deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: I nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Rekomandimet janë shumë të mira sikur të mos mbeteshin në letër, po të veprohej menjëherë. Konsideroj se kjo duhet t'i alarmojë institucionet përgjegjëse, sepse kemi një gjendje kaotike sa i përket menaxhimit të mbeturinave në Kosovë. Kjo u tha edhe nga parafolësit dhe s'dua të shtoj më tepër kurrgjë, veç të mos presim reagime dhe protesta të qytetarëve për të na treguar se çka duhet të bëjmë lidhur me menaxhimin e mbeturinave në Kosovë.

Në Gjilan ka ndodhur një gjë e tillë me qytetarët, sepse deponia është shumë afër vendbanimit, madje kundërmimi i lumit dhe i deponisë është i jashtëzakonshëm, mund të them që është e padurueshme një gjendje e tillë, prandaj është obligim i institucioneve

tona të ndërmarrin masa menjëherë në mënyrë që kjo gjendje të ndryshojë në të mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Ministri Mahir Yagcillar.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti kryesues!

Ka qenë edhe një pyetje, po edhe në disa fjalime, në qoftë se më lejoni. A ka mundësi... Unë krejt këto i kam kuptuar si debat për Raportin lidhur me implementimin e ligjit. Ne ndonjëherë mund ta bëjmë prapë pas 6 muajve raportin për gjendjen e mjedisit. Ne gjithashtu e kemi edhe Raportin për gjendjen e mbeturinave, por unë këtë debat e kam kuptuar si raport për rekomandimet nga implementimi i Ligjit të mbeturinave. Pra, duhet të shikojmë cilat janë ato nene në ligj të cilat pengojnë administrimin e mbeturinave. Dhe, unë e kam deklaruar gjendjen, nuk është mirë. Por, të gjithë duhet të punojmë së bashku, komunat, institucionet tjera ose ministritë, por edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Pra, Ligji për mbeturina ka disa kufizuese, nuk është për ajrin, nuk është për ujin, është vetëm për mbeturina. Në këtë aspekt, unë prapë edhe vetë kam deklaruar, i përkrah rekomandimet e Komisionit. Ne përafërsisht të njëjtat i kemi edhe në gjendjen e mbeturinave në Kosovë, nuk është diçka e kundërt. Gjithashtu edhe vetë kam propozuar të promovojmë, të bëjmë investime në riciklimin e mbeturinave. Ka shumë të interesuar për të investuar, por ndoshta edhe ne vetë e kemi interes nga buxheti i Kosovës të bëjmë disa impiante, atëherë do të bëhet zgjidhja dhe duhet ta bëjmë atë zgjidhjen e sistemit zinxhiror të pagesës. Në qoftë se pagesat nuk fillohen si duhet, atëherë krijohet problemi në atë hallkën e fundit të deponimit të mbeturinave. Sepse hallka zinxhirore duhet të punojë. Prapë edhe unë vetë kam propozuar, dua ta bëj vetëdijesimin më të madh, por për fat të keq para disa muajve kur ka qenë Ligji për mjedisin, ne në Parlament vetë e kemi hequr që të jetë lënda për ambient e detyrueshme, sepse ka qenë propozimi i Komisionit, por Parlamenti ka votuar kundër. Parlamenti e ka hequr propozimin e Komisionit. Në këtë aspekt, vërtet të gjithë duhet të punojmë bashkë, por duhet të bëjmë edhe investime, sepse pa investime në këtë fushë nuk mund të bëhet zgjidhje e mirëfilltë, por duhet të cek se këto investime nuk janë të vogla, kërkojnë mjete goxha shitesë, kështu që unë e kam kuptuar krejt Ligjin, implementimin e ligjit, por unë jam i gatshëm dhe Qeveria është e gatshme për gjendjen e mjedisit, për gjendjen e mbeturinave prapë të bisedojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër. Tash deputetëve po u bie në mend, po paraqiten. Krejt këta janë të rinj tash, normalisht nëse kanë për çka, le të flasin. E ka kërkuar fjalën deputeti Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Sigurisht se është për t'u përshëndetur puna e komisionit për hartimin e këtij raporti me rekomandime dhe, natyrisht, unë e përshëndes edhe punën pararendëse që e ka bërë me raportet e ngjashme për çështje të ngjashme që lidhen me problemet ambientale që i ka Kosova shumë të theksuara. Natyrisht, këtu u thanë shumica e atyre gjërave që duhet të thuhet në këtë rast, përkatësisht që lidhen me këtë raport. Unë u inspirova pak nga zoti Kryeziu me konstatimin e tij të guximshëm se niveli i civilizimit të një vendi matet nga menaxhimi i mbeturinave. Ai e arsyetoi pastaj në mënyrë goxha të elaboruar, e arsyetoi pra atë që e tha, por unë konsideroj se është një pjesë e kësaj problematike që lidhet me problemet sociale, ekzistenciale që i ka popullsia e Kosovës. Dhe, natyrisht mbeturinat në këtë periudhë të mbijetesës të pasluftës janë prioritet i fundit, ndoshta në përditshmërinë e problemeve me të cilat ballafaqohet qytetari i Kosovës dhe natyrisht nëse s'ka një përkujdesje institucionale është problem që të pritet një vetëdijesim i shpejtë i qytetarëve

për të menaxhuar më mirë dhe për të përzgjedhur këtë problem. Unë do të ndalesha tek ajo pjesë, sepse nga sa u tha këtu del se prodhuesit më të mëdhenj të mbeturinave janë kompanitë industriale që realizojnë profit në Kosovë dhe krijojnë mbeturina gjithandëj dhe krijojnë ndotje të madhe të ambientit. Unë vij prej një treve që kolegja deputete - zonja Sala Berisha e potencoi problemin e Feronikelit. Nuk është problem për ta kaluar ndoshta me një diskutim ose me një përmendje sipërfaqësore. Është problem që preokupon 70.000 banorë të Drenasit dhe që zgjidh problemin vetëm të 600 punëtorëve. Dhe tash, çështja a mund të rrimë ne indiferentë nga ndotja që prodhon ky gjigant për atë trevë vetëm e vetëm pse zgjidh problemet e 600 familjeve? Unë bart edhe reagime dhe shqetësime të qytetarëve bashkë me kolegen deputete, ishim në një debat me qytetarët javën e kaluar në Drenas dhe shqetësimet sa vijnë e rriten dhe qytetarët paralajmërojnë forma të reagimit si të them individual dhe kolektiv, pra për t'i dalë përballë këtij fenomeni të keq që po ndodh atje, pra ndotjes gjithnjë e më të theksuar. Natyrisht ligji, u tha këtu dhe komisioni ka konstatuar se ka disa si të them paqartësi në kompetencat lidhur me dhënien e licencave a është Kuvendi, a është Qeveria a është komuna...? Unë mendoj se këtu nuk duhet të jenë pengesë që të merren masa institucionale të ndotësit e mëdhenj, konkretisht të Feronikelit. Nëse në kontratën me rastin e privatizimit të tij janë thënë qartë kriteret në bazë të cilave mund të punojë ai gjigant, atëherë dihen kompetentët, në këtë rast Ministria, prandaj kisha kërkuar prej ministrit që të marrë një veprim serioz ndaj kompanisë, përkatësisht një reagim serioz ndaj kompanisë që ajo të përmirësojë, qysh ta quajmë kushtimisht, performancën e saj ambientale, përndryshe do të thotë dëmi që i shkakton ambientit atje është shumëfish më i madh se profiti që i sjell ajo popullatës. Pra, profiti është tepër i vogël, kur kihet parasysh se aty shpenzohen asete nacionale të pa rikthyeshme, pakompensueshme për Kosovën asnjëherë më. Do të thotë, edhe një herë e mora fjalën, e kisha ndërmend më herët, por s'isha këtu, vetëm e vetëm që ta sensibilizojmë më shumë këtë çështje, sepse do të ndeshemi me një reagim spontan të qytetarëve i cili nuk është i këndshëm as për Ministrinë e as për asnjë institucion të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputetja Vezira Emrush, e ka radhën!

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reć! Pozdravljam predsedništvo i sve koelge poslanike.

Nisam imala nameru da se javljam, medjutim u toku diskusije koju sam jako pažljivo pratila, prvo hoću da pozdravljam izveštaj Komisije i dajem do znanja jedno, javila sam se, najviše me je stimulisao govor gospodina Ekrema to što je rekao da je u Prizrenu, da je Prizren bio jedan od najčistijih gradova. Ja to isto tvrdim da je bio, a da više nije. Isti gospodin je imao dva mandata kao predsednik opštine i nije imao neke konkretne metode i mere za održavanje te čistoće i nivo grada. Hoću da kažem da smo imali jedno veliko nacionalno bogatstvo, kao što je nacionalni park Prevalac, koji je pretvoren praktično u djubrovnik, i to gradjevinski materijal ne samo plastične kese, folije, nego je sada praktično djubrovnik gradjevinskog materijala. Meni je žao, faktor je čovek, nije zakon. Zakone donose ljudi i sprovede ljudi. Samo toliko. Hvala!

KRYESUESI: Hvala! Eqrem, a do t'i përgjigjesh? Eqrem Kryeziu, ka replikë 2 minuuta.

EQREM KRYEZIU: Edhe unë u impresionova edhe më shumë prej fjalimit të zonjës Emrush, më shumë se ajo prej fjalimit tim. Por, desha të them për këtë arsye nuk jam kandidat më për Prizren, se kam dështuar atje, po e pranoj unë dhe ta kam prishur rahatinë atje. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Fjalën e ka kërkuar Arsim Rexhepi! Ju lutem, Arsimi është diskutuesi i fundit, le të përgatitet ta përmbyllë me minutat e vet të fundit, përfaqësuesi i komisionit.

ARSIM REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Raporti nuk paraqet asgjë tjetër pos se një rezultat që është i pritur prej një shoqërie e cila nuk e ka përjetuar iluminizmin dhe nuk ka pasur... Jo, është e vërtetë! Dhe, nuk është faj i saj. Dhe, nuk ka pasur liri për t'i realizuar as individit, as shoqëria. Ky është një rezultat i asaj robërie të pafund që e ka kapluar këtë shoqëri deri para pak kohësh. Dhe, ne nuk mund të kërkojmë të pamundurën nga kjo shoqëri.

E dyta, në situata të tilla sociologjike duhet vepruar sanksioni. Nuk vepron vetëm ligji. Duhet të veprojë sanksioni dhe Qeveria është... Unë i kisha propozuar Qeverisë që të kujtohet për ta vënë në veprim tatimin ekologjik nëpër vendet që kanë një vetëdije të lartë ambientaliste. E keni me Kushtetutë obligimin e tatimit ekologjik. Ky është një propozim imi. Dhe, do të ishte mirë që ne të koncentrohemi kah sanksionet, paralelisht me iluminizmin e shoqërisë, përmes lëndës ambientaliste nëpër shkolla. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Një problem krejt konkret, po duam të bëjmë filozofi, mirë është, po ky është fundi. Përfaqësuesi i komisionit. Kush e thotë fjalën përmbyllëse apo s'ka nevojë? Komisioni nuk shpreh dëshirë që të jap ndonjë fjalë përmbyllëse.

Atëherë, ju lutem, të bëhemi gati. Më jepni numrin e të pranishmëve! Në sallë janë 76 deputetë. I thërras edhe regjinë, edhe deputetët, të bëhen gati që ta votojmë këtë raport bashkë me rekomandimet dhe me ato shtesat e rëndësishme që i kemi nënvizuar gjatë diskutimeve praktiko-filozofike në mbledhjen e sotme.

Ju lutem, regjia, votojmë tash!

A ka kush që voton “për” dhe nuk ka kartelë? Atëherë, janë 4, plus 76, do të thotë, kemi 80 vota “për”, 1 është “kundër”, nuk abstenon askush, konsideroj se me shumicë dërmuese u votuan këto rekomandime.

Unë ju jap pushim gjysmë ore!

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë, vazhdojmë seancën. Është pika e nëntë e rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit Ad-hoc për emërimin e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës**

Komisioni parlamentar ad-hoc ka bërë përzgjedhjen e plotë të të nominuarve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimet.

Propozimet e Komisionit ad-hoc dhe rekomandimet u janë shpërndarë deputetëve.

Sipas radhës, fjalën ia kisha dhënë kryetarit të Komisionit parlamentar ad-hoc, zotit Hajredin Kuçi apo raportuesit të Komisionit.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Komisionit ad-hoc për emërimin e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës të paraqes shkurtimisht rekomandimin që ia kemi dërguar Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Që nga emërimi i Komisionit, Komisioni ka mbajtur 5 mbledhje me radhë duke pasur parasysh zhvillimet e mëhershme, atë që dua të them sot dhe që në fillim, dua të shpreh kënaqësinë time që po dalim para Kuvendit të Kosovës me propozime dhe po ashtu po e them. Njëkohësisht e falënderoj secilin anëtar veç e veç për kontributin që e kanë dhënë në kuadër të Komisionit dhe ajo çka e them deri në ditën e votimit që kemi qenë me votim të fshehtë shumë transparentë para kamerave televizive. Pra, të gjitha vendimet në komision janë marrë me një konsensus të plotë, me një përjashtim kur përfaqësuesi i Partisë Socialiste ka shprehur mendimin ndryshe.

Ne kemi marrë një listë prej 18 emrash nga Komisioni ad-hoc, pra nga Komisioni i Pavarur për Media dhe në atë listë pastaj kemi kërkuar që të plotësohen edhe 2 emra nga komunitetet joshqiptare dhe më pastaj kemi hyrë në procedurën e votimit. Emrat që i kemi përzgjedhur sipas ligjit në fuqi janë këta:

- Zotëri Ali Podrimja,
- Zotëri Aleksandar Janiçijeviq,
- Zotëri Arif Bozaxhi,
- Zotëri Avni Abazi,
- Zonja Lindita Tahiri,
- Zonja Naime Beqiraj,
- Zotëri Rrahman Paçarrizi,
- Zotëri Shemsi Syla, dhe
- Zonja Shukrije Gashi.

Këto janë propozimet që ia kemi rekomanduar Kuvendit dhe besoj se Kuvendi do të japë mendimin e vet.

Krejt në fund, më lejoni të them se atë ditë kur e kemi bërë konstituimin e Komisionit kemi premtuar se do të procedojmë në Kuvend para datës 15 tetor dhe unë jam i bindur se Komisioni ynë ka kryer punën e vet në kuadër të mundësive të tij dhe që nga sot i mbetet Kuvendit që të procedojë më tutje. Faleminderit për mirëkuptim!

KRYETARI: Faleminderit! Radha është e shefave të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, Ramë Buja, apo kush e do fjalën prej juve?

RAMË BUJA: I nderuar, zoti Kryetar!

I nderuar zoti Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

Meqë ka pasur dy shkallë përzgjedhëse ky trup prej 9 vetash, natyrisht se e përkrahim dhe e lëmë që lirshëm të votojnë njerëzit ashtu siç dëshirojnë për këtë trup. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër, anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Grupi Parlamentar i LDK-së ka paraqitur rezervat e tij përmes deklarimit politik më herët sa i përket procedurave dhe mënyrës së përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit.

Duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me një përzgjedhje 3 vjeçare të përealizuar, në dy faza të rëndësishme të vendit, natyrisht që kërkohet nga ne që ta përmbushim këtë kërkesë ligjore. Nën një, në shkallën e parë ka pasur probleme procedurale. Puna jonë në grupin ad-hoc apo puna e grupit ad-hoc ka qenë e përballueshme, sepse procedurat janë zbatuar. Pra grupi ad-hoc ka hasur në shkallën e parë probleme serioze. Selektimi i kandidatëve, i CV-ive, selektimi i listave që është bërë nga ai komision tjetër nuk jep garanci që është përfillur ligji dhe është përfillur kërkesa apo e drejta e njerëzve që këtë pjesë të komisionit që prapë ta marrin deri në fund. Ky është dallimi që ne kemi dashur ta artikulojmë politikisht dhe ta konfirmojmë edhe sot këtu, natyrisht se ne marrim pjesë në proces të votimit. Grupi Parlamentar i LDK-së e ka qëndrimin e vet politik, deputetët votojnë lirshëm, votimi është elektronik, vota është e garantuar, bëhet publike dhe do ta shohim secili, por mbi të gjitha na mbetet që për gjendjen e krijuar në RTK, bordi është organ i vetëm i cili mund ta stabilizojë menaxhmentin, mund të garantojë misionin dhe mund mbi të gjitha të garantojë paanshmërinë për kohën edhe për kohën për të cilën ne po punojmë, vazhdimisht të gjithë bashkë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të AAK-së, Donika Kadaj- Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, Kryetar!

Realisht, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka vendosur që të mos jetë pjesë e një bordi apo tendence të Qeverisë për ta kontrolluar Televizionin Publik. Vetë fakti, që do të thotë në krye të Komisionit ad-hoc ka qenë zëvendëskryeministri, e ky fakt është përmendur edhe në Raportin e progresit, na bën që t'i shprehim shqetësimet tona për shkeljen e ligjit. Nuk do ta votojmë këtë listë, do të thotë, jemi kundër dhe konsiderojmë që Radiotelevizionit të Kosovës i duhet një bord profesional, në një afat sa më të shkurtër kohor. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zonja dhe zotërinj,

Procesi nëpër të cilin kemi kaluar deri sot kur përpara vetes kemi një listë të propozuesve për anëtarë të Bordit të RTK-së kap një periudhë disa mujore, domethënë ka qenë një proces shumë i gjatë dhe shumë i vështirë. Kemi qenë këmbëngulës që të vijmë deri këtu për faktin se ju e dini shumë mirë që ky medium publik – Radiotelevizioni i Kosovës ka afërsisht 3 vjet që funksionon pa bord, përkatësisht me një bord që ka mandat të skaduar. Radiotelevizioni i Kosovës aktualisht udhëhiqet nga një ushtrues detyre si drejtor gjeneral apo i përgjithshëm. Radiotelevizioni i Kosovës dhe menaxhmenti i tij janë që të gjithë ushtrues detyre. Pra, Radiotelevizioni i Kosovës duhet urgjentisht të hartojë politikat prodhuese programore për vitin 2010, të hartojë buxhetin për vitin 2010, duhet të hapë konkursin në qoftë se votohet bordi, sepse bordi ka detyrë të hapë konkursin për menaxhmentin e ri, që thashë edhe një herë drejtohet nga ushtrues detyre.

Duke parë këtë gjendje, ne jo vetëm që jemi vonuar, por unë mendoj që kjo listë që sot ka ardhur këtu duhet të kuptohet nga deputetët e këtij Kuvendi si një çështje që duhet të trajtohet me seriozitetin më të madh. Kemi raportet se mediumet në Kosovës kontrollohen nga politika dhe mundësi më e mirë që të kontrollohet nga politika ky medium me këtë përbërje që e thashë deri tani nuk ka se sa tani.

Grupi Parlamentar i AKR-s kur është çështja te fuqizimi dhe konsolidimi i institucioneve të këtij vendi, të këtij shteti, del mbi interesin partiak dhe mbështet fuqizimin dhe konsolidimin e institucioneve. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, kryetari i Komisionit, Lulzim Zeneli e ka kërkuar fjalën.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Duke konsideruar si esenciale që Kuvendi i Kosovës në bazë të obligimeve dhe përgjegjësi si themelues i institucionit të Radiotelevizionit të Kosovës me ligj, konsiderojmë se edhe këta hapa që i ka ndërmarrë deri më tash, pavarësisht se janë të vonuar, Kuvendi i Kosovës duhet ta përmbushë obligimin e vet dhe ky obligim do të thotë që të kontribuojë me të gjithë mekanizmat që të ofrojë një institucion i cili do të jetë në shërbim të publikut dhe do t'i përmbushë objektivat e parapara me ligj. Në këtë prizëm, Grupi Parlamentar i LDD-së do të marrë pjesë në procesin e votimit, duke konsideruar që si kërkesë e vazhdueshme e këtij Kuvendi ka qenë dhe mbetet që sa më parë të formohet bordi i ri dhe që të jetë në shërbim të objektivave që janë të parapara edhe me ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Xhezair Murati e ka fjalën, shef i Grupit.

DŽEZAIR MURATI: Dozvolite da vas pozdravim predsedniče, i premijera, predstavnike Vlade, kolege,

Mi se sa ovim pitanjem bavimo vrlo intenzivno zadnjih nedelja i meseci. Shvatamo svu bojazan koju iznosi Vlada s obzirom na upražnjeno mesto direktora u Bordu RTK, s obzirom na to da smo pred izbore. Mi smo naše mišljenje iznosili u više navrata i bili prisutni aktivno i u Komisiji za medije i u Ad-hoc komisiji, i u Predsedništvu su iznošena mišljenja unutar grupe. Imamo i jednu, po prvi put moda, podelu s obzirom na to da se negira, šta ja znam, pripadnost nekog člana koji je ili nije, i tako dalje, tako da sam ja danas predlagao prilikom sastanka šefova grupa, što i sada činim, zbog izuzetnog značaja koji je pred nama, zbog odgovornosti, zbog ozbiljnosti, zbog svega i mi smo bili mišljenja da je trebalo za nekoliko dana zakazati jednu sednicu Skupštine na kojoj bi smo ovo razmatrali. Znamo da je 15 oktombar, rekao je zamenik Premijera, takozvani dan D za ovaj problem, ali za nekoliko dana mogli bi smo i ići na kompromis, na to da vidimo što drugi primećuju... nedostaje ono ili ovo, krši se zakon onamo ili ovamo, da vidimo i da mi ukrstimo argumente i da onda sednemo, zašto da glasamo ako se unapred zna recimo rezultat onakav ili ovakav jer nas to kasnije vodi u jedno novo odugovlačenje rešenja ovog problema. Mi ćemo, ako bude sad glasanja, glasati po svojoj savesti unutar naše grupe, ali smo mišljenja da je trebalo napraviti jedan kompromis koji bi išao u prilog rešenja ovog problema. Mislim da je ovo mnogo ozbiljan problem i da bi smo trebali možda za nekoliko dana... jer znamo rezultate ako sada dodje do glasanja. Zašto da dodje do toga i da javnost vidi ipak neodgovornost i neozbiljnost. Mogli bi smo ipak doći do kompromisa, pogotovo izmedju dveju najznačajnijih i najbrojnijih parlamentarnih grupa.

Mi smo takvog mišljenja. Ja u ime naše Grupe to predlažem. Ukoliko dodje do glasanja, mi znači po savesti odlučujemo, ali je ipak najbolje bilo da se održi još jedan sastanak šefova parlamentarnih grupa, gde bi svi bili obavezni da prisustvuju na tom sastanku, da uzmemo odgovornost za rešavanje ovog problema. Zašto? Tako, recimo da ne dolazimo ili neodgovorno ovde da se ponašamo ili da kritikujemo ako nema mesta ili da ostanemo bez kritika ako ima mesta. To je naš stav. Hvala vam!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS a e do dikush fjalën? Nuk ka.

Mendoj se e kemi një deputet që është lajmëruar. Urdhëro, Numan, e ke kërkuar fjalën, por realisht duhet të shkojmë në procedurë të votimit.

NUMAN BALIĆ: Mirë, realisht unë do të flas, pastaj do të shkojmë në procedurë të votimit. Faleminderit, zoti kryesues!

Samo nekoliko riječi da kažem i kao član ove komisije koja se bavila izborom. Smatram važnim da kažem nekoliko principijelnih stvari. Najprije, mislim da imamo potrebu da Radiotelevizija Kosova konačno ima bord i da se zavede malo reda u tu televiziju. Smatram da je to potreba naroda i javnosti Kosova i da treba da se bira bord. To je jedna stvar.

Druga stvar, takodje bih iznio vrlo kratko neke principijelne stvari koje se vežu za izbor, za pripreme, za selekciju i tako dalje. Uprkos odredjenim nedostacima koji jesu bili u ovom slučaju, predsjednik Komisije je dobro vodio, imali smo potpuni konsensus, ljudi su govorili, uglavnom su donešene odluke konsensusom. Naravno da je bilo nedostataka oko pojedinih kandidata, naravno da druge zajednice nisu imale dovoljno dobrih kandidata i dovoljnog prostora, ali osobno mislim da kandidat iz drugih zajednica koji je izabran, kojeg je Komisija izabrala, da treba da dobije poverenje.

Imam jednu rezervu, vezano za jednog kandidata iz većinske zajednice koga su podržavali gotovo svi predstavnici drugih zajednica, koji nije prošao. Mislim to nije bilo u redu, i da je bilo malo političkog navodjenja, ali bože moj, uvijek ima takvih političkih navodjenja. I to je neizbježno da tako ne bude.

Ako je u pitanju Bord, mislim da je važno i da trebamo postaviti ono što je predsjednik Komisije za medije, gospodin Brajšori rekao i molim da ga ponovim, da je vrlo važno da u narednom periodu da se popravi politika na RTK, da se popravi kultura, jer do sada smo proizvodili antikulturu a ne kulturu, da se promjeni odnos prema emisijama o vjeri, o duhovnosti, o mnogim stvarima koje ne smiju da budu tabu-tema i da se naravno obrati posebno pitanje za obaveštavanje i informisanje zajednica, gde sada imamo, recimo u programu na bosanskom jeziku jedan potpuno neprihvatljiv pristup gde se vrši otvorena favorizacija, jedan subjekat na račun drugoga i gde se vrše podvajanja, podele i tako dalje, i tako dalje. Tome se mora stati u kraj, a bez borda to je mnogo teže uraditi.

Zbog svih ovih argumenata, smatram da Parlament treba izabrati taj bord i da Parlament treba kontrolisati i bord i Televiziju, naravno jer trebamo voditi računa oko toga da javni mediji, koji narod plaća, da treba da radi za narod a ne protiv naroda. Dakle, da se glasa. Hvala vam ljepo!

KRYETARI: Faleminderit, megjithatë! Fjalën e ka i fundit, konsideroj në këtë debat, kryetari i Komisionit Ad-hoc, Hajredin Kuçi.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

Unë pas disa debateve që dëgjova, ndjeva të nevojshme të jap disa sqarime, edhe për deputetët, por edhe për opinionin publik.

Ne kemi qenë në Komision 20 veta, besoj se e dini, secili e ka pasur përfaqësimin e vet politik, ndoshta jo në mënyrë proporcionale me fuqinë e votave, por ashtu si është me ligj. Kemi punuar mirë dhe kemi punuar bashkërisht, duke përfshirë të gjitha subjektet politike që janë në këtë Kuvend.

Sa për informim ju them se të gjithë anëtarët kanë marrë pjesë kohë pas kohe, ndërsa në procesin e votimit kanë munguar disa. Mos të harrojmë një, që nënkryetari i këtij komisioni ka qenë zoti Rasim Selmanaj, që e falënderoj publikisht që ka punuar shumë mirë dhe ka qenë shumë korrekt në punën e tij. Po ashtu edhe të tjerët që kanë marrë pjesë edhe nga Lidhja Demokratike e Kosovës, edhe nga Aleanca Kosova e Re, edhe nga Lidhja Demokratike e Dardanisë dhe të tjerët. Kjo përzgjedhje, nëse do t'i hynin veç e veç secili subjekt politik, unë ju premtoj që PDK-ja do ta sillte një listë tjetër, por kjo listë është që nuk i takon askujt veç e veç, por të gjithëve nga pak. Unë ju ftoj që për hir të vënies së rendi do të thosha në RTK, të ikjes së përgjegjësisë ka pasur disa ditë tendenca edhe në opinionin publik që të identifikohet përgjegjësia me një individ ose me një subjekt politik. Zoti Haziri e tha me të drejtë punën e komisionit paraprak, po është mirë ta themi publikisht – të gjitha pengesat nuk kanë qenë dhe asnjë pengesë nuk ka qenë në komisionin që e kam udhëheq unë. Nëse ka pasur pakënaqësi dhe këtë e ka shpreh edhe zoti Xhemajli në Komision, ka pasur në komisionin paraprak, që nuk e menaxhojmë ne, që nuk e menaxhon Kuvendi, por Komisioni i Pavarur i Mediave. Do të thotë në këtë drejtim është mirë të identifikohet përgjegjësia. Unë ju ftoj që secilin si deputet po them, besoj edhe zoti Buja deshi ta thotë të njëjtin qëllim, që PDK-ja nuk e ka asnjë dilemë që do ta votojë këtë, por besoj se edhe partitë tjera politike do ta bëjnë votimin, por lirisht po e themi, vetëm një fjali po e them si individ, unë kisha pas qejf të më dëgjosh Gjylnaze, unë do të dëgjoj pastaj ty deri në mëngjes. Unë vetëm një çështje po e them. Parimisht, duhet të jemi të gjithë korrektë, ta identifikojmë përgjegjësinë kush është ai që në RTK dëshiron të ketë rend ose nuk do që të ketë rend? Po, mirë që po qeshni, por nuk e mendova ashtu. Ju ftoj që të votoni të gjithë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Konsideroj se asnjë vërejtje nuk është se është shkelur ligji në asnjë fazë të tij. Ftoj regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Në sallë kemi 92 deputetë.

Kush është, pa kartela? Sa janë “për” pa kartela? 6.

“Kundër” pa kartela? Regjia, le t'i shënojë.

Kush ka votuar, pa kartelë “për”?

Do të thotë, 55 plus 6, janë 61 vota “për”, 11 “kundër”, 5 abstenime dhe Kuvendi miratoi Bordin për RTK-në, me këtë përbërje:

1. Ali Podrimja,
2. Arif Bozaxhi,
3. Aleksandar Janiçijeviq,
4. Avni Abazi,
5. Lindita Tahiri,

6. Naime Beqiraj,
7. Rrahman Paçarri,
8. Shemsi Sylaj, dhe
9. Shukrije Gashi.

Përcaktimi i kohëzgjatjes së mandatit të anëtarëve të Bordit do të bëhet me lotari publike, në pajtim me nenin 23 pika 4 e Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e dhjetë:

- **Njoftim me Vendimin e Grupit Parlamentar të AKR-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.**

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se Grupi Parlamentar i AKR-së ka vendosur që anëtar në Komisionin për Punë të Brendshme e Siguri në vend të deputetit Shkumbin Demaliaj të emërojë deputeten Suzana Novobrdaliu.

Njëkohësisht, Grupi Parlamentar i AKR-së ka vendosur që anëtar në Komisionin për Buxhet dhe Financa, në vend të deputetit Riza Smaka të emërohet deputetja Suzana Novobrdaliu.

Të nderuar deputetë, me kaq konstatoj përfundimin e punimeve të kësaj seance plenare.

Në orën 14,30 vazhdojmë seancën e re plenare.

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale